

Selim Mehmeti, Lindita Boshtrakaj, Lirije Bytyqi, Haxhere Zylfu, Ismet Potera

PËRVOJAT E PARA NË VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS NË KOSOVË



Qershor, 2018

Selim Mehmeti, Lindita Boshtrakaj, Lirije Bytyqi, Haxhere Zylfu, Ismet Potera

PËRVOJAT E PARA NË
VLERËSIMIN E PERFORMANCËS
SË SHKOLLËS NË KOSOVË

Qershor, 2018



BOTUES:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

PËR BOTUESIN:

Labëri Luzha

KORREKTUES GJUHËSOR:

Bekim Morina

PËRGATITJA TEKNIKE (DIZAJNI):

Gëzim Duzha

SHTYPI:

Shtypshkronja- Printing House “BLENDI”

Përkrahur nga UNICEF, Zyra në Kosovë

Falënderim

Falënderojmë UNICEF-in për mbështetjen e dhënë në realizimin e projektit: Sigurimi i Cilësisë së Performancës së Shkollës në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, dëshirojmë të falënderojmë znj. Kozeta Imami, zyrtare për arsim në Zyrën e UNICEF-it në Kosovë, për ofrimin e përkrahjes në realizimin me sukses të këtij projekti.

Falënderojmë hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës, të angazhuar në këtë projekt, për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në të gjitha fazat e tij, në mënyrë të veçantë për ekspertizën e dhënë në realizimin e këtij studimi.

Ky studim nuk do të mund të realizohej me sukses pa mirëkuptimin dhe përkrahjen e MASHT-it, Inspektoratit të Arsimit, Drejtorive Komunale të Arsimit, drejtorëve të shkollave, mësimitdhënësve, nxënësve dhe të prindërve të përfshirë në këtë studim. Më këtë rast, shprehim falënderim për të gjithë ata që e përkrahën dhe e mbështetën realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij studimi.



PËRMBAJTJA

Falënderimet	3
Abstrakti	7
Abstract	9
Lista e tabelave	11
Lista e figurave	13
Shkurtesat	14

KAPITULLI I: HYRJJA **15**

1.1. Vështrim i përgjithshëm i problemit të studimit	15
1.2. Parashtrimi i problemit të studimit	19
1.3. Nevoja për këtë studim	20
1.4. Qëllimi, objektivat e studimit dhe pyetjet hulumtuese	20
1.5. Rëndësia e studimit	21
1.6. Përkufizimi i koncepteve kryesore	22

KAPITULLI II: QASJA KRAHASUESE E POLITIKAVE, PROCEDURAVE DHE PRAKTIKAVE TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË SHKOLLËS **25**

2.1. Sigurimi i cilësisë në arsimin parauniversitar: politikat, procedurat dhe praktikat në Evropë	25
2.2. Vlerësimi i performancës së shkollës: politikat dhe qasjet në Evropë	29
2.3. Parimet për udhëheqjen e sistemeve për sigurim të cilësisë	36
2.4. Politikat, procedurat dhe qasja ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë	39

KAPITULLI III: METODOLOGJIA E STUDIMIT **48**

3.1. Modeli i studimit	48
3.2. Popullata dhe mostra	49
3.3. Instrumentet e studimit	51
3.4. Procedura e mbledhjes së të dhënave	54
3.5. Analiza e të dhënave	56

KAPITULLI IV: REZULTATET E HULUMTIMIT – PREZANTIMI I GJETJEVE 57

4.1. Përvojat e shkollave në realizimin e vlerësimit të performancës së shkollës	57
4.1.1. Të dhënat demografike të respondentëve në bazë të rolit në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës	57
4.1.2. Informimi dhe përgatitja e institucioneve arsimore për realizimin e VBSH-së	63
4.1.3. Praktikrat e institucioneve arsimore në realizimin e VBSH-së	66
4.1.4. Materialet, trajnimi dhe mbështetja në realizimin e VBSH-së	76
4.1.5. Efektet e para të procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës	82
4.2. Perspektiva e zbatimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës nga këndvështrimet e personelit të shkollës, prindërve dhe nxënësve	90
4.2.1. Pikëpamjet e personelit të shkollës	90
4.2.2. Pikëpamjet e prindërve	96
4.2.3. Pikëpamjet e nxënësve	98
4.3. Përvojat dhe përkushtimi institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës - nga këndvështrimi i inspektorëve të arsimit dhe koordinatorëve të cilësisë në DKA	100
4.3.1. Dokumentet për sigurim të cilësisë dhe vlerësim të performancës së institucionit arsimor/ shkollës dhe zbatimi i tyre	100
4.3.2. Përvoja në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës	102
4.3.3. Planet sektoriale në arsim për përmbushjen e rolit në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës	104
4.3.4. Zbatimi i sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës	107
4.4. Analizë krahasuese e raporteve të vetëvlerësimit	109
4.4.1. Dokumentimi i fazës përgatitore	110
4.4.2. Identifikimi i burimeve të të dhënave dhe përzgjedhja e mostrës për VBSH	111
4.4.3. Përzgjedhja dhe përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave	112
4.4.4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave për VBSH	114

4.4.5. Përshkrimi i gjendjes për tregues të performancës së shkollës dhe vlerësimi në nivel të kriterëve	117
4.4.6. Vlerësimi në nivel të fushave të cilësisë	121
4.4.7. Vlerësimi i performancës së përgjithshme të shkollës	130
4.4.8. Raporti përmbledhës i vetëvlerësimit	134
4.4.9. Përmbledhje e analizës së raporteve të vetëvlerësimit	135
KAPITULLI V: DISKUTIM I REZULTATEVE	138
5.1. Sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë - krahasuar me vendet e Evropës	139
5.2. Përvojat e shkollave në realizimin e vlerësimit të performancës së shkollës	141
5.3. Përkushtimi i institucioneve në zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës	147
5.4. Raportet e vetëvlerësimit të performancës së shkollës	148
KAPITULLI VI: KONKLUZIONE	153
Burimet dhe literatura	160
Shtojcat	165



Abstrakti

Studimi paraqet një analizë të zhvillimeve, të viteve të fundit, në ngritjen e sistemit për vlerësim të performancës së institucioneve arsimore parauniversitare në Kosovë. Studimi është kualitativ dhe kuantitativ, si dhe krahasues e vlerësues. Prezanton politikën, procedurat dhe qasjet për sigurim të cilësisë në sistemin shkollor në Kosovë, krahasuar me përvojat e mira evropiane, si dhe perceptimet e pjesëmarrësve të mbledhura me pyetësorë dhe intervista për informimin me dokumentet dhe materialet e zhvilluara për performancë të shkollës. Gjithashtu, praktikën e realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës, masën e ndikimit të trajnimeve dhe praktikave të tjera mbështetëse për realizimin e procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, efektet e para dhe perspektivën e zbatimit të sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës. Pjesë e rëndësishme e studimit janë raportet e vetëvlerësimit të 39 shkollave të para që filluan të zbatojnë kurrikulën e re në vitin shkollor 2016/2017.

Gjetjet tregojnë se dokumentet kryesore për rregullimin e sistemit për vlerësim të performancës së institucioneve parauniversitare në Kosovë janë në harmoni të plotë me tetë parimet e Bashkimit Evropian për udhëheqjen e sistemeve për sigurim të cilësisë. Ndërsa procesi i vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës në Kosovë, përkundrajt faktit se ka nxitur gatishmërinë e shkollave për të filluar procesin e vetëvlerësimit, ka vënë në lëvizje dhe ka ngritur në masë të madhe bashkëpunimin dhe angazhimin e organeve qeverisëse dhe profesionale të shkollës, përshkruhet me probleme të theksuara në zbatimin e metodologjisë së vetëvlerësimit, si rezultat i mosrespektimit të hapave kryesorë të procesit të vetëvlerësimit dhe kritereve të përcaktuara me udhëzuesit përkatës.

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë dhe instrumenti standard i vlerësimit të performancës së shkollës përbëjnë një risi në përcaktimin e pritshmërive nga shkolla dhe vendosjen e një standardi të ri në sistemin arsimor, siç është vetëvlerësimi i performancës së shkollës dhe planifikimi zhvillimor, por nuk janë përdorur si duhet në procesin e vetëvlerësimit të shkollës dhe në përgatitjen e raportit të vetëvlerësimit. Referuar raporteve të vetëvlerësimit, vërehet një qasje uniforme e vlerësimit të performancës së shkollës, pa përshkrim argumentues të gjendjes në të gjithë treguesit e performancës së shkollës dhe pa një qasje kritike në vlerësim të kritereve dhe fushave të cilësisë së performancës së shkollës, që do të mundësonin orientimin institucional të shkollës për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së saj. Njëkohësisht rezultatet e studimit tregojnë se sistemi për sigurim të cilësisë në Kosovë është duke funksionuar me inversion, për mungesë të përkushtimit institucional për rregullimin e pozitës së koordinatorëve të cilësisë dhe vendosjen e mekanizmave për mbështetje të institucioneve arsimore në zbatimin e ciklit për sigurim të cilësisë.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është promovimi i zhvillimit të kulturës dhe institucionalizimit të sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës, në harmoni me kahet e vendeve të përparuara të Evropës. Për të arritur këtë, rezultatet e këtij studimi adresojnë nevojat për përkushtim më të lartë të të gjitha palëve për zbatimin dhe shfrytëzimin e proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të shkollës për përmirësimin dhe avancimin e cilësisë së arsimit, si dhe për rritjen të nivelit të llogaridhënies dhe të përgjegjësisë.

Fjalë kyçe: Kriteret dhe fushat e cilësisë, menaxhimi i cilësisë, sigurimi i cilësisë, shkolla, treguesit e performancës, vlerësimi i performancës së shkollës.



Abstract

The current study provides an in-depth analysis of the recent developments on the establishment of a system for evaluating the performance of pre-university education institutions in Kosovo. The study is based on qualitative and quantitative, as well as comparative and evaluation methods. It sheds light on policies, procedures, and approaches to quality assurance in Kosovo school system compared to good European experiences. Furthermore, it aims to bring out the perceptions of participants - gathered through questionnaires and interviews - regarding the information on documents and materials developed for school performance. In addition, this study provides enough space for the practices of realizing school's internal evaluation, the impact of the training and other supporting practices for the implementation of the internal evaluation process of school performance, and the first effects and the prospect of implementing the school performance evaluation system. The self-evaluation reports of the first 39 schools that began implementing the new curriculum in 2016/2017 school year are included as well.

The findings show that the main documents for regulating the performance of evaluation system of pre-university institutions in Kosovo are in full harmony with the Eight Principles of the European Union for quality assurance systems. On the other hand, the process of internal school performance evaluation in Kosovo, despite the fact that has encouraged the schools' readiness for commencing the self-evaluation process, and has greatly increased the cooperation and engagement of the governing and professional bodies of the school, is characterized by significant problems in implementing the self-evaluation methodology as a result of not following the main steps of the self-evaluation process, and the criteria set out in the respective guidelines.

The framework for quality assurance of school performance in Kosovo and the standard school performance evaluation instrument constitute a novelty in defining school expectations and setting a new standard in the education system, such as self-evaluation of school performance and development planning. However, these were not used properly in the school self-evaluation process and the preparation of self-evaluation report. Referring the self-evaluation reports, it is noticed a uniform approach to school performance evaluation. Nevertheless, no argumentative description of the situation across all school performance indicators, and no critical approach to evaluating the criteria and areas of school performance quality that would enable the institutional orientation of schools toward quality improvement is given. At the same time, the results of the study show that the quality assurance system in Kosovo is functioning invertedly due to the lack of institutional commitment to regulate the position of quality education coordinators and the establishment of mechanisms for supporting educational institutions in the implementation of the quality assurance cycle.

The main purpose of this study is to promote the development of culture and institutionalization of school performance evaluation system in harmony with the advanced European countries. To achieve this, the results of this study address the need for greater commitment of all parties to the implementation and the use of internal and external school evaluation processes for improvement, and enhance the quality of education as well as increase the level of accountability and responsibility.

Key words: Quality criteria and areas, quality management, quality assurance, school, performance indicators, school performance evaluation.



Lista e tabelave

Tabela 1: Numri i shkollave dhe struktura e përfaqësuesve të mostrës së përfshirë në studim.

Tabela 2: Numri dhe përqindja e stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve të përfshirë në hulumtim, sipas komunave.

Tabela 3: Përshkrimi i rolit të stafit të shkollës në procesin e VBSH, sipas numrit dhe përqindjes së përfshirjes së tyre në hulumtim.

Tabela 4: Përshkrimi i rolit të nxënësve në procesin e VBSH-së, sipas numrit dhe përqindjes së nxënësve të përfshirë në hulumtim.

Tabela 5: Përshkrimi i formave të përfshirjes së nxënësve në ofrimin e të dhënave për procesin e VBSH-së (në numër dhe përqindje).

Tabela 6: Përshkrimi i rolit të prindërve në procesin e VBSH-së, sipas numrit dhe përqindjes së prindërve të përfshirë në hulumtim.

Tabela 7: Përshkrimi i formave të përfshirjes së prindërve në ofrimin e të dhënave për procesin e VBSH-së (në numër dhe përqindje).

Tabela 8: Rezultati mesatar dhe devijimi standard i shkallës së përgjithshme të pajtueshmërisë së personelit të shkollës me informimin dhe përgatitjet e shkollës për procesin e VBSH-së.

Tabela 9: Shkalla e pjesëmarrjes së stafit të shkollës në organizimin e takimeve informative dhe në aktivitete përgatitore të shkollës për realizimin e VBSH-së (në numër dhe përqindje).

Tabela 10: Niveli i pajtueshmërisë së stafit të shkollës lidhur me informimin për detyrat, përgjegjësitë dhe planin e punës së EVV-së (në numër dhe përqindje).

Tabela 11: Rezultati mesatar dhe devijimi standard i shkallës së përgjithshme të kënaqësisë së personelit të shkollës me praktikën e realizimit të VBSH-së.

Tabela 12: Niveli i kënaqësisë së stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve (në numër dhe përqindje) me koordinimin dhe udhëheqjen e VBSH, sipas rolit të tyre në procesin e VBSH-së.

Tabela 13: Niveli i kënaqësisë së stafit të shkollës (në numër dhe përqindje) me koordinimin dhe udhëheqjen e VBSH-së, sipas llojeve të trajnimeve të ndjekura.

Tabela 14: Niveli i kënaqësisë së stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve (në përqindje), lidhur me realizimin e hapave kryesorë të VBSH-së.

Tabela 15: Mesatarja dhe devijimi standard për nivelin e kënaqësisë së stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve me fillimin e zbatimit të masave për përmirësimin e cilësisë së shkollës.

Tabela 16: Rezultati mesatar dhe devijimi standard i shkallës së përgjithshme të pajtueshmërisë së personelit të shkollës me mbështetjen e ofruar në realizimin e VBSH-së.

Tabela 17: Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (në përqindje) për mbështetjen e ofruar me materiale dhe udhëzues për realizimin e VBSH-së, sipas rolit të tyre në koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së.

Tabela 18: Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (në përqindje) për mbështetjen e ofruar shkollave në procesin e VBSH-së me trajnime, informata kthyesë dhe punëtori përcjellëse, sipas rolit të tyre në koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së.

Tabela 19: Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (në %) për mbështetjen e ofruar shkollave nga DKA, sipas rolit të tyre në koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së.

Tabela 20: Përqindjet e përfshirjes në programet e trajnimit të stafit të shkollës që kishin rol në koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së.

Tabela 22: Shkalla e pajtueshmërisë të stafit të shkollës (sipas rolit të tyre në VBSH) me ndikimin e procesit të VBSH-së në motivimin e tyre për kontribut të shtuar në proceset e brendshme për ngritjen e cilësisë në shkollë (në përqindje).

Tabela 23: Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (sipas rolit të tyre në VBSH) me ndikimin e procesit të VBSH-së në mobilizimin e mekanizmave në nivel shkollë për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë (në përqindje).

Tabela 24: Shkalla e pajtueshmërisë të stafit të shkollës (sipas rolit të tyre në VBSH) me ndikimin e procesit të VBSH-së në nxjerrjen në pah të sfidave dhe problemeve që i kanë shkollat karshi proceseve të reja dhe ndryshimeve (në përqindje).

Tabela 25: Shembull i paraqitjes së dëshmive për subjektet e përfshira në VBSH dhe instrumentet e përdorura.

Tabela 26: Shembuj të përshkrimit të gjendjes për tregues të performancës së shkollës në raportet e VBSH-së.

Tabela 27: Forma e përshkrimit të performancës së shkollës në fusha të cilësisë dhe udhëzimet përcjellëse në udhëzuesin për VBSH.

Tabela 28: Shembuj në raportet e VBSH-së të përshkrimit të performancës në fusha të cilësisë së shkollës.

Tabela 29: Forma e përshkrimit në nivel të përgjithshëm të performancës së shkollës dhe udhëzimet përcjellëse në udhëzuesin për VBSH.

Tabela 30: Shembuj në raportet e VBSH-së të përshkrimit në nivel të përgjithshëm të performancës së shkollës.

Tabela 31: Niveli i përmbushjes së kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të performancës së shkollës, sipas hapave kryesorë të procesit të vlerësimit (në numër të shkollave dhe në përqindje).

Lista e grafikëve

Grafiku 1

Niveli i kënaqësisë së stafit të shkollës (në përqindje) me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së.

Grafiku 2

Shkalla e përgjithshme e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (në përqindje) për mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së, sipas tipit të shkollës (SHFMU, Gjinnaz).

Grafiku 3

Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës të përfshirë në hulumtim (në përqindje), për mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së, në ndërlidhje me programet e ndjekura të trajnimit.

Grafiku 4

Shkalla e pajtueshmërisë të stafit të shkollës (sipas viteve të përvojës së punës) me ndikimin e procesit të VBSH-së në motivimin e tyre për kontribut të shtuar në proceset e brendshme për ngritjen e cilësisë në shkollë (në përqindje).

Grafiku 5

Shkalla e përgjithshme e pajtueshmërisë së stafit të shkollës për efektet e procesit të VBSH-së në shkolla, në përqindje dhe sipas tipit të shkollës/ nivelit të shkollimit (SHFMU, Gjinnaz).

Grafiku 6

Shkalla e përgjithshme e pajtueshmërisë së stafit të shkollës për efektet e procesit të VBSH-së në shkolla, në përqindje dhe sipas llojeve të trajnimeve të kryera nga stafi i shkollës të përfshirë në hulumtim.



SHKURTESAT

AP	Aktivet/departamentet Profesionale
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EVV	Ekipi i Vetëvlerësimit
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IA	Inspektorati i Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
ISO	Organizata ndërkombëtare për Standardizim
KC	Koordinatori i Cilësisë
KDSh	Këshilli Drejtues i Shkollës
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KKAP	Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
KSNA	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (UNESKO)
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PBKV	Cikli : Planifiko – Bej – Kontrolllo - Vepro
RVV	Raporti Përmbledhës i Vetëvlerësimit
PISA	Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve
PSAK	Planin Strategjik i Arsimit në Kosovë
PVV	Plani Vjetor i Veprimit
PZhPM	Plani i Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve
PZhSh	Plani Zhvillimor i Shkollës
PZhKA	Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit
SC	Sigurimi i Cilësisë
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
UA	Udhëzim Administrativ
VPSH	Vlerësimi i Performancës së Shkollës
VBSH	Vlerësimi i Brendshëm i Shkollës
VJPSH	Vlerësimi i Jashtëm i Performancës së Shkollës
UNESKO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
ZhPM	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

KAPITULLI I

HYRJE

Ndërtimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë së institucioneve arsimore është nevojë e vazhdueshme. Vlerësimi i performancës së brendshme të shkollës është njëri ndër mekanizmat dhe parametrat më të sigurt për identifikimin dhe diagnostifikimin e çështjeve me rëndësi, të cilat pengojnë ose fshehin treguesit e suksesit të institucionit arsimor.

Në vitet e fundit ka ndodhur një ndryshim në këtë drejtim. Përgatitja dhe përligjja e sistemit për sigurimin e cilësisë, si dhe përgatitja e pakos së instrumenteve dhe udhëzuesve për vlerësimin e brendshëm të shkollës, janë disa nga këto ndryshime të rëndësishme.

Vlerësimi i përvojave dhe i sfidave të para të zbatimit të VBSH-së në shkollat e Kosovës, të përfshira në mostër, paraqet një studim të veçantë ndihmës për vendimmarrësit, për hapat e mëtejshëm në sigurimin e cilësisë në arsim.

Prandaj, studimi kishte për qëllim shqyrtimin e kontekstit dhe zhvillimeve kryesore për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë gjatë e viteve të fundit, me fokus të veçantë shqyrtimin e kontekstit dhe zhvillimeve për vlerësimin e performancës së shkollës, që ndikuan në ndërtimin e sistemit për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në Kosovë. Studimi shqyrton politikat, procedurat dhe qasjet në sigurimin e cilësisë së shkollës, si dhe perceptimet dhe realitetet e ndryshme të pjesëmarrësve të shkollave të përfshira në vlerësimin e brendshëm të shkollës, lidhur me përvojat, mësimet, sfidat dhe mundësitë e zbatimit të suksesshëm të sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës edhe në shkollat e tjera.

1.1. Vështrim i përgjithshëm i problemit të studimit

Sigurimi i cilësisë në arsim paraqet një dimension të veçantë të reformës arsimore të shumicës së shteteve të Bashkimit Evropian (BE), por edhe të shteteve të tjera, të cilat në kuadër të objektivave të tyre kanë në fokus përkrahjen e nxënësve në zotërimin e kompetencave për arsimim të mëtejshëm dhe punësim, zhvillimin shoqëror, inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Njëherësh, për shumicën e shteteve sigurimi i cilësisë në arsim është shqetësim më vete, për shkak të kompleksitetit që ka dhe funksionalizimit të mekanizmave për mirëmbajtje, përmirësim dhe avancim të cilësisë në arsim. Një shqetësim të këtillë e ndan edhe vendi ynë, si rrjedhojë e ndryshimeve të shpeshta të mekanizmave për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar, por edhe faktorëve shoqërorë dhe ekonomikë që e karakterizuan zhvillimin e Kosovës në vitet e fundit.

Në vitin 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016 (PSAK). Me këtë dokument, qasja në arsim dhe cilësia e tij u vunë

në krye të agjendës së zhvillimit të arsimit (Saqipi, 2013), si dhe u sigurua mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë edhe në zhvillimin e Strategjisë për sigurimin e cilësisë në arsim. Sipas raportit të UNESCO-s (2014), përmirësimi i cilësisë dhe të mësuarit ka të ngjarë të jetë më qendror në kuadrin e zhvillimeve globale pas vitit 2015. Një ndryshim i tillë është me rëndësi jetike për të përmirësuar mundësitë e shkollimit për 250 milionë fëmijë, të cilët nuk janë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë, ose të realizojnë veprimet bazë matematikore, 130 milionë prej të cilëve janë në shkollë (Çobaj, 2016).

Zhvillimet për cilësinë e arsimit në vitin 2015 filluan të reflektohen edhe në Kosovë. Fillimisht, me përfshirjen e Kosovës për herë të parë në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA/PVNN). Pjesëmarrja e nxënësve të Kosovës në PISA 2015, nga MASHT-i, u vlerësua si një mundësi për krahasimin e nxënësve tanë, dhe performancën e sistemit arsimor, me vendet pjesëmarrëse. Rezultatet e pjesëmarrjes së parë të nxënësve kosovarë në PISA 2015 nuk ishin të kënaqshme, duke konfirmuar mendimin e aktorëve të arsimit se cilësia e arsimit në Kosovë ka nevojë urgjente që të përmirësohet. Arritshmëria mesatare në shkencë e nxënësve të Kosovës, në PISA, ishte 378 pikë, ose 115 pikë nën mesataren e vendeve të OECD-së. Arritshmëria mesatare në lexim ishte 347 pikë, ose 146 pikë nën mesataren e vendeve të OECD-së, ndërsa arritshmëria mesatare e nxënësve të Kosovës ishte 362 pikë, ose 128 pikë nën mesataren e vendeve të OECD-së (MASHT, 2016).

Para publikimit të rezultateve të PISA-s 2015, MASHT-i filloi hartimin e Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë, 2016-2020, që u zhvillua nga Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje për Zbatimin e Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë, 2011-2016”, financuar nga BE-ja. Qëllimi i projektit ishte të prezantojë një sistem të plotë të sigurimit të cilësisë në nënsektorin e arsimit parauniversitar të Kosovës për të kontribuar në përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultateve të arsimit (MASHT, 2015).

Në ndërlidhje me qëllimin dhe objektivat e strategjisë për sigurimin e cilësisë 2016-2020, MASHT-i, me përkrahjen e projektit ‘Binjakëzimi’, të financuar nga BE-ja, me përkrahjen e GIZ-it, Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe UNICEF-it, filloi me përcaktimin e mekanizmave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e pakos së dokumenteve për sigurim të cilësisë. Një nga masat që MASHT-i e ndërmori ishte miratimi i Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës. Dokumenti u hartua nga IPK-ja, në bashkëpunim me ekspertë vendës dhe ekspertë nga ‘KulturKontakt Austria’, në kuadër të projektit “Sigurimi i cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë”, të financuar nga UNICEF-i dhe MASHT-i. Me këtë dokument synohet mobilizimi i faktorëve brenda dhe jashtë shkollës, që të mundësojnë përmirësimin dhe avancimin e performancës së saj, përmes vendosjes së një kornize të qartë të pritshmërisë nga shkolla, si dhe vendosjes së një standardi të ri në sistemin arsimor, siç është vetëvlerësimi i performancës së shkollës dhe planifikimi zhvillimor përmes qasjes gjithëpërfshirëse (MASHT & IPK, 2016).

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës përcakton: Fushat e cilësisë së performancës së shkollës, kriteret e cilësisë së performancës së shkollës,

treguesit e cilësisë së performancës së shkollës, nivelet e vlerësimit të performancës së shkollës dhe shkallët e cilësisë së performancës së shkollës. Dokumenti Korniza e Performancës së Shkollës paraqet kohezionin e ndërveprimit ndërmjet parimeve kryesore të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Kosovës (KKAP) dhe fushave të cilësisë së performancës së shkollës (MASHT & IPK, 2016). Kjo ndërlidhje është bërë në funksion të masave për zbatimin e Kornizës së re kurrikulare në vend, përkatësisht vendosjes së mekanizmit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies në institucionet arsimore (IPK, 2016d).

Në vitin 2016 u zhvillua edhe Pakoja e Udhëzimeve Administrative (UA) për sigurimin e cilësisë në institucionet arsimore, si: UA për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar; UA për Vlerësimin e Performancës në Institucionet Arsimore; UA për Planin Zhvillimor të Shkollës dhe Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit, si dhe UA për Aktivitet Profesional (Departamentet) të Shkollave. Me Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Performancës në Institucionet e Arsimore, vlerësimi i performancës së shkollës është i detyrueshëm për të gjitha shkollat në Republikën e Kosovës. Sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës përbëhet nga vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi, të cilin e realizon shkolla përmes mekanizmave të saj, si dhe nga vlerësimi i jashtëm, që me dispozita ligjore është përcaktuar ta bëjë Inspektorati i Arsimit.

Sipas pakos së dokumenteve të miratuara për performancën e shkollës, vlerësimi i cilësisë së performancës së shkollës nuk përqendrohet në masat e aplikuara apo investimet në shkollë, por në efektivitetin e këtyre masave, në përmbushjen e funksionit të shkollës, respektivisht avancimit të nivelit dhe të cilësisë së arritshmërisë së nxënësve. Një veçori tjetër e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë është karakteri zhvillimor i tij. Njëkohësisht, vlerësimi i performancës së shkollës i shërben planifikimit zhvillimor të shkollës, por edhe monitorimit të zbatimit të tij nga vetë shkolla. Gjithashtu, do të shërbejë edhe për përcjelljen, monitorimin dhe mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve arsimore nga ana e autoriteteve arsimore. Në këtë kontekst, për shkollën vlerësimi i jashtëm i performancës paraqet bazën për të rishikuar, përmirësuar dhe plotësuar gjetjet nga vlerësimi i brendshëm dhe orientimin për planifikimin zhvillimor të shkollës (MASHT & IPK, 2016).

Në kuadër të pakos ligjore, janë edhe udhëzuesit profesionalë, me qëllim të mbështetjes së institucioneve arsimore, si: Udhëzuesi për Vlerësimin e Brendshëm të Shkollës (IPK, 2016b), Udhëzuesi për Vlerësim të Jashtëm të Shkollës (IPK, 2016d); Udhëzuesi për Udhëheqjen e Zbatimit të Kurrikulës (2016b), Manuali për Sigurimin e Cilësisë në Shkollë ('KulturKontakt Austria', 2016). Me qëllim të përgatitjes së kapaciteteve lehtësuese të procesit të VBSH-së, janë ofruar trajnime për koordinatorët e cilësisë dhe drejtorët e shkollave për udhëheqjen e procesit të sigurimit të cilësisë në shkollë¹ dhe për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës². Shkollat e para të përfshira në procesin e sigurimit të cilësisë ishin shkollat e përfshira në pilotimin e kurrikulës 2013-2015, si dhe zbatimin e kurrikulës në vitin shkollor 2016/2017.

¹ Trajnimet për udhëheqjen e procesit për sigurimin e cilësisë në shkollë janë ofruar nga 'KulturKontakt Austria', në kuadër të Projektit të Binjakëzimit.

² Trajnimet për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës janë ofruar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës,

Zhvillimi dhe miratimi i pakos së dokumenteve të cekura përbën një lëvizje të rëndësishme në kuadër të zhvillimeve për sigurim të cilësisë në arsim. Ky është hapi i parë në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve të shkollave, të cilat tregojnë se çështja e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë po e kthen në fokus zhvillimin e arsimit (Zgaga, 2000).

Procesi i sigurimit të cilësisë në institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Kosovë filloi më herët, kundrejt atij në arsimin e përgjithshëm. Kjo u bë e mundur falë themelimit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (2011) dhe përgjegjësisë së përcaktuar për autoritetin në sigurimin e cilësisë së brendshme dhe të jashtme të AAAP-së. Mbështetje edhe më e madhe u sigurua me rishikimin e Ligjit për Arsim dhe Aftësim Profesional (2013), sipas të cilit për sigurimin e cilësisë: IAAP-të përgatisin raporte vjetore të vetëvlerësimit bazuar në kriteret e përcaktuara nga AKK; Raportet e vetëvlerësimit duhet të publikohen dhe të jenë transparente; Inspektimi i jashtëm kryhet nga inspektorët e MASHT-it; Sigurimi i cilësisë së vlerësimit të IAAP realizohet nga AKK bazuar në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Neni 18, Sigurimi i cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional, 2013).

Janë bërë disa studime kooperative për sigurim të cilësisë në sistemet shkollore të BE-së, derisa studimet e këtilla në Kosovë janë të pakta. Mund të veçojmë raportin e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve mbi rezultatet e hulumtimit të shkollave profesionale dhe qëndrimin të tyre ndaj sigurimit të cilësisë, sipas të cilit sigurimi i cilësisë ka për qëllim përfshirjen e cilësisë së procesit të mësimdhënies, mësimnxënies dhe administrimit, ndërsa raporti i vetëvlerësimit është një prej mënyrave më të mira për të shtuar qëndrueshmërinë e programeve/projekteve, si dhe për të ngritur cilësinë e tyre (AKK, 2014). Një prezantim me i thelluar rreth gjendjes për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë pasqyrohet në kapitullin e dytë të dokumentit të Strategjisë për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë, 2016-2020. Gjithashtu, edhe në raportet për realizimin e PSAK-ut 2011-2016 dhe PSAK-ut 2017-2021 (për vitin e parë – vitin 2017) gjejmë përshkrime lidhur me realizimin e masave dhe aktiviteteve të lidhura me sigurimin e cilësisë në këtë nivel të arsimit.

Në ndërkohë është realizuar hulumtimi Sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë në institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Kosovë, i cili në fokus kishte ndikimin që ka pasur vetëvlerësimi i brendshëm i performancës së institucionit/shkollës në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Hulumtimi tregon se institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional kanë sfida lidhur me procesin e vetëvlerësimit, si të kuptuarit jo të drejtë të procesit të VBSH-së, por edhe rëndësisë së tij në përmirësimin dhe avancimin e vazhdueshëm të performancës së shkollës (Zylfiu, 2017). Gjithashtu, gjetjet e studimit tregojnë se ka munguar mbështetja e shkollave gjatë procesit të vetëvlerësimit përmes monitorimit dhe mentorimit të procesit, realizimit të trajnimeve specifike për zbatimin e vetëvlerësimit, integritit të gjetjeve në planifikimin e zhvillimit të shkollës etj.

në kuadër të projektit me UNICEF-in: Sigurimi i cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë.

1.2. Parashtrimi i problemit të studimit

Sigurimi i cilësisë është një ndër pikat më sfiduese të arsimit parauniversitar në Kosovë dhe i lënë anash. Mekanizmat që ekzistojnë më herët, si Enti Pedagogjik i Kosovës, entet pedagogjike komunale dhe pedagogët në shkolla, u zhbënë në vitin 2000, me një vendim të UNMIK-ut, pa i zëvendësuar me mekanizma të rinj funksionalë (MASHT, 2015). Ndërkohë, brenda katër viteve u krijuan dy struktura arsimore nga niveli qendror, fillimisht Zyrat për Zhvillimin e Arsimit (2001) të vendosura në secilën komunë, të cilat pastaj u zëvendësuan me Zyrat Rajonale për Arsim (2004). Të dy këto struktura të arsimit parauniversitar në Kosovë nuk e kishin përgjegjësi të drejtpërdrejtë sigurimin e cilësisë në institucionet arsimore, por ishin në shërbim të institucioneve arsimore në funksion të sigurimit të cilësisë. Në vitin 2007, Zyrat Rajonale për Arsim u zëvendësuan me Zyrat e Inspektoratit për Arsim, gjegjësisht me Sektorin e Inspektimit në Arsim, si dhe u themelua Instituti Pedagogjik i Kosovës, por detyrat e këtyre dy institucioneve nuk ishin në funksion të sigurimit të cilësisë. Po ashtu, në shtatë vitet e fundit, nga 2012, vërehet një trend i ripunësimit të pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, por veprimtaria e tyre mbetet e pakoordinuar dhe jo e mbikëqyrur nga jashtë. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Ligji për Arsimin në Komuna solli risi edhe në fushën e sigurimit të cilësisë, duke i bartur disa autorizime për këtë fushë nga niveli qendror në atë lokal (MASHT, 2015).

Në vitet e fundit, pas miratimit të Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, 2016-2020, dhe pakos së dokumenteve të tjera për sigurimin e cilësisë dhe performancën e institucioneve arsimore, filloi ndërtimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë, u përcaktuan detyrat dhe përgjegjësitë për secilin nivel, filloi emërimi i koordinatorëve të cilësisë në komuna dhe në shkolla, si dhe ka filluar vlerësimi i brendshëm i performancës së shkollës, fillimisht në shkollat e para që filluan me zbatimin e kurrikulës së re. Me gjithë zhvillimet që kanë ndodhur në procesin e ndërtimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë, procesi doli të jetë me sfida të shumta, si në përcaktimin e koordinatorëve të cilësisë, në nivel shkollë dhe komune, ashtu edhe në ngritjen e kapaciteteve të tyre, në funksionalizimin e ekipeve në nivel shkollë për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës, si dhe në realizimin e vlerësimit të brendshëm.

Për problematikën e këtij studimi, kemi identifikuar katër çështje kryesore për hulumtim të thelluar. Çështja e parë ka të bëjë me analizën krahasuese të politikave, procedurave dhe qasjeve për sigurim të cilësisë në Kosovë me disa vende të BE-së, që të kuptohet konteksti në të cilin ndodhet sistemi ynë i sigurimit të cilësisë; së dyti është e rëndësishme të shqyrtohen raportet e vetëvlerësimit të shkollave që të kuptohet se si reflektohet praktika e shkollës kundrejt udhëzimeve sipas hapave kryesorë për realizimin e procesit të vetëvlerësimit; së treti të eksplorojnë pikëpamjet e përfaqësuesve të shkollave për përvojat e para në realizimin e vlerësimit të brendshëm; dhe së fundi është me rëndësi të elaborohen pikëpamjet e bartësve të procesit të vlerësimit të performancës së shkollës në niveli qendror dhe lokal, që të kuptohet përkushtimi institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës në institucioneve arsimore parauniversitare në Kosovë.

1.3. Nevoja për këtë studim

Me qëllim të shqyrtimit të ndërhyrjeve në ndërtimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë, të analizës krahasuese të trendëve në vendet e BE-së për sigurimin e cilësisë, vlerësimin e performancës së shkollës, si dhe të ndikimeve dhe efekteve të tyre në zhvillimin e arsimit, e konsideruam të nevojshëm një studim tërësor të këtij procesi. Rezultatet e këtij studimi do t'i shërbejnë funksionalizimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Prandaj, studimi përfshin analizën krahasuese të politikave, procedurave dhe praktikave të vlerësimit të performancës së shkollës, përgatitjen e institucioneve arsimore për realizimin e VBSH-së, praktikat e institucioneve arsimore në realizimin e VBSH-së, materialet, trajnimin dhe mbështetjen e ofruar nga institucionet arsimore për realizimin e procesit të VBSH-së, sfidat dhe pengesat e zbatimit të VBSH-së, efektet dhe përvojat e para të VBSH-së, si dhe perspektivën e zbatimit të VBSH-së. Studimi paraqet një tablo të plotë të tërë këtij procesi.

1.4. Qëllimi, objektivat e studimit dhe pyetjet hulumtuese

Qëllimi i këtij studimi është analiza krahasuese e politikave, procedurave dhe qasjeve ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë me vendet e BE-së, shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikës së zbatimit të vlerësimit të brendshëm në shkollat e para (69 shkolla) të Kosovës të përfshira në programin e vlerësimit të performancës së shkollës gjatë vitit shkollor 2016/2017, si mësimet, sfidat, efektet e para të përvojave të vetëvlerësimit dhe rolin e përfaqësuesve të shkollave në këtë proces.

Gjithashtu, ky studim ka për qëllim të nxjerrë përfundime dhe rekomandime për masat që duhet ndërmarrë në përmirësimin dhe avancimin e praktikave të vetëvlerësimit që është synim kryesor i këtij studimi.

Meqenëse ky studim është i modelit krahasues dhe vlerësues, në bazë të qëllimit të studimit dalin tri objektiva themelore të studimit, të cilat konkretizohen përmes katër pyetjeve kërkimore. Objektivat e studimit janë:

Objektiva 1: Të analizohen dhe të përshkruhen ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet politikave, procedurave dhe qasjeve ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë me vendet e BE-së. Lidhur me këtë objektivi, është ngritur edhe supozimi se politikatat, procedurat dhe qasja ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë janë në harmoni me ato të vendeve të BE-së.

Objektiva 2: Të analizohen dhe të përshkruhen ngjashmëritë dhe dallimet e perceptimeve ndërmjet përfaqësuesve të shkollave dhe bartësve të tjerë që kanë rol në procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, lidhur me informimin, përgatitjet, mbështetjen e ofruar, praktikat dhe efektet e para të zbatimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës, si dhe nivelin e përkushtimit institucional në konsolidimin dhe funksionalizimin e plotë të sistemit për vlerësimin e performancës së shkollës në Kosovë.

Lidhur me këtë objektiv kemi ngritur supozimin se ka dallime në perceptimet e përfaqësuesve të shkollave dhe bartësve të tjerë që kanë rol në procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, lidhur me informimin, përgatitjet, praktikat dhe efektet e para të zbatimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe nivelin e përkushtimit institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Objektiva 3: Të vlerësohet niveli i përmbushjes së kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të brendshëm performancës së shkollës në raportet e vetëvlerësimit të shkollave të përfshira në mostrën e studimit. Lidhur me këtë objektiv, kemi ngritur supozimin se përmbushja e kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës pasqyrohet në të gjitha raportet e vetëvlerësimit të shkollave.

Studimi tenton t'u përgjigjet këtyre pyetjeve kërkimore:

- A kanë ngjashmëri politikat, procedurat dhe qasjet ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë me vendet e BE-së?
- Si e perceptojnë subjektet e shkollës përvojën e parë të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës?
- Sa janë përmbushur hapat kryesorë për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës nga shkollat e përfshira në këtë proces?
- Çfarë është niveli i përkushtimit institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë?

1.5. Rëndësia e studimit

Rëndësia e këtij studimi qëndron në faktin se nxjerr në pah argumente dhe informata relevante për të kuptuarit e kontekstit të sigurimit të cilësisë në Kosovë në përgjithësi dhe të vlerësimit të performancës së shkollës në veçanti, të ndërlidhur me politikat, procedurat dhe qasjet në vendet e BE-së.

Rëndësia tjetër e këtij studimi qëndron në ofrimin e informatave se si reflektohet praktika e shkollave në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës kundrejt kornizës për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës, instrumentit/formularit standard për vlerësimin e performancës së shkollës dhe udhëzuesit për vlerësim të brendshëm të shkollës, si dhe në reflektimin e përvojave të para të shkollave që janë duke i prirë zbatimit të kurrikulës së re, mësimet e nxjerra dhe sfidat gjatë realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës.

Rëndësia e këtij studimi është edhe prezantimi i perceptimeve të aktorëve kryesorë në nivel shkolle, që kanë rol në procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, lidhur

me përvojat dhe rolin e tyre, dokumentet dhe materialet e zhvilluara për performancë të shkollës, trajnimet dhe praktikat e tjera mbështetëse për realizimin e procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, efektet e para të zbatimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe perspektivën e zbatimit në të gjitha shkollat e Kosovës.

Së fundi, rëndësia e këtij studimi reflektohet në konkluzionet kryesore që dalin nga rezultatet e studimit dhe orientimet për të udhëhequr praktikën e sigurimit të cilësisë në nivel vendi, udhëheqjen e këtij procesi në nivel shkolle dhe për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës në të gjitha shkollat e Kosovës. Politikat, procedurat dhe përvojat e para në vlerësimin e performancës së shkollës në Kosovë do të analizohen thellësisht, duke u përqendruar në ndikimin e tyre në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe rezultateve arsimore.

1.6. Përkufizimi i koncepteve kryesore

Përkufizimi i koncepteve kryesore është mbështetur kryesisht në dokumentet zyrtare të arsimit në Kosovë, si dokumentet kurrikulare dhe Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë, si dhe në përkufizimet për edukim dhe trajnim (konceptet e lidhura me temën e studimit) nga ISO, OECD, UNESCO, UNICEF, ‘European Commission, European Union’, të trajtuara në Cedefop 2011 “Përmbledhje – cilësia në edukim dhe trajnim dhe ‘Eurydice Report’ në sigurimin e cilësisë në edukim 2014, por edhe në burime të tjera.

Cilësia në arsim - Cilësia përkufizohet si shkallë e përmbushjes së kërkesave për një grup karakteristikash qenësore. Ndërsa, debati mbi cilësinë në arsim ka mbizotëruar për një kohë të gjatë dhe ende nuk mund të flasim për një përkufizim universal të cilësisë. Sipas raportit të Delorit (Jacques Delors) për UNESCO-n “Education: the treasure within” (UNESCO,1996), të cituar në Kurrikulën e Re të Kosovës (2001), katër shtyllat që e përbëjnë arsimin cilësor janë: të mësosh për të ditur, të mësosh për të vepruar, të mësosh për të qenë dhe të mësosh për të jetuar së bashku me të tjerët. Ndërkohë, UNICEF-i e nxjerr në pah edhe shtyllën e pestë: të mësuarit për të transformuar vetveten dhe shoqërinë. UNESCO (2011), në një koncept më të gjerë për cilësinë në arsim, përfshin aspektet në vijim: lidhjen me fushën dhe nivelin e edukimit, barazinë, relevancën, efikasitetin dhe efektivitetin. UNICEF-i e mbështet Kornizën e Dakarit, sipas së cilit dokument përcaktimi i cilësisë në arsim lidhet me nxënësit, mjedisin, përmbajtjet, proceset dhe rezultatet të bazuara në të drejtat e fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje, zhvillim, edukim dhe pjesëmarrje”. Komunikata e Konferencës Botërore për Arsimin e Lartë 2009 thotë se “kriteret e cilësisë duhet të pasqyrojnë synimin e kultivimit në mendimin e studentëve kritikë dhe të pavarur dhe aftësinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Ata duhet të inkurajojnë inovacionin dhe diversitetin.

Sipas Hanushek & Woëßmann (2007), masa e cilësisë së arsimit është një “*mesatare e thjeshtë e rezultateve në matematikë dhe shkencë në testet ndërkombëtare, të interpretuara si përfaqësim i performancës mesatare arsimore.... Kjo masë përmbledh*

shkathtësitë e përgjithshme njohëse, jo vetëm ato të fituara në shkollë. Kështu, pa marrë parasysh nëse shkathtësitë janë fituar në shtëpi, shkollë apo diku tjetër, ato përfshihen në analizën e përparimit arsimor” (Matheis & Mehmeti, 2012).

Sistemi i sigurimit të cilësisë - përfshin të gjitha politikat, procedurat, rregullat, kriteret, mjetet, instrumentet dhe mekanizmat e verifikimit, që të gjitha së bashku sigurojnë dhe përmirësojnë cilësinë e kërkuar nga një institucion arsimor.

Sigurimi i cilësisë në arsim dhe trajnim - ka të bëjë me politikat, procedurat, praktikat dhe veprimtaritë, përfshirë planifikimin, implementimin, vlerësimin, raportimin dhe përmirësimin e cilësisë së zbatuar, në mënyrë që sistemi arsimor të arrijë kërkesat për cilësinë e pritshme nga aktorët. MASHT-i me Udhëzimin Administrativ nr. 24/2016 për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar, sigurimin e cilësisë e definon si një sistem gjithëpërfshirës në nënsektorin e arsimit parauniversitar të Kosovës, që i kontribuon përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe rezultateve arsimore. Ndërsa, zhvillimi i cilësisë shihet si proces i vazhdueshëm në të cilin janë përfshirë i gjithë stafi dhe bazohet në ciklin e cilësisë: planifiko – bëj – kontrollo – vepro, përkatësisht si proces që ndërlidh gjithë veprimtarinë e institucionit arsimor/shkollës në planifikim, zbatim, vlerësim, raportim, rishikim për përmirësim të cilësisë dhe përmbushje të pritshmërive të përcaktuara nga shoqëria.

Performanca e institucionit arsimor/shkollës - tërësia e punës së institucionit arsimor që manifestohet përmes shkallës së arritjes së kriterëve të cilësisë së institucionit arsimor dhe e vlerësuar me procesin e vlerësimit. Performanca e shkollës, në kuptimin e përgjithshëm, pasqyron efektivitetin dhe efikasitetin e procesit të shkollimit.

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së institucionit arsimor - politikë arsimore që përcakton: (i) Kriteret e cilësisë së performancës së institucionit arsimor, (ii) Treguesit e performancës së institucionit arsimor, (iii) Nivelet e vlerësimit të performancës së institucionit arsimor dhe (iv) Shkallët e cilësisë së performancës së institucionit arsimor.

Fushat e cilësisë së shkollës - shtylla kryesore në kuadër të së cilave zhvillohen aktivitetet menaxheriale, arsimore e edukative në shkollë, aktivitetet për vlerësim të brendshëm/vetëvlerësim dhe vlerësim të jashtëm të shkollës, si dhe për planifikim dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës së shkollës.

Kriteret e cilësisë së performancës së shkollës - nënndarje të fushave të cilësisë, të cilat janë të përcaktuara në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës dhe që shërbejnë për të siguruar qasje më sistematike gjatë mbledhjes së të dhënave dhe koherencë në mes të dy proceseve (të jashtëm dhe të brendshëm) të vlerësimit. Kriteret e cilësisë përshkruajnë pritshmëritë themelore që duhet të përmbushen nga secila shkollë dhe orientojnë shkollat për avancim të vazhdueshëm të praktikave të tyre, ndërsa autoritetet arsimore për avancim të politikave arsimore.

Treguesit e performancës së shkollës - deklarata afirmative të pritshmërisë së performancës në kuadër të secilit kriter të cilësisë. Treguesit ndihmojnë vlerësuesit për të konstatuar nivelin e performancës së shkollës në raport me pritshmërinë. Ata

janë referenca kryesore me rastin e vlerësimit të performancës së shkollës në kuadër të kritereve përkatëse.

Vlerësim i brendshëm/vetëvlerësim – kontrolli i planifikuar, sistematik, i standardeve në fushat e cilësisë të përcaktuara nga MASHT-i, i cili kryhet nga shkolla në intervale të rregullta, duke u bazuar në kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës, siç përshkruhet në Kornizën e sigurimit të cilësisë. Vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi në shkollë dhe planifikimi zhvillimor në shkollë janë dy anë të të njëjtit proces të përmirësimit të performancës së shkollës dhe sigurimit të cilësisë. Ato përbëjnë një cikël të vlerësimit dhe intervenimit të planifikuar e sistematik që për qëllim përfundimtar kanë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shkollore, bashkëpunimin e komunikimin më të mirë me komunitetin dhe përfundimisht rritjen e kompetencave të nxënësve.

Vlerësim i jashtëm i shkollës – kontrolli i planifikuar, sistematik, i standardeve në fushat e cilësisë, të përcaktuara nga MASHT-i, i cili kryhet në intervale të rregullta nga inspektorët e arsimit në bazë të kritereve të cilësisë dhe treguesve të performancës, të përcaktuar me Kornizën për sigurimin e cilësisë.

KAPITULLI II

SHQYRTIM I LITERATURËS

Shqyrtimi i literaturës përfshin katër pjesë kryesore. Në pjesën e parë bëhet një përmbledhje për zhvillimet në politikat, procedurat dhe praktikatat për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar në vende të Bashkimit Evropian.

Në pjesën e dytë shqyrtohen politikat dhe qasjet në Evropë për vlerësimin e performancës së shkollës. Fokusi vihet në aspektet që lidhen me vlerësimin e jashtëm të shkollës, përgjegjësit, kriteret për vlerësim, procedurat për vlerësim dhe shfrytëzimin e gjetjeve të vlerësimit. Pastaj prezantohen aspektet që lidhen me vlerësimin e brendshëm të shkollës, si dhe relacionin mes vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të shkollave.

Në pjesën e tretë prezantohen tetë parimet për udhëheqjen e sistemeve për sigurim të cilësisë sipas Kornizës strategjike për bashkëpunim evropian në arsim dhe aftësim profesional (ET 2020).

Në pjesën e katërt shqyrtohen politikat për sigurim të cilësisë, si dhe procedurat dhe qasja ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë, krahasuar me tendencat në vendet e tjera evropiane dhe në raport me tetë parimet e rekomanduara nga Grupi i BE-së për shkollat. Gjithashtu, në këtë pjesë prezantohet një pasqyrë e ngritjes së kapaciteteve të bartësve që kanë rol për sigurim të cilësisë dhe vlerësim të performancës në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë.

2.1. Sigurimi i cilësisë në arsimin parauniversitar: politikat, procedurat dhe praktikatat në Evropë

Mirëmbajtja dhe përmirësimi i cilësisë në arsim është shqetësim i shumicës së qeverive të BE-së në kuadër të objektivave të tyre për të përkrahur kohezionin social të vendeve të tyre, barazinë, punësimin, inovacionin dhe zhvillimin. Përderisa shumica e vendeve të BE-së nuk kanë ndonjë definicion specifik të “cilësisë në arsim”, sipas studimit komparativ për sigurim të cilësisë në sistemet shkollore të BE-së, i bërë për Komisionin Evropian në vitin 2015³, cilësia në arsim përgjithësisht kuptohet se është arritur kur: (1) kompetencat kryesore janë arritur nga të gjithë nxënësit, (2) sistemet shkollore mundësojnë barazi dhe përfshirje (diferenca të vogla apo në rënie në arritjen e rezultateve), (3) udhëhiqen nga ekselencia (p.sh. në mësimdhënie apo qeverisje të shkollës) dhe (4) u mundësojnë nxënësve tranzicion të suksesshëm nga shkolla në tregun e punës dhe arsimim të mëtejshëm. Një sistem “cilësor” i arsimit është po ashtu ai që u përgjigjet dhe u përshtatet sfidave të reja, (p.sh. shkurtimeve buxhetore, rritja e diversitetit në klasa, shfrytëzimi i resurseve digjitale etj.) dhe qasjeve të reja (p.sh. qasja e bazuar në kompetencat kryesore, qasja e bazuar në rezultate, rritja e rëndësisë

³ Comparative study on quality assurance in EU school education systems: Policies, procedures and practices: final report, European Commission, Directorate-General for Education and Culture, 2015.

së aspekteve sociale të arsimit etj.) (European Commission, 2015b).

Në këtë studim, sistemi për sigurim të cilësisë definohet si tërësi e politikave, aktiviteteve, procedurave, rregullave, kriterëve, mjeteve, instrumenteve të verifikimit dhe mekanizmave të dizajnuar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë që ofrohet nga një institucion arsimor apo nga një sistem shkollor. Pra, asnjë mekanizëm i vlerësimit të jashtëm apo të brendshëm nuk mund të sigurojë të dhëna të mjaftueshme për llogaridhënien dhe zhvillimin e shkollës, pasi që mekanizmat e ndryshëm⁴ (nëse janë koherent dhe të qëndrueshëm) ofrojnë perspektiva komplementare për shkollën, mësimdhënësit dhe performancën e nxënësve, duke mbështetur kështu vendimmarrjen e bazuar në fakte. Në Kroaci, për shembull, edhe pse vlerësimi i brendshëm ka filluar të aplikohet 15 vjet më parë, autoritetet arsimore konsiderojnë se ai nuk ishte mjaft efektiv derisa nuk është prezantuar edhe vlerësimi i jashtëm i shkollës (European Commission, 2017). Për më tepër, një mekanizëm i rëndësishëm i sigurimit të cilësisë në Kroaci janë edhe testet e standardizuara dhe matura shtetërore, si dhe mekanizmat e monitorimit të cilësisë në nivel ndërkombëtar (PISA, PIRLS, TIMMS, TALIS).

Grupi punues i BE-së për shkolla në vitin 2017 identifikoi disa sfida dhe mundësi të përbashkëta të sistemeve arsimore në Evropë për sigurim të cilësisë. Ato përfshijnë sfidat për:

- Vendosjen e qëllimeve dhe matjen e progresit të sistemeve arsimore dhe nxënies së nxënësve;
- Dizajnimin e sistemeve për sigurim të cilësisë që janë diverse, të decentralizuara dhe shumënivelshe;
- Përkrahjen dhe inkurajimin e diskutimeve, si dhe kultivimin e mirëbesimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm në fushën e arsimit;
- Sigurimin e transparencës së të dhënave për sigurim të cilësisë, por duke iu shmangur presionit nga ekspozimi i tepruar;
- Prioritizimi i resurseve njerëzore dhe financiare. (European Commission, 2017a).

Tendencë aktuale në vendet e BE-së është rritja gjithnjë e më e madhe e autonomisë së shkollës, në mënyrë që ajo t'u përgjigjet më mirë kontekstit lokal dhe nevojave individuale të nxënësve të saj. Në këtë frymë, mekanizmat për sigurim të brendshëm të cilësisë mbështesin vendimmarrjen e bazuar në fakte për llogaridhënie të brendshme dhe zhvillim të shkollës. Shumica e vendeve evropiane kanë ndërtuar dokumente kornizë, të cilat integrojnë një kombinim të mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm për sigurim të cilësisë, duke përfshirë: Inspektoratet arsimore, vlerësimet nacionale të nxënësve, vetëvlerësimin e shkollave dhe vlerësimin e mësimdhënësve. Në kuadër të Kornizave nacionale apo evropiane të cilësisë, sistemet kryesisht fokusohen në rezultatet e nxënies së nxënësve (respektivisht në performancën e nxënësve) (European

⁴ Për shembull, vlerësimi i brendshëm i shkollës, vlerësimi i jashtëm, vlerësimi i performancës së mësimdhënësve, vlerësimi i performancës së menaxhmentit të shkollave, vlerësimet e nxënësve (vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm)

Commission, 2017).

Sipas studimit komparativ për sigurim të cilësisë në sistemet shkollore të BE-së (European Commission, 2015b), fushat e cilësisë së shkollës, që janë objekt vlerësimi në vendet e BE-së, janë grupuar si më poshtë:

- Konteksti edukativ:
 - Marrëdhënia e shkollës me prindërit, organizatat e tjera në komunitet;
 - Klima dhe komponentët e ndryshëm të saj;
 - Qeverisja e shkollës dhe sistemit.

- Hyrjet në sistemin arsimor:
 - Standardet edukative;
 - Hapësirat fizike dhe pajisjet.

- Proceset:
 - Kurrikula;
 - Vlerësimi i nxënësve;
 - Metodatat e mësimdhënies dhe nxënies;
 - Mësimdhënësit;
 - Udhëheqësit e shkollës.

- Rezultatet:
 - Shkalla e përfundimit të nivelit përkatës të shkollimit;
 - Shkalla e braktisjes;
 - Rezultatet e të nxënësve (kualifikimet).

Vëmendja e mekanizmave për sigurim të cilësisë në fushat e caktuara dallon nga vendi në vend. Gjithsesi, sipas studimit të lartpërmendur, vendet e BE-së angazhimet e tyre për sigurim të cilësisë i fokusojnë kryesisht në fushat vijuese:

- Rezultatet e nxënies;
- Cilësia e mësimdhënësve (rekrutimi, trajnimet, metodatat e mësimdhënies);

- Konteksti edukativ i shkollës (klima e shkollës, qeverisja e shkollës, marrëdhëniet me prindërit, etj.)⁵.

Sa i përket funksionimit të sistemeve për sigurim të cilësisë në vendet e BE-së, dobësitë që janë identifikuar në kuadër të studimit të lartpërmendur, përfshijnë si vijon:

- Në disa shtete, aktorët e nivelit qendror përballen me vështirësi në formulimin dhe zbatimin efektiv të politikave apo aktiviteteve për sigurim të cilësisë;
- Në vendet tjera, performanca e fushave të caktuara të veprimtarisë shkollë nuk monitorohet mjaftueshëm (nuk mbulohet nga fushat e cilësisë që janë objekt vlerësimi), ose informacioni është i dobët apo nuk shfrytëzohet për përmirësime të mëtejme;
- Ka shtete në të cilat efektiviteti në mirëmbajtjen dhe sigurimin e cilësisë nuk monitorohet mjaftueshëm, ose informacioni është i dobët apo nuk shfrytëzohet për përmirësime të mëtejme;
- Në shtetet tjera, udhëheqësit e shkollave dhe mësimdhënësit kanë mungesë kapaciteti dhe/ose motivimi për zbatim të duhur të aktiviteteve për sigurim të cilësisë dhe për shfrytëzimin e rezultateve të tyre, apo janë përballur me vështirësi gjatë zbatimit të aktiviteteve të caktuara për sigurim të cilësisë.

Ky studim identifikoi edhe një numër të tendencave pozitive, si:

- Shfrytëzimi i rezultateve të të nxëniet për vlerësimin e performancës së shkollës dhe/apo sistemit shkollor;
- Aplikimi i qasjes që bazohet në nevoja, sipas së cilës burimet për sigurim të cilësisë u dedikohen shkollave, aktorëve dhe fushave të cilësisë që janë vlerësuar më dobët;
- Përpjekjet për konsolidimin e sistemeve për sigurim të cilësisë dhe sigurimin e një koherence strategjike;
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe analiza e të gjithë faktorëve që

⁵ Në Kroaci, për shembull, fushat e vlerësimit të brendshëm përfshijnë:

- arritjet arsimore,
- proceset e brendshme sociale,
- çështjet organizative dhe
- planifikimin zhvillimor të shkollës.

Në Austri:

- rezultatet e të nxëniet,
- mësimdhënia dhe nxënia,
- mjedisi i shkollës/klasës,
- zhvillimi i personelit,
- partneritetet e shkollës dhe marrëdhëniet e jashtme.

Në Slloveni, sipas protokollit për zbatimin e vetëvlerësimit të shkollës (2014), vlerësimi realizohet në tri fusha të cilësisë:

- mësimdhënia dhe nxënia,
- zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe drejtorëve,
- udhëheqja (menaxhimi) i shkollës.

ndikojnë në të (rekrutimi i mësimdhënësve, trajnimi, masat përkrahëse etj.);

- Kontekstualizimi i vlerësimit të performancës së shkollave, duke marrë në konsideratë faktorët socio-ekonomikë të komunitetit në të cilin vepron shkolla.

Anët e forta dhe dobësitë e sistemeve për sigurim të cilësisë në shtetet anëtare studimi në fjalë i sheh si rrjedhojë e:

- Nivelit të konsolidimit të sistemeve për sigurim të cilësisë (p.sh. shkalla e definimit të dimensioneve të cilësisë së performancës së shkollës, përcaktimi i treguesve për matjen e standardeve të cilësisë, apo vendosja e caqeve që duhen arritur), si dhe nivelit të organizimit të aktiviteteve dhe proceseve të ndryshme që e përbëjnë sistemin e caktuar për sigurim të cilësisë;
- Shkallës së përpjekjeve që në sistemet për sigurim të cilësisë të përfshihet edhe funksioni i tyre formativ (zhvillimor) dhe jo vetëm ai sumativ (respektivisht llogaridhënës).

2.2. Vlerësimi i performancës së shkollës: politikat dhe qasjet në Evropë

Sistemi për sigurimin e cilësisë përfshin një varg mekanizmash, instrumentesh e procesesh për monitorimin e performancës së sistemit arsimor, zbatimit të politikave arsimore, efektivitetit të shkollës dhe personelit të saj, si dhe rezultateve individuale të nxënësve. Vlerësimi i shkollës është vetëm një aspekt i sistemit për sigurim të cilësisë, i cili mund të jetë më pak apo më shumë i zhvilluar, respektivisht më pak apo më shumë i rëndësishëm në kuadër të sistemit⁶.

Gjithsesi, duke njohur rëndësinë e vlerësimit të shkollës, si një ndër hallkat kryesore të sistemit për sigurim të cilësisë së arsimit, në vitin 2001, Parlamenti dhe Këshilli Evropian nxjerrin rekomandimin mbi bashkëpunimin evropian për vlerësim të cilësisë në arsim⁷, me qëllim promovimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave për vlerësimin e cilësisë së shkollës në nivel evropian, si dhe avancimin e mekanizmave për sigurim të cilësisë. Ky rekomandim u bën thirrje vendeve anëtare që:

- të ndërtojnë sistem transparent për sigurim të cilësisë, duke inkurajuar vetëvlerësimin e shkollave në kuadër të një sistemi të balancuar të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm;
- të inkurajojnë dhe të përkrahin, kurdo që është e përshtatshme, përfshirjen e aktorëve kryesorë të shkollës (mësimdhënësit, nxënësit, menaxhmentin, prindërit dhe ekspertët) në procesin e vlerësimit të jashtëm dhe vetëvlerësimit të shkollave, duke promovuar ndarjen e përgjegjësisë për përmirësimin e shkollave;
- të përkrahin trajnimet e ekipeve me bazë në shkollë për menaxhimin e procesit dhe përdorimin e instrumenteve të vetëvlerësimit;

⁶ Disa vende përcaktohen që monitorimin e sistemit arsimor ta bazojnë më tepër në rezultatet e nxënësve në testet e standardizuara, vlerësimin e autoriteteve lokale për shkollat, apo vlerësimin individual të mësimdhënësve.

⁷ RECOMMENDATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 12 February 2001 on European cooperation in quality evaluation in school education (2001/166/EC)

- të përkrahin shkollat që të shkëmbejnë përvojat dhe të mësojnë nga njëra-tjetra në nivel vendi dhe në nivel evropian;
- të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet të gjitha autoriteteve të përfshira në vlerësimin e cilësisë dhe të promovojnë rrjetëzimin e tyre në nivel evropian.

Rekomandimi i bën thirrje edhe Komisionit Evropian që, përveç tjerash, të inkurajojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave në nivel evropian, ndërmjet të gjitha autoriteteve të përfshira në vlerësimin e cilësisë në arsim. Për këtë qëllim, KE rekomandohet që:

- të shfrytëzojë përvojën e rrjetit Eurydice⁸;
- të vendosë një databazë për shpërndarjen e instrumenteve efektive për vlerësimin e cilësisë së shkollës;
- të përgatisë një inventar të instrumenteve dhe strategjive për vlerësim të cilësisë në arsimin fillor dhe të mesëm që janë në shfrytëzim nga vendet anëtare;
- të përgatisë raporte të detajuara trevjeçare mbi zbatimin e këtij rekomandimi, në bazë të kontributit të vendeve anëtare, dhe t'i prezantojë ato para Parlamentit, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social, si dhe Komitetit të Rajoneve, dhe
- të nxjerrë konkluzione dhe të ofrojë propozime bazuar në këto raporte.

Nisur nga kjo, Eurydice ka botuar dy raporte mbi vlerësimin e shkollës në Evropë. Ato përshkruajnë profilin e sistemeve për sigurim të cilësisë në nivel vendi (për secilin shtet që mbulohet me raport), si dhe krahasojnë qasjet, strukturat dhe rolin e sistemeve për vlerësim të jashtëm dhe të brendshëm të shkollave.

Raporti i parë, *“Evaluation of Schools providing Compulsory Education in Europe”*, është botuar në vitin 2004 dhe u referohet të dhënave të viteve 2000/2001. Botimi i dytë, *“Sigurimi i cilësisë në arsim- politikat dhe qasjet ndaj vlerësimit të shkollës në Evropë”*, bazohet në të dhënat e periudhës 2013/2014 dhe është shfrytëzuar si referencë në kuadër të këtij studimi, me qëllim krahasimin e qasjes, sistemit dhe progresit në vendosjen e mekanizmave për sigurim të cilësisë në Kosovë me tendencat në Evropë. Aty ofrohet një pasqyrë e plotë e vlerësimit të cilësisë në 32 vende evropiane, përfshirë të gjitha vendet e BE-së, si dhe Islandën, ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Norvegjinë dhe Turqinë.

Raporti i fundit konfirmon se vlerësimi i shkollës në Evropë është pa dyshim duke u zhvilluar dhe me tendencë drejt qasjeve më përfshirëse, të bazuara në dialog dhe të gjithanshme. Vlerësimi i shkollës në tërë Evropën shfrytëzohet për sigurim të cilësisë dhe në 26 nga 32 vendet e përfshira në hulumtim aplikohet edhe vlerësimi i jashtëm edhe ai i brendshëm.

⁸ Eurydice është Rrjet evropian i informimit në fushën e arsimit, themeluar nga Komisioni Evropian në vitin 1980. Qëllim ka që përmes studimeve dhe raporteve të vazhdueshme të ofrojë informata të përditësuara dhe të besueshme, mbi të cilat mund të bazohen vendimet për avancim të politikave në fushën e arsimit.

2.2.1. Vlerësimi i jashtëm i shkollës

Sipas studimit komparativ për sigurim të cilësisë, në sistemet shkollore të BE-së (European Commission, 2015b), vlerësimi i jashtëm i shkollës, i aplikuar që në fillim të viteve 2000, si qasje për sigurim të cilësisë në disa vende, ka filluar të gjejë aplikim të gjerë në mbarë Evropën. Gjatë viteve 2007, respektivisht 2009, komunitetet frankofone dhe gjermanofone të Belgjikës e kanë zgjeruar fokusin e tyre të sistemeve të vlerësimit, të cilat më parë përqendroheshin vetëm në vlerësimin individual të mësimitdhënësve. Në Danimarkë dhe Suedi, ku sistemi i vlerësimit përqendrohej vetëm te autoritetet lokale, që nga viti 2006, respektivisht 2003, e kanë fuqizuar rolin e autoriteteve qendrore në vlerësimin e jashtëm të shkollës. Përderisa në Itali dhe Hungari, ku vlerësimi i shkollës nuk ka qenë element i rëndësishëm për sigurim të cilësisë, gjatë periudhës 2013/2014, ka filluar pilotimi i qasjeve më të gjithanshme të vlerësimit.

- **Inspektorati i nivelit qendror është përgjegjës për vlerësimin e jashtëm të shkollës në shumicën e vendeve**

Në 27, nga 31 sisteme arsimore në të cilat aplikohet vlerësimi i jashtëm i shkollës, ky proces realizohet nga inspektoratet e arsimit në nivel qendror. Kjo trupë zakonisht është ngritur në nivel qendror. Edhe Shqipëria hyn në këtë grup të shteteve, ku Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP) është përgjegjës për vlerësimin e jashtëm të shkollës. Në Danimarkë, Lituani dhe Islandë, përgjegjësia për vlerësimin e jashtëm ndahet ndërmjet niveleve qendrore dhe rajonale apo lokale. Në Estoni, Hungari, Austri, Poloni dhe Turqi përgjegjësia për realizimin e vlerësimit të jashtëm bie mbi organet rajonale apo nënrajonale, që rezultojnë me nivele të ndryshme të standardizimit në entitetet e decentralizuara. Ndërsa, në Estoni, Sllovaki, Mbretërinë e Bashkuar dhe IRJ të Maqedonisë edhe autoritetet lokale ushtrojnë përgjegjësi të caktuar për realizimin e vlerësimeve të jashtme të shkollave, të cilat janë nën mbikëqyrjen e tyre, krahas qasjes kryesore të vlerësimit të jashtëm që aplikohet nga organet qendrore.

Sa i përket kualifikimit të vlerësuesve të jashtëm, në shumicën e vendeve kërkohet kualifikim në fushën e mësimitdhënies dhe një periudhë e caktuar e përvojës profesionale në shkollë (si mësimitdhënës apo pozitë menaxheriale). Në disa vende, edhe kandidatët me përgatitje më të gjerë profesionale, si në fushën e arsimit, hulumtimeve e psikologjisë, mund të bëhen vlerësues të jashtëm. Ndërsa në disa të tjera (p.sh. në Itali, Islandë) përfshirja e personave me ekspertizë jashtë fushës së arsimit, si për shembull me ekspertizë në fushën e hulumtimeve apo vlerësimeve, është kërkesë dhe përparësi për ekipet e vlerësuesve të jashtëm.

- **Kriteret që shfrytëzohen për vlerësimin e jashtëm të shkollës janë kryesisht të standardizuara**

Në shumicën e rasteve, vlerësimi i jashtëm fokusohet në një spektër të gjerë të aktiviteteve të shkollës, duke përfshirë detyrat arsimore dhe drejtuese, rezultatet e nxënësve, si dhe përmbushjen e kërkesave të përcaktuara me kuadrin rregullativ të punës së shkollës. Vlerësuesit bazohen kryesisht në një kornizë të vendosur në nivel qendror, e cila përcakton në formë të strukturuar jo vetëm pikat kryesore të vlerësimit

të jashtëm, por edhe standardet e “shkollës së mirë”. Megjithatë, disa qasje fokusohen vetëm në aspekte të veçanta të punës së shkollës, siç është përmbushja e kërkesave të përcaktuara me kuadrin rregullativ (Estonia, Sllovenia, Turqia), apo “nivele të mësimave” (ekipe të mësimore në fushat e caktuara), siç është rasti në Komunitetin francez të Belgjikës. Në Francë, ku sistemi i inspektimit fokusohet kryesisht në personelin individual të shollës, nuk ka ndonjë protokoll standard që definon përmbajtjen dhe procedurat e vlerësimit të jashtëm të shkollës. Në Suedi, Inspektorati ka autonominë e përcaktimit të kriterëve të vlerësimit dhe i bazon ato në kuadrin ligjor dhe rregullativ të punës së shkollave, si dhe në kurrikulat e arsimit të obliguar. Në Danimarkë, pjesa më e madhe e procesit të vlerësimit të jashtëm dizajnohet nga komunat, me përkrahje të autoritetit qendror. Sa i përket Austrisë, Korniza e vlerësimit përbëhet nga Akti Federal për Inspektim të Shkollave (dokument i cili definon cilësinë e shkollave), Mandati i Inspektoratit të Shkollave (i cili vendos vlerat themelore të Inspektoratit të Shkollave) dhe Cilësia e Shkollave në Arsimin e Përgjithshëm 2013/2014 (i cili përcakton parametrat e vlerësimit të shkollës, respektivisht fushat dhe treguesit e cilësisë) (European Commission, 2015b).

Në Shqipëri, vlerësimi i jashtëm i shkollës bëhet në bazë të Kartës së performancës së shkollës, e cila garanton cilësinë përmes treguesve të standardizuar dhe shërben si instrument për vetëvlerësimin e shkollës dhe inspektimin (Pasku, 2014). Ndërsa në Kroaci vlerësimi i brendshëm rregullohet me Ligjin për Shkollat Fillore dhe të Mesme (2008), kurse roli dhe përgjegjësitë e palëve në këtë proces rregullohen me Kornizën Kombëtare të Kurrikulës për Arsimin Parashkollor dhe Arsimin e Përgjithshëm Obligativ dhe të Mesëm (2010). Shkollat kanë autonomi të lartë në përcaktimin dhe përzgjedhjen e fushave të vetëvlerësimit dhe në procesin e vetëvlerësimit; udhëzuesit dhe instrumentet vihen në dispozicion, por nuk janë obligative për shkollat.

- **Qasjet e bazuara në rrezikshmëri dhe aktivitetet për ngritje të imazhit të shkollave praktikohen në fare pak vende**

Analiza e proceseve të vlerësimit të jashtëm vë në pah edhe dy përvoja interesante që shfrytëzohen në disa vende: qasja e bazuar në rrezikshmëri dhe aktivitetet për ngritje të imazhit. Në gjashtë sisteme arsimore: Danimarkë, Irlandë, Holandë, Suedi, Mbretëri e Bashkuar (Angli dhe Irlandë Veriore), kohët e fundit është prezantuar qasja e bazuar në rrezikshmëri. Kjo nënkupton fokusimin e punës së vlerësuesve në shkollat që nuk janë duke performuar sipas standardeve të pritura (Danimarkë, Irlandë, Holandë dhe Mbretëri e Bashkuar - Angli), apo për të përcaktuar tipologjinë e inspektimit (Suedi dhe Mbretëri e Bashkuar - Irlandë Veriore). Qasja ka për qëllim rritjen e efikasitetit, si të shfrytëzimit të buxhetit ashtu edhe të burimeve, por edhe bazohet në relevancën e treguesve që aplikohen. Për më tepër, ajo thekson rolin e vlerësimit të jashtëm në identifikimin e dobësive në sistem, por kjo mund të ndikojë që përvoja e mira të mos evidentohen dhe të mbesin në margjina. Gjithsesi, kjo qasje dhe implikimet e saj duhen hulumtuar tutje dhe mund të përbëjë një fushë për shkëmbimin e informacioneve mes vendeve.

Në disa sisteme të tjera (Francë për SNKA 1, Lituani, Poloni dhe Mbretëri të Bashkuar

(Angli, Uells dhe Irlandë Veriore), vlerësimet e jashtme nuk kanë për synim vetëm konstatimin e tendencave të performancës së shkollave, por edhe të rrisin imazhin dhe fizibilitetin e atyre që janë duke performuar mirë dhe duke arritur rezultate të larta. Raporti vlerëson se kjo qasje mundëson mbledhjen dhe ndarjen e përvojave që funksionojnë dhe rrethanave në të cilat përvojat e caktuara funksionojnë, duke kontribuar edhe në nivel të shkollës edhe në nivel të sistemit. Ajo po ashtu trason rrugën për zhvillim të mëtejshëm të rolit dhe funksionit të vlerësimit të jashtëm.

- **Procedurat për vlerësimin e shkollave janë pothuajse homogjene**

Me gjithë dallimet në mbulueshmërinë dhe llojin e aktiviteteve që vlerësohen, zbatimi i vlerësimit të jashtëm në Evropë bazohet në një strukturë pothuajse homogjene, që konsiston në tre hapa kryesorë: analizë, vizita dhe raportim. Të gjitha vendet që aplikojnë vlerësimin e jashtëm kanë procedura brenda kësaj kornize. Përveç kësaj, një llojllojshmëri e pasur dhe e shumëllojshme e instrumenteve është në dispozicion të vlerësuesve në shumicën e sistemeve arsimore, duke ofruar mundësi për diversifikim të burimeve të informacionit, rritje të nivelit të shfrytëzimit të dialogut me aktorët relevantë dhe nxjerrjen e konkluzioneve transparente dhe të bazuara në fakte. Edhe pse ekzistojnë dallime, p.sh. në shkallën e autonomisë së vlerësuesve për përzgjedhjen e instrumenteve apo në qëllimin për të cilin shfrytëzohen, pasqyra e përgjithshme e spektrit të proceseve dhe instrumenteve konfirmon një strukturë solide dhe mjete adekuate për realizimin e vlerësimeve të jashtme.

- **Shfrytëzimi i gjetjeve të vlerësimit**

Sa u përket tendencave për shfrytëzimin e gjetjeve të vlerësimit, raporti në fjalë pranon kategorizimin që bëjnë Harris dhe Herrington (2006), sipas të cilit llogaridhënia e shkollave mund të jetë e orientuar kah tregu ose kah qeveria. Në sistemet ku llogaridhënia orientohet kah tregu, prindërit kanë mundësi zgjedhjeje të shkollës, të cilën do ta vijoje fëmijët e tyre, dhe stimulohet një dinamikë e tregut në të cilën shkollat duhet të performojnë dhe garojnë për nxënës, si me llojllojshmëri të shërbimeve që ofrojnë ashtu edhe me cilësi. Në sistemet në të cilat llogaridhënia orientohet kah qeveria, menaxhimi i instrumenteve që mund të kenë ndikim në performancën e shkollës është i deleguar tek autoriteti përgjegjës. Këto instrumente mund të jenë iniciativa, sanksione, alokim i fondeve, varësisht nga treguesit socio-ekonomikë, e kështu me radhë.

Dy treguesit që përcaktojnë se cilës kategori i takojnë sistemet e caktuara janë: publikimi i raportit të vlerësimit të jashtëm dhe shkalla e lirisë së nxënësve/prindërve për përzgjedhjen e shkollës. Pra, një raport që bëhet publik në një sistem që u jep liri të plotë prindërve dhe nxënësve për zgjedhjen e shkollës provokon një dinamikë tregu, me ç'rast raporti, e me këtë edhe sistemi i vlerësimit të jashtëm, influencon zgjedhjen e prindërve, e si rrjedhojë u bën presion shkollave që të përmirësojnë performancën e tyre. Nga ana tjetër, një raport që nuk bëhet publik apo shpërndahet me kufizime të caktuara, në kuadër të një sistemi që bën shpërndarjen e nxënësve në shkolla sipas kritereve të paracaktuara (siç mund të jetë distanca gjeografike), mban llogaridhënien e shkollave brenda obligimeve të shtetit, i cili është përgjegjës për arsimin e qytetarëve të vet dhe për përmirësimin e performancës së shkollave.

Sistemet arsimore të Belgjikës (Komuniteti flaman), Irlanda, Lituania, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar (Anglia, Uells dhe Irlanda Veriore) janë me vizion të orientuar kah tregu; pra rezultatet e vlerësimit bëhen publike sepse llogaridhënia e shkollave është në radhë të parë ndaj komunitetit të cilit i shërbejnë. Në skajin e kundërt janë vendet si: Franca, Qipro, Sllovenia dhe Turqia, në të cilat përgjegjësia e shkollave është para së gjithash ndaj shtetit, prandaj gjetjet e vlerësimeve nuk bëhen domosdo publike. Të gjitha sistemet e tjera janë diku brenda këtij spektri, pa përcaktim të qartë të njërit apo tjetrit vizion. Në fakt, në disa prej vendeve, edhe pse raportet bëhen publike, mundësia për përzgjedhjen e shkollës nga prindërit apo nxënësit pothuajse nuk ekziston fare (p.sh. Estonia, Polonia, Portugalia dhe Islanda), ndërsa në të tjerat ekziston pothuaj liri e plotë e prindërve dhe nxënësve në përzgjedhjen e shkollave, por kjo nuk shoqërohet me bërjen publike të informatave për cilësinë e shkollës (p.sh. Belgjika-Komuniteti francez, Italia, Lituania, Spanja).

Sa i përket funksionit të vlerësimit të performancës së shkollës, tendenca është që të arrihet një balancë ndërmjet funksionit llogaridhënës dhe zhvillimor. Për shembull, shumë vende theksojnë rëndësinë e kalimit nga qasja ndaj sigurimit të cilësisë si formë “kontrolli” drejt qasjes së “bazuar në besim” (European Commission, 2017a). Kjo pasi që qasja “sanksionuese” konsiderohet të ndikojë në demotivimin e personelit të shkollës dhe pengimin e zhvillimit të saj. Masat sanksionuese mund të përfshijnë mosakreditimin e shkollave, të cilat nuk i përmbushin standardet e sigurimit të cilësisë, ndikimin në karrierën apo pagën e mësimitdhënësve etj. Shumë vende publikojnë rezultatet e vlerësimeve të nxënësve dhe/apo vlerësimeve të shkollave (shih më lart), gjë që nga mësimitdhënësit mund të perceptohet si masë presioni. Nga ana tjetër, fokusi zhvillimor i vlerësimit siguron që të dhënat shfrytëzohen për të identifikuar nevojat, përshtatur strategjitë e shkollës dhe për të motivuar përmirësimin e mësimitdhënies.

2.2.2. Vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi

Gjatë dhjetë viteve të fundit, pritshmëritë nga vlerësimi i brendshëm i shkollës në Evropë janë rritur. Nga fillimi i viteve 2000 statusi i vlerësimit të brendshëm në shumicën e vendeve ka avancuar nga ‘i rekomanduar apo i mundshëm’ në ‘obligativ’. Në 27 sisteme arsimore, vlerësimi i brendshëm i shkollës është obligativ. Shtetet e vetme në të cilat shkollat nuk janë të obliguara, apo të sugjeruara që të bëjnë vlerësimin e brendshëm, janë Bullgaria dhe Franca (kjo e dyta obligimin për VBSH e ka të kufizuar vetëm në arsimin fillor).

Cristofer Chapman dhe Pamela Sammons, duke analizuar parimet bazë të procesit të vetëvlerësimit, shkruajnë: shumica e udhëzuesve për vetëvlerësimin sugjerojnë që procesi duhet të jetë pjesë e një procesi të vazhdueshëm, i cili fokusohet në rishikimin e arritjeve të gjithanshme të nxënësve dhe integrohet me sistemet e përgatitjes për menaxhim, zhvillim dhe praktikë. Një ndër parimet kryesore të vetëvlerësimit është që shkolla duhet të bëjë përmbledhjen e të dhënave vjetore dhe të përfshijë informacion që argumenton impaktin e veprimeve të ndërmarra tek nxënësit. Pohimet dhe listat e iniciativave konsiderohen të padobishme (Çobaj, 2013).

Edhe pse obligimi për vlerësim të brendshëm të shkollës është pothuajse në të gjitha vendet, politikat për zbatimin e tij dallojnë mjaft dhe në shumicën e vendeve shkollat kanë autonomi të caktuar sa i përket realizimit të VBSH-së. Shtetet në të cilat nga shkollat pritet që me rastin e vlerësimit të brendshëm të shfrytëzojnë kornizën e njëjtë, sikurse vlerësuesit e jashtëm (Rumania dhe IRJ e Maqedonisë), të cilat shfrytëzojnë një kornizë të veçantë për vlerësim të brendshëm (Greqia), apo ato tek të cilat përmbajtja e raportit të vlerësimit të brendshëm definohet me ligj (Lituanian dhe Sllovakia janë përjashtime). Në Mbretërinë e Bashkuar (Skotlandë), të gjitha shkollat kanë adaptuar kornizën e njëjtë që shfrytëzohet nga vlerësuesit e jashtëm, në bazë të një konsensusi nacional.

Sa u përket palëve që duhet të përfshihen në procesin e VBSH-së, shumica e sistemeve arsimore kanë rregullore përkatëse. Nga ato 16 sisteme kërkojnë pjesëmarrjen e një numri të madh të aktorëve, përfshirë nxënësit dhe prindërit, ndërsa shtatë të tjera rregullojnë vetëm pjesëmarrjen e personelit të shkollës (por duke rekomanduar edhe pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë).

Mënyra e shfrytëzimit të rezultateve të vlerësimit të brendshëm në shumicën e rasteve është në autonominë e personelit të shkollës. Autoritetet e arsimit zakonisht japin indikacione rreth shfrytëzimit të gjetjeve të vlerësimit të brendshëm për përmirësimin e cilësisë së shkollave. Megjithatë, në shumicën e sistemeve arsimore, shkollat duhet të shfrytëzojnë gjetjet e vlerësimeve të brendshme për të planifikuar masat e përmirësimit. Në lidhje me publikimin e rezultateve të vlerësimit të brendshëm, një gjë e tillë kërkohet vetëm në Irlandë, Greqi, Latvi, Holandë, Rumani, Sllovakia, Islandë dhe IRJ e Maqedonisë. Ndërsa, pothuajse të gjitha vendet vendosin në dispozicion për shkollat masa dhe instrumente përkrahëse për realizimin e vlerësimit të brendshëm. Pavarësisht asaj se a është vlerësimi i brendshëm obligativ apo i rekomandueshëm, të gjitha shkollat (përveç në Bullgari) aplikojnë së paku njërin prej atyre masave (e kryesisht me shumë) për realizimin e vetëvlerësimeve të tyre. Në këto masa përfshihen: trajnimet në fushën e vlerësimit të brendshëm, shfrytëzimi i kornizave të vlerësimit të jashtëm, treguesit që u mundësojnë shkollave krahasimin me shkollat e tjera, udhëzues dhe doracakë të veçantë, forume ‘online’, si dhe këshillime nga specialistë të jashtëm dhe përkrahje financiare. Forma më e rëndomtë e përkrahjes së shkollave në tërë Evropën është ofrimi i udhëzuesve dhe doracakëve. Nga ana tjetër, përkrahja financiare është masa e fundit që vihet në dispozicion për shkollat, pasi që ajo ofrohet vetëm në Spanjë dhe në Kroaci. Në vitin 2004, vetëm një e katërta e vendeve u kanë ofruar shkollave mundësinë për të shfrytëzuar treguesit, si p.sh. rezultatet e testeve të nxënësve, për të krahasuar performancën e tyre me atë të shkollave tjera që punojnë në rrethana të ngjashme. Në vitin 2014 kjo ndodh në dy të tretat e sistemeve, duke e bërë shfrytëzimin e treguesve si masën e dytë më të përdorur për vlerësim të brendshëm të shkollës në Evropë.

2.2.3. Relacioni ndërmjet vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të shkollave

Në 31 sisteme arsimore shkollat edhe realizojnë vlerësimet e brendshme edhe

vlerësohen nga vlerësuesit e jashtëm. Forma më e përhapur e ndërvarësisë ndërmjet dy proceseve është shfrytëzimi i gjetjeve të vlerësimit të brendshëm nga vlerësuesit e jashtëm. Bashkë me burimet tjera, gjetjet e vetëvlerësimit janë pjesë e informacioneve që analizohen gjatë fazës përgatitore për vlerësim të jashtëm. Por, në rastet kur vlerësimet e brendshme nuk e kanë qëllimin dhe mbulueshmërinë e njëjtë me vlerësimet e jashtme, në rastet kur nuk janë të detyrueshme dhe kur nuk janë zbatuar plotësisht, ato nuk shfrytëzohen nga vlerësuesit e jashtëm.

Sa i përket autonomisë së shkollës për procesin e vetëvlerësimit, ajo mund të ketë dimension nga poshtë - lart, apo mund të jetë plotësisht e informuar nga strategjitë prej lart - poshtë. Gjithsesi, edhe në rastet kur qasja është nga poshtë - lart autoritetet arsimore ndikojnë përmbajtjen e vlerësimit të brendshëm përmes rekomandimeve për shfrytëzimin e listës së paracaktuar të kriterëve, duke ofruar udhëzues dhe doracakë, apo përmes vënies në dispozicion të treguesve që u mundësojnë shkollave të krahasohen me njëra-tjetrën. Por, janë shumë të rralla rastet kur komplet procesi determinohet nga autoritetet arsimore. Kështu për shembull, në Rumanë shkollat inkurajohen që standardeve nacionale të vlerësimit t'ua shtojnë edhe fushat e veçanta me interes për shkollën. Ky orientim pak a shumë pasqyrohet edhe në praktikat e vlerësimit të jashtëm, siç janë proceset e diskutimit të raportit final të vlerësimit ndërmjet vlerësuesve të jashtëm dhe personelit shkollor, apo përfshirjes së nxënësve, prindërve dhe komunitetit lokal në vlerësimin e jashtëm.

Pra, shumë shtete janë në hapat e parë të zbatimit të sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës përmes vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm. Prandaj, mund të thuhet se vlerësimi i jashtëm dhe vetëvlerësimi kanë shumë për të bërë. Tashmë pranohet se këto dy vlerësime janë plotësuese dhe reciprokisht përforcuese, të dyja të fokusuara tek përmirësimi i procesit të mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënësve, të arritura nga nxënësit (Pasku, 2014).

2.3. Parimet për udhëheqjen e sistemeve për sigurim të cilësisë

Bazuar në nevojën dhe kërkesat që kanë sistemet shkollore që vazhdimisht të përshtaten dhe të prodhojnë cilësi, reflektimet e përbashkëta në nivel evropian kanë rezultuar me një marrëveshje rreth objektivave të përbashkëta për sistemet arsimore, e njohur si Korniza Strategjike për Bashkëpunim Evropian në Arsim dhe Aftësim Profesional 'ET 2020'⁹. Për zbatim të suksesshëm të ET 2020, Grupi Punues, i përbërë nga ekspertë të vendeve anëtare dhe aktorëve të tjerë, punojnë në ofrimin e udhëzimeve dhe instrumenteve të përbashkëta për reformimin e politikave në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional.

Në kuadër të mandatit aktual, Grupi Punues për shkollat është duke analizuar

⁹ Në vitin 2009 Komisioni Evropian në kuadër të kornizës së bashkëpunimit ndërmjet vendeve të BE-së në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional (Arsimi dhe aftësimi profesional 2020-ET 2020) vendosi katër objektiva të përbashkëta të BE-së për adresimin e sfidave në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional deri në vitin 2020, përfshirë:

Bërjen realitet të mësimin gjatë gjithë jetës dhe mobilitetit;

zhvillimet e politikave në vendet anëtare sa i përket qeverisjes së sistemeve arsimore, të cilat mund të përkrahin dhe të përmirësojnë cilësinë, përfshirjen dhe inovacionin. Fokusi i tyre është në ngritjen e kapacitetit për ndryshime sistematike në katër fusha të ndërlidhura: 1) sigurimi i cilësisë për zhvillimin e shkollës, 2) vazhdimësia e zhvillimit të nxënësve, 3) zhvillimi i profesioneve të mësimdhënies, 4) menaxhimi i rrjeteve të shkollave dhe shfrytëzimi optimal i resurseve.

Në vitin 2017, Grupi Punues për shkollat ka përgatitur një raport në të cilin përcakton tetë parime për udhëheqjen e sistemeve për sigurim të cilësisë dhe për sigurimin e një sinergjie produktive të mekanizmave të jashtëm dhe të brendshëm për sigurim të cilësisë (European Commission, 2017a). Këto parime janë:

- **Koherenca e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm për sigurim të cilësisë.** Sistemet duhet të angazhohen gjatë gjithë kohës që të arrijnë një balancë dhe koherencë ndërmjet mekanizmave të ndryshëm që janë zhvilluar për të përmbushur pritshmëritë e aktorëve, të cilët punojnë në kuadër të shkollës apo në kuadër të sistemit të gjerë arsimor;
- **Komunitetet e nxënies profesionale.** Politikat për sigurim të cilësisë duhet të përkrahin komunitetet e nxënies profesionale që në mënyrën më të mirë t'i shfrytëzojnë të dhënat për sigurim të cilësisë për zhvillimin e shkollës dhe zhvillimin e sistemit.
- **Besimi dhe llogaridhënia e përbashkët.** Besimi dhe respekti ndërmjet aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm janë të domosdoshëm për vlerësim efektiv dhe zhvillim të shkollës.
- **Mundësitë për të përkrahur inovacionin në shkolla.** Udhëheqësit e shkollave dhe mësimdhënësit kanë nevojë për mundësi që të ndërmarrin rreziqe të konsiderueshme në mënyrë që të zhvillohen. Vëmendja e kujdesshme për të dhënat mbi ndikimin e inovacioneve që aplikohen në shkollë, përfshirë efektet potenciale të padëshirueshme, është qenësore.
- **Mirëkuptimi dhe dialogu ndërmjet aktorëve.** Sistemet për sigurim të cilësisë duhet të përkrahin kultivimin e një gjuhe të përbashkët ndërmjet aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm dhe të kuptuarit e drejtë të karakterit zhvillimor të vlerësimit.
- **Rrjetet për përkrahjen e zhvillimit.** Rrjetet ndërmjet shkollave dhe të shkollave me komunitetin lokal dhe më të gjerë mund t'i kontribuojnë angazhimit të përbashkët, ndërtimit të kapitalit social e intelektual si dhe të prodhojnë sinergji të reja në sistemet shkollore.
- **Ndërtimi i kapaciteteve për të gjeneruar, interpretuar dhe shfrytëzuar të dhënat.** Investimet në ndërtimin e kapaciteteve të aktorëve kryesorë për të

Përmirësimin e cilësisë dhe efijencës në arsim dhe aftësim profesional;

Promovimin e barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive;

Rritjen e kreativitetit dhe inovacionit, përfshirë ndërmarrësinë, në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin profesional.

gjeneruar, interpretuar dhe shfrytëzuar të dhënat janë qenësore.

- **Zhvillimi i një pikëpamje të balancuar për zhvillimin e shkollës.** Llojet e ndryshme të të dhënave - edhe kualitative edhe kuantitative - janë të domosdoshme për kuptim të balancuar të zhvillimit të shkollës dhe progresit të nxënësve. Këto të dhëna duhet të komunikojnë narracione autentike për shkollat dhe të ofrojnë informatat e domosdoshme për të ushqyer procesin e vendimmarrjes në nivel shkollë apo në nivel të sistemit.

Në po të njëjtin dokument, Grupi Punues për shkollat rekomandon që vendet të udhëhiqen nga tetë parimet e lartpërmendura kur i rishikojnë mekanizmat për sigurim të cilësisë së shkollave. Po aty, ky grup rekomandon që:

- Shtetet t'i shfrytëzojnë mundësitë e mësimit dhe këshillimit reciprok, në mënyrë që të reflektojnë dhe t'i rafinojnë qasjet për sigurim të cilësisë;
- Diskutimet ndërmjet shteteve të vazhdojnë në mënyrë që t'i shpijnë përpara arritjet e Grupit Punues për shkollat në adresimin e sfidave të caktuara sa i përket sigurimit të cilësisë, me theks të veçantë gjenerimit, interpretimit dhe shfrytëzimit të të dhënave në nivele të ndryshme, si dhe trajnimeve përkatëse;
- Të bëhet monitorimi i ndikimit që kanë shkëmbimet mes shteteve, me qëllim që të vlerësohet dobishmëria e saj për zhvillimin e politikave dhe për udhëheqjen e punës së mëtejme;
- Rekomandimet për sigurim të cilësisë të jenë koherente me rekomandimet e tjera për qeverisjen e arsimit shkollor.¹⁰

Në nivel nacional:

- Iniciativat dhe qasjet e reja për sigurim të cilësisë duhet të fillojnë nga anët e forta të shkollës dhe sistemit arsimor, si dhe duhet të zhvillohen dhe të monitorohen nga ajo perspektivë;
- Kur merren në konsideratë iniciativa dhe qasje të reja, është e dobishme që të bëhen planifikime taktike, si dhe të priten reagime nga aktorët, prandaj:
 - Duhet të planifikohet dialog i dyanshëm ndërmjet aktorëve, sidomos sa u përket të dhënave;
 - Duhet të konsiderohen masa stimuluese për mësimdhënësit dhe udhëheqësit e shkollave që të bëhen agjentë të ndryshimit, krahas një strategjie për kultivimin e një kulture besimi;

10 Quality assurance for school development: Guiding principles for policy development on quality assurance in school education, Report of the ET2020 Working Group Schools, European Commission, 2017.

- Shkollat që nuk janë pjesë e sistemit për sigurim të cilësisë duhet të përfshihen në këtë dialog dhe duhet të merren parasysh nevojat specifike të qasjeve alternative pedagogjike.
- Vetëvlerësimi i shkollës duhet të fuqizohet, përfshirë ngritjen e kapacitetit të udhëheqësve të shkollave dhe mësimitdhënësve; marrjen e përvojave nga sektorët e tjerë, të cilët kanë qenë vazhdimisht të përfshirë në vlerësime të brendshme; zhvillimin e instrumenteve kurdo që është e përshtatshme/nevojshme.
- Roli i inspektorateve të shkollës duhet të përqendrohet në lehtësimin e përmirësimit, duke përkrahur shkollat në adresimin e sfidave të evidentuara, si dhe përmes shpërndarjes së përvojave të mira.
- Koherenca e mekanizmave për sigurim të cilësisë me politikat e tjera relevante duhet të sigurohet.
- Shtetet duhet të kenë perspektivë të avancimit, jo të kurthohen me nevojat në të kaluarën, por të veprojnë drejt një vizioni për të ardhmen.

2.4. Politikat, procedurat dhe qasja ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë

Politikat për sigurim të cilësisë, si dhe procedurat dhe qasja ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë, janë analizuar duke i krahasuar me tendencat në vendet e tjera evropiane dhe në raport me tetë parimet e rekomanduara nga Grupi i BE-së për shkollat.

2.4.1. Sistemi për sigurim të cilësisë

Një interesim dhe angazhim i shtuar për sigurimin e cilësisë, respektivisht për vendosjen e një sistemi për sigurim të cilësisë në Kosovë, fillon në vitin 2013, kur edhe inicohet procesi për hartimin e një Strategjie për Sigurim të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar.

Në atë periudhë edhe në Kosovë, sikurse edhe në vendet e tjera evropiane, nuk kishte konsensus lidhur me atë që është ‘arsim i mirë’. Por, për dallim nga vendet e tjera, të cilat cilësinë në arsim përgjithësisht e kanë kuptuar si arritje në zotërimin e kompetencave kryesore nga të gjithë nxënësit, barazi dhe përfshirje, ekselencë (p.sh. në mësimitdhënie apo qeverisje të shkollës) dhe shkallë e lartë e tranzicionit nga shkolla në tregun e punës dhe arsimim të mëtejshëm, në Kosovë cilësia në arsim është kuptuar më tepër në aspektin e të hyrave, duke e reduktuar në infrastrukturë shkollore, mjete mësimore dhe shkallë të kualifikimit të mësimitdhënësve. Kjo pikëpamje e ngushtë e cilësisë, në kuadër të Strategjisë për sigurim të cilësisë, është konsideruar si një pengesë e madhe për të ndryshuar në mësimitdhënie, nxënie dhe vlerësim në veçanti. Nga ana tjetër, edhe vlerësimet e jashtme për nxënësit e klasës së fundit të arsimimit të detyrueshëm (Testi i Arritshmërisë) dhe të arsimimit të mesëm të lartë (Provimi i Maturës) janë kritikuar

gjërësisht për administrim të dobët dhe mungesë informacioni kthyes në shkolla, prandaj edhe nuk janë shfrytëzuar mjaftueshëm për vlerësimin e cilësisë (MASHT, 2015).

Në përgjithësi, lidhjet e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së munguar ose keqfunksionimit, si dhe mungesa e koherencës ndërmjet masave të ndryshme për sigurim të cilësisë (p.sh. vlerësimi i efikasitetit të performancës së mësimdhënësit nga drejtori i shkollës, sistemi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve nga Inspektorati i arsimit me fokus pedagogjik, menaxhimi i shkollave nga autoritetet komunale, planifikimet zhvillimore të shkollave, planifikimet zhvillimore të komunave, rezultatet e testeve të jashtme), kanë ndikuar negativisht në cilësinë e arsimit.

Gjithsesi, nga ajo periudhë Kosova ka shënuar një përparim të dukshëm në kompletimin e kuadrit ligjor e rregullativ për konsolidimin e sistemit për sigurim të cilësisë, përgatitjen e udhëzuesve dhe doracakëve për të përkrahur proceset e vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të shkollave, si dhe ngritjen e kapacitetit të autoriteteve qendrore, komunale dhe shkollave për realizimin e këtyre proceseve.

Dokumenti bazë për sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar, i cili shërben si referencë kryesore për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e performancës së shkollës, planifikimin zhvillimor të saj dhe avancimin e vazhdueshëm të cilësisë së shkollës, është Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës. Ajo përcakton:

- Fushat e cilësisë së performancës së shkollës;
- Kriteret e cilësisë së performancës së shkollës;
- Treguesit e cilësisë së performancës së shkollës;
- Nivelet e vlerësimit të performancës së shkollës dhe
- Shkallët e cilësisë së performancës së shkollës.

Duke standardizuar konceptet dhe dispozitat themelore, Korniza për sigurim të cilësisë siguron koherencë dhe komplementaritet ndërmjet vlerësimit të brendshëm dhe atij të jashtëm të performancës së shkollës dhe ndërmjet niveleve të ndryshme të planifikimit zhvillimor të shkollës¹¹.

Si e tillë, qasja ndaj sigurimit të cilësisë në Kosovë dhe pakoja e dokumentacionit rregullativ janë në harmoni të plotë me tetë parimet e BE-së dhe rrjedhimisht në linjë me përvojat e mira të evidentuara deri më tani në Evropë.

¹¹ Planifikimit në nivel shkolle, në nivel komune dhe në nivel qendror.

2.4.2. Fushat e cilësisë

Fushat e cilësisë së performancës së shkollës janë të përcaktuara me Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë dhe shërbejnë si shtylla organizative për menaxhim të shkollës, vlerësim, vetëvlerësim, planifikim dhe intervenim përmirësues.

Siç është paraqitur në tabelën më poshtë, këto fusha janë brenda kategorive kryesore që janë objekt vlerësimi në vendet e BE-së.

Kategoritë e fushave të cilësisë së performancës së shkollës në vendet e BE-së	Fushat e cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë
Konteksti edukativ	
<ul style="list-style-type: none"> - Marrëdhënia e shkollës me prindërit, organizatat tjera në komunitet 	Menaxhimi dhe qeverisja
<ul style="list-style-type: none"> - Klima në shkollë dhe komponentët e ndryshëm të saj 	Kultura dhe mjedisi shkollor
<ul style="list-style-type: none"> - Qeverisja e shkollës dhe sistemit 	
Hyrjet në sistemin arsimor	
<ul style="list-style-type: none"> - Standardet edukative 	Kultura dhe mjedisi shkollor
<ul style="list-style-type: none"> - Hapësirat fizike dhe pajisjet 	
Proceset	
<ul style="list-style-type: none"> - Kurrikula 	
<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i nxënësve 	Mësimdhënia dhe nxënia
<ul style="list-style-type: none"> - Metodat e mësimdhënies dhe nxënies 	
<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënësit 	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve
<ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqësit e shkollës 	
Rezultatet	
<ul style="list-style-type: none"> - Shkalla e përfundimit të nivelit përkatës të shkollimit 	
<ul style="list-style-type: none"> - Shkalla e braktisjes 	Performanca e nxënësve
<ul style="list-style-type: none"> - Rezultatet e të nxënit (kualifikimet) 	

2.4.3. Vlerësimi i performancës së shkollës

Vlerësimi i performancës së shkollës, si një element i rëndësishëm i sistemit për sigurim të cilësisë, ka filluar të konsolidohet edhe në Kosovë. Ky proces komunikon me elementet e tjera të sistemit për sigurim të cilësisë, por edhe me reformën aktuale kurrikulare, duke u kontribuar kësioj qëndrueshmërisë, ndërlidhjes dhe koherencës në sistemin arsimor në Kosovë.

Ngjashëm me tendencat aktuale në vendet tjera evropiane, vlerësimi i performancës së shkollës në Kosovë ka karakter zhvillimor, ndërsa qasja e tij është e orientuar kah rezultatet e pritura të performancës. Mbi këtë bazë, vlerësimi i cilësisë së performancës së shkollës nuk përqendrohet në masat e aplikuar apo investimet (respektivisht hyrjet), por në rezultatet e arritura, respektivisht efektivitetin e masave të aplikuar drejt përmbushjes së funksionit të shkollës, respektivisht avancimit të nivelit të arritshmërisë së nxënësve.

Konceptet kryesore, parimet dhe procedurat për vlerësimin e performancës së shkollës, si dhe bartësit kryesorë të këtij procesi (përfshirë rolin dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve) përcaktohen me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2017 të MASHT-it për Vlerësimin e Performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar.

A. Vlerësimi i brendshëm i performancës së shkollës

Në Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar, vetëvlerësimi definohet si: “kontroll i planifikuar, sistematik, i standardeve në fushat e cilësisë, të përcaktuara nga MASHT-i, i cili kryhet nga shkolla në intervale të rregullta, duke u bazuar në kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës, siç përshkruhet në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës”. Sikurse pothuajse në të gjitha vendet e Evropës (në 27 sisteme arsimore), edhe në Kosovë vlerësimi i brendshëm i shkollës obligohet/rekomandohet nga niveli qendror. Gjithsesi, politikat për zbatimin e tij dallojnë mjaft dhe në shumicën e vendeve shkollat kanë autonomi të caktuar sa i përket realizimit të VBSH-së.

Në Kosovë, fushat, kriteret dhe treguesit e cilësisë janë përcaktuar në nivel qendror (përmes një procesi të gjerë konsultues dhe me përfshirje të shkollave) dhe vlejné edhe për vlerësimin e brendshëm edhe atë të jashtëm të shkollës. Nga shkollat pritet që me rastin e vetëvlerësimit të parë të përqendrohen në të gjitha fushat e përcaktuara me Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, ndërsa në vetëvlerësimet pasuese shkollat duhet të vlerësojnë së paku dy fusha të cilësisë, prej së cilave njëra është e përcaktuar në nivel qendror, ndërsa tjetra vendoset nga vetë shkolla.

Sa u përket palëve që duhet të përfshihen në procesin e VBSH-së në Kosovë, me UA 04/2017 të MASHT-it rregullohet përbërja e ekipit për vetëvlerësimin e shkollës, i cili është bartës i procesit (neni 13), por edhe e drejta dhe detyrimi i gjithë personelit shkollor për pjesëmarrje në vlerësimin e performancës së shkollës (neni 4). Pjesëmarrja e prindërve dhe nxënësve implikohet në mënyrë të tërthortë, përmes natyrës së

treguesve, shumica e të cilëve nuk mund të vlerësohen pa pjesëmarrjen e prindërve dhe nxënësve.

Mënyra e shfrytëzimit të rezultateve të vlerësimit të brendshëm kryesisht është në autonominë e personelit të shkollës, por në shumicën e sistemeve arsimore autoritetet qendrore japin indikacione rreth shfrytëzimit të gjetjeve të vlerësimit të brendshëm për përmirësimin e cilësisë së shkollave. Edhe në Kosovë shkollat duhet të shfrytëzojnë gjetjet e vlerësimeve të brendshme për të planifikuar masat e përmirësimit. Sa i përket publikimit të rezultateve të vlerësimit të brendshëm, një gjë e tillë (si në shumicën e vendeve të tjera evropiane) nuk kërkohet nga shkollat.

Në lidhje me përkrahjen e shkollave për realizimin e vetëvlerësimeve, edhe në Kosovë, sikur në pothuajse të gjitha vendet e tjera, janë vënë në dispozicion masa dhe instrumente përkrahëse për realizimin e vlerësimit të brendshëm. Edhe spektri i masave është pothuaj i njëjtë me masat në vendet e tjera, përfshirë:

- Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës;
- Programin e trajnimeve në fushën e vlerësimit të brendshëm;
- Udhëzues dhe doracakë për vlerësimin e brendshëm të shkollës;
- Këshillime nga institucioni, i cili pritet të përcaktohet nga MASHT-i.

Një praktikë shumë e shpeshtë në vendet tjera janë edhe forumet ‘online’ të vlerësimit, të cilat në Kosovë ende nuk praktikohen mjaftueshëm. Sa i përket përkrahjes financiare, ajo është masa e fundit që vihet në dispozicion për shkollat, pasi që ofrohet vetëm në Spanjë dhe në Kroaci. Gjithsesi, kuadri rregullativ i shkollave (përfshirë përkrahimin e detyrave të mësimdhënësve, normimin e punës së tyre dhe angazhimin e personelit profesional) duhet të jetë i favorshëm për të mundësuar aktivitetet e shkollës për sigurim të cilësisë.

B. Vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës

Në Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Performancës së Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar, vlerësimi i jashtëm definohet si “kontroll i planifikuar, sistematik, i standardeve në fushat e cilësisë, të përcaktuara nga MASHT-i, i cili kryhet në intervale të rregullta nga inspektorët e arsimit, në bazë të kriterëve të cilësisë dhe treguesve të performancës, të përcaktuar me Kornizën për Sigurimin e Cilësisë”.

Ngjashëm me përvojën e vendeve tjera evropiane, bartës kryesor i vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës është Inspektorati i Arsimit, krahas rolit të caktuar që kanë edhe autoritetet e tjera të nivelit qendror (MASHT), autoritetet e nivelit lokal, si dhe vetë shkollat¹². Kriteret e përzgjedhjes së vlerësuesve të jashtëm në Kosovë, respektivisht kërkesat sa i përket kualifikimit të tyre, janë po ashtu në linjë me përvojat

¹² Roli dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve janë përcaktuar me UA të MASHT-it nr. 4/2017, për Vlerësimin e Performancës së Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar, nenet 9-12.

e mira të vendeve të tjera në Evropë.

Kriteret e cilësisë. Sa u përket kriterëve për vlerësimin e jashtëm, edhe në Kosovë vlerësuesit bazohen në një kornizë të vendosur në nivel qendror, e cila përcakton në mënyrë të strukturuar jo vetëm aspektet kryesore të vlerësimit të jashtëm, por edhe standardet e “shkollës së mirë”. Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës i definojnë ato si nënndarje të fushave të cilësisë, të cilat shërbejnë për të siguruar qasje më sistematike gjatë mbledhjes së të dhënave dhe koherencë në mes të dy proceseve të vlerësimit (të jashtëm dhe të brendshëm). Nisur nga nevoja që sistemi për sigurim të cilësisë të komunikojë edhe me reformën kurrikulare në vend, kriteret e vlerësimit janë përcaktuar bazuar në ndërveprimin në mes të fushave të cilësisë dhe parimeve të Kornizës së Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar në Kosovë.

Edhe në Suedi ku Inspektorati ka autonomi në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, ato i bazon në kuadrin ligjor dhe rregullativ të punës së shkollave, si dhe në kurrikulat e arsimit të obliguar. Ndërsa dallim bën Danimarka, ku procesi i vlerësimit të jashtëm dizajnohet nga komunat, si dhe Franca, ku vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës përqendrohet vetëm në personelin individual të shkollës dhe nuk bazohet në ndonjë protokoll standard që definojnë përmbajtjen dhe procedurat e vlerësimit.

Procedura e vlerësimit të jashtëm. Procedura e vlerësimit të jashtëm është pothuajse homogjene në të gjitha vendet evropiane dhe, sikurse edhe në Kosovë, konsiston në tre hapa kryesorë: analizë, vizita dhe raportim. Spektri i instrumenteve dhe udhëzimeve që vihen në dispozicion dallon nga vendi në vend, por gjithsesi sigurohen në të gjitha rastet.

Shfrytëzimi i gjetjeve të vlerësimit. Në pajtim me qasjen e orientuar kah shteti, me ç’rast përgjegjësia e shkollave është para së gjithash ndaj shtetit, i cili bën shpërndarjen e nxënësve në shkolla, sipas kriterëve të paracaktuara (si në rastin e Sllovenisë, Turqisë, Francës e Qipros), raporti i gjetjeve të vlerësimit në Kosovë nuk parashihet që të bëhet publik¹³. Në këto raste, menaxhimi i masave për përmirësimin e performancës së shkollës (sanksione, subvencione, përkrahje apo tjetër) bëhet nga shteti. Në rastin e Kosovës, raporti i përgjithshëm i vlerësimit të jashtëm dhe raportet e veçanta për secilën shkollë parashihet të jenë referencë për mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve arsimore të shkollave në veçanti dhe të sistemit të arsimit në përgjithësi, nga ana e autoriteteve komunale dhe/apo atyre qendrore të arsimit. Në këtë mënyrë mundësohet identifikimi i sfidave, arritjeve, tendencave dhe një planifikim i bazuar në fakte për ngritjen e cilësisë së arsimit në vend dhe/apo në komunë.

Në sistemet e orientuara kah tregu (Belgjika - Komuniteti flaman, Irlanda, Lituania, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar - Anglia, Uellsit dhe Irlanda Veriore) raporti bëhet publik, duke provokuar një dinamikë tregu, pasi që prindërit dhe nxënësit kanë liri të plotë të zgjedhjes së shkollës dhe shkollat duhet të garojnë për nxënës. Në këto raste raporti (i cili bëhet publik) influencon zgjedhjen e prindërve, e si rrjedhojë u bën

¹³ Për shfrytëzimin e gjetjeve të vlerësimit dhe kategorizimin e sistemeve të llogaridhënies shih më tepër detajet e dhëna në pikën 3.1. të këtij kapitulli.

presion shkollave që të përmirësojnë performancën e tyre¹⁴.

C. Relacioni ndërmjet vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm

Rekomandimet e fundit, të bazuara në hulumtimet krahasuese të realizuara në vendet e BE-së, por edhe parimet e propozuara nga Grupi Punues i KE-së për shkollat, theksojnë nevojën për koherencë dhe sinergji më të lartë ndërmjet proceseve dhe mekanizmave të ndryshëm për sigurim të cilësisë, me theks të veçantë në ndërveprim sa më efektiv ndërmjet elementeve të sistemeve të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm.

Sikur në 31 sisteme të tjera arsimore në Evropë, edhe sistemi për sigurim të cilësisë në Kosovë parasheh që shkollat të realizojnë vlerësimet e brendshme dhe të vlerësohen nga vlerësuesit e jashtëm. Po ashtu, ndërvarësia ndërmjet dy proceseve edhe në Kosovë parashihet që të manifestohet përmes shfrytëzimit të gjetjeve të vlerësimit të brendshëm nga vlerësuesit e jashtëm. Praktika më e shpeshtë është që gjetjet e vetëvlerësimit të analizohen gjatë fazës përgatitore për vlerësim të jashtëm, bashkë me informacionet e burimeve tjera. Por, në Kosovë këto dy procese kanë edhe lidhje organike. Vlerësimi i jashtëm shërben si metavlerësim, duke mbivlerësuar procesin e vetëvlerësimit të shkollës me qëllim (a) analizën e kapacitetit të shkollës për vetëvlerësim, (b) për shfrytëzimin e gjetjeve të vetëvlerësimit për planifikim të përmirësimit/avancimit të cilësisë dhe (c) identifikimin e pikave të dobëta, respektivisht nevojave për përkrahjen e shkollave në procesin e vetëvlerësimit dhe planifikimit zhvillimor.

Sa i përket autonomisë së shkollës për procesin e vetëvlerësimit, ajo mund të ketë dimension nga poshtë-lart, apo mund të jetë plotësisht e informuar nga strategjitë prej lart-poshtë. Siç është potencuar edhe te analiza e gjendjes në Evropë, në rastet kur qasja është nga poshtë-lart, autoritetet arsimore ndikojnë përmbajtjen e vlerësimit të brendshëm përmes rekomandimeve për shfrytëzimin e listës së paracaktuar të kriterëve, duke ofruar udhëzues dhe doracakë, apo përmes vënies në dispozicion të treguesve që u mundësojnë shkollave të krahasohen me njëra-tjetrën. Në Kosovë, përveç Kornizës së përbashkët për sigurim të cilësisë, nga shkollat pritet që të vlerësojnë së paku dy fusha të cilësisë, prej së cilave njëra është e përcaktuar në nivel qendror, ndërsa tjetra vendoset nga vetë shkolla. Edhe fokusi i vlerësimit të jashtëm imponohet nga shkolla, pasi që ai duhet të vlerësojë fushat e cilësisë që kanë qenë objekt i vetëvlerësimit të shkollës, duke gërshetuar kështu qasjen nga poshtë-lart dhe nga lart-poshtë.

¹⁴ Vendet e tjera nuk kanë përcaktim të artë të njërit apo tjetrit vizion, p.sh. Estonia, Polonia, Portugalia dhe Islanda, ku raportet bëhen publike, edhe pse mundësia për përzgjedhjen e shkollës nga prindërit apo nxënësit pothuajse nuk ekziston fare apo rastet si Italia, Latvia, Spanja, ku ekziston pothuajse liri e plotë me përzgjedhjen e shkollave, por raportet nuk bëhen publike.

D. Ngritja e kapaciteteve për sigurim të cilësisë dhe vlerësim të performancës së shkollës

Projekti i binjakëzimit, i financuar nga BE-ja, “Mbështetje për Zbatimin e Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011-2016”, një mbështetje të veçantë e ka ofruar për ngritjen e kapaciteteve të drejtorëve të shkollave, koordinatorëve të cilësisë në shkolla, koordinatorëve të cilësisë në DKA dhe inspektorëve të arsimit, për rolin e tyre në sigurimin e cilësisë në arsim, përkatësisht në shkollë. Projekti ka trajnuar 124 drejtorë të shkollave dhe 180 koordinatorë të SC-së me bazë në shkollë, për rolin e tyre në drejtimin e proceseve të reja të SC-së, si dhe ka trajnuar dhe certifikuar 11 trajnerë lokalë për realizimin e programit të trajnimit për koordinatorët e sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, për nevojat për trajnim të DKA-ve dhe inspektorëve të shkollave për të përmbushur rolin e tyre të ri në zhvillimin e cilësisë janë identifikuar, janë trajnuar 24 koordinatorë të SC-së nga DKA-të dhe 40 inspektorë të arsimit. Nga grupi i 40 inspektorëve të arsimit të trajnuar për SC, në bashkëpunim me IPK-në, 17 inspektorë të arsimit janë trajnuar për realizimin e vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës (Komisioni Evropian, Raporti përfundimtar i Projektit të Binjakëzimit, 2017).

IPK-ja me mbështetje financiare nga UNICEF-i dhe MASHT-i ka ofruar trajnimin e drejtorëve të shkollave dhe koordinatorëve të cilësisë për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës. Programi i trajnimit, i ofruar për vlerësim të brendshëm të performancës së shkollës, për shkak të natyrës praktike të punës, është organizuar në tri punëtori dhe është ofruar në pesë ditë trajnimi në qendra të trajnimit dhe përmes takimeve mentoruese dhe këshillimeve nga trajnerët, në bazë të drafteve të produkteve të nxjerra nga ekipet për vlerësim të brendshëm në shkollë. Punëtorja e parë, njëditore¹⁵, kishte karakter informativ dhe karakterizohej me prezantime të temave nga trajnerët, punë praktike me pjesëmarrës, diskutime dhe reflektime të ndërlidhura me aktivitetet e zhvilluara në trajnim. Punëtorja e dytë, dyditore¹⁶, kishte në fokus përgatitjen e përfaqësuesve të shkollës për punë me ekipin e vlerësimit të brendshëm në shkollë. Punëtorja e tretë, njëditore, është organizuar në dy pjesë. Në sesionet e paradites janë shkëmbyer përvojat e shkollave në realizimin e vlerësimeve të brendshëm në një fushë të cilësisë, ndërsa në sesionet e pasdites janë dhënë orientime për finalizimin e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe rishikimin/hartimin e planeve zhvillimore të shkollave, në bazë të rezultateve të vlerësimit të brendshëm të shkollave të tyre.¹⁷

Programi i trajnimit për vlerësim të brendshëm të shkollës është ofruar në tri faza. Në

¹⁵ Çështjet kryesore që trajtohen gjatë punëtorisë së parë përfshijnë si vijon:

- Zhvillimet në reformën arsimore në Kosovë;
- Parimet e KKAP-së dhe ndikimi i tyre në performancën e shkollës;
- Qëllimi, funksioni dhe përmbajtja e Kornizës për VPSH;
- Roli i ri i shkollës- pritsmëritë e reja nga shkolla;
- Korniza e VPSH-së, mbulueshmëria dhe funksioni i fushave të cilësisë, kritereve dhe treguesve.

¹⁶ Çështjet kryesore që trajtohen gjatë punëtorisë së dytë, përfshijnë si vijon:

- Sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës;
- Parimet e vetëvlerësimit të shkollës;
- Hapat kryesorë të vetëvlerësimit të shkollës (përgatitja, mbledhja e të dhënave, vlerësimi i performancës së shkollës);
- Raporti i vetëvlerësimit të shkollës.

¹⁷ Më gjerësisht, shih katalogun e programeve të akredituara dhe të aprovuara për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të arsimit, MASHT 2017, f. 163 -164.

fazën e parë janë përfshirë 69 shkolla nga të gjitha komunat e Kosovës, shkollat që ishin në zbatim të kurrikulës së re¹⁸. Trajnimet me përfaqësuesit e këtyre shkollave janë mbajtur në nivel rajoni, në këto komuna: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Në trajnime kanë marrë pjesë 156 pjesëmarrës, me pozita dhe role të ndryshme në shkollë: drejtorë, zëvendësdrejtorë, pedagogë të shkollave, koordinatorë të cilësisë, koordinatorë të kurrikulës dhe mësimdhënës nga shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta – gjimnazet (IPK, Raporti 1 për UNICEF). Në fazën e dytë të trajnimeve për VBSH, të realizuara deri në prill 2017, janë trajnuar 126 përfaqësues të 63 shkollave (2 përfaqësues nga një shkollë) në komunat Podujevë, Vushtrri, Drenas, Klinë dhe Suharekë (IPK, Raporti 2 për UNICEF), ka përfshirë katër punëtori për një grup dhe dy ditë të mentorimit. Ndërsa, në fazën e tretë të trajnimeve për VBSH, të realizuara në periudhën shtator – nëntor 2017, janë trajnuar 172 përfaqësues të 86 shkollave (2 përfaqësues nga një shkollë) në këto komuna: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Trajnimi në këtë fazë është realizuar me përfshirje edhe të koordinatorëve të cilësisë në DKA (IPK, Raporti 3 për UNICEF). Pra, në trajnimet për vlerësim të brendshëm të performancës së shkollës kanë marrë pjesë 454 nga 218 shkolla.

Ndërkohë, gjatë vitit 2017, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), me mbështetje nga “KulturKontakt Austria”, në kuadër të projektit “Twinning Follow up”, ka organizuar dy faza të punëtorive, me 5 grupe të shkollave të para të përfshira në programin për vlerësim të performancës së shkollës. Faza e parë e punëtorive dyditore është realizuar në periudhën mars-prill 2017, ndërsa faza e dytë e punëtorive është realizuar në dhjetor të vitit 2017. Në kuadër të kësaj mbështetje nga “KulturKontakt Austria”, në qershor 2017 është mbajtur edhe konferenca dyditore, me pjesëmarrës të 69 shkollave të para të përfshira në programin për vlerësim të performancës së shkollës dhe të aktorëve të tjerë, në nivel qendror dhe lokal. Temë kryesore e punëtorive dhe konferencës ishte zbatimi i ciklit për sigurim të cilësisë, me fokus përdorimin e rezultateve të vlerësimit të brendshëm/vetëvlerësimit për rishikimin/hartimin e planit të zhvillimit të shkollës dhe planin vjetor/planin e veprimit. Nga kontrolli në veprim dhe realizimi i prioriteteve të shkollave për vitin 2017 (Kabashi, A. Raporti për “KulturKontakt Austria”, 2017).

¹⁸ Mostra e shkollave të përfshira në këtë studim është nga ky grup i shkollave, të cilat trajnimin për vlerësimin e brendshëm të shkollës e kanë përfunduar në fillim të dhjetorit të vitit 2016.

KAPITULLI III

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ky kapitull prezanton një përshkrim të metodologjisë së përdorur në këtë studim. Zhvillimi i metodologjisë dhe përgatitja për hulumtim janë bërë pas shqyrtimit të dokumenteve në dispozicion, raporteve të shkollave për vlerësim të brendshëm dhe në konsultim me ekipin hulumtues nga IPK-ja. Në zhvillim të metodologjisë është marrë parasysh konteksti i zhvillimeve në Kosovë për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore, me qëllim marrjen e një perspektive më objektive të aspekteve që janë në fokus të studimit. Në pjesën në vijim do të pasqyrohen modeli i studimit, popullata dhe mostra e studimit, instrumentet e studimit, procedura e mbledhjes së të dhënave dhe analiza e të dhënave.

3.1. Modeli i studimit

Qasja hulumtuese e përdorur në këtë studim është mikse, sasiore dhe cilësore. Kjo qasje është përdorur në bazë të objektivave dhe pyetjeve kërkimore, të cilat kanë orientuar se nevojiten të dhëna sasiore dhe cilësore, si dhe në bazë të modelit të studimit krahasues dhe vlerësues. Zakonisht modelet e hulumtimit krahasues përdoren më së shumti në fushën e studimit të politikave, shqyrtimit të një aspekti, të një çështjeje apo karakteristike të veçantë. Ndërsa modelet vlerësuese pyesin nëse një program ose projekt i ka arritur qëllimet e parapara, vlerëson se sa mirë ka funksionuar një proces, nëse një ndërhyrje apo ndryshim i caktuar ka sjellë rezultatet e synuara, shqyrton se si mund të përmirësohet një ndërhyrje apo proces etj. (Matthews & Ross, 2010).

Përmes modelit krahasues të hulumtimit, u bë një shqyrtim i hollësishëm i politikave, procedurave dhe qasjeve ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë me vendet e BE-së. Rezultatet krahasuese u prezantuan në kapitullin e dytë të këtij studimi. Ndërsa modeli vlerësues i hulumtimit u përdor për të vlerësuar praktikën e zbatimit të vlerësimit të brendshëm në shkollat e para të Kosovës të përfshira në programin për vlerësimin e performancës së shkollës, materialet e zhvilluara për performancë të shkollës, trajnimet dhe praktikatat e tjera mbështetëse për realizimin e procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, efektet e përvojave të para në zhvillimin e shkollës, rolin e përfaqësuesve të shkollave në këtë proces, si dhe për të shqyrtuar mundësitë se si mund të përmirësohet procesi i vlerësimit të performancës së shkollës. Kapitulli i tretë prezanton rezultatet e studimit të realizuara në bazë të modelit vlerësues të hulumtimit.

3.2. Popullata dhe mostra

Popullata e studimit. Në programin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës në vitin shkollor 2016/2017 janë përfshirë 69 shkollat e para që filluan zbatimin e kurrikulës së re, pas përfundimit të fazës së pilotimit të kurrikulës. Në bazë të rolit të subjekteve në procesin e VBSH-së, popullacioni i hulumtimit për një shkollë përbëhet nga dy shtresa. Shtresa e parë përfshin përfaqësuesit e shkollës që kanë rol në procesin e realizimit të vlerësimit të brendshëm, ku përfshihen drejtori i shkollës, koordinatori i cilësisë ose personi që e ushtron këtë pozitë dhe ekipi për vlerësim të brendshëm, me përbërje prej 3-5 përfaqësues të shkollës (mësimdhënës dhe anëtarë nga shërbimi profesional i shkollës). Ndërsa shtresa e dytë e popullacionit përbëhet nga nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit e përfshirë nga shkolla, sipas kriterëve të përfshirjes në ofrimin e informacioneve për vlerësim të performancës së shkollës në treguesit e performancës dhe kriteret përkatëse të cilësisë së punës së shkollës.

Në bazë të këtyre të dhënave, popullacioni nga shkollat në këtë studim përbëhet prej 2484 subjekteve, prej tyre 1104 anëtarë të stafit të shkollës (drejtorë dhe zv.drejtorë të shkollave, koordinatorë të cilësisë, udhëheqës të aktiveve profesionale, shërbimi profesional në shkollë, anëtarë të ekipit për vetëvlerësim të shkollës dhe mësimdhënës të përfshirë në procesin e VBSH-së, pa ndonjë rol të veçantë në realizimin e VBSH), 690 nxënës dhe 690 prindër, të përfshirë në procesin e vlerësimit të brendshëm, në bazë të rolit të tyre të prezantuar me pakon e dokumenteve për VBSH.

Përveç popullacionit në nivel shkollë, në popullacion të studimit janë përfshirë edhe 17 inspektorët arsimorë, përkatësisht grupi i parë i inspektorëve të trajnuar për vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës dhe 24 koordinatorët e cilësisë në DKA, po ashtu të trajnuar për të përmbushur rolin e tyre në procesin e sigurimit të cilësisë së arsimit në nivel komune.

Mostra e studimit. Nga popullacioni i paraqitur më lart, mostra është përzgjedhur me anë të probabilitetit, në mënyrë që të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe reprezentative. Përveç përzgjedhjes së mostrës, e cila ka qenë e parapërcaktuar, në bazë të rolit që kanë pasur në realizimin e procesit të VBSH-së (drejtorët, zv.drejtorët, koordinatorët e cilësisë dhe anëtarët e ekipit për vlerësim të brendshëm), mostra e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve, është marrë nga lista e përfshirjes së tyre nga shkolla, me rastin e realizimit të procesit të VBSH-së.

Si janë përzgjedhur shkollat dhe mostra nga këto shkolla për përfshirje në hulumtim? Mostra e shkollave për përfshirje në këtë studim është përzgjedhur duke përdorur strategjinë e mostrës të tipit rastësor grupor. Fillimisht është marrë lista e 69 shkollave të përfshira në programin e vlerësimit të brendshëm të shkollës në vitin shkollor 2016/2017. Pastaj, nga lista e përgjithshme e shkollave janë ndarë tri grupe të shkollave, në bazë të numrit të nxënësve:

- grupi i parë i shkollave përbëhet nga shkollat deri në 500 nxënës,
- grupi i dytë i shkollave mbi 500 – 1000 nxënës dhe
- grupi i tretë i shkollave me mbi 1000 nxënës.

Me qëllim që përfaqësimi i shkollave të jetë sa më gjithëpërfshirës, në mënyrë rastësore, janë marrë mbi 50% e shkollave nga të tri grupet. Në bazë të kriterit rastësor, janë përfshirë 6 shkolla me numër të nxënësve deri në 500, 16 shkolla me numër të nxënësve mbi 500-1000 dhe 17 shkolla me numër të nxënësve mbi 1000.

Bazuar në numrin e nxënësve në vitin shkollor 2016/2017, nga shkollat e përzgjedhura është përcaktuar edhe struktura dhe numri i përfshirjes në studim, përfshirë numrin e stafit menaxhues të shkollës që kanë pasur rol në realizimin e VBSH-së (drejtorët, zv.drejtorët, koordinatorët e cilësisë, anëtarët e EVV-së dhe anëtarë nga shërbimi profesional i shkollës), mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve të përfshirë nga shkolla në procesin e mbledhjes së të dhënave për VBSH. Struktura e përfshirjes sërisht bazohet në numrin e nxënësve:

- Shkollat me numër të nxënësve deri në 500: 4 nga stafi menaxhues, 3 nga stafi i mësimdhënësve, 5 nxënës dhe 2 prindër, të mostrës së VBSH-së;
- Shkollat me nxënës mbi 500 - 1000: 5 nga stafi menaxhues, 5 nga stafi i mësimdhënësve, 7 nxënës dhe 3 prindër, të mostrës së VBSH-së;
- Shkollat me mbi 1000 nxënës: 6 nga stafi menaxhues, 7 nga stafi i mësimdhënësve, 10 nxënës dhe 5 prindër, të mostrës së VBSH-së.

Tabela 1

Numri i shkollave dhe struktura e përfaqësuesve të mostrës së përfshirë në studim

Nr.	Grupimi i shkollave sipas numrit të nxënësve	Numri i shkollave	Struktura e përfaqësuesve të mostrës së shkollës				Gjithsej	
			Stafi menaxhues ¹	Mësimdhënës	Nxënës	Prindër	Nr.	%
1	Shkollat me numër të nxënësve deri në 500	6	24	18	30	12	84	9,55
2	Shkollat me numër të nxënësve mbi 500 -1000	16	80	80	112	48	320	36,36
3	Shkollat me numër të nxënësve mbi 1000	17	102	119	170	85	476	54,09
Gjithsej:		39	206	217	312	145	880	100,0
%			23,41	24,66	35,45	16,48		

¹ Drejtorët, zv.drejtorët, koordinatorët e cilësisë, anëtarët e EVV-së dhe anëtarë nga shërbimi profesional i shkollës.

Nga kjo strukturë e subjekteve të shkollës, 807 subjekte të 39 shkollave i kanë plotësuar instrumentet e hulumtimit në bazë të metodologjisë së përcaktuar, ose 32.5% e popullacionit të shkollave të përfshira në programin e vlerësimit të performancës së shkollës, prej tyre nga stafi i shkollës 387 (udhëheqës të shkollave, koordinatorë të cilësisë, anëtarë të EVV-së dhe mësues), 299 nxënës dhe 121 prindër mësues.

Mostra e inspektorëve arsimorë dhe koordinatorëve të cilësisë në DKA është përzgjedhur nga lista e siguruar nga Projekti i binjakëzimit, për inspektorët arsimorë të trajnuar për vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës dhe nga lista e koordinatorëve të cilësisë në DKA, të trajnuar për përmbushjen e rolit të tyre në procesin e sigurimit të cilësisë në arsim në nivel komune. Mostrën e inspektorëve arsimorë dhe të koordinatorëve të cilësisë në DKA e përbëjnë 3 inspektorë të arsimit të trajnuar për vlerësim të performancës së shkollës, apo 17.65% e inspektorëve të trajnuar dhe 4 koordinatorë të cilësisë në DKA, apo 16.67% e popullacionit të koordinatorëve të cilësisë në DKA, të trajnuar në këtë komponentë.

3.3. Instrumentet e hulumtimit

Për mbledhjen e të dhënave, kemi zhvilluar tre pyetësorë, si instrument kryesor, pyetjet e të cilëve janë hartuar në bazë të pyetjeve kërkimore të prezantuara në kapitullin e parë të këtij studimi si dhe nënpyetjet kërkimore¹⁹, objektivat e studimit dhe supozimet e ngritura për çështjet në fokus të studimit. Ndërsa për të dhënat e tjera kemi përdorur edhe protokollin e intervistës dhe listë kontrolli.

Përveç të dhënave demografike, struktura e instrumenteve të zbatuara për mbledhjen e të dhënave për hulumtim është:

- Tre pyetësorë për anketim të kategorive të mostrës së përfshirë në studim, adresuar komponentë të ndryshëm të praktikave të vlerësimit të brendshëm të shkollës. Pyetësorët janë ndërtuar në pesë shkallët e vlerësimit Likert (5= *Pajtohem plotësisht*, 4= *Pajtohem*, 3 = *Neutral*, 2= *Nuk pajtohem*, 1= *Fare nuk pajtohem*);
- Një protokoll i intervistës;
- Një listë kontrolli për analizën e raporteve të vlerësimit të brendshëm të shkollave të përfshira në studim.

Pyetësori për stafin e shkollës - Janë përfshirë drejtori ose zv.drejtori, koordinatorët të cilësisë, anëtarët e ekipit për vlerësim të brendshëm, stafit profesional (pedagog/psikolog), udhëheqësit e aktiveve profesionale, mësuesit të angazhuar në përkrahje të ekipit të shkollës për vlerësim të brendshëm dhe mësuesit të përfshirë në mostrën e shkollës për vlerësim të brendshëm. Me anë të këtij pyetësori,

¹⁹ Nënpyetjet kërkimore mundësojnë zhvillimin e instrumenteve dhe lidhjet ndërmjet variablave të marrë për këtë studim. Ato ishin si në vijim:

kemi marrë qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre për praktikatat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, Pyetëtori përbëhet nga 5 seksione dhe 71 kërkesa. Seksioni i parë përmban 12 informacione demografike për stafin e shkollës. Seksioni i dytë përmban 28 kërkesa që matin perceptimet e stafit të shkollës lidhur me fazën përgatitore dhe praktikatat e shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm. Seksioni i tretë përmban 9 kërkesa që matin perceptimet e stafit të shkollës lidhur me materialet, trajnimin dhe mbështetjen e shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm. Seksioni i katërt përmban 17 kërkesa që matin perceptimet e stafit të shkollës lidhur me efektet e procesit të vlerësimit të brendshëm. Ndërsa, seksioni i pestë përbëhet nga pesë pyetje të hapura, nëpërmjet së cilave morëm qëndrimet e stafit të shkollës rreth perspektives së zbatimit të vlerësimit të brendshëm shkollës.

Pyetëtori për nxënës - Për nxënësit e përfshirë në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Nëpërmjet këtij pyetëtori mblodhëm perceptimet e nxënësve për praktikatat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm. Pyetëtori përbëhet nga dy seksione: i pari, të dhëna demografike me 8 kërkesa, i dyti 20 pyetje/kërkesa të lidhura me fushën e studimit. Vetëm një prej pyetjeve është e hapur, me të cilën morëm komente, sugjerime, lidhur me përfshirjen e nxënësve dhe procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.

Pyetëtori për prindër - Të përfshirë në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Ka dy seksione: i pari përmban 10 kërkesa për informacione demografike të prindërve, ndërsa i dyti 20 pyetje/kërkesa për përfshirjen e prindërve në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës si dhe perceptimet e tyre për praktikatat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm. Vetëm një kërkesë për prindër ishte e hapur, nëpërmjet së cilës morëm sugjerime lidhur me përfshirjen e nxënësve dhe procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.

-
- a) Cilat janë karakteristikat e subjekteve të përfshira në procesin e VBSH-së, në bazë të rolit të tyre në këtë proces?
 - b) Çfarë janë këndvështrimet e përfaqësuesve të shkollave të përfshira në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës për:
 - informimin dhe përgatitjen e shkollës në realizimin e VBSH-së,
 - praktikën e udhëhequr nga shkolla për realizimin e VBSH-së,
 - materialet dhe mbështetjen profesionale në realizimin e VBSH-së,
 - efektet e para të VBSH-së dhe
 - përmirësimin e cilësisë së procesit të VBSH-së.
 - c) A ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve, për koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së me rolin e tyre në këtë proces?
 - d) A ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të stafit të shkollës për koordinimin dhe udhëheqjen e VBSH-së me përfshirjen e tyre në programet e trajnimit të lidhura me fushën e studimit?
 - e) A ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të personelit udhëheqës dhe koordinues sipas tipave të shkollës të shkollës (SHFMU, Gjimnaz) për mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së?
 - f) A ka ndërlidhje midis rolit të personelit të shkollës të përfshirë në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës dhe nivelit të qëndrimeve të tyre për efektet e para të këtij procesi?
 - g) A ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të inspektorëve të arsimit dhe KC në DKA lidhur me interesimin dhe përkushtimin institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë?
 - h) Çka tregojnë raportet e vlerësimit të brendshëm të shkollës për përvojat e para të vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë – respektimi i kërkesave dhe procedurave të vlerësimit, mësimet e nxjerra dhe sfidat gjatë realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës?

Protokolli i intervistës me inspektorë të arsimit dhe koordinatorë të cilësisë në DKA - Përbëhet nga 15 pyetje lidhur me dokumentet për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë dhe vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore, përvojat në procesin e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore, planet e veprimit për përmbushjen e rolit të tyre në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës dhe perspektivën e zbatimit në praktikë të politikave arsimore për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë, në mënyrë të veçantë të sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës.

Listë kontrolli për analizën e raporteve të vlerësimit të brendshëm të shkollës - Është ndarë në tetë kategori që mbulojnë hapat kryesorë të VBSH-së:

Në kategorinë e parë janë përfshirë tregues që lidhen me fazën përgatitore të vlerësimit të brendshëm të shkollës, si: Vendimi për themelimin e ekipit për vlerësim të brendshëm (EVV); detyrat dhe përgjegjësitë e EVV-së; dispozitat që krijojnë kushte për të përmbushur funksionin e vet EVV-së; plani i punës së EVV-së; plani i aktiviteteve kryesore të procesit të vetëvlerësimit, përfshirë afatet kohore dhe bartësit e aktiviteteve.

Në kategorinë e dytë përfshihen tregues për identifikimin e burimeve të të dhënave dhe përzgjedhjen e mostrës së shkollës për përfshirje në vlerësim të brendshëm, si: listën e dokumentacionit shkollor që do të përdoret për mbledhjen e të dhënave, kriteret për përzgjedhjen e mostrës së nxënësve, kriteret për përzgjedhjen e mostrës së prindërve dhe kriteret për përzgjedhjen e mostrës së mësimitdhënësve.

Në kategorinë e tretë përfshihen tregues për përzgjedhjen dhe përgatitjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, si: llojet e instrumenteve të shfrytëzuara dhe përgatitja e instrumenteve. Në kategorinë e katërt përfshihen tregues për mbledhjen dhe analizën e të dhënave nga dokumentacioni pedagogjik dhe subjektet në nivel shkolle.

Në kategorinë e pestë përfshihen tregues për vlerësimin në nivel të kriterëve të cilësisë, si: përshkrimi i gjendjes në treguesit e performancës – qasja koncize, informatat për gjendjen dhe faktet e ofruara për tregues, si dhe shkalla e cilësisë në nivel të kriterëve - në ndërlidhje me përshkrimet e bëra në treguesit e performancës.

Në kategorinë e gjashtë përfshihen tregues për vlerësimin në nivel të fushave të cilësisë së shkollës, si: shkalla e cilësisë reflekton vlerësimin e bërë në nivel të kriterëve; përshkrimi i performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë, i cili përmban nga një konstatim përmbledhës për secilin kriter; konstatimet përmbledhëse për kritere që reflektojnë gjendjen e evidentuar në raport me treguesit (për kriterin përkatës); përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë janë identifikuar, evidencat/burimet e shfrytëzuara janë të mjaftueshme dhe relevante.

Në kategorinë e shtatë përfshihen tregues për vlerësimin e përgjithshëm në nivel shkolle, si: shkalla e cilësisë reflekton vlerësimin e bërë në nivel të fushave të cilësisë; përshkrimi i performancës së shkollës përmban nga një konstatim përmbledhës për secilën fushë të cilësisë; konstatimet përmbledhëse për fusha të cilësisë reflektojnë gjendjen e evidentuar për kriteret e cilësisë (në kuadër të fushës përkatëse); përparësitë

dhe dobësitë e performancës së shkollës në nivel të përgjithshëm janë identifikuar; trendi i performancës së shkollës dhe përkushtimi i saj për përmirësim, respektivisht avancim të vazhdueshëm është përshkruar; rekomandimet e ofruara përmbajnë zgjidhjet e mundshme dhe masat e nevojshme për tejkalimin e dobësive dhe/apo përforcimin e anëve të forta.

Në kategorinë e tetë përfshihen tregues për raportin përmbledhës të vlerësimit të brendshëm /vetëvlerësimit, si: raporti përmbledhës është përgatitur nga EVV, raporti respekton strukturën/përmbajtjen e propozuar me UVB, raporti ofron një bazë të mirë për rishikimin e PZSHH-së dhe për përgatitjen e planit vjetor të veprimit.

3.3.6. Besueshmëria e pyetësorit të realizuar me stafin e shkollës

Besueshmërinë e instrumentit me stafin e shkollës (drejtorë dhe zv.drejtorë të shkollave, koordinatorë të cilësisë, kryetarë të aktiveve profesionale, shërbimi profesional në shkollë, anëtarë të ekipit për vetëvlerësim të shkollës dhe mësimdhënës të përfshirë në procesin e VBSH-së dhe atyre të përfshirë në mostër) e kemi bërë përmes analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) dhe KMO and Bartlett's Test. Rezultati i testimeve në kuadër të programit SPSS për 54 kërkesa që ndërlidhen me praktikat e realizimit të procesit të VBSH-së, mbështetjes së ofruar në këtë proces, si dhe për efektet e para të këtij procesi në shkollat e përfshira në studim, rezultoi të jetë ($\alpha=.920$), ndërsa KMO Bartlett's Test =.919, Sig.=.000. Sipas kësaj del se pyetësori ka qenë i besueshëm.

Analiza e koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) dhe KMO and Bartlett's Test, e bërë ndaras për katër faktorët që grupojnë pyetje të instrumentit me stafin e shkollës për (i) informimin dhe përgatitjen e shkollës për realizimin e VBSH, (ii) praktikat e realizimit të procesit të VBSH-së, (iii) mbështetjen e ofruar në këtë proces, si dhe për efektet e para të këtij procesi në shkollat e përfshira në studim, rezultojë të jetë më vlera të larta të besueshmërisë për analiza të tjera faktoriale. Vlerat e analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) sipas faktorëve që grupojnë pyetjet për stafin e shkollës, janë si në vijim:

1. Informimi dhe përgatitja: $\alpha = .88$
2. Praktikrat e realizimit: $\alpha = .88$
3. Mbështetja e ofruar: $\alpha = .81$
4. Efektet e para: $\alpha = .92$

3.4. Procedura e mbledhjes së të dhënave

Yin përshkroi në hollësi burimet e ndryshme të evidencës dhe parimet e mbledhjes së të dhënave në një studim kërkimor dhe rekomandon që studiuesit në procesin e të

dhënave të ndjekin tri parime për kryerjen e studimeve të cilësisë së lartë: a) Përdorimi i disa burimeve të dëshmisë; b) Krijimi i databazës për rastet e studimit dhe c) Ruajtjen e një zinxhiri të evidencave (Buleshkaj, 2013). Respektimi i këtyre parimeve gjatë procedurave për mbledhjen e të dhënave, krijuan mundësinë e trajtimit të një sërë qasjeve, praktikave e perceptimeve për vlerësimin e performancës së shkollës.

Pilotimin e pyetësorit e kemi bërë me menaxhmentin dhe mësimdhënësit e shkollave: SHFMU “Faik Konica” në Prishtinë, SHFMU “Daut Bugujevci” në Fushë-Kosovë dhe në gjimnazin “Qamil Ilazi” në Kaçanik. Pilotimi tregoi se duhet bërë disa ndryshime në instrumente, të cilat i kemi bërë para se të fillojmë mbledhjen e të dhënave. Të dhënat për këtë studim i kemi mbledhur në muajin tetor dhe nëntor të vitit 2017. Për mbledhjen e të dhënave me të gjithë subjektet e shkollave të përfshira në studim²⁰, u angazhuan katër hulumtues nga IPK-ja, të cilët kishin përvojë në hulumtime dhe në fushën e studimit. Të dhënat i kemi mbledhur shkollë më shkollë për të marrë informacionet e nevojshme nga drejtorët e shkollave, koordinatorët e cilësisë, anëtarët e EVV-së, mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit e përfshirë nga shkolla në procesin e VBSH-së.

Para realizimit të hulumtimit në terren, përmes telefonit, i kemi kontaktuar drejtorët e shkollave ose koordinatorët e cilësisë në shkolla. Ata kanë marrë informacione të nevojshme për procesin e hulumtimit në shkolla, kërkesat për të cilat duhet të ndihmojnë shkollat, si në informimin e stafit të shkollës, nxënësve dhe prindërve të përfshirë në mostër të studimit, sigurimin e dëshmive, raporteve të shkruara nga shkolla për procesin e VBSH-së. Në kontaktet e para me shkollat është vendosur edhe data kur do të administrohen pyetësorët me mostrën e përcaktuar për përfshirje në studim. Ndërkohë, përmes e-mailit, shkollave ua kemi dërguar dokumentin me kriteret për përfshirje në studim të subjekteve të shkollës dhe me listën e dëshmive e raporteve që lidhen me procesin e VBSH-së që duhet të sigurohen nga shkollat.

Në ditën e administrimit të pyetësorëve në shkolla, hulumtuesit kanë ofruar informata të plota për qëllimin e studimit dhe mënyrën e plotësimit të pyetësorit. Pyetësorët kanë qenë anonimë. Pjesëmarrësit e përfshirë në studim, gjatë plotësimit të pyetësorit, janë vendosur në salla të ndryshme, të cilat paraprakisht ishin siguruar nga menaxhmeti i shkollës. Pyetësorët e plotësuar janë pranuar/mbledhur në ditën e shpërndarjes, përkatësisht pas kohës së paraparë për plotësim, 45-60 minuta, me përjashtim të 10% të pyetësorëve me prindër, të cilët janë dërguar me e-mail nga prindërit, në përpjekjet e ekipit hulumtues për të përfshirë prindërit që kanë qenë pjesë e VBSH-së. Asnjëri nga pjesëmarrësit në mostër nuk ka refuzuar të plotësojë pyetësorin dhe të ofrojë të dhënat e kërkuara.

Gjithashtu, hulumtuesit kanë marrë një listë të dëshmive dhe raporteve të përgatitura nga menaxhmeti i shkollës për procesin e VBSH-së, përmes të cilave kemi siguruar të dhëna për realizimin e hapave kryesorë të procesit të vlerësimit të brendshëm të shkollës. Nga 39 shkolla të përfshira në studim, 7 prej tyre dëshmitë dhe raportet e procesit të VBSH-së i kanë dërguar në formë elektronike. Raportet e vlerësimit të brendshëm të shkollave fillimisht i koduam me ID të shkollës, pastaj krijuam evidencat

²⁰ Shih shtojcën A, për listën e shkollave të përfshira në studim.

në bazë të listës kontrollit për analizë të raporteve të VBSH-së, si dhe u kuantifikuan në numër dhe përqindje në pesë kategori: (1) Plotësim i plotë i kërkesave të VBSH-së, (2) Plotësim mesatar i kërkesave të VBSH-së, (3) Plotësim minimal i kërkesave të VBSH-së, (4) Nuk është plotësuar asnjë kërkesë e VBSH-së dhe (5) Nuk ka dëshmi ose nuk është përdorur instrumenti standard i VBSH-së.

Të dhënat me intervista gjysmë të strukturuar i kemi mbledhur gjatë periudhës shkurt–mars 2018. Intervistat i kemi zhvilluar me anë të postes elektronike, të cilat kanë zgjatur afërsisht rreth dy orë. Gjatë intervistës, përgjigjet i kemi shkruar, pastaj tekstin ua kemi dhënë subjekteve të intervistuar për të vërtetuar perceptimet e tyre, të cilat ata i kanë shprehur gjatë intervistës.

3.5. Analiza e të dhënave

Qasja e studimit është sasiore dhe cilësore. Përpunimin e të dhënave sasiore e kemi bërë me analiza statistikore përshkruese. Pasi i kemi mbledhur të dhënat, kemi bërë kodimin, duke ndërtuar bazën e të dhënave të krijuara në një nga faqet e programit SPSS (Statistical Package for the Social Sciences), versioni 20. Për përpunimin e të dhënave janë përdorur lloje të ndryshme të analizave, siç janë: Reliability Analysis (Crombach's Alfa), Analiza faktoriale dhe Krostabulimet.

Analizën e të dhënave cilësore e bazuam kryesisht në metodën e analizës së përmbajtjes. Për analizën e të dhënave cilësore, u aplikuan tri faza të analizimit të të dhënave të sugjeruara nga Creswell (1998), siç citohet nga Buleshkaj (2013), këto faza ishin klasifikimi, interpretimi dhe përshkrimi. Kjo qasje mundësoi që të dhënat e mbledhura të grupohen në kategori tematike që lidhen me pyetjet kërkimore, për të cilat pastaj u bënë interpretime brenda një strukture që karakterizoi hapat kryesorë të procesit të VBSH-së dhe perceptimet e pjesëmarrësve mbi perspektivën e përmbushjes së rolit të tyre në këtë proces. Përshkrimi u bë në raport me udhëzimet për rolin e institucioneve arsimore në vlerësimin e performancës së shkollës, udhëzuesin për vlerësim të brendshëm të performancës së shkollës lidhur me hapat kryesorë të procesit të VBSH-së dhe me dokumente, plane e raporte në fushën e studimit.

KAPITULLI IV

REZULTATET E STUDIMIT

Në këtë kapitull prezantohet rezultatet e studimit, të ndara në tri pjesë. Në pjesën e parë prezantohen këndvështrimet e subjekteve të përfshira në studim lidhur me përvojën e parë të vlerësimit të performancës së shkollës. Në pjesën e dytë prezantohen këndvështrimet e subjekteve të përfshirë në studim lidhur me perspektivën e zbatimit të sistemit për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë dhe interesimin e përkushtimin institucional për zbatimin e këtij sistemi. Ndërsa, në pjesën e tretë të këtij kapitulli prezantohen rezultatet e analizës kritike të raporteve të vlerësimit të brendshëm të shkollës, të bërë për hapat kryesorë të realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës.

4.1. PËRVOJAT E SHKOLLAVE NË REALIZIMIN E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË PERFORMANCËS

Analizat dhe rezultatet në këtë pjesë janë organizuar në pesë nënndarje, duke filluar nga të dhënat e respondentëve të studimit, në bazë të rolit në procesin e VBSH-së, për të vazhduar me prezantimin e perceptimeve të subjekteve nga shkollat për përgatitjen e institucioneve arsimore për realizimin e VBSH-së, praktikën në realizimin e VBSH-së, mbështetjen e ofruar shkollave për procesin e VBSH-së me material, udhëzues dhe trajnime, si dhe për efektet e përvojave të para të VBSH-së.

4.1.1. Të dhënat demografike të pjesëmarrësve, sipas rolit të tyre në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës

Në studim kanë marrë pjesë respondentë (stafi i shkollës, nxënës dhe prindër) nga 39 shkolla të 18 komunave në Kosovë, të cilët kanë pasur rol në procesin e VBSH-së, pastaj zyrtarë të arsimit nga 4 drejtori komunale të arsimit dhe inspektorë të arsimit nga tre sektorë rajonalë të inspektimit të arsimit. Nga personeli i shkollës janë përfshirë N=387, prej tyre 224 ose 57.9% nga niveli fillor dhe i mesëm i ulët i arsimit dhe 163 nga gjimnazet ose 42.1%. Nxënës të përfshirë në studim (N= 299), prej tyre (n=150) nga klasat 6-9 ose 50.2% dhe (n=149) nxënës nga klasat 10-12 në gjimnaze ose 49.8%. Kurse, prindër të përfshirë (N=121), prej tyre (n=65) prindër nga niveli fillor dhe i mesëm i ulët i arsimit ose 53.72% dhe (n=56) prindër nga gjimnazet ose 46.28%. Përveç respondentëve nga shkollat, në studim janë përfshirë edhe 4 zyrtarë të arsimit në komuna, gjegjësisht koordinatore të cilësisë në DKA dhe 3 inspektorë të arsimit në sektorët rajonalë të Inspektoratit të arsimit (SIA). Tabela numër 2 paraqet të dhënat e pjesëmarrësve.

Tabela 2

Numri dhe përqindja e stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve të përfshirë në hulumtim, sipas komunave.

Nr	Komuna	Numri i shkollave	Stafi i shkollës		Prindër		Nxënës	
			Nr	%	Nr	%	Nr	%
1	F. Kosovë	2	16	4,1	4	3,3	4	1,3
2	Ferizaj	2	29	7,5	9	7,4	22	7,4
3	Gjakovë	2	13	3,4	9	7,4	25	8,4
4	Gjilan	2	23	5,9	3	2,5	22	7,4
5	Hani i Elezit	1	9	2,3	2	1,7	5	1,7
6	Kaçanik	2	5	1,3	-	-	-	-
7	Kamenicë	2	16	4,1	3	2,5	10	3,3
8	Klinë	4	32	8,3	14	11,6	27	9,0
9	Mitrovicë	2	24	6,2	5	4,1	8	2,7
10	Novobërdë	1	9	2,3	2	1,7	4	1,3
11	Obiliq	1	13	3,4	7	5,8	15	5,0
12	Pejë	2	25	6,5	11	9,1	16	5,4
13	Podujevë	4	43	11,1	10	8,3	18	6,0
14	Prishtinë	4	51	13,2	14	11,6	42	14,0
15	Prizren	2	16	4,1	12	9,9	31	10,4
16	Suharekë	2	15	3,9	4	3,3	10	3,3
17	Shtime	2	20	5,2	2	1,7	15	5,0
18	Vushtri	2	28	7,2	10	8,3	25	8,4
Gjithsej	18	39	387	100,0	121	100,0	299	100,0

Një analizë përshkruese e rolit të respondentëve të përfshirë në këtë studim në procesin e VBSH-së (stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve) është bërë me qëllim që të shohim përmbushjen e kërkesave të UA 4/2017 për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë, për përfshirjen e komunitetit të shkollës në vlerësimin e brendshëm të performancës së institucionit/shkollës. Në tabelën numër 3 prezantohen të dhënat për rolin e pjesëmarrësve në hulumtim në procesin e VBSH-së.

Tabela 3

Përshkrimi i rolit të stafit të shkollës në procesin e VBSH-së, sipas numrit dhe përqindjes së përfshirjes së tyre në hulumtim

Roli i stafit të shkollës të përfshirë në VBSH ²	Përgjigjet	
	Frekuenca	Përqindja
Drejtor i shkollës	36	8,7%
Zv.drejtor i shkollës	8	1,9%
Shërbimi profesional në shkollë (pedagog/psikolog)	15	3,6%
Koordinator i cilësisë në shkollë	38	9,2%
Udhëheqës i aktivitetit profesional	51	12,3%
Anëtar i ekipit të shkollës për vetëvlerësim	125	30,2%
Mësimdhënës i përfshirë në mostrën e studimit dhe i angazhuar në përkrahje të EVV-së	49	11,8%
Mësimdhënës i përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit të brendshëm të shkollës	92	22,2%
Total	414	100,0%

Analiza e përgjigjeve të dhëna në pyetësor nga stafi i shkollës tregojnë se 301 respondentë ose 77.78% e të përfshirëve në studim nga stafi i shkollës kanë qenë të përfshirë në ofrimin e të dhënave për procesin e VBSH-së. Shihet se kanë dominuar tri forma të përfshirjes së stafit të shkollës në ofrimin e informacionit për të vlerësuar performancën e shkollës në kuadër të procesit të VBSH-së: (i) plotësimin e pyetësorëve (170 ose 56.5%); (ii) intervistuar nga EVV (43 ose 14.3%) ; (iii) të përfshirë në fokus grup (88 ose 29.2%).

Analiza e përgjigjeve të dhëna në pyetësor nga nxënësit tregoi se në procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës nxënësit janë përfshirë sipas roleve në vijim: Kryetar i këshillit të nxënësve në nivel shkolle, anëtar i Këshillit të nxënësve në nivel shkolle, kryetar i klasës, anëtar i Kryesisë së klasës, nxënës i përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit, anëtar i Këshillit të nxënësve të shkollës dhe kryetar i klasës, anëtar i Këshillit të nxënësve të shkollës dhe anëtar i Kryesisë së klasës. Tabela numër 4 paraqet rolin dhe frekuencën e përfshirjes së nxënësve në procesin e VBSH-së.

² Në bazë të përgjigjeve të stafit të shkollës, disa prej tyre kanë më shumë se një rol, p.sh. ka zv.drejtor apo pedagog/psikolog shkolle që ka qenë edhe anëtarë të EVV-së, gjithashtu disa anëtarë të EVV-së kanë qenë edhe udhëheqës të aktiveve profesionale

Tabela 4

Përshkrimi i rolit të nxënësve në procesin e VBSH-së, sipas numrit dhe përqindjes së nxënësve të përfshirë në hulumtim

Roli i nxënësve - të përfshirë në VBSH	Përgjigjet	
	Frekuenca	Përqindja
Kryetar i Këshillit të nxënësve në nivel shkolle	9	3,0
Anëtar i Këshillit të nxënësve në nivel shkolle	29	9,7
Kryetar i klasës	51	17,1
Anëtar i Kryesisë së klasës	56	18,7
I përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit	125	41,8
Kryetar i Këshillit të nxënësve dhe kryetar i klasës	2	0,7
Anëtar i Këshillit të nxënësve të shkollës dhe kryetar i klasës	15	5,0
Anëtar i Këshillit të nxënësve të shkollës dhe anëtar i kryesisë së klasës	6	2,0
Përgjigjur gjithsej	293	98,0
Pa përgjigje	6	2,0
Gjithsej të përfshirë në hulumtim	299	100,0

Bazuar në llogaritjen e përgjigjeve të nxënësve të dhëna në pyetësor, del se 220 nxënës ose 73.76% nga numri i përgjithshëm i nxënësve (N=299) kanë qenë të përfshirë në ofrimin e të dhënave për procesin e VBSH-së përmes plotësimit të pyetësorit të anketës të realizuar nga shkolla. Një pjesë e tyre janë përfshirë edhe në forma të tjera, si intervista dhe takime në fokus grupe. Disa prej tyre janë përfshirë në një e më shumë forma të ofrimit të informacionit në kuadër të procesit të VBSH-së.

Tabela 5

Përshkrimi i formave të përfshirjes së nxënësve në ofrimin e të dhënave për procesin e VBSH-së, në numër dhe përqindje

Format e përfshirjes së nxënësve në ofrimin e të dhënave për procesin e VBSH-së	Përgjigjet	
	Frekuenca	Përqindja
Plotësim të pyetësorit	220	73,6
Të intervistuar	7	2,3
Të përfshirë në fokus grup	23	7,7
Formë tjetër e përfshirjes	12	4,0
Pyetësor dhe intervistë	8	2,7
Pyetësor dhe fokus grup	4	1,3
Pyetësor dhe formë tjetër të përfshirjes	3	1,0
Pyetësor, intervistë, fokus grup	2	,7
Të gjitha format e përfshirjes	2	,7
Pyetësor, intervistë, formë tjetër	1	,3
Pyetësor, fokus grup, formë tjetër	1	,3
Gjithsej	283	94,6
Pa përgjigje	16	5,4
Gjithsej të përfshirë në hulumtim	299	100,0

Analiza e të dhënave të pyetësorit për prindër tregon se ata ishin të përfshirë në procesin e VBSH-së, në këto role: Kryetar i KDSH-së, anëtar i KDSH-së, kryetar i prindërve të klasës, anëtar i Kryesisë së prindërve në nivel klase, i përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit.

Tabela 6

Përshkrimi i rolit të prindërve në procesin e VBSH-së, sipas numrit dhe përqindjes së prindërve të përfshirë në hulumtim

Roli i prindërve të përfshirë në VBSH	Përgjigjet	
	Frekuenca	Përqindja
Kryetar i KDSH-së	9	7,4
Anëtar i KDSH-së	27	22,3
Kryetar i prindërve të klasës	16	13,2
Anëtar i Kryesisë së prindërve në nivel klase	12	9,9
I përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së	54	47,1
Gjithsej	121	100,0

Rezultatet tregojnë se një pjesë e prindërve (N=14) ose 10.7 nga numri i përgjithshëm (N=121) të përfshirë në studim kanë rol në shkollë, si: Kryetar i KDSH-së, anëtar i KDSH-së, kryetar i prindërve të klasës, anëtar i Kryesisë së prindërve në nivel klase, etj., nuk kanë qenë fare të përfshirë nga shkolla në procesin e VBSH-së. Tabela numër 7 paraqet frekuencën e përfshirjes dhe rolin e prindërve në procesin e VBSH-së.

Tabela 7

Përshkrimi i formave të përfshirjes së prindërve në ofrimin e të dhënave për procesin e VBSH-së, në numër dhe përqindje

Format e përfshirjes së prindërve në ofrimin e të dhënave për procesin e VBSH-së	Përgjigjet	
	Frekuenca	Përqindja
Plotësim të pyetësorit	59	48,8
Të intervistuar	17	14,0
Të përfshirë në fokus grup	12	9,9
Pyetësor dhe intervistë	3	2,5
Pyetësor dhe fokus grup	2	1,7
Të papërfshirë në VBSH	14	10,7
Formë tjetër e përfshirjes	14	10,7
Gjithsej	121	100,0

Sipas rolit që kanë në procesin e VBSH-së, në studim janë përfshirë edhe tre inspektorë dhe katër KC/ zyrtarë të arsimit në DKA. Të gjithë të intervistuarit ishin persona me

përvojë të gjatë në arsim dhe me përvojë relativisht të gjatë në pozitat aktuale. Pesë prej tyre kanë përvojë pune mbi 10-vjeçare në pozitat aktuale, një me përvojë tetëvjeçare dhe një me përvojë gjashtëvjeçare. Zyrtarët e arsimit në komuna, që tani kanë edhe rolin e KC, i referohen përvojës së punës në cilësinë e zyrtarit arsimor në DKA. Raporti gjinor i të intervistuarve është dy femra dhe pesë meshkuj. Të gjithë të intervistuarit janë përfshirë në procesin e VPSH-së, përmes aktiviteteve të ndryshme, si në fazën e zhvillimit të dokumenteve për sistemin e VPSH-së, ashtu edhe në aktivitetet që lidhen me fillimin e zbatimit të këtij sistemi, në bazë të rolit të tyre në këtë proces. Përfshirja e inspektorëve të arsimit në këtë proces ishte më e madhe, kundrejt KC/ zyrtarëve arsimorë në DKA.

4.1.2. Informimi dhe përgatitja e institucioneve arsimore për realizimin e VBSH-së

Vlerat e analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) për 9 pyetjet e personelit të shkollës lidhur me faktorin e informimit dhe përgatitjes së institucioneve arsimore është $\alpha = .88.$, kurse signifikanca sipas KMO dhe Bartlett's Test është $= .000.$ Vlerat tregojnë se kemi një lidhje të mirë në mes të pyetjeve për hulumtimin e këtij faktori dhe besueshmëri të rëndësishme të pyetësorit të zbatuar në hulumtim.

Nga tabela numër 8 shihet se shkalla e pajtueshmërisë nga 1 (fare nuk pajtohem) deri në 5 (pajtohem plotësisht), personeli i shkollës i përfshirë në procesin e vetëvlerësimit, në forma të ndryshme dhe me role të ndryshme, shpreh pajtueshmëri të lartë lidhur me shkallën e informimit për procesin e VBSH-së, mbi nivelin mesatar ($M=4.35$), ($DS=.91$), ndërsa gabimi standard i mesatares së mostrës ishte ($SE=.052$).

Tabela 8

Rezultati mesatar dhe devijimi standard i shkallës së përgjithshme të pajtueshmërisë së personelit të shkollës me informimin dhe përgatitjet e shkollës për procesin e VBSH-së

	N	Range/ vargu	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Gabimi standard	Statistic
Totali	314	4.00	1.00	5.00	4.35	.052	.91
							.83

Detajet e tjera për shkallën e pajtueshmërisë së personelit të shkollës, por edhe të prindërve dhe nxënësve, lidhur me informimin me dokumentet dhe procedurat e VBSH-së, përfshirjen në fazën përgatitore të VBSH-së dhe informimin me përgatitjet e EVV-së për realizimin e VBSH-së do të prezantohen në pjesën në vijim.

a) Informimi me dokumentet, procedurat e VBSH-së dhe pjesëmarrja në fazën përgatitore të VBSH-së

Procesi i vlerësimit të brendshëm të shkollës fillon me informimin e gjithë komunitetit të shkollës. Fillimisht me sistemin e vlerësimit dhe dokumentet që e rregullojnë atë, pastaj me rolin e shkollës dhe organeve të saj, qëllimin e vetëvlerësimit dhe dinamikën e realizimit (IPK, 2016b). Në pyetjet lidhur me informimin për dokumentet dhe procedurat e vlerësimit të brendshëm të shkollës janë përgjigjur mbi 96% e stafit të shkollës, nga të cilët mbi 80% pajtohen se kanë marrë pjesë në takime informative dhe janë informuar me dokumentet dhe procedurat e VBSH-së.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se niveli i pajtueshmërisë lidhur me organizimin e takimeve dhe informimin e stafit të shkollës për dokumentet e hartuara nga MASHT-i për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës është i lartë (*Pajtohem plotësisht=37,6%, Pajtohem=45,9%, Neutral 11,2%, Nuk pajtohem 3,7% dhe Fare nuk pajtohem 1,6%*). Gjithashtu, pjesëmarrësit kanë marrë informata dhe udhëzime të qarta për procedurat e realizimit të VBSH-së dhe rolin e aktorëve kryesorë të shkollës në këtë proces (*Plotësisht pajtohem dhe Pajtohem 83,4%, Neutral 10,1%, ndërsa Nuk pajtohem dhe Fare nuk pajtohem 6,1%*).

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se sikurse stafi i shkollës, edhe prindërit dhe nxënësit kanë shkallë të lartë pajtueshmërie lidhur me organizimin e takimeve informuese për procesin VBSH-së: *Stafi i shkollës 90%, nxënësit 68,1%, prindërit 81%*. Pjesa më e madhe e stafit të shkollës të përfshirë në studim, përveçqë kanë qenë pjesëmarrës në takime informative, gjithashtu kanë pasur rol në organizimin e takimeve informative dhe aktivitetet përgatitore të shkollës për realizimin e VBSH-së (N=387), (fr=173) dhe 44%.

Tabela 9

Shkalla a pjesëmarrjes së stafit të shkollës (në numër dhe %) në organizimin e takimeve informative dhe në aktivitete përgatitore të shkollës për realizimin e VBSH-së

Përfshirja	Frekuenca	Përqindja e vlefshme
Nuk kanë qenë të përfshirë fare në takimet informative e as në aktivitetet përgatitore	89	23,0
Kanë marrë pjesë vetëm në takime informative	72	18,6
Kanë marrë pjesë në takime informative dhe kanë pasur rol në aktivitetet përgatitore	173	44,7
Kanë pasur rol vetëm në organizimin e aktiviteteve përgatitore të VBSH-së	53	13,7
Gjithsej	387	100,0

Tabela numër 9 tregon se shumica e stafit të shkollës të përfshirë në hulumtim kanë marrë pjesë në takimet informative dhe kanë pasur rol në organizimin e takimeve informative dhe aktiviteteve përgatitore të shkollës për realizimin e VBSH-së. Rreth 23% e stafit të shkollës nuk kanë qenë të përfshirë fare në takimet informuese e as në aktivitetet përgatitore të shkollës për realizimin e VBSH-së.

b) Informimi për përgatitjet e shkollës për realizimin e VBSH-së

Bazuar në rezultatet e hulumtimit shihet se kemi pajtueshmëri të lartë të të gjithë pjesëmarrësve në hulumtim me informimin për formimin e EVV-së: *Stafi i shkollës 85,5%, prindërit 84,5% dhe nxënësit 71,2%.*

Stafi i shkollës gjithashtu është informuar edhe me detyrat, përgjegjësitë dhe planin e EVV-së. Në 5 shkallët e vlerësimit Likert, (*5-Pajtohem plotësisht, 4-Pajtohem, 3-Neutral, 2-Nuk pajtohem, 1-Fare nuk pajtohem*), 58,1% e stafit të shkollës pajtohen plotësisht sa kanë qenë të informuar me detyrat dhe përgjegjësitë e EVV dhe 49,1% për planin e EVV-së, ndërsa 27,7% e stafit të shkollës pajtohen se ishin të informuar me detyrat dhe përgjegjësitë e EVV-së dhe 34,8% e stafit të shkollës për planin e EVV-së.

Tabela 10

Niveli i pajtueshmërisë së stafit të shkollës (në numër dhe %) lidhur me informimin për detyrat, përgjegjësitë dhe planin e punës së EVV-së

	Informimi për detyrat dhe përgjegjësitë e EVV-së		Informimi me kohë për planin e punës së EVV-së dhe rolin e tij në VBSH	
	Nr	%	Nr	%
Fare nuk pajtohem	7	1,9	6	1,6
Nuk pajtohem	5	1,3	18	4,9
Neutral	34	9,0	36	9,7
Pajtohem	112	29,7	129	34,8
Pajtohem plotësisht	219	58,1	182	49,1
Gjithsej	377	100,0	371	100,0

Tabela numër 10 tregon se rreth 10% e pjesëmarrësve janë neutralë sa i përket informimit me detyrat e EVV-së dhe lidhur me planin e punës së tyre për VBSH. Të përfshirë me detyrat dhe përgjegjësitë e EVV-së në masë më të madhe janë mësimdhënësit e përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit të brendshëm të shkollës 46.5%, udhëheqësit

e aktiveve profesionale 34.9%, mësimdhënësit e angazhuar në përkrahje të EVV-së 16,3%, si dhe drejtorët e shkollave 2.3%.

Nga numri i stafit të shkollës, që fare nuk pajtohen se janë të painformuar me kohë me planin e punës së EVV ishin mësimdhënësit e përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Analiza të tjera përshkruese për përgatitjen e institucioneve arsimore për realizimin e VBSH-së shih në tabelat e analizës statistikore në shtojcën C.

4.1.3. Praktikrat e institucioneve arsimore në realizimin e VBSH-së

Vlerat e analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) për pyetjet e personelit të shkollës lidhur me praktikën e institucioneve arsimore në realizimin e VBSH-së është $\alpha=.88$, pra ka një lidhje të mirë në mes të pyetjeve të lidhura me praktikrat e institucioneve arsimore në realizimin e VBSH-së dhe besueshmëri të mirë të pyetësorit.

Tabela 11 tregon nivelin e kënaqshmërisë së personelit të shkollës me praktikrat e realizimit të VBSH-së. Kemi kërkuar të shprehin pesë nivele të kënaqësisë (Plotësisht i/e pakënaqur) deri në 5 (Plotësisht i/e kënaqur). Bazuar në analizën statistikore del se kemi në shpërndarje jo shumë homogjene të kënaqësisë me praktikrat në realizimin e VBSH-së (N=387, M =3.14, DS =1.15). Ndërsa gabimi standard i mesatares së mostrës ishte (SE= 0.55).

Tabela 11

Rezultati mesatar dhe devijimi standard i shkollës së përgjithshme të kënaqësisë së personelit të shkollës me praktikën e realizimit të VBSH-së

	Numri	Range	Minimumi	Maximum	Mesatarja	DS	Varianca
	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic
Totali	387	4.00	1.00	5,00	3,14	.055	1.15


Detajet e tjera të rezultateve për pajtueshmërinë e personelit të shkollës, por edhe të prindërve dhe nxënësve, lidhur me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së, zbatimi i hapave kryesorë të procesit të VBSH-së dhe shfrytëzimi i gjetjeve të VBSH-së për planifikim zhvillimor të shkollës do të prezantohen në pjesën në vijim.

a) Koordinimi dhe udhëheqja e procesit të VBSH-së

Koordinimi dhe udhëheqja e procesit të vetëvlerësimit të shkollës bëhet nga koordinatori i cilësisë së shkollës, i cili pas hartimit të planit të EVV-së dhe miratimit

të tij nga drejtori i shkollës, së bashku me EVV, i njofton të gjithë aktorët e shkollës me planin dhe dinamikën e realizimit, ngase për zbatimin e planit nevojitet përkrahja dhe pjesëmarrja organeve qeverisëse dhe profesionale të shkollës, si dhe e mësimitdhënësve, prindërve dhe nxënësve të shkollës.

Grafiku 1 tregon se shumica e pjesëmarrësve në hulumtim janë të kënaqur me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së.



Grafiku 1.

Niveli i kënaqësisë së stafit të shkollës (në %) me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së

Niveli i kënaqësisë, pasqyruar në grafikun 1, nga vlerësimi pesë shkallësh Likert (5-Plotësisht të kënaqur, 4-Të kënaqur, 3-Neutral, 2-Të pakënaqur dhe 1-Plotësisht të pakënaqur) është përmbledhur në tri shkallë (5 dhe 4=3-Të kënaqur, 3=2-Neutral, 2 dhe 1=1- Të pakënaqur).

Më të pakënaqurit me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të vetëvlerësimit të shkollës janë nxënësit, me 15,12%, ndërsa shkallë më të lartë të pakënaqësisë tregojnë nxënësit e përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit, kryetarët e klasave, anëtarët e Këshillit të nxënësve në nivel shkolle dhe anëtarët e Kryesisë së klasës. Pas nxënësve, me përqindje më të lartë të pakënaqësisë janë prindërit, me 12,61%, dhe prej tyre në përqindje më të lartë të pakënaqur del të jenë prindërit e përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit të brendshëm të shkollës, prindërit që janë anëtarë të Këshillit Drejtues të shkollës, kryetarë të këshillit të prindërve të klasës apo anëtarë të Kryesisë së prindërve të klasës.

Të pakënaqur nga stafi i shkollës janë vetëm 1,30%. Tabela numër 13 tregon se në përqindje më të lartë të pakënaqur sa u përket koordinimit dhe udhëheqjes së procesit të VBSH-së nga stafi i shkollës janë mësimitdhënësit e angazhuar në mbështetje të

EVV-së, drejtorët e shkollave, udhëheqësit e aktiveve profesionale dhe mësimdhënësit e përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së.

Specifikuar sipas rolit që kanë në shkollë, respondentët e përfshirë në studim kanë nivele të ndryshme të kënaqësisë lidhur me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së. Tabela në vijim i paraqet këto dallime.

Tabela 12

Niveli i kënaqësisë së stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve (në numër dhe %) me koordinimin dhe udhëheqjen e VBSH-së, sipas rolit të tyre në procesin e VBSH-së

Stafi i shkollës - Roli	Të pakënaqur		Neutral		Të kënaqur		Gjithsej
Drejtor i shkollës	1	4,0%	0	,0%	24	96,0%	25
Zv.drejtor i shkollës	0	,0%	0	,0%	8	100,0%	8
Shërbimi profesional në shkollë	0	,0%	0	,0%	14	100,0%	14
Koordinator i cilësisë në shkollë	0	,0%	1	2,70%	36	97,30%	37
Udhëheqës i aktivitetit profesional	1	2,0%	7	14,0%	42	84,0%	50
Anëtar i ekipit të shkollës për vetëvlerësim	0	,0%	2	1,68%	117	98,32%	119
Mësimdhënës i përfshirë në mostër dhe i angazhuar në përkrahje të EVV-së	2	4,44%	1	2,22%	42	93,33%	45
Mësimdhënës i përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së	1	1,14%	11	12,5%	76	86,36%	88
Gjithsej stafi	5	1,30%	22	5,70%	359	93,01%	386
Prindër - Roli	Të pakënaqur		Neutral		Të kënaqur		Gjithsej
Kryetar i KDSH-së	0	,0%	1	10,0%	9	90,0%	10
Anëtarë i KDSH-së -përfaqësues i prindërve	2	8,33%	3	12,5%	19	79,17%	24
Kryetar i prindërve të klasës	2	13,33%	1	6,67%	12	80,0%	15
Anëtar i Kryesisë së prindërve në nivel klase	2	11,11%	0	,0%	16	88,89%	18
Prind i përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së	9	17,31%	7	13,46%	36	69,23%	52
Total prind	15	12,61%	12	10,08%	92	77,31%	119
Nxënës - Roli	Të pakënaqur		Neutral		Të kënaqur		Gjithsej
Kryetar i Këshillit të nxënësve në nivel shkolle	0	,0%	3	27,27%	8	72,73%	11
Anëtar i Këshillit të nxënësve në nivel shkolle	10	23,26%	5	11,63%	28	65,12%	43
Kryetar i klasës	11	18,64%	14	23,73%	34	57,63%	59
Anëtar i Kryesisë së klasës	6	10,91%	16	29,09%	33	60,0%	55
Nxënës i përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së	17	13,82%	33	26,83%	73	59,35%	123
Total nxënës	44	15,12%	71	24,40%	176	60,48%	291
Gjithsej	64	8,04%	105	13,19%	627	78,77%	796

Specifikuar sipas tipit të shkollës (në rastin e hulumtimit tonë, kemi përfshirë shkollat e arsimit fillor të mesëm të ulët dhe gjimnazeve), gjejmë dallime të vogla, rreth 5% ndërmjet tipave të shkollës, sa i përket nivelit të kënaqësisë së personelit të shkollës lidhur me koordinimin e procesit të vetëvlerësimit. Rezultatet tregojnë se në arsimin fillor e të mesëm të ulët mbi 95% e stafit të shkollës janë të kënaqur me koordinimin

e procesit të vetëvlerësimit, ndërsa në gjimnaze ky nivel i kënaqësisë është i shprehur në 90% të stafit të shkollës.

Meqenëse pjesëmarrësit në mostër nga stafi i shkollës kanë qenë të përfshirë në programe të ndryshme trajnimi, ishte me interes të shohim nëse ka dallime në qëndrimet e pjesëmarrësve për sa i përket përfshirjes në programet e ndryshme të trajnimit. Nga të dhënat rezulton se nuk ka dallime të rëndësishme në nivelin e qëndrimeve të stafit të shkollës për koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të vlerësimit të brendshëm të shkollës për sa i përket përfshirjes në programe të ndryshme të trajnimit.

Tabela 13

Niveli i kënaqësisë së stafit të shkollës (në numër dhe %) me koordinimin dhe udhëheqjen e VBSH-së, sipas llojeve të trajnimit të ndjekur

Llojet e trajnimeve	Shkalla e kënaqësisë me koordinimin dhe udhëheqjen e VBSH-së						Gjithsej
	E ulët	Mesatare		E lartë			
Trajnimi për sigurim të cilësisë në shkollë	1	1.32	0	0	75	98,68	76
Trajnimi për udhëheqje dhe menaxhim të shkollës	2	2.53	2	2.53	75	94.94	79
Trajnimi për VBSH	0	0	1	1.14	87	98.86	88
Trajnimi për zbatim të kurrikulës	4	1.28	16	5.11	293	93.61	313

Stafi i shkollës pohon të jetë i kënaqur me punën e EVV-së, si dhe me përfshirjen e aktorëve kryesorë të shkollës në procesin e VBSH-së.

Në pyetjen sa jeni të kënaqur me punën e EVV-së, bërë anëtarëve të EVV-së, tregon se (*Plotësisht të kënaqur 48.7%, Të kënaqur 36.8%, Neutralë 12.2%, Të pakënaqur 2.1% dhe Plotësisht të pakënaqur 0.3%*).

Sa i përket përkrahjes së dhënë EVV-së nga drejtori i shkollës, vetëm 0.82% të anëtarëve të EVV-së janë të kënaqur, të pakënaqur janë 3.28%, 95.90% neutralë. Ndërsa lidhur me koordinimin e procesit nga udhëheqësi i EVV-së, anëtarët e EVV-së shprehen kështu: *Plotësisht të kënaqur 62,30%, Të kënaqur 37,70%, Neutralë 1,64%, Të pakënaqur 1,64%*.

b) Zbatimi i hapave kryesorë të procesit të VBSH-së

Për procesin e vetëvlerësimit të performancës së shkollës, në Udhëzuesit për VBSH janë udhëzimet për hapat kryesorë të realizimit të VBSH-së (IPK 2017, f. 16-25). Ndërsa për qasjen që duhet ndjekur shkolla për t'i udhëhequr proceset e rëndësishme për sigurim të cilësisë në shkollë, duke filluara nga procesi i vetëvlerësimit të performancës së shkollës deri te menaxhimi i cilësisë PBKV, janë dhënë udhëzime në manualin për sigurim të cilësisë në shkollë (Mehmeti, Zylfiu, Potera, Buleshkaj dhe Lehner-Stift, U, 2016). Shkollat e përfshira në programin e VBSH-së tashmë i kanë kaluar hapat kryesorë të realizimit të VBSH-së, prandaj është me rëndësi që të njohim qëndrimet e tyre për praktikën e udhëhequr nga shkolla në këtë proces.

Në pyetjen lidhur me nivelin e kënaqësisë për zbatimin e hapave kryesorë të procesit të VBSH-së, pjesëmarrësit kanë shprehur nivele të ndryshme të kënaqësisë. Rezultatet tregojnë se pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim janë të kënaqur me zbatimin e hapave kryesorë të procesit të vetëvlerësimit të shkollës.

Tabela 14

Niveli i kënaqësisë së stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve, lidhur me realizimin e hapave kryesorë të VBSH-së (në %)

Pjesëmarrësit	Të kënaqur	Neutralë	Të pakënaqur
Stafi i shkollës	75,7%	20,4%	3,9%
Prindërit	60,3%	28,9%	10,7%
Nxënësit	41,5%	43,5%	15,1%

Tabela 14 tregon vlerësimin pesëshkallësh Likert (5-Plotësisht të kënaqur, 4-Të kënaqur, 3-Neutralë, 2-Të pakënaqur dhe 1-Plotësisht të pakënaqur), është përmbledhur në tri shkallë (5 dhe 4=3-Të kënaqur, 3=2-Neutralë, 2 dhe 1=1- Të pakënaqur- ky shkallëzim vlen edhe për të dhënat në vazhdim).

Pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim shprehen të kënaqur me:

Identifikimin e burimeve të të dhënave:

- *Stafi i shkollës: Të kënaqur 79,8%; Neutralë 17,25%; Të pakënaqur 0,3%,*

Përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit:

- *Stafi i shkollës: Të kënaqur 81,8%; Neutralë 15%; Të pakënaqur 2,9%,*

- *Prindërit: Të kënaqur 52,2%; Neutralë 26,1%; Të pakënaqur 8,7%,*
- *Nxënësit: Të kënaqur 58,1%; Neutralë 29,1%; Të pakënaqur 12,5%,*

Mbledhjen/ofrimin e të dhënave, saktësinë për të dhënat e mbledhura/ofruara:

- *Stafi i shkollës: Të kënaqur 79,6%; Neutralë 17,2%; Të pakënaqur 3,1%,*
- *Prindërit: Të kënaqur 67,8%; Neutralë 19,5%; Të pakënaqur 12,7%,*
- *Nxënësit: Të kënaqur 63,5%; Neutralë 22,6%; Të pakënaqur 13,5%.*

Objektivitetin dhe paanshmërinë në ofrimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura:

- *Stafi i shkollës: Të kënaqur 82,1 %; Neutralë 16,1%; Të pakënaqur 1,8 %,*
- *Prindërit: Të kënaqur 78,4 %; Neutralë 15,5%; Të pakënaqur 6,0%,*
- *Nxënësit: Të kënaqur 64,7 %; Neutralë 29,5%; Të pakënaqur 6,5%.*

Stafi i shkollës, 77,8% prej tyre, shprehen të kënaqur me finalizimin e gjetjeve preliminare në instrumentet e VBSH-së, duke pasqyruar gjendjen për secilin tregues në mënyrë specifike, të matshme, të pranueshme dhe reale për shkollën, me përcaktimin objektiv të shkallës së cilësisë në nivel të kriterëve, në nivel të fushave të cilësisë dhe në nivel të përgjithshëm 82.9% prej tyre, me identifikimin e përparësive dhe mangësive të performancës së shkollës 84,7%, me praktikën e formulimit të rekomandimeve për masat e nevojshme për përmirësim të mangësive dhe avancim të përparësive 77,5%, me praktikën e informimit të të gjithë aktorëve në nivel shkolle për rezultate e vlerësimit të brendshëm, si dhe me përfundimet e rekomandimet 80,0% e pjesëmarrësve të përfshirë në mostër.

Sa i përket rolit të stafit të shkollës, të dhënat tregojnë se nuk ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të stafit të shkollës për zbatimin e hapave kryesorë të procesit të VBSH-së. Dallime të tilla nuk ka as sa i përket përfshirjes së stafit të shkollës në programin e trajnimit për vlerësimin e performancës së shkollës.

c) Shfrytëzimi i gjetjeve të VBSH-së për planifikimin zhvillimor të shkollës

Gjetjet nga procesi i VBSH-së pasqyrohen në raportin përmbledhës të vlerësimit të përgatitur nga EVV-ja. Raporti i vetëvlerësimit shërben për orientimin e veprimeve konkrete për përmirësim, respektivisht avancim të gjendjes së shkollës ose fushave të caktuara të cilësisë. Vendosja e caqeve specifike të bazuara në vlerësimin e performancës së shkollës, në nivel të fushave të cilësisë, është pika fillestare e veprimit

për përmirësim. Informata përkatëse për cilësinë e performancës së shkollës i dërgohet Këshillit Drejtues të Shkollës. Pas shqyrtimit të raportit të vetëvlerësimit, Këshilli Drejtues i Shkollës vendos prioritete dhe inicion procesin e rishikimit të PZHSH-së dhe hartimit të PVV-së (Udhëzuesi i VBSH-së, f. 24).

Stafi i shkollës, në masë të madhe, del të jenë të kënaqur me formimin e ekipit për rishikimin/hartimin e PZHSH-së: *Të kënaqur 81,6%; Neutralë 15,1%; Të pakënaqur 4,3%*, me rishikimin/hartimin e PZHSH-së, duke u mbështetur në gjetjet e raportit të VBSH-së: *Të kënaqur 77,6%; Neutralë 18,2%; Të pakënaqur 4,2%*, si dhe me hartimin e planit vjetor të punës/planit të përmirësimit të shkollës, në ndërlidhje me PZHSH-në e rishikuar: *Të kënaqur 80,8%; Neutralë 14,7%; Të pakënaqur 4,4%*.

Gjithashtu, prindërit dhe nxënësit shprehen se janë të kënaqur me përcaktimin e masave që do të ndërmerren nga shkolla për përmirësimin e cilësisë në shkollë, me fokus në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies: *Prindërit 84,7%, nxënësit 71,6%*.

Sa i përket fillimit të zbatimit të masave për përmirësimin e cilësisë së shkollës, pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim shprehin nivel të lartë të kënaqësisë, si stafi i shkollës, ashtu edhe nxënësit dhe prindërit e përfshirë në hulumtim.

Tabela 15

Mesatarja dhe Devijimi Standard për nivelin e kënaqësisë së stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve, me fillimin e zbatimit të masave për përmirësimin e cilësisë së shkollës

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Stafi i shkollës	380	1	5	4.18	.814
Prindërit	116	1	5	4.08	.915
Nxënësit	297	1	5	4.14	1.031
Valid N	793				

Tabela numër 15 shfaq një shpërndarje të theksuar te nxënësit (N=297, M=4.14, DS=1.03), ndërsa kjo shpërndarje nuk shpreh dallime të rëndësishme midis prindërve (DS=.915) dhe stafit të shkollës (M=4.18 me DS=.814).

Nga 5 shkallët e vlerësimit Likert (*5-Pajtohem plotësisht, 4-Pajtohem, 3-Neutral, 2-Nuk pajtohem, 1-Plotësisht nuk pajtohem*), mesatarja e përgjigjeve të të anketuarve është më e lartë se 4, që do të thotë se janë shumë të kënaqur me fillimin e zbatimit të masave për përmirësimin e cilësisë së shkollës. Në përgjithësi, të gjithë aktorët e përfshirë në hulumtim janë të kënaqur me shfrytëzimin e gjetjeve të vetëvlerësimit të

shkollës për planifikimin zhvillimor të shkollës: *stafi i shkollës 86,3%, prindërit 86,8% dhe nxënësit 81,9%*.

4.1.4. Materialet, trajnimi dhe mbështetja në realizimin e VBSH-së

Nëse i referohemi dokumentit *Strategjia e sigurimit të cilësisë për arsimin parauniversitar në Kosovë 2016-2020*, (MASHT, 2015), ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet është një nga katër objektivat strategjike në mbështetje të zbatimit të sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar. I njëjti objektivi përcillet edhe me masa përkatëse, në mbështetje të sigurimit të cilësisë dhe referuar nivelit lokal (DKA) e nivelit të shkollës, Strategjia parasheh intervenimin e drejtpërdrejtë në ngritjen e kapaciteteve të këtyre mekanizmave. Ndër të tjera, kemi hartimin e doracakut për aktivet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë (masa 3.2); trajnimin e stafit të DKA-së, drejtorëve dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhimin e cilësisë (masa 3.3); ofrimin e ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal (masa 3.4); trajnimin e përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikim zhvillimor (masa 3.5), etj.

Deri më tani, janë emëruar koordinatorët për sigurimin e cilësisë në nivel të DKA-së dhe në nivel shkolle. Shkollat kanë formuar edhe grupet/ekipet për realizimin e VBSH-së, janë hartuar materiale e udhëzues mbështetës, janë realizuar trajnime dhe punëtori përcjellës, në funksion të mbështetjes së këtij procesi në të dyja nivelet.

Lidhur me rëndësinë e mbështetjes së shkollave për realizimin e VBSH-së, kemi të parashtruar 9 pyetje në pyetësor²¹, kërkesat e së cilave janë të kategorizuara në:

- a) *Mbështetjen e ofruar shkollave në procesin e VBSH-së me materiale/dokumente dhe udhëzues;*
- b) *Mbështetjen e ofruar shkollave në procesin e VBSH-së me trajnime dhe informata kthyes;*
- c) *Mbështetjen e ofruar shkollave në procesin e VBSH-së nga DKA-të përkatëse.*

Vlerat e analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) për 9 pyetjet e personelit të shkollës, lidhur me mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së me materiale/dokumente dhe udhëzues, trajnime dhe informata kthyes, si dhe mbështetja nga DKA, është ($\alpha = .81$), kurse signifikanca sipas KMO dhe Bartlett's Test është = .000.

Tabela 16 tregon shkallën nga 1 (Fare nuk pajtohem) deri në 5 (Plotësisht pajtohem), personeli i shkollës të përfshirë në procesin e vetëvlerësimit që kishin rol në udhëheqjen dhe koordinimin e procesit të VBSH-së, kanë pajtueshmëri në nivel të lartë për mbështetjen e ofruar në realizimin e VBSH-së ($M = 3.85$, $DS = .90$) gabimi standard i

²¹ Për shkak të specifikave të roleve që aktorët i kanë në procesin e VBSH-së, kjo pjesë e pyetësorit është realizuar vetëm me drejtorët/ zv.drejtorët, koordinatorët e cilësisë dhe anëtarë të EVV-së në shkolla. Shih në shtojën B pyetësorin për stafin e shkollës.

mesatares së mostrës (SE=0.55).

Tabela 16

Rezultati mesatar dhe devijimi standard i shkallës së përgjithshme të pajtueshmërisë së personelit të shkollës me mbështetjen e ofruar në realizimin e VBSH-së

	Numri	Range/ vargu	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja		Devijimi standard	Varianca
	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Gabimi standard	Statistic	Statistic
Totali	262	4.00	1.00	5.00	3.85	.055	.90	.80

Detajet e tjera të rezultateve për pajtueshmërinë e personelit të shkollës, lidhur me mbështetjen e ofruar për procesin e VBSH-së me materiale/dokumente dhe udhëzues, trajnime dhe informata kthyesë, si dhe mbështetja nga DKA-ja, do të prezantohen në pjesën në vijim.

a) Mbështetja ofruar shkollave në procesin e VBSH-së, me materiale/dokumente dhe udhëzues

Në vitin 2016 u hartua *Korniza për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës*, si referencë kryesore për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e performancës së shkollës, planifikimin zhvillimor të saj dhe avancimin e vazhdueshëm të cilësisë së shkollës. Po në të njëjtin vit, u hartua edhe *Udhëzuesi për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës*, i cili shërben për t'i mbështetur ekipet e shkollës dhe të gjithë faktorët e tjerë të interesit për shkollën që ta bëjnë vlerësimin e brendshëm - vetëvlerësimin e shkollës. Shkollat e përfshira në studim bazë për procesin e VBSH-së i kishin këto dy dokumente mbështetëse për realizimin e këtij procesi.

Në pyetësin e realizuar me stafin e përfshirë, kemi synuar të marrim informacion se sa dy dokumentet e kanë ndihmuar dhe lehtësuar procesin e VBSH-së. Analiza e përgjigjeve të dhëna tregon se kemi pajtueshmëri të lartë të stafit të anketuar sa i përket mbështetjes me këto dokumente për procesin e VBSH-së. Në pesë shkallët e vlerësimit Likert (5 = *Pajtohem plotësisht*, 4 = *Pajtohem*, 3 = *Neutralë*, 2 = *Nuk pajtohem*, 1 = *Fare nuk pajtohem*), kemi përgjigje për të gjitha shkallët e vlerësimit, ndërsa përqindje më të lartë kemi te vlerësimi me 4 dhe 5. Sipas tyre, *kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës të përcaktuara me Kornizën për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës* kanë pritshmëri të qarta për shkollën se ku duhet të fokusohet në VBSH (*Pajtohem plotësisht*=38,7% dhe *Pajtohem*= 53,4%). Edhe *dokumenti i Udhëzuesit për VBSH-në është specifik dhe ofron informacion të*

mjaftueshëm për realizimin e procesit të VBSH-së (Pajtohem plotësisht=44,3% dhe Pajtohem =50,0%), ndërsa instrumentet e bashkëngjitura në pjesën e shtojcave në këtë dokument, gjithashtu, kanë lehtësuar punën e EVV-së për realizimin e këtij procesi (Pajtohem plotësisht=52,6% dhe Pajtohem= 41,6%).

Të dhënat e plota lidhur me shkallën e pajtueshmërisë së aktorëve të anketuar gjenden në tabelën numër 1, të bashkëngjitur në shtojcën E në raport.

Tabela 17

Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (në %) për mbështetjen e ofruar me materiale dhe udhëzues për realizimin e VBSH-së, sipas rolit të tyre, në koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së

<i>Roli kryesor i të anketuarve në procesin e VBSH-së</i>	<i>Shkalla e pajtueshmërisë në %</i>			
	Fare nuk pajtohem/ Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem/Pajtohem plotësisht	Gjithsej nr.
Drejtor i shkollës	0%	37,1%	62,9%	35
Zv.drejtor i shkollës	0%	42,9%	57,1%	7
KC	0%	22,2%	77,8%	36
Anëtar i EVV-së	1,8%	33,3%	64,9%	111

Vëmendje: Për qëllime të interpretimit më të lehtë, vlerësimi pesë shkallësh Likert është përmbledhur në tri shkallë vlerësimi!

Tabela numër 17 tregon se pajtueshmëri më të lartë të mbështetjes me dokumente (Kornizën, Udhëzuesin dhe Shtojcat) kanë deklaruar koordinatorët e cilësisë (Pajtohem/Pajtohem plotësisht=77,8%), përderisa rezultoi se 42,9% e zv.drejtorëve të shkollave kanë treguar qëndrim *Neutral* ndaj kësaj mbështetje. Në anën tjetër, anëtarët e EVV-së kanë treguar papajtueshmëri lidhur me mbështetjen e shkollave me materiale mbështetëse në procesin e VBSH-së (Fare nuk pajtohem/Nuk pajtohem=1,8%).

b) Trajnimi për VBSH, informatat kthyesë për raportet e VBSH-së dhe punëtoritë përcjellëse

Përveç kornizës për performancë të shkollës dhe udhëzuesve, shkollat janë mbështetur edhe me përfshirjen e drejtorit/zv.drejtorit, koordinorit të cilësisë dhe një numri të anëtarëve të EVV-së në trajnime për procesin e VBSH-së. Qëllimi i trajnimit ishte informimi i aktorëve të shkollave dhe koordinorëve të cilësisë lidhur me kërkesat dhe rolin e ri të shkollës në sistemin e sigurimit të cilësisë, si dhe ngritja e kapaciteteve të koordinorëve të cilësisë në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në kuadër të

sigurimit të cilësisë në nivel shkollë.

Pjesë e trajnimeve ishte edhe hartimi i raporteve të VBSH-së dhe dokumenteve përcjellëse, si dhe nxitja e reflektimeve nga shkollat për përdorimin e të dhënave të vlerësimit për hartimin/rishikimin e PZSHH-së dhe planin vjetor/ planin e veprimit.

Analiza e përgjigjeve të dhëna në pyetësorë tregoi se të anketuarit kanë vlerësuar lart mbështetjen e dhënë shkollave përmes përfshirjes së ekipeve në trajnime. Sipas tyre, *trajnimi për VBSH ka ofruar informacion të mjaftueshëm për hapat, procedurat dhe praktikrat që duhet ndjekur në realizimin e procesit të VBSH-së (Pajtohem plotësisht=36,5% dhe Pajtohem= 46,4%)*. Të anketuarit pohojnë se *përfaqësuesit e shkollës të trajnuar për VBSH kanë ofruar informacion të mjaftueshëm për ekipin e shkollës për vetëvlerësim lidhur me hapat, procedurat dhe praktikrat që duhet ndjekur në realizimin e procesit të VBSH-së (Pajtohem plotësisht=49,5,0% dhe Pajtohem= 43,8%)*.

Për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të VBSH-së raportet e vetëvlerësimit dhe dokumenteve që dalin nga ky proces, shkollat kanë pranuar edhe informacione kthyes nga trajnerët lidhur me përgatitjet e shkollës, instrumentet dhe raportin e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Sipas të anketuarve, *këto informata kthyes kanë qartësuar punën e ekipit të shkollës, kanë orientuar nevojat për plotësim/ndryshim në vetëvlerësimin e radhës të shkollës (Pajtohem plotësisht=38,4% dhe Pajtohem= 48,9%)*.

Përveç trajnimeve, me përfaqësuesit e shkollave të përfshira janë realizuar edhe punëtoritë përcjellëse lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe përdorimin e gjetjeve nga ky vlerësim në planifikimin e zhvillimit të shkollës. Të anketuarit kanë dhënë vlerësim të lartë për rëndësinë e kësaj forme të mbështetjes në avancimin e këtij procesi, meqenëse, sipas tyre, *punëtoritë përcjellëse e kanë qartësuar mënyrën e shfrytëzimit të gjetjeve dhe rekomandimeve nga raporti i vlerësimit në planifikim shkollor dhe në marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm (Pajtohem plotësisht=33,5% dhe Pajtohem= 52,7%)*.

Të dhënat e plota lidhur me shkallën e pajtueshmërisë së aktorëve të anketuar gjenden në tabelën numër 1 të bashkëngjitur në shtojcën E.

Tabela 18

Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (në %) për mbështetjen e ofruar shkollave në procesin e VBSH-së me trajnime, informata kthyese dhe punëtori përcjellëse, sipas rolit të tyre në koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së

Roli kryesor i të anketuarve në procesin e VBSH-së	Shkalla e pajtueshmërisë në %			Gjithsej. Nr.
	Fare nuk pajtohem/ Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem/ Pajtohem plotësisht	
Drejtor dhe zv. drejtori i shkollës	0,0%	11,8%	88,2%	40
KC	0,0%	11,1%	88,9%	36
Anëtar i EVV-së	1,9%	16,3%	81,7%	104

Vëmendje: Për qëllime të interpretimit më të lehtë, vlerësimi pesë shkallësh Likert është përmbledhur në tri shkallë vlerësimi!

Tabela numër 18 tregon se pajtueshmëri më të lartë të mbështetjes me trajnime, informata kthyese dhe punëtori përcjellëse kanë deklaruar drejtorët, zv.drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë. Në anën tjetër, anëtarët e EVV-së të përfshirë në studim kanë treguar papajtueshmëri lidhur me këtë formë të mbështetjes së shkollave në procesin e VBSH-së dhe kanë shkallë më të lartë të qëndrimit neutral (*Fare nuk pajtohem/Nuk pajtohem=1,9%; Neutral 16.3%*). Kjo tregon se anëtarët e EVV-së nuk kanë marrë informata të mjaftueshme nga drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë të përfshirë në trajnime dhe punëtoritë për VBSH, lidhur me realizimin e procesit të VBSH dhe përmirësimet e nevojshme pas marrjes së informatave kthyese nga analiza e drafteve të para të raporteve të VBSH-së.

c) Mendimet lidhur me Mbështetjen e ofruar shkollave nga DKA-të përkatëse

Koordinatorët e cilësisë në nivel të DKA-ve dhe DKA-të përkatëse kanë obligim t'i mbështesin shkollat në procesin e sigurimit të cilësisë. Secila DKA emëron një anëtar të stafit përgjegjës për sigurimin e cilësisë në nivel të komunës, detyrë e të cilit është koordinimi i punës me koordinatorët të cilësisë në shkolla. Sipas Strategjisë... (MASHT, 2016), DKA-të inkurajohen të ngrenë grupe profesionale në nivel komunal për të mbështetur shkollat në sigurimin e cilësisë. Këto grupe, të përbëra nga ekspertë të arsimit dhe njerëz të praktikës, do të ndihmojnë shkollat për të ngritur dhe zbatuar në mënyrë të efektshme sigurimin e cilësisë me bazë në shkollë dhe të adresojnë çështje të ndryshme që lidhen me punën e tyre, si zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, zhvillimin e kurrikulës, përdorimin e teknologjisë së arsimit dhe kështu me radhë. (Masa 1.4).

Stafi shkollës i përfshirë në studim, në pyetësorin e realizuar me ta, ka treguar nivel të lartë të pajtueshmërisë me *Mbështetjen e ofruar nga DKA – koordinatori i cilësisë në*

realizimin e procesit të VBSH-së (Pajtohem plotësisht=30,7% dhe Pajtohem= 36,0%). Në anën tjetër, mbështetja financiare e ofruar nga DKA-ja ka ndihmuar shkollën në priorizimin dhe ndërmarrjen e masave për përmirësim të performancës në kriterët/fushat e cilësisë që vlerësimet kanë dalë jo mirë, të anketuarit kanë deklaruar nivel jo edhe aq të lartë të pajtueshmërisë (Neutralë =39,6% dhe Fare nuk pajtohem= 26,6%), gjë që lë për të kuptuar se shkollat nuk janë edhe aq të informuara për rolin, mundësinë dhe mbështetjen edhe në aspektin financiar që DKA-të përkatëse duhet dhe ofrojnë në funksion të realizimit të procesit të sigurisë në shkolla.

Të dhënat e plota lidhur me shkallën e pajtueshmërisë së aktorëve të anketuar gjenden në tabelën nr. 1, të bashkëngjitur në shtojcën E.

Tabela 19

Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (në %) për mbështetjen e ofruar shkollave nga DKA, sipas rolit të tyre në koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së

Roli kryesor i të anketuarve në procesin e VBSH-së	Shkalla e pajtueshmërisë në %			
	Fare nuk pajtohem/Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem/Pajtohem plotësisht	Gjithsej nr.
Drejtor i shkollës	32,4%	41,2%	26,5%	34
Zv.drejtor i shkollës	14,3%	14,3%	71,4%	7
KC	33,3%	22,2%	44,4%	36
Anëtar i EVV-së	17,6%	42,6%	39,8%	108

Vëmendje: Për qëllime të interpretimit më të lehtë, vlerësimi pesëshkallësh Likert është përmbledhur në tri shkallë vlerësimi!


Tabela numër 19 tregon se pajtueshmëri më të lartë të mbështetjes nga DKA-të përkatëse kanë deklaruar zv.drejtorët e shkollave (Pajtohem/Pajtohem plotësisht=71,4%), përderisa 32,4% e drejtorëve Fare nuk pajtohem/Nuk pajtohem që DKA-të përkatëse kanë ofruar mbështetje shkollave në procesin e VBSH-së. Ndërsa 41,2% e drejtorëve dhe 42,6% e anëtarëve të EVV-së kanë qëndrim neutral lidhur me këtë mbështetje.

d) Perceptimet e përgjithshme të aktorëve të përfshirë për mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së

Specifikuar në nivel të shkollimit, më tutje kemi provuar të vërtetojmë nëse ka dallime në mes të tipit të shkollave të përfshira në studim, pra shkollave të nivelit të arsimit fillor dhe të atij të mesëm të ulët (1-9) dhe gjimnazeve në raport me pajtueshmërinë për mbështetjen e ofruar shkollave në procesin e VBSH-së. Shikuar në tërësi, shohim

se perceptimet e stafit të shkollës të përfshirë në këtë pjesë të studimit tregojnë pajtueshmëri të lartë lidhur me mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së.

Krahasimi i përqindjeve për tri shkallët e vlerësimit (për interpretim më të lehtë, vlerësimi pesë shkallësh Likert: Plotësisht pajtohem/ Pajtohem =3; Neutral=2; Nuk pajtohem/Fare nuk pajtohem=1), specifikuar në tipin/nivelin e shkollave të përfshira në studim, vërehet një shkallë e përafërt e pajtueshmërisë për mbështetjen e ofruar shkollave në procesin e VBSH-së (gjimnaze: *Pajtohem/ Plotësisht pajtohem*=54,2% dhe arsimit fillor dhe i mesëm i ulët: *Pajtohem/Plotësisht pajtohem*=52,1%). Një dallim i vogël në përqindje ekziston te gjimnazet, të cilat kanë treguar shkallë më të lartë të mospajtueshmërisë: *Fare nuk pajtohem/Nuk pajtohem*=8,5%, përderisa te shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, në përqindje më të lartë janë deklaruar te qëndrimi neutral ndaj kësaj mbështetje (*Neutral* =44,2%).



Grafiku 2

Perceptimet e përgjithshme të stafit të shkollës (në %) për mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së, sipas tipit të shkollës (SHFMU, Gjimnaz)

Lidhur me mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së, kemi analizuar ndërlidhjen e mundshme në mes të llojit të trajnimeve të realizuara nga stafi i shkollës dhe shkallën e pajtueshmërisë me mbështetjen e ofruar. Janë tri lloje të trajnimeve të përfshira në pyetësorin e realizuar me këtë mostër:

- Trajnimin për udhëheqje dhe menaxhim të shkollës;
- Trajnimin për sigurim të cilësisë në shkollë;

- Trajnimin për vlerësim të brendshëm të shkollës.

Në pyetësor të anketuarit kanë pasur mundësinë të japin më shumë se një përgjigje, varësisht se sa prej këtyre trajnimeve i kanë të përfunduara. Referuar përqindjeve më të larta të të përgjigjurve për një dhe më shumë se dy programe, kemi marrë përgjigje të ndryshme lidhur me trajnimet.


Tabela 20

Përqindjet e përfshirjes në programet e trajnimit të stafit të shkollës, që kishin rol në koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së

Pozita	Përfshirja në një program trajnimi	Përfshirja në dy e më shumë programe trajnimi
<i>Drejtor i shkollës:</i>	88,9% për programin e UA-së	63,9% për programin SC dhe VBSH
<i>Zv.drejtor i shkollës:</i>	87,5% për programin e UA-së	12,5% për programin SC dhe VBSH
<i>KC:</i>	86,8% për programin e VBSH-së	28,9% për programin SC dhe VBSH
<i>Anëtar i EVV-së:</i>	26,4% për programin e VBSH-së	55,2% për programin e UA-së

Pasqyra e plotë me përqindjet e të trajnuarve për programet e cekura më lart mund të shihet në tabelën 2, të bashkëngjitur në shtojcën E.

Për shkallën e pajtueshmërisë së të anketuarve lidhur me mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së dhe ndërlidhjen me trajnimet, të cilat kanë qenë më specifike për rolin e tyre në mbështetje të sigurimit të cilësisë në shkolla dhe me procesin e VBSH-së, nuk ka ndonjë dallim të madh statistikor sa i përket këtij aspekti, për të tri shkallët e vlerësimit. Megjithatë, përqindje më të lartë të pajtueshmërisë për mbështetjen e shkollave me materiale, trajnime dhe mbështetjen nga DKA-ja në procesin e VBSH-së, rezulton stafi i trajnuar për programin e VBSH-së. Ndërsa përqindje më të ulët për shkallën e vlerësimit *Plotësisht pajtohem/ Pajtohem* (48,75%) dhe përqindje më të lartë të perceptimeve neutrale (48,7%) , por edhe të atyre Fare nuk pajtohem/ Nuk pajtohem(2,6%) kemi te ndikimi i mundshëm i trajnimit për Udhëheqje arsimore në procesin e VBSH-së.



Grafiku 3.

Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës të përfshirë në hulumtim (në %), për mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së, në ndërlidhje me programet e ndjekura të trajnimit

4.1.5. Efektet e procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës

Me pyetësin për drejtorët, koordinatorin e cilësisë, anëtarët e EVV-së, kryetarët e aktiveve profesionale, mësimdhënës të përfshirë në mostër, si dhe mësimdhënës të angazhuar në përkrahje të ekipit të shkollës për vlerësim të brendshëm (shih tabelën nr.1), janë gjithsej 17 pyetje të ndërtuara në shkallën e vlerësimit Likert (5= *Pajtohem plotësisht*, 4= *Pajtohem*, 3 = *Neutral*, 2= *Nuk pajtohem*, 1= *Fare nuk pajtohem*). Me kërkesat e parashtruara në pyetësor synuam identifikimin e ndikimit të procesit të VBSH-së në:

- Motivimin aktorëve të përfshirë në mostër për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë;
- Mobilizimin e aktorëve të tjerë të shkollës për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme për ngritjen e cilësisë në shkollë;
- Nxjerrjen në pah të sfidave që i ka shkolla karshi proceseve të reja dhe ndryshimeve.

Vlerat e analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) për 17 pyetjet për personelin e shkollës, lidhur me qëndrimin e tyre për efektet e para pozitive të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, është $\alpha = .92$, kurse rëndësia sipas KMO dhe Bartlett's Test është = ,000.

Të dhënat e tabelës numër 22 tregojnë shkallën nga 1 (Fare nuk pajtohem) deri në 5

(Plotësisht pajtohem), personeli i shkollës i përfshirë në procesin e vetëvlerësimit, në forma të ndryshme dhe me role të ndryshme, kanë pajtueshmëri në nivel të lartë për ndikimin pozitiv nga përvoja e parë me praktikën e vetëvlerësimit ($M=4.22$, $DS=.88$). Ndërsa, gabimi standard i mesatares së mostrës ishte ($SE=0.04$).

Tabela 21

Rezultati mesatar dhe devijimi standard i shkallës së përgjithshme të pajtueshmërisë së personelit të shkollës për ndikimin pozitiv të VBSH-së në proceset e brendshme në shkollë

	Numri	Range/ vargu	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja		Devijimi standard	Varianca
	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Gabimi standard	Statistic	Statistic
Totali	387	4.00	1.00	5.00	4.22	.045	.88	.78

a) Motivimi i aktorëve të përfshirë në studim, për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë

Për të marrë perceptimet e aktorëve të përfshirë për motivimin e pjesëmarrësve në hulumtim lidhur me zhvillimin e proceseve të brendshme, kemi pesë kërkesa të parashtruara në pyetësor. Bazuar në analizën e të dhënave, të gjithë kanë dhëna përgjigjet e tyre, në të gjitha shkallët e vlerësimit. Përqindje më të lartë të vlerësimit kemi për shkallët: *Plotësisht pajtohem dhe Pajtohem*. Gjetjet e përgjithshme janë të prezantuara në tabelën numër 7, në shtojcën 1. Ndërsa referuar përqindjeve më të larta të përgjigjeve, procesi i VBSH-së i ka nxitur ata *për të bërë punë shtesë për shkollën, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së shkollës (Plotësisht pajtohem=49,9% dhe Pajtohem=40,4%), i ka përgatitur për të punuar me ekipin e vetëvlerësimit për të realizuar të gjitha fazat e këtij procesi (Plotësisht pajtohem=43,2% dhe Pajtohem=39,2%), u ka krijuar një ndjenjë më të fortë për të qenë pjesë e ekipit të shkollës për përmirësim të vazhdueshëm të performancës së shkollës (Plotësisht pajtohem=48,1% dhe Pajtohem=36,8%), u ka bërë të besojnë se shkolla e tyre çdo vit do ta realizojë me sukses VBSH-në (Plotësisht pajtohem=50,0% dhe Pajtohem=25,9%) dhe i ka motivuar ata për të qenë më i përkushtuar ndaj procesit të mësimdhënies dhe nxënies (Plotësisht pajtohem=59,4% dhe Pajtohem=34,0%)*.

Specifikuar në rolin kryesor të të anketuarve në procesin e VBSH-së, te të gjithë të anketuarit, përqindje më të lartë të pajtueshmërisë lidhur me *ndikimin e procesit të VBSH-së në motivimin e tyre për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë* kemi te shkalla e vlerësimit *Pajtohem/Plotësisht pajtohem*.

Llogaritur në përqindje, del se drejtorët e shkollave (94,4%) dhe anëtarët e EVV-së (91,4%) kanë treguar shkallë më të lartë të pajtueshmërisë për këto aspekte.


Tabela 22

Shkalla e pajtueshmërisë të stafit të shkollës (sipas rolit të tyre në VBSH) me ndikimin e procesit të VBSH-së në motivimin e tyre për kontribut të shtuar në proceset e brendshme për ngritjen e cilësisë në shkollë (në %)

<i>Roli kryesor i të anketuarve në procesin e VBSH-së</i>	<i>Shkalla e pajtueshmërisë në %</i>			<i>Gjithsej. nr.</i>
	<i>Fare nuk pajtohem/ Nuk pajtohem</i>	<i>Neutral</i>	<i>Pajtohem/ Plotësisht pajtohem</i>	
Drejtor i shkollës	0,0%	5,6%	94,4%	36
Zv.drejtor i shkollës	0,0%	25%	75,0%	8
Shërbimi profesional në shkollë (pedagog/psikolog)	0,0%	23,5%	76,5%	17
Koordinator i cilësisë në shkollë	0,0%	10,5%	89,5%	38
Udhëheqës i aktivitetit profesional	5,7%	20,8%	73,6%	53
Anëtar i ekipit të shkollës për vetëvlerësim	0,0%	8,6%	91,4%	128
Mësimdhënës i angazhuar në përkrahje të ekipit të shkollës për VBSH	0,0%	15,9%	84,1%	69
Mësimdhënës i përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së	4,9%	27,2%	68%	103

Vëmendje: Për qëllime të interpretimit më të lehtë, vlerësimi pesëshkallësh Likert është përmbledhur në tri shkallë vlerësimi!

Përveç analizës së ndikimit të VBSH-së në motivimin e drejtorëve/zv.drejtorëve, koordinatorëve të cilësisë dhe anëtarëve të EVV-së të përfshirë në anketim për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë, kemi bërë edhe analizën e përvojës së tyre në shkollë dhe mundësitë e ndikimit në motivim. Rezultatet tregojnë se të anketuarit me përvojë pune 1-5 vjet kanë pajtueshmëri më të lartë lidhur me ndikimin e procesit të VBSH-së në motivimin e tyre për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë (*Plotësisht pajtohem/Pajtohem=85%*).



Grafiku 4

Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (sipas viteve të përvojës së punës) me ndikimin e procesit të VBSH-së në motivimin e tyre për kontribut të shtuar në proceset e brendshme për ngritjen e cilësisë në shkollë (në %)

b) Mobilizimi i aktorëve të tjerë të shkollës për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme për ngritjen e cilësisë në shkollë

Lidhur me ndikimin e VBSH-së në mobilizimin e aktorëve të tjerë të shkollës për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë, kemi parashtruar nëntë pyetje në pyetësorin e realizuar me këtë mostër. Referuar gjetjeve, përgjigje të të anketuarve kemi pothuajse në të gjitha shkallët e vlerësimit, por që përqindje më të lartë të përgjigjeve kemi te vlerësimi *Plotësisht pajtohem dhe Pajtohem*. Gjetjet e përgjithshme janë të prezantuara në tabelën numër 3, në shtojcën E. Duke iu referuar përqindjeve më të larta të të përgjigjeve, procesi i VBSH-së ka ndikuar në:

- Mobilizimin e të gjithë aktorëve të shkollës në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për përmirësimin e cilësisë (*Plotësisht pajtohem=43% dhe Pajtohem=44,3%*);
- Nxiti diskutime në shkollë rreth cilësisë së performancës në shkollë (*Plotësisht pajtohem=53,5% dhe Pajtohem=37,6%*);
- Rezultoi me motivim shtesë të të gjithë mësimdhënësve për t'u angazhuar në aktivitete që sigurojnë cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies për të gjithë nxënësit (*Plotësisht pajtohem=39,2% dhe Pajtohem=48,4%*);

- Rezultoi me veprime konkrete nga udhëheqja e shkollës për përmirësim të vazhdueshëm të shkollës (*Plotësisht pajtohem=46,1% dhe Pajtohem=45%*);
- Nxiti organet qeverisëse në shkollë (KDSH, KP dhe KN) të organizojnë konsultime më të shpeshta për SC (*Plotësisht pajtohem=37,5% dhe Pajtohem=44,5%*);
- Nxiti bashkëpunim më të madh në mes të vet mësimdhënësve (*Plotësisht pajtohem=51,1% dhe Pajtohem=41,6%*);
- Nxiti organet profesionale në shkollë të organizojnë konsultime më të shpeshta për procesin mësimor (*Plotësisht pajtohem=44,7% dhe Pajtohem=44,7%*);
- Rezultoi me monitorim më të shpeshtë të punës së mësimdhënësve nga udhëheqja e shkollës (*Plotësisht pajtohem=38,9% dhe Pajtohem=47,7%*);
- Nxiti përkushtimin më të madh të shkollës ndaj zhvillimit profesional të mësimdhënësve (*Plotësisht pajtohem=44,5% dhe Pajtohem=44%*).

Bazuar në rezultatet e anketimit, përqindje më të lartë të pajtueshmërisë lidhur me ndikimin e procesit të VBSH-së në mobilizimin e aktorëve të tjerë të shkollës për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë kemi te shkalla e vlerësimit *Pajtohem/Plotësisht pajtohem*. Paraqitur në përqindje, Shërbimi profesional në shkollë -pedagogu/psikologu (88,2%) dhe zv.drejtori i shkollës (87,5%) kanë treguar shkallë më të lartë për këto aspekte.

Tabela 23

Shkalla e pajtueshmërisë së stafit të shkollës (sipas rolit të tyre në VBSH) me ndikimin e procesit të VBSH-së në mobilizimin e mekanizmave në nivel shkollë, për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë (në %)

<i>Roli kryesor i të anketuarve në procesin e VBSH-së</i>	<i>Shkalla e pajtueshmërisë në %</i>			
	<i>Fare nuk pajtohem/ Nuk pajtohem</i>	<i>Neutral</i>	<i>Pajtohem/ Plotësisht pajtohem</i>	<i>Gjithsej nr.</i>
Drejtor i shkollës	0,0	25,0	75,0	36
Zv.drejtor i shkollës	0,0	12,5	87,5	8
Shërbimi profesional në shkollë (pedagog/psikolog)	0,0	11,8	88,2	17

Koordinator i cilësisë në shkollë	2,6	26,3	71,1	38
Udhëheqës i aktivitetit profesional	3,8	34,0	62,3	53
Anëtar i ekipit të shkollës për vetëvlerësim	0,0	14,8	85,2	128
Mësimdhënës i angazhuar në përkrahje të ekipit të shkollës për VBSH	0,0	21,7	78,3	69
Mësimdhënës i përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së	6,8	35,0	58,3	103

Vëmendje: Për qëllime të interpretimit më të lehtë, vlerësimi pesëshkallësh Likert është përmbledhur në tri shkallë vlerësimi!

c) Sfidat e shkollës karshi proceseve të reja dhe ndryshimeve

Nisur nga mësimi i tretë i paradigmës së re të ndryshimit, të promovuar nga M. Fullan, se problemet janë miqtë tanë, problemet janë të pashmangshme dhe nuk mund të mësojmë pa to (Fullan, 2010), del se zbatimi i ciklit për sigurimin e cilësisë dhe udhëheqja e ndryshimeve tjera në shkollë nuk mund të bëhet duke ikur nga problemet që e sfidojnë atë dhe ndryshimet e nevojshme në shkollë. Prandaj, me tri pyetje të parashtruara në pyetësin e realizuar me aktorët e shkollës është hulumtuar *ndikimi i VBSH-së në nxjerrjen në pah të sfidave dhe problemeve që i kanë shkollat karshi proceseve të reja dhe ndryshimeve*.

Gjetjet e përgjithshme lidhur me sfidat dhe problemet e shkollës karshi procesit të VBSH-së janë të prezantuar në tabelën 3 në shtojcën E, duke iu referuar përqindjeve më të larta të të përgjigjurve, procesi i VBSH-së nxori në pah tri probleme kryesore, gjegjësisht problemet dhe pakënaqësitë e stafit të shkollës me:

- Mënyrën e organizimit të punës në shkollë (*Plotësisht pajtohem=26,9% dhe Pajtohem=44,8%*);
- Udhëheqje të proceseve të ndjeshme, siç është zbatimi i kurrikulës së re, planifikimi zhvillimor etj. (*Plotësisht pajtohem=36,5% dhe Pajtohem=43,2%*), si dhe
- Rezistencën e stafit të shkollës ndaj ndryshimeve (*Plotësisht pajtohem=30,4% dhe Pajtohem=37,5%*).

Duke u bazuar në rolin kryesor të të anketuarve në procesin e VBSH-së, përqindje më të lartë të pajtueshmërisë lidhur me *ndikimin e VBSH-së në nxjerrjen në pah të sfidave që i kanë shkollat karshi proceseve të reja dhe ndryshimeve* kemi te shkalla e vlerësimit *Pajtohem/Plotësisht pajtohem*. Sipas kësaj del se drejtorët dhe zv.drejtorët e shkollave (77,2%) kanë treguar shkallën më të lartë të pajtueshmërisë për këto aspekte (*Plotësisht pajtohem/Pajtohem*), përderisa te udhëheqësit e aktiveve profesionale, edhe pse përqindje më të lartë të të përgjigjurve kemi te shkalla e pajtueshmërisë (*Plotësisht pajtohem/Pajtohem=49,1%*), megjithatë kemi edhe një përqindje të theksuar të atyre

që kanë perceptime *neutrale* ndaj kësaj mbështetje (35,8%), ose kanë deklaruar mospajtueshmëri (*Fare nuk pajtohem/Nuk pajtohem=15,1%*) lidhur me mbështetjen e ofruar shkollave në procesin e VBSH-së.

Tabela 24

Shkalla e pajtueshmërisë të stafit të shkollës (sipas rolit të tyre në VBSH) me ndikimin e procesit të VBSH-së në nxjerrjen në pah të sfidave dhe problemeve që i kanë shkollat karshi proceseve të reja dhe ndryshimeve (në %)

Roli kryesor i të anketuarve në procesin e VBSH-së	Shkalla e pajtueshmërisë në %			
	Fare nuk pajtohem/ Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem/ Plotësisht pajtohem	Gjithsej nr.
Drejtor i shkollës dhe zv.drejtor	11,4	11,4	77,2	44
Shërbimi profesional në shkollë (pedagog/psikolog)	0,0	29,4	70,6	17
Koordinator i cilësisë në shkollë	2,6	21,1	76,3	38
Udhëheqës i aktivitetit profesional	15,1	35,8	49,1	53
Anëtar i ekipit të shkollës për vetëvlerësim	7,8	22,7	69,5	128
Mësimdhënës i angazhuar në përkrahje të ekipit të shkollës për VBSH	4,3	24,6	71,0	69
Mësimdhënës i përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së	8,7	33,0	58,3	103


Vëmendje: Për qëllime të interpretimit më të lehtë, vlerësimi pesëshkallësh Likert është përmbledhur në tri shkallë vlerësimi!

d) Perceptimet e përgjithshme të stafit të shkollës për efektet e procesit të VBSH-së në shkolla

Bazuar në tipin/nivelin e shkollimit, vërehet një shkallë e përafërt e pajtueshmërisë statistike për efektet e procesit të VBSH-së në shkolla, respektivisht në *motivimin e stafit për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë, mobilizimin e aktorëve të tjerë të shkollës për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë dhe në nxjerrjen në pah të sfidave që i kanë shkollat karshi proceseve të reja dhe ndryshimeve*. Sipas kësaj, del se në përqindje më të larta, nga të dyja tipat e shkollave, pajtueshmëri më të lartë të ndikimit të VBSH-së në proceset e shkollës kemi te shkalla *Pajtohem/Plotësisht pajtohem* (gjimnaze =33,9% dhe arsimit fillor dhe i mesëm i ulët=30,4%). Një dallim i vogël në përqindje duket te gjimnazet, të cilat kanë deklaruar shkallë më të lartë të mospajtueshmërisë, *Fare nuk pajtohem/Nuk pajtohem=8,5%*, përderisa te shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të

ulët në përqindje më të lartë janë deklaruar tek qëndrimi neutral ndaj kësaj mbështetje (*Neutral* =44,2%).

Bazuar në tipin/nivelin e shkollimit, vërehet një shkallë e përafërt e pajtueshmërisë për efektet e procesit të VBSH-së në shkolla, respektivisht në *motivimin e stafit për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë, mobilizimin e aktorëve të tjerë të shkollës për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë dhe në nxjerrjen në pah të sfidave që i kanë shkollat karshi proceseve të reja dhe ndryshimeve*. Referuar përqindjeve më të larta, mund të themi se nga të dy tipat e shkollave pajtueshmëri më të lartë të ndikimit të VBSH-së në proceset e shkollës kemi te shkalla *Pajtohem/Plotësisht pajtohem* (gjimnaze =81% dhe arsimi fillor dhe i mesëm i ulët=75,8%). Një dallim i vogël në përqindje ekziston te arsimi i mesëm i ulët, ku është deklaruar mospajtueshmëri, *Fare nuk pajtohem/Nuk pajtohem*=1,1%, perceptim neutral ndaj kësaj mbështetje (*Neutral* =23,2%), grafiku nr. 5.




Grafiku 5

Shkalla e përgjithshme e pajtueshmërisë së stafit të shkollës për efektet e procesit të VBSH-së në shkolla, në përqindje dhe sipas tipit të shkollës/ nivelit të shkollimit (SHFMU, Gjimnaz)

Bazuar në llojin e trajnimit të ndjekur nga aktorët e përfshirë në këtë pjesë të studimit, vërehet gjithashtu një shkallë e përafërt e pajtueshmërisë për efektet e procesit të VBSH-së në shkolla për të tri shkallët e vlerësimit. Pajtueshmëri më të lartë lidhur me efektet e procesit të VBSH-së kemi nga aktorët që kanë përfunduar trajnimin për programin e VBSH-së (57,6%) dhe trajnimin për sigurim të cilësisë në shkollë (55,4%). Bazuar në përqindjen më të lartë të të përgjigjurve, perceptime *neutrale* për efektet e procesit të VBSH-së në proceset e brendshme në shkollë kemi nga aktorët që kanë

përfunduar programin Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës (48,7%).



Grafiku 6

Shkalla e përgjithshme e pajtueshmërisë së stafit të shkollës për efektet e procesit të VBSH-së në shkolla, në përqindje dhe sipas llojeve të trajnimeve të kryera nga stafi i shkollës i përfshirë në hulumtim

4.2. PERSPEKTIVA E ZBATIMIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË SHKOLLËS NGA KËNDVËSHTRIMET E STAFIT TË SHKOLLËS, PRINDËRVE DHE NXËNËSVE

Nga konteksti i analizës së përgjigjeve, në pyetjet e hapura në pyetësorët e administruar me stafin e shkollës, prindërit dhe nxënësit, kemi nxjerrë një përmbledhje të rezultateve për këndvështrimet e stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve për perspektivën e zbatimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës. Të dhënat e analizuarra kanë nxjerrë në pah një numër informatash të rëndësishme, komente dhe sugjerime, si nga stafi i shkollës, ashtu edhe nga prindërit dhe nxënësit e përfshirë në studim. Këto të dhëna do të analizohen në pjesën në vijim.

4.2.1. Pikëpamjet e personelit të shkollës

Seksioni i pestë i pyetësorit për personelin e shkollës përbehej prej pesë pyetjeve të hapura, të cilat mundësuan që të marrim qëndrimet e stafit të shkollës rreth perspektivës së zbatimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës. Pas leximit dhe kodimit të përgjigjeve, të dhënat i kemi ndarë në katër kategori kryesore: (a) Praktikrat e mira gjatë realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës; (b) Aspektet sfiduese të VBSH-

së dhe mësimet për shkollat tjera dhe (c) Sugjerimet për përmirësimin e cilësisë së procesit të vlerësimit të brendshëm të shkollës.

a) Praktikrat e mira gjatë realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës

Praktikat e realizimit të VBSH-së janë reflektuar në vlerësimin pesë shkallësh Likert, përmes disa kërkesave, rezultatet e së cilave u elaboruan në pjesën 4.1 të këtij kapitulli. Ato janë plotësuar edhe me përgjigje të hapura nga respondentët e përfshirë në studim. Nga 387 respondentë nga stafi i shkollës, të përfshirë në studim, kemi marrë gjithsej 323 përgjigje me shkrim.

Në shumicën e komenteve dhe sugjerimeve të bëra nga pjesëmarrësit dominon ‘rëndësia e bashkëpunimit’ ndërmjet aktorëve të shkollës për një vlerësim real. Këtë ia sugjerojnë edhe shkollave të tjera.

Gjatë realizimit të hulumtimit të brendshëm, në shkollën tonë bashkëpunimi ka qenë aspekti më i mirë, pastaj fillimisht edhe ndarja e detyrave dhe llogaridhënia. (S/7)²²

Çështjen e bashkëpunimit shumica e shohin si një vlerë të shtuar në realizimin e procesit të VBSH-së. Gjithashtu edhe informimi me kohë, ndarja e detyrave dhe përfshirja e gjerë e pjesëmarrësve me interes për shkollën janë aspekte të vlerësuara. Por kemi marrë vlerësim edhe sa i përket rëndësisë së vlerësimit për diagnostikimin e gjendjes së shkollës, si ky në vijim:

Përcaktimi i gjendjes reale të performancës së shkollës. Ajo që do të mund t’u sugjerohet shkollave të tjera është përgatitja me kohë e instrumenteve të VV-së në mënyrë që të merren informata më kredibile nga aktorët e interesit. (S/12)

Një aspekt me rëndësi që hasëm te disa mësimdhënës është edhe çështja e vlerësimit të brendshëm dhe ndikimi në motivimin e mësuesit për bashkëpunim. Çështja e motivimit të mësuesve si reflektim i procesit të vlerësimit të brendshëm është e rëndësishme së veçantë. Disa të këtillë i zgjodhëm këtu, kur shprehen se:

Mendoj që çdo shkollë duhet të ketë ekipin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, pasi që shumë aspekte mësimore dhe përgjegjësi janë ngritur në nivelin e duhur. Aspektet që do të mund të ndahen në shkollat të tjera do të ishin: motivon mësimdhënësit, nxit bashkëpunim ndërmjet mësimdhënësve dhe stafit të shkollës, etj. (S/77) Motivim shtesë në identifikim të faktorëve që ndikojnë në mbarëvajtje të procesit dhe ngritje të cilësisë. (S/158). Sa i përket specifikimit të aspekteve më të mira gjatë aplikimit të vlerësimit të brendshëm ka shumë, por unë kam hasur në një motivim shumë më të madh të të gjithë mësimdhënësit për punë më produktive. (S/165) VBSH-ja motivon mësimdhënësit që të angazhohen më tepër për sukses të mëtutjeshëm. (S/167)

Prandaj ua sugjerojnë edhe shkollave të tjera që ky proces ka ndikim pozitiv, sepse

²² S= Staf i shkollës dhe numri paraqet kodin e stafit të shkollës në pyetësor.

nxjerr në shesh aspekte të rëndësishme të funksionimit të shkollës. Edhe porosia për shkollat e tjera që ta kenë ekipin, por edhe ta bëjnë vlerësimin e brendshëm, është me rëndësi promovimi të këtij procesi.

Gjithëpërfshirja: në këtë vlerësim të brendshëm kanë marrë pjesë mësimitdhënësit, prindërit dhe nxënësit, të cilët në mënyrën e tyre më të mirë kanë dhënë mendime se si të realizohet një performancë e mirë në shkollë, si dhe të ngrihet cilësia e mësimitdhënies dhe nxënies. (S/175)

Përfshirja e aktorëve në vlerësim ndikon në performancën e shkollës. Sipas këtij komenti dhe të tjerë si ky, dhënia e mendimeve nga këto palë ndikon në cilësinë e mësimitdhënies dhe nxënies. Është gjykim pozitiv për rëndësinë e vlerësimit të brendshëm të shkollës.

Me anë të VBSH-së janë identifikuar problemet që na përcjellin në shkollën tonë dhe si rezultat i kësaj është rritur bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm. (S/227)

Vlerësimin e brendshëm e shohin si instrument për identifikimin e mangësive dhe problemeve në shkollë. Identifikimi i tyre ka ndikuar në rritjen e bashkëpunimit brenda shkollës për zgjidhjen e problemeve apo për përmirësimin e mangësive. Disa e shohin edhe si element të ri në shkollë, i cili u ndihmon për përmirësim, prandaj edhe ua sugjerojnë shkollave të tjera që ta realizojnë një proces të këtillë.

Ishte risi për shkollën tonë VBSH-ja, prandaj fillimisht kishte vështirësi për të kuptuar të gjithë faktorët pjesëmarrës rëndësinë e zbatimit të VBSH-së, por me kohë janë eliminuar vështirësitë dhe pengesat. Fundi i procesit të zbatimit të VBSH-së ka rezultuar i suksesshëm dhe ka hapur perspektivë të re për shkollën tonë, për ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies dhe nxënies. (S/235)

E vlerësoj shumë VBSH-në, sepse ka nxjerrë një gjendje reale për të gjitha fushat e cilësisë dhe zhvillimet e brendshme të shkollës, duke përfshirë përparësitë, dobësitë dhe rekomandimet e nxjerra nga VBSH-ja. Realisht ka qenë sfiduese për ne si ekip. Është nxjerrë gjendja reale se çka ka nevojë shkolla për të arritur një performancë të mirë. S/285)

Vetë fakti që ky proces ishte diçka e re për shkollën paraqet edhe vështirësi dhe sfida. Por hapja e një perspektive të re paraqet një moment me rëndësi jo vetëm për rëndësinë e procesit të VBSH-së, por është edhe porosi e fuqishme për shkollat, të cilat ende nuk e kanë ndërmarrë një proces të këtillë. Potencomi i nxjerrjes në shesh të gjendjes reale, diagnostikimi dhe marrja e vendimeve bazuar në këto gjetje është një element i rëndësishëm për përmirësimin e fushave të cilësisë së shkollës.

b) Aspektet sfiduese dhe mësimet për shkollat tjera

Vlerësimi i performancës së institucionit arsimor/shkollës është përvojë e re. Identifikimi me kohë i sfidave të mundshme, sfidave nëpër të cilat kanë kaluar shkollat në përvojën e tyre të parë në këtë proces, por edhe i mësimave, janë me

rëndësi të veçantë për punën e shkollave në rrugëtimin e tyre për përmirësim të vazhdueshëm. Lidhur me aspektet sfiduese dhe mësimet për shkollat e tjera, kanë dhënë komente e sugjerime me shkrim gjithsej 296 pjesëmarrës nga stafi i shkollës të përfshirë në hulumtim. Ne i përzgjedhëm ato më të rëndësishmet, të vlefshme për hulumtimin, por edhe porositë për shkollat tjera. Si aspekt sfidues në shumë komente paraqiten çështje të hartimit të instrumenteve, mbledhja e të dhënave, përfshirja e aktorëve të ndryshëm, por edhe:

Rezistenca e një numri të madh të mësimitdhënësve për të ndryshuar, mungesa e motivimit dhe përkrahjes nga DKA. (S/2)

Është evidentuar nga disa mësimitdhënës e drejtorë çështja e hezitimit dhe e rezistencës së një numri mësuesish për të bashkëpunuar në çështje të caktuara të vlerësimit të performancës. Kjo rezistencë nga disa shihet edhe si:

Interesimi jo i mjaftueshëm i mësimitdhënësve dhe prindërve për të marrë përgjegjësi. (S/32)

Mosinteresimin për pjesëmarrje, ose përfshirje në procesin e vlerësimit, e ndërlidhin me aspekte të ndryshme të funksionimit të shkollës. Por edhe hezitimi për shkak të pjesëmarrjes së nxënësve në vlerësim për mësuesit, siç është ky:

Aspektet më sfiduese kanë qenë kur nxënësit është dashur të vlerësojnë mësimitdhënësit. Kjo ka qenë edhe kënaqësi, por edhe motivim për punën që mësimitdhënësit bëjnë me nxënësit. (S/52).

Është me interes të theksohet se disa mësues kanë ndier kënaqësi nga vlerësimi që ua bëjnë nxënësit, por në anën tjetër edhe i motivonte ata për punë. Sigurisht që vlerësimin, me anë të pyetësorit, që ua bëjnë nxënësit, e shohin ose e përjetojnë si rezultat të punës së tyre me nxënës. Ndërsa sfida, mangësi, apo telashe, kishte edhe me menaxhmentin:

Mospajtimet me menaxhmentin e shkollës, sidomos te fusha menaxhimi dhe qeverisja, gjë që duhet të keni kujdes me shkollat e tjera rreth kësaj sfide. (S/112, S/113, S/115)

Gjatë procesit të vlerësimit shpërfaqen edhe mospajtime rreth vlerësimit. Dalin në shesh aspekte të subjektivizmit në vlerësim ose tendenca për vlerësim real dhe joreal. Gjendjen reale, sidomos mangësitë, nuk mund t'i durojnë drejtorët, sepse edhe mund t'i marrin si çështje të dështimit të tyre, ose pjesë e fajësisë. Megjithatë, askujt nuk do të duhej t'i shkonte për shtati anashkalimi i dobësive në cilëndo fushë të cilësisë, sepse nuk do të kishim një pasqyrim real të gjendjes mbi të cilën duhet të ndërmarim hapa konkretë për përmirësim ose avancim të gjendjes.

Mësimitdhënësit, të cilët vlerësohen me më pak pikë, fillojnë urrejtjen ndaj mësimitdhënësve të tjerë, të cilët kanë marrë më shumë pikë dhe mund të mos ketë bashkëpunim me ta. (S/164)

Një element ky interesant, që e hasëm në komentet e mësimitdhënësve për sfidat. Kjo tregon se ende nuk jemi familjarizuar me vlerësimin, nuk është bërë pjesë e kulturës

së shkollës çështja e vlerësimit nga kolegu, drejtori apo nxënësi e prindi. Kjo sfidë nuk është shumë e theksuar në vlerësimet dhe komentet e tjera, por tërthorazi përmendet si mundësi e vlerësimit kolegu-kolegun me nuanca subjektivizmi, gjë që nëse kjo ka qenë prezent e dëmton objektivitetin dhe cilësinë e vlerësimit të performancës.

Koha e limituar, sepse, përveçse është dashur të merremi me mësimdhënie, edhe puna për vetëvlerësim na ka marrë kohë dhe energji kur dihet se kjo punë ka kërkuar përqendrim të nivelit të lartë. (S/136)

Çështjen e kohës së pamjaftueshme për vlerësim të mirëfilltë të performancës së shkollës e kanë vërë në spikamë disa mësimdhënës.

Angazhimi i prindërve në shkollë dhe përgjegjësia e tyre ndaj fëmijëve dhe shkollës është e mangët dhe ende nuk e kanë kuptuar prindërit se janë pjesë e proceseve në shkollë dhe kontribuues në arritjen e rezultateve në mësimdhënie dhe nxënie. (S/235)

Derisa prindërit çështjen e bashkëpunimit me shkollën e vlerësojnë si shumë të rëndësishme, disa mësimdhënës i fajësojnë ata për nivel të ulët të interesimit për bashkëpunim me shkollën. Sfida e mësipërme (S/235) paraqet rolin dhe rëndësinë e përfshirjes së prindërve, por edhe papërgjegjësinë e tyre për mospërfshirje ose informimin e ulët të tyre lidhur me rëndësinë që ka ky bashkëpunim, sidomos kur në pyetje është nxënësi.

Një numër i caktuar i mësuesve, drejtorëve dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues si sfiduese e shohin edhe çështjen e trajnimit paraprak të ekipeve dhe të mësimdhënësve për zbatimin e vlerësimit, hartimin e pyetësorëve, por edhe informimin e drejtë dhe me kohë të stafit lidhur me qëllimin dhe përmbajtjen e vlerësimit të brendshëm të shkollës.

Ndër kategoritë kryesore, të dala nga analiza e komenteve të kësaj pjese të mostrës, ishin: *Hartimi i instrumenteve; rezistenca ndaj ndryshimit; vlerësimi i mësuesve nga ana e nxënësve shkakton kënaqësi dhe motivon mësuesit; ngurrimi i prindërve për të bashkëpunuar me shkollë, keqkuptimet mes mësuesve për shkak të vlerësimit/tejkalimi; vlerësimi shkakton urrejtje mes mësuesve; vlerësimi reciprok jo i mirëfilltë, ose kërkesa për vlerësim joobjektiv; përfshirja e prindërve në shkollë, VBSH; mungon bashkëpunimi me prindër ose interesim jo i duhur i tyre; nxjerrja e përfundimeve pas vlerësimit etj.*

c) Përmirësimi i cilësisë së procesit të vlerësimit të brendshëm të shkollës

Sipas UA (MASHT 4/2017), vlerësimi i brendshëm apo vetëvlerësimi i performancës së institucionit arsimor bëhet çdo vit. Në vetëvlerësimin e parë të performancës së institucionit arsimor objekt vlerësimi janë të gjitha fushat e cilësisë. Ndërsa, në të gjitha vetëvlerësimet pasuese të performancës së institucionit arsimor objekt vlerësimi janë së paku dy fusha të cilësisë, të cilat duhet të mbulojnë nevojat e shkollës për përmirësim dhe avancim të punës së saj dhe temat me interes shtetëror. Fusha e cilësisë, që duhet

të jetë objekt i çdo vetëvlerësimi, është performanca e nxënësve. Pavarësisht numrit të fushave të cilësisë së shkollës, që do të jenë objekt i vlerësimit, përmirësimi i cilësisë së këtij procesi është qëllim në vetvete, përmes të cilit sigurohen edhe përmirësimi dhe avancimi i performancës së shkollës.

Ndër çështjet më të frekuentuara, të ngritura nga stafi i shkollës i përfshirë në studim, si nevojë për rritjen e cilësisë së VBSH-së përmenden: trajnimet, rritja e bashkëpunimit cilësor ndërmjet të gjithë aktorëve të shkollës, stimulimi i ekipeve për vlerësim, përfshirja e të gjithë mësimeve në trajnimet për vetëvlerësim, si dhe mbështetja nga ana e DKA-së gjatë procesit të vlerësimit. Gjithashtu, janë disa raste të kërkimlogarisë dhe të përgjegjësisë profesionale të mësuesve dhe të tjerëve gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm. Si ky në vijim:

Së pari, duhet pasur përgjegjësi profesionale ndaj nxënësve dhe vendit të punës, si mësimeve ashtu edhe udhëheqësit e shkollës. Së dyti, duhet monitoruar vazhdimisht puna e EVV-së dhe udhëheqësve të shkollës. Së treti, duhet të krijojmë kushte, lehtësira në punë, mbështetje morale dhe forma të tjera të përkrahjes. (S/69,S/235)

Kërkimi i llogaridhënies, përgjegjësisë, monitorimit të procesit etj., janë disa nga pikat me rëndësi, të sugjeruara nga pjesëmarrësit. Por kishte edhe të tilla si kërkimi i llogarisë dhe përgjegjësisë edhe nga prindërit, sidomos për rritjen e cilësisë së bashkëpunimit me shkollën.

Efikasiteti i punës së udhëheqësve dhe ekipeve shkollore për vlerësimin e brendshëm të shkollës bëhet me trajnime të ndryshme dhe ligjërata që do ta ndihmojnë shumë këtë proces. Trajnimet na japin informacione të mjaftueshme më tej. (S/324)

Efikasiteti i punës së udhëheqësve dhe ekipeve shkollore për vlerësimin të brendshëm të shkollës mendoj se do të rritet me trajnime adekuate dhe me bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet udhëheqësve të ekipeve shkollore. (S/69)

Të ketë më shumë punëtori të organizuara për vlerësimin e shkollës, të përfshihen më shumë anëtarë të kolektivit, të kuptojnë drejt rolin që ka vlerësimi në përmirësimin e fushave të caktuara, e jo të punojnë ndaras, pa dhënë informata të bollshme dhe të kuptueshme se çka është vetëvlerësimi apo vlerësimi i brendshëm i shkollës. Çdo punë bëhet për të rritur cilësinë e shkollës dhe për t'i vetëdijësuar aktorët pjesëmarrës që të jenë të përkushtuar. (S/71, S/90)

Gjatë analizës së përgjigjeve për këtë kategori, hasëm edhe në një ngatërrim në mes të procesit dhe procedurave të VBSH-së me procesin dhe procedurat e vlerësimit të njohurive të nxënësve. Gjithashtu, kishte edhe mendime e sugjerime, të cilat fare nuk kishin të bënin me vlerësimin e performancës së shkollës, si çështje të infrastrukturës,

numri i madh i nxënësve, apo edhe sheshimi i problemeve të tjera në raportet e brendshme të shkollës, sidomos me menaxhmentin, bashkëpunimin me prindër etj.

Disa sugjerime nga ana e pjesëmarrësve në hulumtim janë përtej qëllimit dhe objektit të hulumtimit. Në pah nxirren problemet e ndryshme të shkollës nga e cila vijnë dhe jo sugjerime e komente që do të ndihmonin hulumtimin apo hulumtimet e këtilla në të ardhmen. Nga komentet dhe sugjerimet tjera për temën e studimit, që dominojnë, përvijohen edhe këto: proces i qëlluar, përkushtim më i madh i gjithë stafit, përkrahje nga DKA-ja, trajnime, vlerësim real, transparencë në vlerësim, monitorim nga jashtë etj. Por kemi marrë edhe sugjerime të këtilla si në vazhdim:

VBSH-ja, një proces që është dashur që të aplikohet shumë më herët. Është i qëlluar, pikërisht në kohën më të nevojshme për ngritje të cilësisë në shkolla. Dhe, mundësisht të kontrollohen shkollat e tjera që bëjnë vlerësim të brendshëm, që mos të marrin të gatshme vlerësimet nga shkollat e tjera, pasi që secila shkollë i ka specifikat e veta. (S/71, S/117).

Si te sfidat, edhe këtu, pjesëmarrësit sugjerojnë si sfiduese çështjen e mospjesëmarrjes ose edhe hezitimit nga një numër mësuesish për të qenë pjesë e vlerësimit, prandaj:

Të binden mësimdhënësit që nuk janë pjesë e EVV-së se ky vlerësim i brendshëm ka për qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. (S/71, S/221)

Disa e shohin rëndësinë e VBSH-së nëse shtrihet në gjithë vendin, gjë që edhe do të bëhet, sepse tanimë është detyrim juridik për të gjitha shkollat, por njëri prej tyre ka këto arsye:

Të zbatohet VBSH në tërë territorin e R. së Kosovës, të mentorohet procesi çdo vit, të mblidhen rezultatet dhe të krahasohen ato, si dhe të rangohen shkollat sipas performancës. Të përkrahjet në formë të ndryshme procesi i VBSH-së nga MASHT-i. (S/71, S/235).

4.2.2. Pikëpamjet e prindërve për procesin e vlerësimit të brendshëm

Në fund të pyetësorit për prindër kemi parashtruar një kërkesë të hapur për të marrë komentet e tyre, por edhe sugjerimet lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe rolin e tyre në këtë proces. Nga gjithsej 121 prindër të përfshirë në hulumtim, vetëm 97 prej tyre kanë dhënë sugjerime dhe komente.

Marrë në përgjithësi, prindërit në shumicën e rasteve shprehin rëndësinë e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, por edhe kënaqësinë me procesin, gjegjësisht me përfshirjen e tyre në proces. Disa prindër këtë e ndërlidhin edhe me vlerësimin e nxënësve.

Si prind, jam i kënaqur në përfshirjen e procesit në realizimin e vlerësimit në diskutimin me stafin. Sugjeroj që rezultatet e nxënësve të publikohen

brenda një kohe më të shkurtër. Nga mësimdhënësit bëhet punë maksimale. (P/6)²³

Vlerësime të këtilla hasim te shumica e prindërve, me çka tregohet kënaqësia e tyre që u është dhënë mundësia të kontribuojnë në këtë proces. Por edhe sugjerime të këtilla, personalizuese, si:

Besoj dhe mendoj fuqishëm se roli i prindërve në mbarëvajtjen e procesit edukativ-arsimor është më se i domosdoshëm. Angazhimi edhe më i madh i prindërve besoj se do të pasojë me rezultate edhe më të mira. E them këtë gjithmonë pa e përjashtuar personelin mësimdhënës, si dhe stafin drejtues të shkollës, në krye me drejtoreshën. Shkolla gjithmonë ka nevojë për përkrahje, si nga institucionet e vendit po ashtu edhe nga prindërit. Besoj dhe shpresoj se me një angazhim të mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve, rezultatet nuk do të mungojnë. Drejtoria e shkollës ka punuar shumë mirë rreth përfshirjes së prindërve në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Pjesëmarrja jonë në jetën e përditshme të shkollës na fuqizon ne si aktorë të domosdoshëm në mbarëvajtjen e të gjitha proceseve të shkollës: mësimdhënie cilësore dhe nxënie, staf më përgjegjës, si dhe mirëmbajtje më të mirë të objektit shkollor. (P/20)

Shihet që prindi është shumë i përfshirë në jetën e shkollës, sepse vë në pah edhe nevojat e saj. Por përfshirja edhe i fuqizon si prindër dhe si aktorë të domosdoshëm në shkollë. Domosdoshmërinë e prezencës së prindërve në shkollë e parasheh/sugjeron edhe një prind:

Është plotësisht e domosdoshme përfshirja e prindërve në procesin e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës në shkollë, sepse roli i prindërve është i rëndësishëm në procesin e vlerësimit të brendshëm në shkollë. (P/27)

Por kërkohet pjesëmarrje edhe më e gjerë e tyre në këto procese.

Roli i prindërve në procesin e realizimit të VBSH-së nëse do të kishte përfshirje më të gjerë do të ishte shumë i madh. Besoj që një përqindje e vlerësimit duhet t'u takonte prindërve, pasi që ata bashkë me nxënësit kanë njohuri të mjaftueshme për performancën e mësimdhënësve në klasë. (P/30)

Edhe prindërit ngrenë shqetësimet e tyre lidhur me procesin dhe menaxhimin e tij:

Konsideroj që projekti ka pasur probleme dhe pakënaqësi të disa mësimdhënësve, pasi që kanë refuzuar me raste të implementimit. Stafi mësimor i angazhuar ka tentuar të jetë në nivelin e caktuar, pavarësisht këtyre refuzimeve, konsideroj se është dështimi i zgjedhjes së drejtorit ndikon negativisht në përgjithësi, pasi stafi i angazhuar për vlerësim ka pasur tendencë të mos njihet si kredibil nga disa mësimdhënës. Në përgjithësi, jam i kënaqur me angazhimin e këtij ekipi. (P/54)

²³ P=prindi, numri paraqet kodin e prindit në pyetësor.

Çështja e rezistencës ndaj vlerësimit nga ana e mësuesve është vënë në spikamë edhe nga pjesëmarrës e tjerë në hulumtim.

Kishte edhe kërkesa për rritje të kompetencës së prindërve në proceset në shkollë, siç kërkon ky:

Roli i prindërve duhet të jetë aktiv jo vetëm në vlerësimin e performancës së nxënësve, por edhe në vlerësimin e performancës së punës së mësimitdhënësve. Ne jemi dëshmitarë të ndryshimeve të metodave mësimore kudo në botë dhe implementimin bukfal të këtyre metodave tek mësimitdhënësit, pa u fokusuar mirë në analizat detale të personelit mësimor se a janë të përgatitur për të bartur saktë praktikat. A është niveli i përgatitjes së mësimitdhënësit tanë (kosovarë) me nivelin e përgatitjes së nivelit të mësimitdhënësit nga vijë këto praktika. A janë kushtet e njëjta për t'u zbatuar këto praktika: ambienti i nxënësve në klasë, mjetet, teknikat, instrumentet, laboratorët, orari i mësimit dhe faktorët të tjerë. (P/75).

Varësisht nga roli i prindërve në proceset në shkollë, edhe sugjerimet dhe komentet e tyre dalin përtej kërkesës për të komentuar dhe për të dhënë sugjerime lidhur me vetë procesin e vlerësimit të brendshëm. Këta kryesisht janë anëtarë të Këshillit Drejtues të shkollës ose të Këshillit të Prindërve.

Nga këndvështrimi im personal dhe prindërve në përgjithësi, mendoj se ka vend për përmirësimin e pozitës dhe përfshirjes së prindërve në shkollë, me qëllim që të kenë mundësi të japin kontributin për vlerësim, e aq më tepër sugjerime për mbarëvajtjen e procesit dhe posaçërisht rritjen e cilësisë në arsim. Duke aluduar gjithmonë në perspektivën e fëmijëve dhe shtetit, bashkëpunimi dhe involvimi i prindërve në shkollë, qoftë edhe si vlerësues, do t'i paraprijë progresit, jo vetëm individual, madje edhe si shkollë, por atij të përgjithshëm. Duke detektuar mekanizmat, ne kuptojmë ku jemi, si të ecim të sigurt, për të arritur qëllimin si destinacion. (P/94)

Në përgjithësi komentet dhe sugjerimet e prindërve janë për përfshirje më të gjerë të tyre në proceset që zhvillohen në shkollë, informimin e duhur me ato procese, përfshirje edhe e prindërve të tjerë, vlerësimi i brendshëm si proces shumë i qëlluar dhe i nevojshëm, shprehja e kënaqësisë me pjesëmarrjen në procesin e vlerësimit të brendshëm. Kjo flet për nevojën për përfshirje më të gjerë dhe më të shpeshtë të prindërve në proceset dhe aktivitetet që zhvillohen në shkollë.

4.2.3. Pikëpamjet e nxënësve

Me anë të pyetësorit për nxënës, kemi parashtruar vetëm një kërkesë të hapur për të marrë komentet e tyre, por edhe sugjerimet lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe rolin e tyre në këtë proces. Nga numri i përgjithshëm i nxënësve (N=299) të përfshirë në mostër, në kërkesën e hapur kanë dhënë mendimin e tyre (N=213) ose rreth 71%. Pas leximit dhe kodimit të përgjigjeve i kemi ndarë në dy kategori kryesore, të cilat ndërlidhen me kërkesën bosht: Roli dhe përfshirja

e nxënësve dhe prindërve në procesin e VBSH-së. Analizën e përgjigjeve e kemi bërë një nga një, duke bërë përzgjedhjen e atyre që kanë dhënë mendim për temën, çështjen e kërkuar: roli dhe përfshirja e nxënësve dhe prindërve në procesin e VBSH-së në shkollën e tyre. Nga mendimet e nxënësve të shprehur mësojmë se nxënësit më shumë u referohen rolit dhe përfshirjes së prindërve në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës.

Te shumica e komenteve dhe sugjerimeve të nxënësve, lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm, dominojnë konceptet si: ‘vlerësimi i shkollës tepër i rëndësishëm’, ‘informimi i nxënësve’, ‘mungesë informimi’, ‘prindërit si pjesë e vendimmarrjes në shkollë’, ‘jam i kënaqur me pjesëmarrjen e prindërve në shkollë’, ‘prindërit duhet të jenë më shumë prezentë në shkollë’.

Një numër i konsiderueshëm i komenteve të nxënësve shprehin shqetësimin e tyre për gjendjen në shkollë, shumë prej tyre i referohen vlerësimit sipas kurrikulës së re, por edhe kanë lëvdata për punën që bëhet në shkollë. Shqetësimet e tyre janë edhe në fushën e mosdëgjimit të zërit të tyre në shkollë, si ‘mendimet tona të merren në konsideratë’. Gjithashtu, kemi edhe raste të mosinformimit të nxënësve lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, rolin e nxënësve në këtë proces dhe përfshirjes në hulumtim. Prandaj, një numër i konsiderueshëm i tyre ngatërrojnë rolin dhe përfshirjen e tyre në VBSH me përfshirjen në vlerësimin e tyre nga ana e mësuesve.

Nxënësit sugjerojnë se roli i tyre dhe i prindërve në VBSH duhet të rritet. Prindërit duhet të mbahen të informuar për gjendjen në shkollë. Ky/kjo e sheh rolin më të rëndësishëm të prindit në shkollë. Komenti në formë kërkese është që të rritet roli i tyre, por edhe ‘të mbahen të informuar’. Nga kjo mund të dalë se prindërit nuk janë të informuar sa duhet me gjendjen në shkollë, apo edhe për ndikimin e tyre mbi nxënësit për të qenë pjesë aktive e procesit të vlerësimit të performancës së shkollës duke u bërë pjesë e vlerësimit. Kërkesat për ‘duhet të rritet’ dhe të ‘mbahen të informuar’ për shkollën dhe rrethanat në shkollë paraqesin edhe një shkallë brengosjeje të nxënësve lidhur me cilësinë e përfshirjes së prindërve në proceset që zhvillohen në shkollë.

Prindërit nuk janë aktivë në procesin e realizimit të VBSH-së. Në qoftë se roli i tyre do të ishte më i avancuar, atëherë kishte me qenë më mirë. (Nx²⁴/25)

Një paraqitje shumë e qartë e (mos)përfshirjes së prindërve në proceset në shkollë. Prandaj, sipas kësaj, roli i tyre është tejet pasiv, sepse nëse roli i tyre ‘do të ishte avancuar’ do të ndryshonin shumë gjëra për të mirë në shkollë, pra edhe në VBSH.

Natyrisht se roli i prindërve në përfshirjen dhe përgjithësisht në procesin e VBSH-së do të duhej të ishte më i madh, pra një bashkëpunim më i madh i prindërve dhe mësimit nxënësve besoj se do të ishte i mirëpritur. (Nx./31)

Është ky një sugjerim interesant nga njëri nxënës, i cili në dukje rëndësinë e informimit të të gjitha palëve, edhe të prindërve, lidhur me proceset që zhvillohen në shkollë dhe të vlerësimit të brendshëm. Por, nxënësit kanë edhe zë kritik ndaj vetë procesit dhe përfshirjes së prindërve në të:

²⁴ Paraqet kodin e identifikimit të nxënësve të përfshirë në hulumtim.

Sa i përket bashkëpunimit prind-shkollë, është i dobët, ngaqë bashkëpunimi sa më i madh rezultatet janë më të mira. Nëse ky vlerësim është aq i rëndësishëm, atëherë nevojitet një seriozitet më i madh për këtë punë. Nëse na drejtohen pyetjet për informata të rezultateve të këtij lloji pyetësori, atëherë ne duhet informuar, ngase nuk është bërë fjalë as edhe një herë të vetme për një gjë të tillë. Integrimi të jetë i gjithanshëm. (Nx./163)

4.3. KËNDVËSHTRIMI I INSPEKTORËVE TË ARSIMIT DHE KOORDINATORËVE TË CILËSISË NË DKA PËR PËRVOJAT DHE PËRKUSHTIMIN INSTITUCIONAL NË ZBATIMIN E SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË SHKOLLËS

Intervistat e realizuara me inspektorë të arsimit dhe koordinatorë të cilësisë/ zyrtarë të arsimit në DKA, përbëjnë burimin parësor të analizës së përkushtimit institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Rezultatet e analizës për këtë pjesë janë plotësuar me analizën e planeve të MASHT-it, Inspektoratit të Arsimit dhe të katër Drejtorive Komunale të Arsimit, për vitin 2018. Të dhënat e mbledhura i analizuam për katër tema:

- (i) *Dokumentet për sigurim të cilësisë, sistemin e vlerësimit të performancës dhe zbatimin e tyre në praktikë;*
- (ii) *Përvoja e IA dhe KC në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës;*
- (iii) *Planet sektoriale për përmbushjen e rolit në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës;*
- (iv) *Zbatimi i sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës.*

4.3.1. Dokumentet për sigurim të cilësisë dhe vlerësim të performancës së institucionit arsimor/ shkollës dhe zbatimi i tyre

Ekziston perceptimi se fokusi i zhvillimit të arsimit në Kosovë ka ndjekur modelin e standardizimit dhe përshkrimit, duke besuar se ndryshmet do të ndodhin duke u fokusuar në hartimin e politikave dhe sigurimin e politikave të standardizuara (Saqipi, 2013), kundrejt fuqizimit të shkollës dhe krijimit të mekanizmave për mbështetje, mbikëqyrje, monitorim dhe vlerësim të punës së shkollës. Zhvillimi i dokumenteve që lidhen me sigurim të cilësisë dhe vlerësim të performancës së shkollës ka në fokus zhvillimin e mekanizmave për sigurim të cilësisë nga niveli qendror deri në nivel shkollë. Të gjithë të intervistuarit në përgjigje të pyetjes për politikën dhe procedurat e VPSH-së iu referuan dokumenteve bazë të miratuara nga MASHT-i për sigurim të cilësisë dhe VPSH. Kjo tregon për një njohje të mirë nga ana e tyre, të dokumenteve e politikave arsimore që e rregullojnë këtë sistem. Ka edhe reflektime të tjera lidhur me dokumentet në këtë fushë:

- Pako e dokumenteve për sigurim të cilësisë është një bazë e mirë për punën e suksesshme në institucionet e arsimit parauniversitar (KC/3)²⁵;
- Janë dokumente që u kanë munguar shkollave tona, por vlerësimi përmes konstatimeve përshkruese paraqet vështirësi për shkollat tona, mungon përvoja e vlerësimeve të kësaj natyre (IA/2)²⁶;
- Këto dokumente mendoj se janë dokumente të zbatueshme dhe praktike. Zbatimin e tyre mendoj se e bëjnë edhe më të lehtë udhëzuesit përkatës për zbatim, siç është Udhëzuesi për Vlerësimin e Brendshëm të Shkollës (KC/2).

Në mesin e tre inspektorëve të arsimit dhe katër KC/ zyrtarëve të arsimit në DKA, gjashtë prej tyre në intervistë u referohen edhe aspekteve që lidhen me zbatimin e këtyre dokumenteve. KC e cilësisë në DKA flasin për fillimin e zbatimit të UA për koordinatorë të cilësisë dhe vështirësitë në zbatimin në praktikë, si dhe për fillimin e vlerësimit të performancës së shkollës në disa shkolla të komunës së tyre. Inspektorët e arsimit flasin për progresin në zbatimin e këtyre dokumenteve, por edhe për vështirësitë me të cilat ballafaqohen gjatë punës në terren.

Shkollat, sidomos ato të cilat janë monitoruar, me përkushtim dhe përgjegjësi të plotë, mbështeten në pakon e dokumenteve për sigurim të cilësisë dhe VPSH, disa shkolla bëjnë përpjekje, por ende kanë paqartësi në disa segmente. Mungesa e studimit të dokumenteve dhe veçanërisht e udhëzuesit dhe të kuptuarit e kërkesave krijojnë dilema tek EVV (IA/1);

Duke pasur parasysh se deri tani kemi vlerësuar gjashtë shkolla dhe në të shtatën jemi në grumbullim të të dhënave, mendoj se kam njohuri solide për procesin, ka mungesë të përvojës dhe njohjes së sistemit të vlerësimit të shkollës. Në vlerësimet e realizuara nga shkollat, pak po arrijnë të paraqesin gjendjen reale, ka tendencë të “përmirësimit” të gjendjes (IA/2).

Të intervistuarit i referohen edhe përgatitjes së institucioneve arsimore për realizimin e vlerësimit të performancës së shkollës. Pothuajse të gjithë të intervistuarit nuk janë të kënaqur me praktikën e institucioneve arsimore/shkollave, në përgatitjet e tyre për fillimin e vlerësimit të performancës së shkollës. Këtë e ndërlidhin me mungesën e koordinatorit për cilësi në MASHT dhe me mungesën e zbatimit të UA (MASHT, 2016) për koordinatorë të cilësisë. Tre nga të intervistuarit, mungesën e përgatitjes së duhur e arsyetojnë me mungesën e përvojës për një qasje të re, që deri tash nuk është praktikuar në shkollat tona. Njëri prej të intervistuarave mospërgatitjen e institucioneve për realizimin e VPSH e ndërlidh me mungesën e seriozitetit në leximin e dokumenteve për të kuptuar rolin e tyre dhe procedurat që duhen ndjekur. Për adresim të kësaj problematike, një nga të intervistuarit sugjeron që t’i kushtohet më shumë rëndësi përfshirjes në trajnime edhe të EVV-së:

Është evidente se nuk lexohen mjaftueshëm dokumentet që përshkruajnë gjithë ecurinë e punës, prandaj duhet kushtuar kujdes ngritjes profesionale të EVV-së në

²⁵ KC=Koordinator i cilësisë në DKA, numri paraqet kodin e KC të intervistuar.

²⁶ IA=Inspektor i arsimit, numri paraqet kodin e IA të intervistuar.

këtë fushë. Kujtoj se përgatitja e vetëm dy personave (drejtorit dhe KC) nuk është e mjaftueshme për një punë që duhet të kryhet nga një ekip me më shumë se dy anëtarë. Informacionet që marrin këta dy persona të caktuar nga shkolla, respektivisht njëri nga ta, sepse drejtori tërë punën ia lë KC, derisa po arrijnë tek të tjerët, nuk po janë të plota (KC/3).

Për përgatitje më serioze për procesin e vlerësimit të performancës në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë, një nga KC në DKA kërkon që MASHT-i dhe DKA-ja të bëjnë riorganizime për këtë proces:

MASHT-i duhet ta ngrejë një divizion të veçantë për realizimin e vlerësimit të performancës në institucione arsimore, duhet të vendosë koordinatorin e cilësisë në nivel të MASHT- it, ndërsa DKA-ja pozitën e KC nuk duhet ta ngarkojë me detyra të tjera, jashtë atyre që janë të përshkruara me UA për KC, kur kemi parasysh ndjeshmërinë e vlerësimit të performancës së shkollës dhe nevojat e shkollave për mbështetje, sidomos në fazën e parë të vlerësimit. Ndryshe, procesi i VPSH-së do të sfidohet (KC/1).

4.3.2. Përvojat e inspektorëve të arsimit dhe KC në vlerësimin e performancës së shkollës

Të gjithë të intervistuarit kanë përvojë në procesin e VPSH-së, natyrisht përvoja të ndryshme, në bazë të rolit të tyre të përcaktuar me sistemin e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore, përkatësisht UA nr. 4/2017. Përvojat e tyre lidhen në tri aspekte, me përfshirje, në diskutime gjatë zhvillimit të dokumenteve, me përfshirje në trajnime në këtë fushë, fasilitimim e disa punëtorive për VBSH me mbështetje nga ‘KulturKontakt Austria’ dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës, si dhe me fillimin e zbatimit në praktikë të sistemit të VPSH-së. Reflektimet e të intervistuarve flasin për përfshirje në diskutim të dokumenteve dhe në trajnime, si përvoja të mira, që u mundësuan të njohin më mirë dhe të familjarizohen më shumë me procesin e VPSH-së.

Mendoj se tani kam një përvojë të mirë, sepse jam familjarizuar me fushat, kriteret dhe treguesit që ka udhëzuesi. Trajnimi ynë ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, kemi bërë edhe pilotimin e procesit të vlerësimit në një shkollë në vlerësimin e një fushe të cilësisë. Kam përcjellë edhe trajnimin për vlerësim të brendshëm të shkollave me grupin e parë të shkollave në rajonin tonë (IA/2).

Të intervistuarit reflektojnë edhe për mësimet pozitive nga përvoja e tyre në procesin e VPSH-së, dobësitë e vërejtura dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar gjatë kësaj përvoje. Përvoja e punës me dokumentet për VPSH-në perceptohet si një mësim pozitiv. Gjithashtu, në mesin e mësimave pozitive janë edhe përgatitja profesionale e tyre, përvoja me shkollat, fasilitimim e punëtorive për VBSH, bashkëpunimi me mësimdhënësit, lidhja me procesin e zbatimit të kurrikulës së re, gatishmëria e shkollave për ta bërë vetëvlerësimin e punës së tyre, mobilizimi i organeve të shkollës për këtë proces etj. Disa inspektorë flasin edhe për mësim të tjera pozitive nga përvoja e tyre e parë në VJPSH dhe njëri prej tyre shprehet kështu:

Kemi shtrirë më tepër gjerësinë dhe thellësinë e marrjes së informatave për

performancën e shkollës. Përshkrimi narrativ i gjendjes paraqet sfidë edhe për ne, për shkak të mungesës së përvojës dhe të dhënave ...(IA/2).

Të gjithë të intervistuarit nxjerrin në pah disa dobësi të vërejtura në fazën e parë të zbatimit të sistemit të VPSH-së. Ato lidhen me mungesën e informimit në disa shkolla për procesin e VPSH-së, mospranimin e përgjegjësive për të bërë VBSH, mosrespektim të kritereve nga disa shkolla në përcaktimin e KC, mungesë të njohurive paraprake për këtë lloj të vlerësimit, probleme në formimin dhe funksionalizimin e EVV-së, mosrespektim të hapave kryesorë të procesit të vlerësimit të brendshëm; mungesën e të dhënave të besueshme në disa shkolla, mungesë në të kuptuarit e disa treguesve të performancës, mangësi të veçanta në vlerësimin e fushës së cilësisë për performancën e nxënësve, mospërfshirje të duhur të aktiveve profesionale të disa shkollave në këtë proces, probleme serioze në disa shkolla për zbatimin e sistemit të vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës së re, qëndrimin “anash” të disa drejtorëve të shkollave ndaj këtij procesi etj.

Të intervistuarit ndanë edhe sfidat me të cilat është ballafaquar dhe mund të ballafaqohet ky proces edhe në të ardhmen, si:

- Mosrespektimi i UA për lirin nga orët mësimore të koordinatorëve të cilësisë;
- Dilema të shumta rreth detyrave të KC, në këtë kontekst edhe në lidhje me VPSH-në;
- Mosgatishmëria e disa mësimdhënësve të shkollave për të qenë pjesë e ekipeve për vetëvlerësim;
- Përshkrimi narrativ i gjendjes paraqet sfidë edhe për ne;
- Tendenca për të paraqitur shkollën në shkallë më të lartë të cilësisë, kundrejt gjendjes reale;
- Vlerësimi i fushës së cilësisë Performanca e nxënësve – në mënyrë të veçantë;
- Mungesa e kapaciteteve të DKA-së për të mentoruar dhe monitoruar procesin në vazhdimësi;
- Mungesa e analizave pas përfundimit të procesit të VPSH-së.

Gjithashtu, të intervistuarit reflektojnë edhe për efektet e para nga procesi i vlerësimit të performancës në zhvillimin e shkollës. Krijimi i një përvoje të re dhe të standardizuar, mobilizimi i shkollave, rritja e bashkëpunimit të të gjithë aktorëve të lidhur me procesin e vlerësimit të performancës së shkollës etj., perceptohen nga të intervistuarit, si disa nga efektet e para të këtij procesi. Tre nga të intervistuarit i përshkruajnë kështu efektet e para të këtij procesi:

Janë mobilizuar shkollat më mirë dhe është përparësi, ngase shkalla e interesimit është më e madhe, përgjegjësia e ndarë, puna efektive, ka raporte të shëndosha ndërmjet kolegëve, si dhe bashkëpunim dhe koordinim i detyrave. Në fakt, hetohet frymë e

garës pozitive, sepse janë të interesuar të shohin ku ka ngecje për të ngritur shkallën e cilësisë në shkollë (IA/1);

Në shkolla shihet një mobilizim më i madh në punë, përgjegjësi më e madhe, sidomos e stafit udhëheqës të shkollave. Ka një ngritje të bashkëpunimit dhe aktivizim të organeve qeverisëse dhe profesionale të shkollave (IA/2).

Ndër efektet e para të procesit të vlerësimit të brendshëm në zhvillimin e shkollës do të theksoja krijimin e një përvoje bazë të standardizuar për vetëvlerësim dhe adresimin e nevojave për përmirësim/zhvillim të shkollës (KC/2).

Të gjithë të intervistuarit flasin për nevojën e përmirësimit të efikasitetit të punës së udhëheqësve të shkollave dhe EVV-së. Pikëpamjet e tyre lidhen me respektimin e kritereve në përcaktimin e KC në shkolla, vendosjen e KC kredibil dhe të pranueshëm nga stafi shkollës, vendosjen në praktikë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies për të gjithë të përfshirët në këtë proces, mbikëqyrjen sistematike të këtij procesi, përfshirjen në trajnime/punëtori për vlerësimin e brendshëm edhe të anëtarëve të ekipeve të shkollave, motivimit për punën shtesë që e bëjnë, mbështetjen më të madhe nga Inspektorati i Arsimit, MASHT-i dhe DKA-të, si dhe përfshirjen e njerëzve kompetentë, që e njohin mirë këtë proces.

4.3.3. Planet sektoriale në arsim për përmirësimin e rolit në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës

Masa dhe aktivitete të veçanta për VPSH-në janë përfshirë në planin e vjetor të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2018 (Qeveria e Republikës së Kosovës, 2017), në planin e Inspektoratit të Arsimit (të miratuar nga Sekretari i përgjithshëm në MASHT, referencë: 10/587), në planet PSHAK të analizuar për pesë komuna (*PZHAK Prishtinë (2017)*, *PZHAK Mitrovicë (2017)*, *PZHAK Pejë (2017)*, *PZHAK Fushë-Kosovë (draft, 2017)* dhe *PZHAK Vushtrri (2017)*), në planet e sektorëve të Inspektimit të Arsimit (SIA në Mitrovicë, Pejë dhe Ferizaj), si dhe në planet e njëjësive të shtatë respondentëve të intervistuar për tematikën e studimit, të dërguara gjatë intervistave me IA dhe KC.

Brenda kontekstit të planeve të sektorëve të arsimit, nga niveli qendror deri tek planet e njëjësive që kanë rol në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës, duket të këtë një lidhje dhe dallime në mënyrën e përmirësimit të rolit të tyre në këtë proces. Vërehet se planifikuesit e masave dhe aktiviteteve në kuadër të sektorëve të arsimit kanë për bazë PSAK 2017-2021 dhe Strategjinë për SC 2016 -2020, por përtej kësaj reference në dokumentet strategjike nuk ka ndonjë planifikim për harmonizim të aktiviteteve për përmirësimin e rolit të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal për procesin e vlerësimit të performancës së shkollës. Në planin vjetor të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2018, në aktivitetin 4. a.2.9, është përcaktuar një aktivitet kryesor për vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës, brenda të cilit është integruar ngritja profesionale e inspektorëve të arsimit për VJPSH. Brenda këtij plani më shumë ka detaje për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve përmes vizitave studimore sesa për procesin e realizimit të VJPSH-së.

Në planin e Inspektoratit të Arsimit, të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i IA dhe sekretari i përgjithshëm në MASHT (referencë 10/587), janë dhënë detaje për numrin e shkollave që do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës, vendin e shkollave dhe periudhën kohore të realizimit të VJPSH-së. Sipas këtij plani, të miratuar më 02.10.2017, në vitin shkollor 2017/2018 do të përfshihen 48 shkolla, përkatësisht rreth 70% e shkollave të cilat në vitin 2016/2017 e kanë realizuar vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës. Rritja e numrit të shkollave të përfshira në programin për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës nuk do të mund të ndiqet me vlerësim të jashtëm nga IPA, kur kemi parasysh se në vitin shkollor 2017/2018 vlerësimin e brendshëm e kanë përfunduar edhe mbi 130 shkolla. Ky trend i përfshirjes së shkollave në VJPSH nuk do të mund të përmbushë kërkesat e UA numër 4/2017 për vlerësimin e performancës së shkollës, sipas të cilit nga ky vit shkollor të gjitha shkollat duhet ta realizojnë vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës, kurse VJPSH, vlerësimi i rregullt, duhet të bëhet për çdo shkollë, së paku një herë brenda pesë viteve.

Në planin e Inspektoratit të Arsimit nuk ka aktivitete të planifikuara për informimin dhe sensibilizimin e shkollave për procesin e vlerësimit të performancës së shkollës, zhvillimin e një platforme për përfshirjen e bashkëpunëtorëve në ekipet për vlerësim të jashtëm, ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe të inspektorëve që udhëheqin punën me ekipet e vlerësuesve të jashtëm. Në planet PZHAK, të pesë komunave të analizuara, kemi një qasje të përafërt në emërtimin e objektivave strategjike për sigurim të cilësisë apo prioriteteve të përcaktuara nga DKA-të²⁷, duke iu referuar dokumenteve strategjike të MASHT-it, ku brenda kësaj objektivave DKA-të kanë përcaktuar nga dy deri në katër masa për vlerësim të performancës së institucioneve arsimore/shkollës, brenda objektivave që lidhet me sigurimin e cilësisë. Përshkrimet e masave për objektivat e përcaktuara për sigurim të cilësisë, aktivitetet sipas masave, treguesit e verifikimit, si dhe përshkrimi i kostos financiare, janë një shpresë se autoritetet lokale kanë një orientim të ri në kuadrin e zhvillimeve për sigurim të cilësisë në institucionet e arsimit parauniversitar. Disa prej masave dhe aktiviteteve mund të sfidohen nga mungesa e buxhetit të prezantuar në analizën e rrezeve për zbatimin e planeve zhvillimore komunale të arsimit (PZHKA).

Kultura e planifikimit institucional reflektohet si në planet e SIA-s dhe DKA-vë, njësisive përkatëse për vitin 2018, ashtu edhe në planet e subjekteve të përfshirë në intervistat e zhvilluara në kuadër të këtij studimi. Si inspektorët e arsimit ashtu edhe KC në komuna shprehen se në dy muajt e parë të këtij viti kanë vazhduar me aktivitetet e fundvitit të kaluar të filluara për vlerësimin e performancës së shkollës. Inspektorët e arsimit nga SIA në Mitrovicë, Pejë dhe Ferizaj, kanë planifikuar që në vitin 2018, me kapacitetet ekzistuese, të realizojnë VJPSH-në në 6 – 8 shkolla. Dy nga katër KC / zyrtarët e arsimit në DKA u referohen planeve të tyre për mbështetjen e grupeve të 10-12 shkollave për realizimin e vlerësimit të brendshëm, proces të cilin e kanë filluar në fund të vitit të kaluar. Por, edhe të përfshirjes së shkollave të tjera në këtë proces. Dy të intervistuarit e tjerë nuk kanë planifikuar aktivitete të detajuara për këtë proces, për

²⁷ A) Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Prishtinës 2018-2022: **Objektivi Strategjik 1.** Zhvillohen kapacitetet njerëzore dhe institucionale për sigurimin e qëndrueshëm të cilësisë në arsimin e Komunës Prishtinës;

shkak të numrit të vogël të stafit në DKA dhe pamundësisë për të realizuar aktivitete edhe në këtë fushë.

Të gjithë të intervistuarit nxjerrin në pah nevojën për mbështetje nga MASHT-i në realizimin e planeve të tyre për VPSH. Mbështetja kërkohet si në ngritjen e kapaciteteve, ashtu edhe me burime njerëzore dhe financiare. Kjo e fundit në masë më të madhe reflektohet në kërkesat e KC në DKA. Në perceptimet e pjesëmarrësve të intervistuar del në sipërfaqe edhe humbja e besimit në MASHT për mbështetjen e nevojshme në këtë proces. Këtë e ndërlidhin edhe me mungesën e mbështetjes së duhur për procesin e zbatimit të kurrikulës së re.

Në pyetjen: A mund të sfidohet zbatimi i planit për VPSH në sektorin tuaj? Nëse PO, pse? Nëse JO, cilat janë argumentet kryesore? Kemi pikëpamje të ndryshme. Inspektorët shprehen se kanë qenë të kujdesshëm në planifikimin e numrit të shkollave në të cilat do ta bëjnë VJPSH-në, duke iu referuar kapaciteteve të tyre ekzistuese, prandaj edhe nuk presin që të sfidohet plani i tyre. Nëse VJPSH realizohet vetëm në numrin minimal të planifikuar nga SIA përkatëse në rajone, del që në shkallë vendi në vitin 2018 do të këtë VJPSH vetëm në rreth 50 shkolla. Kjo do të jetë një sfidë më vete, kur kemi parasysh qasjen zhvillimore të këtij procesi dhe mundësinë që shkollat të mësojnë nga raporti i vlerësimit të jashtëm të performancës. Njëri nga inspektorët e intervistuar është optimist që ky proces nuk do të sfidohet as nga vetë shkollat:

Nuk e besoj. Ky proces e ka vënë në lëvizje tërë shkollën dhe ata kanë filluar identifikimin e çështjeve, të cilat duhen përmirësuar. Shkollave, së cilave po u bëhet vlerësimi i jashtëm, inspektorët po u ofrojnë ndihmë në tejkalimin e sfidave (IA/3).

Planet e DKA-ve sa i përket përkrahjes së shkollave në vlerësimin e brendshëm dhe përkrahjes së inspektorëve në vlerësim jashtëm të performancës së shkollës janë mjaft ambicioze, në anën tjetër të gjithë KC në DKA të intervistuar shprehen se planet dhe procesi i VPSH-së mund të sfidohen nëse nuk zbatohet UA për vendosjen e koordinatorëve të cilësisë në nivel qendror, në nivel komunal dhe në nivel të secilës shkollës. Ata, gjithashtu, shprehen se planet e mbështetjes për procesin e VPSH-së mund të sfidohen edhe për mungesë të kapaciteteve në DKA dhe për mungesë të mjeteve të nevojshme financiare. Njëri nga KC shprehet:

Ky plan mund të sfidohet për arsye të pamundësisë së sigurimit të mjeteve buxhetore për zbatim dhe ofrimi të mbështetjes nga institucionet që janë të profesionalizuara në këtë fushë (KC/2).

Një koordinator tjetër shpreh rezerva edhe sa i përket përmbushjes së planit të tyre dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera që kanë rol në këtë proces. Sipas tij:

- B) Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Pejës 2018-2022: **Objektivi Strategjik 2.** Sigurimi i një mësimdhënieje cilësore për zhvillim të kompetencave të nxënësve
- C) Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Mitrovicës 2018-2022: **Objektivi Strategjik 4.** Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve në shkolla
- C) Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Vushtrrisë 2017-2020: **Prioriteti 1.** Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë
- D) Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Fushë Kosovës 2017-2019: **(draft): Prioriteti 3.** Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Edhe në këtë fazë procesi i VBSH-së është duke u sfiduar, ekipet nuk janë shumë funksionale, mungon motivimi nga udhëheqësit e shkollave, numri i vogël i stafit të SIA-s. P.sh., deri më tani vetëm në një shkollë të komunës sonë është duke u bërë vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës...(KC/1)

4.3.4. Zbatimi i sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës

Perceptimet e IA dhe KC mbi interesimin dhe përkushtimin institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës janë të ndryshme dhe të ndikuara nga përvojat paraprake në zbatimin e reformave në fusha të tjera, si në zbatimin e kurrikulës së re dhe në zbatimin e sistemit të vlerësimit të mësimdhënësve. Në përgjithësi pjesëmarrësit nuk janë të kënaqur me praktikën aktuale, interesimin dhe përkushtimin e MASHT-it për zbatimin e politikave arsimore për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë, me interesimin dhe përkushtimin e DKA-ve për rregullimin e pozitës së koordinatorëve të cilësisë në shkolla, si dhe për përkrahjen e shkollave në realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe në zbatimin e ciklit për sigurim të cilësisë në shkollë.

Sipas IA dhe KC, të përfshirë në hulumtim, MASHT-i ka mekanizma që funksionojnë në nxjerrjen e dokumenteve ose politikave të reja arsimore, mirëpo nuk ka mekanizma funksionale apo kulturore të shtyrjes së proceseve për zbatimin e tyre dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tyre. Kështu shprehen dy të intervistuar për praktikë të dobët të MASHT-it në zbatimin e politikave arsimore.

MASHT-i është i përkushtuar në nxjerrjen e dokumenteve të mira, me standarde ndërkombëtare, por fatkeqësisht jo mirë të implementueshme në terren. Edhe mungesa e koordinatorit të sigurimit të cilësisë në nivel të MASHT-it shkon në favor të mendimit tim (IA/3).

Praktika aktuale, interesimi dhe përkushtimi i MASHT-it për zbatimin e politikave arsimore për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë, mendoj se nuk e ka intensitetin e duhur. Disa hapa që e shtyjnë tutje këtë proces janë shumë të ngadalshëm, p.sh. ende nuk është zgjedhur (nuk është funksional) koordinatori i cilësisë në nivel të ministrisë, që kishte me qenë një hallkë e rëndësishme në zinxhirin e koordinimit të aktiviteteve që lidhen me sigurimin e cilësisë MASHT-DKA-shkolla (KC/2).

Në kontekst të zbatimit në praktikë të dokumenteve të reja, në bazë të rolit dhe përgjegjësisë të caktuara, paraqitet të jetë edhe më keq në praktikën e Drejtorive Komunale të Arsimit. Perceptimet e pjesëmarrësve shprehin qartazi mungesë të kapaciteteve me burime njerëzore në shumicën e DKA-ve, por edhe mungesë të interesimit dhe përkushtimit të disa DKA-ve për përmbushjen e rolit të tyre në rregullimin e pozitës së koordinatorëve të cilësisë dhe në ofrimin e përkrahjes së shkollave në procesin e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës. Kështu shprehen disa KC dhe inspektorë të arsimit për përkushtimin e DKA-ve:

DKA-të nuk janë sa duhet të interesuara dhe të përkushtuara në emërimin (cilësor) të koordinatorëve të cilësisë së shkollave dhe po ashtu këtë çështje (koordinatorin e cilësisë në DKA) nuk e kanë të zgjidhur (KC/2).

Interesimi i politikave të komunës nuk është jetësimi i UA për koordinator të cilësisë, derisa ka më tepër së 10 mësimdhënës jashtë listës së pagave, ndërsa askush nga MASHT-i nuk interesohet për zbatimin në praktikë të këtij UA (emërimi i disa koordinatorëve ka mbetur vetëm në letër) (KC/4).

Deri më tani, procesi i emërimit të KC ka ndodhur sikurse për lëndën zgjedhore. Edhe me këtë rast emërimi i KC bëhet për plotësim orësh, sigurisht jo në të gjitha rastet, por po ndodh... (KC/3).

DKA-të nuk e kanë marrë aq seriozisht këtë proces, e shpeshherë (mos të them në të gjitha rastet që ne i njohim) nuk u kanë dalë në ndihmë shkollave për t'ua siguruar materialet e nevojshme, si dhe mbështetjen teknike (fotokopje, letër, etj.) (IA/3).

Nga disa DKA nuk ka seriozitet në punë. Në shumë shkolla nuk ka angazhim formal, me vendime nga DKA-të, për koordinator të cilësisë, dhe kjo situatë dallon prej shkollës në shkollë (IA/2).

Ka KC të cilët shprehin pikëpamjet e tyre se DKA-të mbështesin shkollat gjatë realizimit të VBSH-së, por:

Nuk nxjerrin vlerësime, nuk bëjnë analiza se sa dhe si ndodhin këto procese në shkolla. Pra, nuk nxjerrin vlerësime se sa janë serioze aktivitetet në vazhdimësi rreth VBSH-së... (KC/3).

Kjo nënkupton se mbështetja sipërfaqësore e shkollave nga DKA-ja, pa hyrë në mbështetje që siguron vlerësime reale të gjendjes në shkolla, nuk reflekton në përkushtim të lartë institucional të nivelit lokal, për të dinamizuar ciklin për sigurim të cilësisë në shkolla.

Perceptimi i pjesëmarrësve për qasjen që duhet të tregojnë institucionet arsimore (niveli qendror dhe lokal) në mbështetje të shkollave për realizimin e procesit të vlerësimit të performancës së shkollës, përfshin attribute që i referohen lidhjes midis zhvillimit të dokumenteve dhe zbatimit të tyre në praktikë, si:

- Zbatimi cilësor i UA për sigurim të cilësisë dhe VPSH-së;
- Zbatimi i masave dhe aktiviteteve të planifikuara për aspektet që lidhen me sigurimin e cilësisë në institucione arsimore;
- Mbështetje të drejtpërdrejtë për shkollat në koordinimin e agjendave për realizimin e vlerësimit të performancës së shkollës dhe zbatimin e plotë të ciklit për sigurimin e cilësisë në shkollë;
- Ndarje të buxhetit shtesë për zbatim të prioriteteve që sigurojnë cilësinë në arsim;
- Trajnime dhe punëtori shtesë për procesin e VPSH-së.

Në veçanti, ata theksuan nevojën për funksionalizimin e KC në nivelin qendror, në

DKA dhe në secilën shkollë. Gjithashtu, u konstatua se përvojat paraprahe në zbatimin e dokumenteve dhe politikave e programeve arsimore duhet të shërbejnë si mësim për zbatimin e dokumenteve të reja, siç janë dokumentet e kurrikulës dhe këto të fundit për sigurimin e cilësisë në institucionet arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Nevojitet seriozitet në punë dhe bashkëpunim më i madh ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal në këtë aktivitet, duhet që DKA-të të kenë personel mbështetës profesional për të ndihmuar këtë aktivitet dhe ky aktivitet duhet të monitorohet nga MASHT-i. Nëse nuk arrijmë të mbajmë nën kontroll dhe ta mbështetim me profesionistë të vërtetë, VBSH do të bëhet sipas një rutine të caktuar dhe nuk do të jetë frytdhënës si mekanizëm i ngritjes së cilësisë në shkolla (IA/2).

Shkollat kanë nevojë për një qasje mbështetëse konkrete, zinxhirore dhe të planifikuar/koordinuar mirë prej nivelit qendror dhe atij lokal. E shoh si tejet të rëndësishëm procesin e vlerësimit të performancës së shkollës dhe zbatimit të ciklit për sigurim të cilësisë në shkollë dhe shqetësimi im është se ky proces kërkon më shumë seriozitet, përkushtim dhe mbështetje nga të gjitha institucionet zinxhirore, ngase përbën “pikënisjen” për një shkollë cilësore - arsim cilësor (KC/2).

Duhet të jetë një bashkëpunim që sjell rezultate të prekshme, të matshme, në mes të nivelit lokal dhe atij qendror. Me këtë rast, Inspektorati (MASHT) dhe DKA-ja duhet të mbikëqyrin shkollën të koordinuara, pse jo edhe së bashku, pasi kanë (duhet ta kenë) të njëjtin qëllim. Nëse procesi i vlerësimit bëhet si duhet, atëherë patjetër do të lëvizin gjërat drejt suksesit, drejt cilësisë. Pa dyshim është një mekanizëm që duhet të shfrytëzohet nga të gjithë ata që janë të involvuar dhe duan që arsimi të lëvizë kah cilësia (KC/3).

4.4. ANALIZË KRAHASUESE E RAPORTEVE TË VETËVLERËSIMIT

Deri në vitin shkollor 2016/2017, shkollat në Kosovë kanë vazhduar të përgatisin plane vjetore të punës në vijimësi të një tradite të vendosur për vite me radhë dhe në bazë të analizave që zakonisht janë bërë në përfundim të vitit shkollor, gjegjësisht në gusht – para fillimit të vitit të ri shkollor, pa një vlerësim të bazuar në kriteret e caktuara. Ndërkohë, me miratimin e pakos së dokumenteve për vlerësim të performancës së shkollës, shkollat kanë filluar të përgatisin raporte të vlerësimit të brendshëm, në bazë të instrumentit për vlerësim të brendshëm të shkollës, përshkrimeve e udhëzimeve të dhëna në udhëzuesin për vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe në bazë të përvojave të fituara në trajnimet e organizuara për këtë qëllim që është përshkruar më sipër, në kapitullin e dytë të këtij raporti.

Duke qenë përvoja e parë e shkollave në sistemin e vendosur për vlerësimin e performancës së shkollës, në këtë studim u është kushtuar vëmendje e veçantë raporteve të vlerësimit të brendshëm të shkollave, me qëllim nxjerrjen e mësimave, sfidave dhe mundësive të përdorimit të raporteve të para të vlerësimit të brendshëm të shkollës për sigurimin e cilësisë në shkollë. Sipas Birzea, C., Cecchini, M., Harrison, C., Krek, J., Spajic-Vrkas, V. (2005), kur paraqesin karakteristikat që duhet të përmbajë një sistem efektiv i sigurimit të cilësisë së shkollës, siç shprehen: “Të bëjë

përshtatjet në cilat shkolla bëhet agjenci çelës për sigurimin e cilësisë së parashikuar dhe zhvillim progresiv në drejtim të qëllimeve të saj” Sipas Çobaj, (2016). Këtë qëllim e ka edhe sistemi i vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore në Kosovë, përmes qasjes zhvillimore në përkrahje të shkollës për përmirësim të vazhdueshëm në përbushje të rezultateve të pritura të performancës së shkollës.

Analiza krahasuese e raporteve të VBSH-së është fokusuar në tetë kategori që mbulojnë hapat kryesorë të procesit të vlerësimit të brendshëm: 1. *Faza përgatitore*; 2. *Identifikimi i burimeve të të dhënave dhe përzgjedhja e mostrës*; 3. *Përzgjedhja dhe përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave*; 4. *Mbledhja dhe analiza e të dhënave*; 5. *Përshkrimi i gjendjes për tregues të performancës së shkollës dhe vlerësimi në nivel të kriterëve*; 6. *Vlerësimi në nivel të fushave të cilësisë*; 7. *Vlerësimi i përgjithshëm*; dhe 8. *Raporti narrativ – raporti përmbledhës* (IPK, Udhëzuesi për vlerësim të brendshëm, f. 14-24). Për secilën fushë të analizës janë përgatitur tregues të veçantë, me një listë të kontrollit, të cilët u përdorën për analizë të raporteve të VBSH-së, për konstatime lidhur me nivelin e plotësimit të kërkesave - sipas hapave kryesorë të procesit të VBSH-së dhe për diskutim të gjetjeve të raporteve të VBSH-së.

4.4.1. Dokumentimi i fazës përgatitore

Në bazë të UA për vlerësimin e performancës së shkollës (MASHT, Nr. 4/2017), menaxhmenti i shkollës e formon ekipin për vetëvlerësim (EVV) prej tre-pesë anëtarësh, si dhe e cakton koordinatorin e ekipit. Anëtarë të ekipit për vetëvlerësim mund të jenë: koordinatori për cilësi, përfaqësues nga mësimdhënësit dhe nga shërbimi profesional i institucionit arsimor. Në udhëzimet e dhëna për shkollat në udhëzuesin për vlerësim të brendshëm të shkollës, shkollat orientohen që në vendimin për formimin e EVV-së të përcaktohen edhe fushat e cilësisë që do të jenë objekt i vetëvlerësimit, si dhe përshkruhen mjetet dhe dispozitat që i krijojnë kushte EVV-së për të zbatuar mandatin e vet (këtu do të përfshihej edhe qasja e papenguar në të gjitha burimet e mundshme të informative dhe kushtet teknike për realizimin e aktiviteteve). Po aty, thuhet se në mbledhjen konstitutive EVV do të bëjë ndarjen e detyrave dhe roleve, si dhe do të hartojë planin e vet të punës për realizimin e vetëvlerësimit, në të cilin përcaktohen aktivitetet kryesore të procesit (përzgjedhja e pjesëmarrësve në vetëvlerësim, përgatitja e instrumenteve, informimi, mbledhja e të dhënave, analiza e të dhënave, vlerësimi), koha dhe afatet e zbatimit të secilit aktivitet, personat përgjegjës, si dhe resurset e nevojshme për zbatim (IPK, 2016b). Këto aspekte të fazës përgatitore u analizuan në dokumentacionin e marrë nga shkollat për procesin e realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës.

Nga analiza e raporteve të vlerësimit të brendshëm të 39 shkollave të përfshira në studim, identifikua raporte të 6 shkollave ose 15.4% e shkollave, të cilat kanë dëshmi se janë përbushur plotësisht kërkesat për këtë fazë të procesit të vlerësimit të brendshëm, 13 shkolla, ose 33.3%, mesatarisht i kanë plotësuar kërkesat e kësaj faze, 6 shkolla ose 15.4% kanë nxjerrë vetëm vendimin për themelimin e ekipit, pa plotësim të kërkesave të tjera në këtë fazë dhe 14 shkolla ose 35.9% nuk kanë ofruar

dëshmi të shkruara për fazën përgatitore, por në mënyrë verbale drejtorët e shkollave të kontaktuar kanë thënë se i kanë plotësuar pjesën më të madhe të kërkesave të fazës përgatitore për procesin e vlerësimit të brendshëm. Megjithatë, marrë në përgjithësi, mund të konstatojmë se shkollat i kanë përmbushur kërkesat bazë për fazën përgatitore të realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës. Ky është tregues i rëndësishëm për fazat tjera të realizimit të procesit të vlerësimit të brendshëm.

4.4.2. Identifikimi i burimeve të të dhënave dhe përzgjedhja e mostrës për VBSH

Në udhëzuesin për VBSH, shkollat kanë marrë orientime për metodologjinë që duhet të ndjekin për identifikimin e burimeve të të dhënave dhe përzgjedhjen e mostrës së nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve që do të përfshihen në vlerësimin e brendshëm të shkollës. Analiza e dokumentacionit të dërguar nga shkollat tregon se EVV-të kanë shfrytëzuar dokumentacionin shkollor, por në përshkrimet e bëra për gjendjen në tregues të performancës së shkollës nuk vërehet mjaftueshëm shfrytëzimi i dokumentacionit shkollor, si pjesë e burimit të të dhënave të identifikuar në këtë fazë. Në mënyrë të veçantë vërehet se në listën e dokumentacionit të shfrytëzuar nga EVV mungojnë raportet statistikore për arritjet e nxënësve në vlerësimet e brendshme dhe të jashtme, në fusha mësimore që ishin edhe pjesë e studimit PISA, pastaj mungesë e informimit për dokumentacionin që lidhet me punën e mësimitdhënësve, si planet mësimore deri te ora e mësimit, programet për aktivitete të lira dhe aktivitete ekstra-kurrikulare, instrumentet e vlerësimit të nxënësve, raportet e monitorimit dhe mentorimit të mësimitdhënësve etj.

Sa i përket mostrës, listës së pjesëmarrësve nga radhët e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve, me udhëzuesin për VBSH, shkollat janë udhëzuar që numri i nxënësve të përzgjedhur nuk duhet të jetë më i vogël se 10, në mënyrë që të sigurohet respektimi i këtyre kriterëve të përfaqësimit (*Nxënës me performancë të lartë, të mesme dhe të ulët; nxënës me prirje të theksuara dhe nxënës me nevoja të veçanta; nxënës nga shkallë të ndryshme kurrikulare; nxënës me prejardhje të ndryshme familjare*), mësimitdhënësit do të përzgjidhen nga ekipi i mësimitdhënësve që punojnë me nxënësit e përzgjedhur. Numri i mësimitdhënësve duhet të përbëjë së paku 60% të mësimitdhënësve që punojnë me nxënësit e përzgjedhur. Ndërsa prindërit që do të marrin pjesë në vlerësim duhet të jenë prindërit e nxënësve të përzgjedhur për mostër (IPK, 2016b).

Nga raportet e shkollave për përfshirjen e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve, në vlerësimin e brendshëm shohim se vetëm 3 shkolla, ose 7.6% prej tyre, kanë ofruar dëshmi se janë përmbushur plotësisht kriteret për përfshirjen e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve në vlerësimin e brendshëm, 8 shkolla ose 20.4% mesatarisht i kanë plotësuar kërkesat për përfshirjen e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve në VBSH, 12 shkolla ose 30.7% kanë ofruar dëshmi për plotësim minimal të kërkesave për mostrën e studimit, ndërsa 16 shkolla ose 41.3% nuk kanë ofruar dëshmi të shkruara për mostrën e përfshirjes në VBSH. Mirëpo në mënyrë verbale kanë thënë se i kanë përfshirë nxënësit, mësimitdhënësit dhe prindërit në VBSH, sipas udhëzimeve në udhëzuesin për vlerësim të

brendshëm. Sa i përket përfshirjes së nxënësve, të cilët ishin subjekti bazë për përfshirjen edhe të mësimdhënësve dhe prindërve, shumica e shkollave i kanë përfshirë në vlerësimin e shkollës nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm dhe shumë mirë. Këtë e pasqyrojnë të dhënat demografike të nxënësve që ishin pjesë e studimit tonë, ku rreth 83% e tyre deklarojnë se kanë sukses të shkëlqyeshëm dhe 13% kanë sukses të shumë mirë. Ndërsa, për përfshirjen e nxënësve me prirje të theksuara, me nevoja të veçanta, si dhe për nxënës me prejardhje të ndryshme familjare, nuk kanë ofruar të dhëna.

4.4.3. Përzgjedhja dhe përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave

EVV-të janë udhëzuar që përzgjedhjen e teknikave, të cilat do të aplikohen në VBSH dhe përpilimin e instrumenteve përkatëse, ta bëjnë në bazë të treguesve të përcaktuar për secilin kriter të vlerësimit, në kuadër të fushave të cilësisë, që janë në fokus të vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu, EVV janë udhëzuar që me rastin e përgatitjes së instrumenteve të kenë parasysh se pyetjet orientuese, të dhëna për vërtetim të gjendjes në tregues të performancës së shkollës, të cilat përmbajnë orientimet e përgjithshme të mbulueshmërisë së secilit tregues, duhen shfrytëzuar për t'i mbajtur të fokusuar instrumentet për mbledhjen e të dhënave (IPK, 2016b).

Përdorimi për analizë i një numri të madh të instrumenteve të shkollave për mbledhjen e të dhënave, krijimi i një database të instrumenteve të përdorura nga shkollat, si dhe ruajtja e një zinxhiri të evidencave për llojet e instrumenteve të përdorura nga shkollat, formatin e pyetjeve, lidhjen e pyetjeve me matjen e treguesve të performancës së shkollës, krijojnë mundësinë e nxjerrjes së një sërë problemesh lidhur me përzgjedhjen dhe përgatitjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave nga EVV për vlerësim të performancës së shkollës.

Problemet e identifikuara në përzgjedhjen dhe përgatitjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për VBSH janë si në vijim:

- Përzgjedhja e teknikave dhe përgatitja e instrumenteve akoma pa u identifikuar mirë burimet për mbledhjen e të dhënave;
- Përgatitja e instrumenteve duke mos marrë për bazë pyetjet orientuese, të dhëna në udhëzuesin për VBSH, të cilat përmbajnë orientimet e përgjithshme të mbulueshmërisë së secilit tregues;
- Në disa raste, pyetjet orientuese, të dhëna në udhëzuesin për VBSH, janë përfshirë në instrumentet për mbledhjen e të dhënave nga pjesëmarrësit në vetëvlerësim, pa asnjë ndryshim dhe në instrumente joadekuate, ku p.sh. disa pyetje kanë qenë specifike për një instrument të listës së kontrollit, ndërsa ato janë përfshirë në protokollin e intervistës me mësimdhënës ose udhëheqësit e shkollës;
- Përfshirja e disa pyetjeve të panevojshme në instrumentet për mbledhjen e të dhënave, e pyetjeve jo të duhura dhe jorelevante për treguesit e performancës së shkollës, pastaj shtruarja e disa pyetjeve sugjestive, shtruarja e disa pyetjeve që nuk ndërlidhen me mundësinë e përgjigjes nga subjekte të caktuara, sidomos kjo është e shprehur në pyetjet për nxënës, prindër etj.

- Mungesa e lidhjes logjike në mes të kërkesave/pyetjeve dhe alternativave për përgjigje, p.sh. për kërkesën Shkolla ofron një mjedis të sigurt dhe stimulues për nxënës dhe mësimitdhënës, janë vendosur për mundësi të përgjigjes katër alternative: a) Performancë e papranueshme; b) Performancë e pranueshme; c) Performancë e mirë dhe d) Performancë e shkëlqyeshme. Shembull nga një shkollë tjetër: Në një pyetësor për nxënës, pyetja është shtruar në këtë mënyrë: A bën shkolla planifikim profesional për jetësimin e kurrikulës me zgjedhje? Edhe për këtë pyetje janë vendosur për mundësi të përgjigjes katër alternativa: a) Performancë e papranueshme; b) Performancë e pranueshme; c) Performancë e mirë; d) Performancë e shkëlqyeshme.
- Në masë të madhe, mungon strukturimi i pyetësorëve në mënyrë të qartë dhe logjike;
- Numri i instrumenteve të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave zakonisht është i pamjaftueshëm, vërehet tendencë për reduktimin e instrumenteve vetëm në pyetësorë, duke u ikur agjendave dhe pyetjeve për takimet me fokus-grupe, protokollit të intervistës, protokollit të vëzhgimit të punës në klasë (sidomos për fushën e cilësisë: mësimitdhënësia dhe të nxënës, por edhe për fushat e tjera), ku do të vëzhgohej klima e përgjithshme në klasë, praktikatat e mësimitdhënies dhe të nxënës, interesimi dhe pjesëmarrja e nxënësve në procesin mësimit, komunikimi, vlerësimi për të nxënës, përdorimi i TIK-ut në procesin e mësimitdhënies, të nxënës etj.
- Shfrytëzimi vetëm i mostrave të instrumenteve të vendosura në udhëzuesin për vlerësim të brendshëm të shkollës, pa bërë një analizë të nevojave për instrumente të tjera bazuar në kontekstin e shkollës dhe specifikave të treguesve që nuk kanë evidence në nivel shkolle. Ose ekstremi tjetër mospërdorimi i asnjë modeli të instrumenteve të dhëna në udhëzuesin për VBSH, përgatitja dhe përdorimi i instrumenteve, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret minimale të përshkruara më sipër etj.

Rezultatet e analizës për instrumentet e përgatitura nga shkollat, për mbledhjen e të dhënave për VBSH, i kemi kuantifikuar në bazë të kërkesave në Udhëzuesin për VBSH dhe ato janë si në vijim: asnjë shkollë, nga 39 shkolla të përfshira në studim, nuk i ka përmbushur të gjitha udhëzimet për përzgjedhjen dhe përgatitjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për VBSH, 8 shkolla ose 20.4% kanë dëshmi se janë përmbushur mesatarisht kërkesat në përzgjedhjen dhe përgatitjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, 27 shkolla ose 69.2% kanë plotësuar kriteret minimale, ndërsa 4 shkolla ose 10.3% nuk kanë ofruar dëshmi për përgatitjen dhe përzgjedhjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për VBSH, ku supozohet se raportet e VBSH-së nga këto katër shkolla janë bërë me përshkrim, duke njohur kontekstin dhe gjendjen e shkollës nga vetë ekipi i vlerësimit të brendshëm.

Në raportet e shkollave gjejmë edhe shembuj të prezantimit të detajuar të informatave që plotësojnë dëshmitë e shkollës për identifikimin e burimeve të të dhënave, përzgjedhjen e mostrës për VBSH, si dhe për përzgjedhjen dhe përgatitjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave.

Tabela 25

Shembull i paraqitjes së dëshmive për subjektet e përfshira në VBSH dhe instrumentet e përdorura

Subjektet	Instrumentet	Pjesëmarrës	Numri i pyetjeve me alternativa	Numri i pyetjeve të hapura	Numri i përgjithshëm i pyetjeve
Nxënës	Pyetësor	31	25	7	32
Prindër	Pyetësor	31	18	5	23
Mësimdhënës	Pyetësor	33	33	5	38
Këshilli i klasave	Int.fok.grupe	9		9 pyetje	9
Udhëheqës të fushave kurrikulare	Int.fok.grupe	4		15pyetje	15
Sekretari	Listë kontrolli	1	15	15	30
Drejtori	Listë kontrolli	1	27	27	54
Gjithsej	8	110	118	83	201

4.4.4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave për VBSH

Në udhëzimet e dhëna për shkollat në udhëzuesin për VBSH, EVV është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e procesit të mbledhjes së të dhënave për vetëvlerësim. Të dhënat e mbledhura mund të jenë sasiore dhe cilësore. Të dhënat duhet të mblidhen nga mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, menaxhmenti, personeli administrativ, në hapësirat brenda dhe jashtë shkollës (IPK, 2016b).

Në instrumentin për vlerësim të brendshëm të shkollës, në pjesën për të dhënat e përgjithshme, është lënë hapësirë e veçantë për përshkrimin e procesit të mbledhjes së të dhënave (MASHT & IPK, 2016). Në pjesën më të madhe të raporteve të VBSH-së, të analizuar, gjejmë disa të dhëna rreth procesit të mbledhjes së të dhënave, mirëpo në shumicën e përshkrimeve nuk janë dhënë detaje për organizimin e mbledhjes së të dhënave, llojet e të dhënave të mbledhura dhe mënyrën e analizës së tyre. Në ato shkolla që kanë përshkruar në raporte të VBSH-së procesin e mbledhjes së të dhënave shihet se dominojnë të dhënat e mbledhura me pyetësorë, kurse për analizë të të dhënave kryesisht është përdorur programi Exel, ku të dhënat janë nxjerrë në numër dhe në përqindje. Në pjesën më të madhe të rasteve të dhënat janë përgatitur në formë të tabelave dhe paraqitjeve grafike.

Ja një shembull i përshkrimit të procesit të mbledhjes së të dhënave për VBSH (Raporti nr. 8 i VBSH-së):

Pas trajnimit, që ka përfunduar më 5.11.2016, menjëherë jemi mobilizuar për grumbullimin e fakteve për ta bërë vlerësimin e brendshëm. Fillimisht më 7.11.2016 është formuar ekipi për vlerësim, prej tre anëtarëve. Koordinatori i cilësisë dhe dy anëtarë të përzgjedhur nga drejtori dhe koordinatori i shkollës. Pastaj kemi filluar

për mbledhjen e të dhënave dhe nga treguesit e performancës i kemi përpiluar pyetjet për intervistim të nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve për të gjitha fushat. I kemi përzgjedhur nxënësit nga të gjitha kategoritë: nxënës të shkëlqyeshëm, të mirë, të dobët, të padisiplinuar dhe nxënës të urtë. Gjithashtu e kemi shikuar edhe shkallën e arsimimit të prindërve dhe jemi munduar t'i përzgjedhim të gjitha nivelet e arsimimit. Pastaj ua kemi shpërndarë pyetësorin nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve dhe pas plotësimit të tyre i kemi grumbulluar. Pas saj i kemi mbledhur të dhënat prej çdo pyetësori, i kemi analizuar dhe i kemi plotësuar treguesit përkatës. Nga drejtori kemi kërkuar dokumentacionin shtesë, që na është nevojitur për gjetjen e treguesve të tjerë të fushave tjera. Gjatë kësaj kohe kemi grumbulluar (shikuar) Ligjin mbi arsimin parauniversitar, udhëzuesit administrativë, rregulloren e shkollës, librin e protokollit të dokumentacioneve, librat e procesverbaleve të Këshillit të shkollës, Këshillit të prindërve, Këshillit të nxënësve, Këshillit të arsimtarëve, librat e aktiveve profesionale, ditarët e vitit të kaluar, librat amë të nxënësve, dosjet e mësimitdhënësve, certifikatat e trajnimeve të mësimitdhënësve, testet e mësimitdhënësve, planet e mësimitdhënësve, kopjen e planit të shkollës, listën poseduese të shkollës. Gjithashtu, kemi organizuar intervista me gojë me grupe nxënësish, arsimtarësh, drejtorin, punëtorë teknikë, prindër. Si dhe prezantimi në orët mësimore te kolegët.

Raportet e shkollave tregojnë se EVV kanë mbledhur të dhëna edhe përmes teknikave dhe instrumenteve të diskutuara në pjesën e mësipërme, përfshirë edhe mbledhjen e të dhënave përmes intervistave, fokus grupeve etj. Nga instrumentet për intervista, që i kemi marrë nga shkollat, shohim se dominojnë instrumentet e intervistave me shkrim, për të cilat respondentët janë thirrur për të dhënë përgjigje në hapësirat e zbrazëta të pyetjeve të intervistës. Vetëm në tri raporte të EVV-së kemi hasur në përshkrim të intervistave të realizuara drejtpërdrejt me mësimitdhënës, apo drejtorë të shkollës. Një shembull se si është përshkruar një intervistë e realizuar me mësimitdhënës (Raporti nr. 12 i VBSH-së):

Sipas intervistës, që është zhvilluar me mësimitdhënësit e matematikës nga ana e zv.drejtorit, i cili kishte shënuar (dëshmuar) atë që kanë shprehur mësimitdhënësit gjatë intervistës, mund të themi se fusha e matematikës sa u përket infrastrukturës dhe kushteve shkollore nga arsimtarët është në nivel të duhur, edhe pse kërkohen disa intervenime (plotësimi i disa kushteve) si: mësimi tërëditor, harmonizimi i plan-programit me KKK dhe KB, shtimi i orëve, puna praktike. Fushat problematike, sipas mësimitdhënësve të intervistuar, janë: Thyesat nga përmbajtjet gjeometrike, Sistemet e ekuacioneve lineare... Sa i përket shfrytëzimit të teknologjisë gjatë intervistës, thuhet se TIK-u shfrytëzohet për hulumtime, prezantime të nxënësve. Shkathtësitë e nxënësve plotësohen me mësimin shtues, plotësues, gara etj.

Gjithashtu, raportet e shkollave tregojnë se EVV kanë mbledhur të dhëna edhe përmes fokus grupeve me nxënës dhe mësimitdhënës. Mirëpo, në pjesën më të madhe mungojnë dëshmi për analizën e bërë të të dhënave të mbledhura përmes diskutimeve me fokus grupe. Edhe për diskutimet në fokus grupe, në tri raporte të shkollave, janë dhënë pjesë të analizave të bëra nga diskutimet. Një shembull (Raporti nr. 21 i VBSH) se si janë

nxjerrë pikat kryesore të nxjerra nga diskutimi për fushën Mësimdhënia dhe të nxënit me një fokus grup të nxënësve:

Pyetja për diskutim: Cilat janë arritjet kryesore në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit? Kemi këtë përmbledhje të diskutimeve të nxënësve:

- Në lëndët e shkencave organizohet mësimi praktik në kabinete;
- Nga disa mësimdhënës përdoret platforma digjitale - modele të testeve dhe kuize online;
- Përdoret kabineti i informatikës;
- Biblioteka e shkollës.

Pyetja për diskutim: Cilat janë shqetësimet kryesore të nxënësve lidhur me procesin mësimor? Kemi këtë përmbledhje e diskutimeve të nxënësve:

- Disa mësimdhënës nuk i përfillin planet mësimore;
- Disa mësimdhënës nuk shpjegojnë në mënyrë të duhur;
- Disa mësimdhënës nuk kanë sjellje dhe qëndrim të mirë ndaj nxënësve;
- Disa mësimdhënës nuk janë korrektë në vlerësimin e nxënësve.

Në pyetjen si mund të përmirësohemi? Kemi këtë përmbledhje të diskutimeve të nxënësve:

- Testet e vlerësimit të nxënësve të përshtaten me natyrën e lëndëve mësimore;
- Të bëhet monitorimi i mësimdhënësve në orë mësimore për të parë qëndrimet e tyre ndaj nxënësve dhe praktikat e shpjegimit në orë mësimore;
- Të bëhet vlerësimi i mësimdhënësve.

Nga ky shembull shohim se është provuar të nxirret një produkt nga diskutimi me nxënës, njëkohësisht kuptojmë se fokusi i diskutimit me nxënës është bërë vetëm për punën që lidhet me mësimdhënësit, por jo edhe për rolin dhe përfshirjen e nxënësve në proceset mësimore. Pastaj nuk janë bërë nënpyetje të tjera për të nxjerrë nga nxënësit të dhëna për format e përfshirjes në procesin mësimor, për format e motivimit të nxënësve, për përfshirjen e tyre në planifikimin mësimor, për nevojat dhe kërkesat e nxënësve etj. Gjithashtu, shohim se moderatori nuk i është përmbajtur udhëzuesit për VBSH, pjesës së udhëzimeve për diskutim në grup fokusi në shkollë (IPK, 2016b).

Kuantifikimi i raporteve të shkollave për pjesën e mbledhjes së të dhënave dhe analizën e tyre tregon se asnjëra nga 39 shkollat e përfshira në studim nuk i ka përmbushur të gjitha udhëzimet për procesin e mbledhjes së të dhënave dhe analizën e tyre. Vetëm 7 shkolla, ose 17.9% kanë dëshmi se janë përmbushur mesatarisht kërkesat në këtë fazë të procesit të VBSH-së, ndërsa 20 shkolla ose 51.3% kanë plotësuar kriteret minimale, derisa për 12 shkolla ose 30.8% nuk kemi siguruar dëshmi për të konkluduar lidhur me përmbushjen e kërkesave për këtë fazë të VBSH-së, përkatësisht lidhur me mbledhjen dhe analizën e të dhënave.

4.4.5. Përshkrimi i gjendjes për tregues të performancës së shkollës dhe vlerësimi në nivel të kriterëve

Treguesit e performancës në Kornizën për vlerësimin e performancës së shkollës janë dhënë në formë të deklaratave afirmative të pritshmërisë së performancës në kuadër të secilit kriter të cilësisë, të cilët ndihmojnë për të konstatuar nivelin e performancës së shkollës në raport me pritshmërinë. Ndërsa, kriteret e cilësisë përshkruajnë pritshmëritë themelore që duhet të përmbushen nga çdo shkollë që funksionon në Republikën e Kosovës, orientojnë shkollat për avancim të vazhdueshëm të praktikave të tyre, ndërsa autoritetet arsimore për avancim të politikave arsimore (IPK, 2016b).

Bazuar në treguesit e performancës së shkollës, të përcaktuar me Kornizën për vlerësimin e performancës së shkollës dhe pyetjet kryesore për secilin tregues të performancës, nga EVV kërkohet që të mbledhin të dhëna dhe t'i analizojnë ato, pastaj të bëjnë përshkrimin e gjendjes së shkollës në treguesit përkatës dhe të vlerësojnë përmbushjen e kriterëve të cilësisë. Për gjithë këtë fazë të procesit të VBSH-së, EVV janë njoftuar me udhëzuesin për VBSH, që përshkrimi i gjendjes në raport me treguesit të përmbajë informacion të mjaftueshëm (së paku përgjigje në të gjitha pyetjet orientuese të dhëna në UVB), përshkrimi i gjendjes të jetë konciz, jo informacion të tepërt dhe të panevojshëm, përshkrimi i gjendjes në raport me treguesit të jetë bazuar në fakte dhe vlerësimi për shkallën e cilësisë në nivel të kriterëve të reflektojë gjendjen e përshkruar në raport me treguesit e kriterit përkatës (IPK, 2016b).

Në bazë të kërkesave të prezantuara më lart, për përshkrimin e gjendjes së shkollës në treguesit e performancës së shkollës dhe vlerësimin e performancës në nivel të kriterëve, kemi analizuar përshkrimet e shkollave për treguesit e performancës së shkollës dhe vlerësimin e kriterëve të cilësisë. Gjetjet nga kjo pjesë e analizës, pasqyrojnë dallime të theksuara në përshkrimin e treguesve të performancës së shkollës. Disa shembuj të përshkrimeve të gjendjes për dy tregues të performancës për kriterin e cilësisë 1.1. *Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës:*

Tabela 26

Shembuj të përshkrimit të gjendjes për tregues të performancës së shkollës në raportet e VBSH-së

Fusha e cilësisë 1: MENAXHIMI DHE QEVERISJA

Kriteri i cilësisë 1.1: Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës

		Treguesit		
Nr.	Treguesit sipas Kornizës për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës	Përshkrimi i gjendjes për tregues të performancës së shkollës - gjendja e shkollës		
		Raporti i VBSH (nr.8)	Raporti i VBSH (nr.22)	Raporti i VBSH (nr.4)
1.1.2	Nxënësit, mësuesit dhe prindërit janë në dijeni për vizionin dhe misionin e shkollës si dhe për prioritetet e PZhSh-së	Në bazë të gjetjeve në Planin e shkollës nuk pashë se nxënësit dhe prindërit janë në dijeni për vizionin, misionin dhe prioritetet e shkollës, por në Planin zhvillimor tek vizioni ceket se prindërit janë pjesëmarrës në përpilimin e këtij plani.	Organet përfaqësuese të nxënësve, prindërve dhe mësuesit pjesërisht janë në dijeni për vizionin, misionin dhe prioritetet e PZhSh-së.	Nxënësit, prindërit dhe mësuesit janë në dijeni për misionin dhe vizionin e shkollës ngase është e ekspozuar në hyrjen e shkollës. Shkolla ka mekanizma të definuar dhe procedura, përmes së cilave nxënësit dhe prindërit mund të shprehin mendimet e tyre dhe janë pjesë e vendimmarrjes për çështje të ndryshme të shkollës. Ne si mësues nuk jemi gjithmonë në dijeni për prioritetet e PZhSh-së.

1.1.4

Organet e qeverisjes së shkollës i kanë definuar përgjegjësitë e tyre në zbatimin e PZhSh-së

Organet e qeverisjes së shkollës i kanë të përshkruara qartë detyrat dhe ndarjet e përgjegjëseve. Sipas gjetjeve nuk takohen të gjitha organet në intervale të rregullta. Nuk kemi dëshmi për takim në vitin e fundit të KDSH-së, por në ditarë të shkollës gjenden raportet e Këshillit të klasave dhe në librin e Këshillit të arsimtarëve ka shënime. Prandaj disa organe nuk i kanë përmbyshur përgjegjësitë e tyre.

Organet e qeverisjes së shkollës janë funksionale dhe efektive në përmbyshjen e përgjegjëseve.

Në kuadër të shkollës funksionojnë: Këshilli drejtues, aktivitetet profesionale, Këshilli i arsimtarëve, Këshilli i nxënësve të shkollës. Të gjitha këto grupe takohen në intervale të rregullta. Këshilli Drejtues takohet kryesisht sipas semestrave apo nevojave. KD përfaqësohet nga tre mësime, tre prindër dhe një nxënës, ndërsa drejtori është sekretar - pa të drejtë vote. Këshilli i arsimtarëve mban dy mbledhje të rregullta brenda periudhës. Në dy takimet e këtyre organeve të qeverisjes janë trajtuar suksesi i nxënësve, realizimi i plan-programeve dhe vijueshmëria, si dhe synimet për rritjen e cilësisë brenda shkollës.

....

Nga shembujt e dhënë në përshkrimin e gjendjes për dy tregues të performancës së shkollës, në raportet e tri shkollave, shohim dallime të theksuara në përshkrim, në natyrën e informatës që prezantohet, në sasinë e informacionit të ofruar dhe në burimet e shfrytëzuara për përshkrimin e gjendjes. Sipas përshkrimit në raportin e VBSH nr. 8, burimet e përdorura për përshkrimin e treguesit nr. 1.1.2. janë Plani i shkollës (nuk dihet cili plan) dhe PZSH, në raportin e VBSH-së nr. 22, burimet e përdorura si duket janë anketat me përfaqësues të nxënësve, mësime dhe prindërve (edhe pse nuk citohen anketat dhe numri i përfaqësuesve të nxënësve, mësime dhe prindërve që kanë dhënë informata për këtë tregues). Ndërsa, në raportin e VBSH-së nr. 4 burim i të dhënave duket të jetë deklarata e vizionit të shkollës, i ekspozuar në hyrje të shkollës dhe mekanizmat e shkollës përmes të cilave nxënësit dhe prindërit mund të shprehin mendimet e tyre. Për treguesin e performancës 1.1.2: *Nxënësit, mësime dhe prindërit janë në dijeni për vizionin dhe misionin e shkollës si dhe për prioritetet e PZhSh-së*, shohim edhe dallime të tjera në përshkrimet e bëra nga shkollat tjera:

Raporti i VBSH-së nr. 29: *Paraprakisht janë diskutuar vizioni dhe misioni i shkollës dhe janë formësuar përmes takimeve gjithëpërfshirëse, me prindër dhe nxënës, dhe janë koherentë me pritshmëritë e nxënësve, prindërve, mësime dhe komunitetit dhe janë diskutuar në*

Këshillin e shkollës dhe organet relevante të shkollës.

Raporti i VBSH-së nr. 14: *Organet përfaqësuese të nxënësve dhe të prindërve kanë informata për vizionin, misionin dhe prioritetet e shkollës, por nuk janë në dijeni për rolin e tyre në përmbushjen e vizionit dhe misionit të shkollës.*

Raporti i VBSH-së nr. 6: *Organet përfaqësuese të nxënësve dhe të prindërve janë në dijeni për e vizionin dhe misionin, prioritetet e shkollës, si dhe për rolin e tyre që kanë në përmbushjen e vizionit dhe misionit të shkollës që kjo punë bëhet falë detyrave dhe përgjegjësi të ekipit të caktuar nga përfaqësuesit e mësimdhënësve, prindërve, nxënësve.*

Raporti i VBSH-së nr. 24: *Duke iu referuar rezultateve të dala nga pyetësorët për prindër dhe nxënës rezultoi se 62.4% e të anketuarve mendojnë se kanë njohuri për vizionin, misionin dhe prioritetet e shkollës, si dhe janë në dijeni për rolin e tyre në përmbushjen e vizionit dhe misionit të shkollës, 31.3% deklarohen se nuk janë në dijeni dhe vetëm 6.9% kanë mendim të kundërt.*

Raporti i VBSH-së nr. 19: *Shkolla jonë posedon Planin Zhvillimor të Shkollës, me vizion dhe prioritetet, të cilat kanë qenë të njohura vetëm prej Këshillit të Shkollës dhe drejtorit. Perceptimi i nxënësve është se 65 % kanë njohuri për vizionin dhe misionin e shkollës, 26% nuk kanë njohuri vetëm për vizionin dhe 9% nuk kanë fare njohuri.*

Raporti i VBSH-së nr. 31: *Në bazë të instrumenteve të përdorura, nxënësit dhe prindërit kanë rezultuar të përgjigjen pozitivisht rreth informimit për misionin, vizionin dhe prioritetet e shkollës, përkatësisht prej 30 nxënësve 73% kanë deklaruar që janë të informuar dhe prej 10 prindërve 100% kanë deklaruar që janë të informuar, për më shumë është bashkangjitur statistika e raportit së bashku me pyetësorët. Gjithashtu, nga menaxhmenti është prezantuar PZSHH, që prezanton misionin, vizionin dhe rolet e tjera me rëndësi për shkollën.*

Duke u nisur nga fakti se treguesi i performancës është i njëjtë për të gjitha shkollat, si dhe pyetjet orientuese për treguesin përkatës kanë qenë të njëjta për të gjitha shkollat, nuk pritej të ketë kaq shumë dallime në përshkrimin e gjendjes. Natyrisht që nuk kemi pritje që përshkrimet për gjendjen në këtë tregues të jenë të njëjta, kur kemi parasysh kontekstin e shkollave dhe burimet e të dhënave që shkollat mund t'i kenë pasur, përkatësisht instrumentet e përdorura për mbledhjen e informacionit për treguesin përkatës. Dallime të tilla vërehen në pjesën më të madhe të përshkrimeve, edhe për treguesit e tjerë të performancës së shkollës.

Pasi që EVV ka përshkruar gjendjen për secilin tregues të performancës, për kriterin përkatës të cilësisë, ka përcaktuar shkallën e cilësisë së performancës për kriterin përkatës. Si referencë për përcaktimin e cilësisë së performancës së shkollës në nivel të kriterëve të cilësisë, shkollat janë udhëzuar që të mbështeten në përshkrimin e të gjithë treguesve të bërë nga vetë shkolla dhe në përshkrimin për nivelet e cilësisë së performancës, të vendosura në Kornizën për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës (f. 32-33).

Nga analiza e raporteve të shkollave për këtë pjesë (vlerësimin e kriterëve të cilësisë) mund të përfundojmë se vlerësimi për shkallën e cilësisë në nivel të kriterëve të

cilësisë, të bërë nga EVV, në masë të madhe reflekton gjendjen e përshkruar në raport me treguesit e kriterit përkatës. Mirëpo, gjendja e përshkruar, ashtu edhe vlerësimi në nivel të kriterëve, dominohen nga vlerësimi i lartë, përkatësisht me performancë të mirë për kritere të cilësisë, edhe pse mungojnë dëshmi për shumë tregues të performancës në raport me pritshmëritë e përcaktuara me Kornizën e performancës së shkollës.

Bazuar në Kornizën për cilësinë e performancës performancë e mirë, në kuadër të kriterit përkatës, shkolla i përmbush obligimet themelore ligjore në mënyrë korrekte dhe në masë të konsiderueshme i adreson nevojat specifike të nxënësve dhe të komunitetit në të cilin vepron, i ka anët e forta dhe të dobëta, por dominojnë anët e forta, si dhe nevojitet avancim i mëtejshëm i nivelit të performancës në kuadër të kriterëve të cilësisë.

Kërkesat e Udhëzuesit për VBSH, lidhur me përshkrimin e gjendjes në raport me treguesit, përmbajtjen e informacionit në përshkrim, saktësinë dhe koncizitetin e përshkrimit, informacionin e kërkuar me pyetjet kryesore për treguesit përkatës, si dhe në udhëzimet për vlerësimin e shkollës në cilësisë në nivel të kriterëve, duke reflektuar gjendjen e përshkruar në raport me treguesit e kriterit përkatës, krijuan mundësinë që të bëjmë edhe kuantifikimin e të dhënave. Në bazë të të dhënave të kuantifikuara, lidhur me përmbushjen e kërkesave të përmendura më sipër nxorëm një pasqyrë për të gjitha shkollat. Kuantifikimi i raporteve për përshkrimin e gjendjes për tregues të performancës së shkollës dhe vlerësimi në nivel të kriterëve tregon se asnjëra nga 39 shkollat e përfshira në studim nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat për këtë pjesë. Nga këto 6 shkolla ose 15.4% prej tyre kanë dëshmi se janë përmbushur mesatarisht kërkesat në këtë pjesë të procesit të VBSH-së. Pastaj 27 shkolla ose 69.2% i kanë plotësuar kërkesat minimale, 2 shkolla ose 5.2% nuk i kanë plotësuar fare kërkesat për këtë pjesë, ndërsa për 4 shkolla ose 10.3% nuk e kanë përdorur fare instrumentin e vlerësimit, rrjedhimisht nuk kanë bërë përshkrim në tregues të performancës së shkollës, por kanë bërë vlerësim të drejtpërdrejtë për kritere të cilësisë, për të cilat nuk ka dëshmi për shkallën e cilësisë në raportet të cilat i janë dërguar ekipit hulumtues.

4.4.6. Vlerësimi në nivel të fushave të cilësisë²⁸

Fushat e cilësisë janë shtyllat kryesore, në kuadër të së cilave zhvillohen aktivitetet menaxheriale, arsimore dhe edukative në shkollë. Fushat e cilësisë, të përcaktuara me Kornizën për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës, shërbejnë për të orientuar dhe për të siguruar koherencën në mes të procesit të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm të shkollës. Fushat e cilësisë ndërlihen me parimet e Kornizës së Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar të Kosovës dhe sigurojnë mbulueshmëri të aspekteve të rëndësishme të zhvillimit të shkollës (IPK, 2016b).

²⁸ Sipas Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës (f. 32), cilësia e performancës së shkollës në nivel të kriterëve të cilësisë, në nivel të fushave të cilësisë dhe në nivel të përgjithshëm, kategorizohet në njërin nga katër shkallët vijuese:

- Performancë e shkëlqyeshme;
- Performancë e mirë;
- Performancë e pranueshme;
- Performancë e papranueshme.

Sipas udhëzimeve të Udhëzuesit për VBSH, vlerësimi i performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë duhet të përmbajë:

NIVELI I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS SË SHKOLLËS (Raporti i VBSH (nr. 4)

Shkalla e cilësisë: *Performancë e mirë*

Përshkrimi i performancës së përgjithshme	Përparësitë dhe dobësitë e evidentuara	Rekomandime
<p>parë është bërë vlerësimi i brendshëm i performancës së shkollës tonë. Nga rezultatet e dala: prindërit, nxënësit dhe mësimitdhënësit janë në dijeni për misionin dhe vizionin e shkollës. PZSHH dhe plani vjetor i shkollës janë hartuar në tërësi dhe i adresohen problemeve të brendshme të shkollës. Në bazë të këtyre planeve këshillat që funksionojnë në kuadër të shkollës i kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre. Shkollës i mungon PIZH të mësimitdhënësit janë identifikuar nevojat e nxënësve dhe mësimitdhënësit. Shkolla punon në dy ndërrime, që do të thotë se hapësirat janë deri diku të mjaftueshme, sepse disa klasa kanë hapësirë më të vogël krahasuar me numrin e nxënësve. Po ashtu mungojnë disa laboratorë e kabinete. Lëvizja e nxënësve është e lirë dhe sigurt, për sigurinë e tyre kujdeset roja që paguhet nga kontributet e prindërve. Nuk ka raste të raportuara të dhunës, ndërsa ngacmimet ndërmjet nxënësve i menaxhon ekipi i ndërmjetësimit. Nxënësit me nevoja të veçanta kanë mundësi lëvizjeje vetëm në katin përdhës, po ashtu shkolla posedon dhe tualet për ata nxënës mirëpo nuk kanë mundësi që të frekuentojnë edhe hapësirat e katit të parë të shkollës për shkak të mungesës së ashenorit. Me qëllim të mbështetjes së nxënësve me nevoja të veçanta, mësimitdhënësit kanë nevojë për njohuri profesionale për hartimin e PLA. Preferojmë ngritje të bashkëpunimit ndërmjet MASHT dhe shkollës. Tekstet nuk korrespondojnë me temat e fushave të kurrikulës bërthamë që kontribuojnë arritjen e rezultateve. Shkolla ka kabinetin e informatikës të pajisur me teknologji ku secila fushë ka laptop dhe projektor ku mësimitdhënësit prezantojnë punimet e tyre, por nxënësit përdorin teknologjinë informativë vetëm në kabinetin e informatikës. Shkolla ka krijuar hapësirë që prindërit të kenë qasje në procesin mësimor përmes „DITËS së HAPUR”, po ashtu informohen rregullisht për vijueshmërinë dhe suksesin e nxënësve. Prindërit shprehen lirshëm për vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në këshillin e prindërve dhe pastaj në këshillin drejtues barten këto vërejtje a sugjerime. Mësimitdhënësit janë bashkëpunues në hartimin e planeve vjetore, për fusha, po ashtu ato dymujore etj. Disa nga mjetet janë por mungojnë dhe një pjesë e tyre. Kryetarët e aktiveve profesionale udhëheqin takimet dhe koordinojnë aktivitetet brenda fushave, organizohen mentorime kolegjiale etj. Mësimitdhënësit monitorohen në mënyrë të rregullt dhe raportet nga ky monitorim janë në shkollë.</p>	<p>PËRPARSITË</p> <ul style="list-style-type: none"> -Realizimi i PZSHH-së -Realizimi i planit dhe programit të planit vjetor të punës së shkollës. -Hartimi i rregullores së shkollës -Zgjedhja e ekipeve për ndërmjetësim. -Psikologja e shkollës. -Rregullimi i infrastrukturës shkollë -Realizimin e aktiviteteve jashtë mësimore. -Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme. -Bashkëpunimi me prindër. -Funksionimi i Këshillit Drejtues të Shkollës. -Ofrimi i kushteve të mira për klasat parafillore. -Lëvizja e lirë e nxënësve. -Ambienti i sigurt për nxënës. -Kamerat e sigurisë. -Hapësirat e gjelbëruara. -Ekipet e parandalimit të dhunës në shkollë. -Kutia e ankesave. -Grupi ndërmjetësues i nxënësve. -Këshilli Drejtues i nxënësve. -Sigurimi i shkollës. -Aparatet për fikjen e zjarrit. - 'Dita e hapur e shkollës'. -Prindërit janë të përfaqësuar në bordin e shkollës. -Funksionojnë aktivitetet profesionale. -Planifikimi në kohë të planeve mësimore. -Përdorimi i burimeve të ndryshme nga mësimitdhënësit. -Monitorohemi dhe nga drejtori i shkollës dhe nga inspektorati i arsimit. -Shkolla ka trajner në fushat e KKB-në tri nivelet. -Lexim, matematikë, mendim kritik, vlerësim formative EGRA etj. -Shkëmbimi i përvojave me shkolla jashtë Kosovës. -Shkolla përkrah nxënësit në aktivitete. -Nxënësit e shkollës sonë janë ndër të parët në pilotim. -Nxënësit janë të përfshirë në Këshillin e shkollës. -Nxënësit janë pjesë e vendimmarrjeve në shkollë dhe informohen me kohë për sukseset e tyre. -Motivohen përmes lëvdatave që ndahen nga drejtorja e shkollës. <p>DOBËSITË</p> <ul style="list-style-type: none"> -Mungesa e përkrahjes në përpilimin e planeve dhe programeve të punës me KKKB. 	<p>Mbështetur në gjetjet nga analiza në aspektin teorik dhe krahasimet në aspektin e realizimit praktik të vlerësimit për të gjithë hapat, nëpër të cilën kaloi procesi i vlerësimit brendshëm arin në këto rekomandime.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ofrim i trajnimeve me bazë në shkollë - për planifikimin mësimor. -Përkrahje më e madhe e mësimitdhënësit për punën e tyre. -Shkolla ti përkrahë dhe ti aplikoi ndryshimet dhe reformat e parashikuara për nxënës, mësimitdhënësit dhe prindër. -Shkolla të bashkëpunojë dhe të përkrahë në mënyrë më aktive nga MASHT-i. -Shkolla duhet të ketë programe adekuate për trajtim të nxënësve. -Shkolla të hartoi një sistem funksional dhe koherent i mbështetjes së zhvillimit profesional me bazë në shkollë dhe i monitorimit, monitorimit dhe vlerësimit profesional të mësimitdhënësit. -Të organizohet një program trajnime për mësimitdhënësit, për vlerësimin e nxënësve dhe vlerësimin e brendshëm.

- *Përcaktimin e shkallës së cilësisë së performancës në fushën përkatëse;*
- *Përmbledhjen e gjendjes reale të shkollës në kuadër të fushës përkatëse, duke u bazuar në gjetjet e evidentuara në raport me treguesit për secilin kriter të fushës përkatëse;*
- *Paraqitjen e evidencave (dëshmime) që mbështesin gjetjet e konstatuara në raport me treguesit, për secilin kriter të fushës përkatëse dhe*
- *Konstatimin e trendit (krahasuar me vlerësimin paraprak), evidentimin e ndikimit negativ apo pozitiv të faktorëve që janë jashtë kontrollit të institucionit arsimor dhe masat që do të ndërmerren nga shkolla për adresimin e këtyre ndikimeve.*

Si shembull për ilustrim po japim tabelën në vijim, e cila është pjesë e formularit të vlerësimit të performancës së shkollës që i referohet vlerësimit në nivel të fushave të cilësisë dhe që duhet të plotësohet në bazë të udhëzimeve të mësipërme.

Tabela 27

Forma e përshkrimit të performancës së shkollës në fusha të cilësisë dhe udhëzimet përcjellëse në udhëzuesin për VBSH

NIVELI I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS SË SHKOLLËS (Raporti i VBSH (nr. 24)

Shkalla e cilësisë: Performancë e mirë

Përshkrimi i performancës së përgjithshme	Përparësitë dhe dobësitë e evidentuara	Rekomandime
<p><i>Organet e qeverisjes së shkollës kanë ndarje të qartë të përgjegjësiave dhe përshkrim të detyrave në bazë të Rregullores për institucionet edukativo arsimore të komunës së N.N. Bëhen përpjekje të vazhdueshme që në bazë të përgjegjësiave që kanë, të japin kontributin e tyre duke bashkëpunuar nxënësit dhe mësimitdhënësit për të formësuar e më pas për të realizuar vizionin e shkollës që është pjesë përbërëse e PZSH dhe është i njohur për të gjithë aktorët. Organet profesionale të shkollës kanë përshkrim të qartë të detyrave dhe ndarje të qartë të përgjegjësiave. Ato takohen në intervale të rregullta. Më herët nuk është praktikuar vetëvlerësimi në këtë shkollë, prandaj vështirësitë në realizimin e tij ishin evidente, por me një frymë gjithëpërfshirëse, u tejkalua edhe kjo sfidë dhe rezultatet e dala do të informojnë drejt të gjitha palët e interesit.</i></p> <p><i>Mësimitdhënësit, nxënësit dhe prindërit ndihen pjesë e rëndësishme e proceseve vendimmarrëse të shkollës, si dhe të përfaqësuar në këtë organe. Sistemi i administrimit të rezultateve të arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore është në nivel të kënaqshëm.</i></p> <p><i>Plani vjetor i shkollës është operativ dhe i ka të ndara në intervale kohore të gjitha masat e planifikuara, si dhe përgjegjësit për secilin aktivitet ashtu si janë të përshkruara edhe në përgjegjësitë dhe detyrat e organeve profesionale të shkollës</i></p> <p><i>Hapësirat brenda dhe jashtë objektivit të shkollës janë të sigurta, të këndshme dhe stimuluese. Ato mundësojnë të zhvillohen aktivitete edukative, sociale por edhe rekreative. Mjedisi i shkollës është mbështetës dhe miqësorë, ku të gjithë nxënësit dhe prindërit ndihen të mirëpritur, të përkrahur dhe pjesë e institucionit dhe të gjithë trajtohen me respekt. Shkolla mundëson realizimin e potencialit të secilit nxënës përmes aktiviteteve të ndryshme jashtëkurrikulare që kanë për qëllim avancimin e prirjeve individuale të nxënësve. Prindërit dhe komuniteti janë të përfshirë në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit të shkollës me anë të punës vullnetare. Janë funksionale klubet e ndryshme në nivel të shkollës që merren me ruajtjen dhe gjelbërimin e ambientit, pastaj pasurimin e bibliotekës së shkollës me libra etj. Mësimitdhënësit bashkëpunojnë ngushtë në mes veti dhe me nxënësit për krijimin e materialeve mësimore, për sigurimin dhe shkëmbimin e tyre. Me anë të mjeteve të riciklueshme kanë krijuar materiale të ndryshme mësimore. Pakoja e rregulloreve të shkollës është në funksion të parandalimit të abuzimeve, ekseseve dhe shkeljeve të të gjitha llojeve.</i></p> <p><i>Shkolla ka një traditë në përfshirjen e prindërve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm në proceset mësimore në shkollë. Shkolla ofron kushte të përshtatshme për nxënësit me nevoja të veçanta, duke përfshirë edhe integrimin e tyre. Metodat e mësimitdhënies janë të përshtatshme dhe atraktive dhe mundësojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në proceset mësimore. Prindërit informohen rregullisht me progresin e fëmijëve të tyre dhe rezultatet e arritshëm të kompetencave. Vlerësimi i të nxënësve (ViN) është transparent dhe nxënësit janë në dijeni për notat e tyre në shumicën e rasteve... Në kuadër të organeve profesionale (fushave kurrikulare) mësimitdhënësit bashkëpunojnë në hartimin e planit vjetor, dymujor, javor dhe atij ditor.</i></p>	<p>Përparësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> -Shkolla posedon me planin zhvillimor të shkollës(PZSHSH). - Shkolla posedon me planin e vet për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve (PZHPM). -Të gjithë mësimitdhënësit janë të kualifikuar. -Organet profesionale të shkollës kanë përshkrim të qartë të detyrave dhe ndarje të qartë të përgjegjësiave. -Ambienti është i përshtatshëm dhe miqësor. -Klasat, laboratorët, hapësirat përcjellëse dhe pajisjet janë në funksion të plotë të realizimit të mësimit. -Nxënësit kanë qasje të pavarur në burimet e të nxënësve me të cilat posedon shkolla. - Shkolla ofron kushte të përshtatshme për nxënësit me nevoja të veçanta. 	<ul style="list-style-type: none"> -Të bëhet vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve në mënyrë të rregullt. -Të hartohet nga secili mësimitdhënës plani individual i zhvillimit (PIZH). - Të hartohet plan veprimi për mbajtjen e mësimit plotësues për nxënësit që kanë ngecje në mësimit. -Të bëhet vlerësimi për shkollë kurrikulare. -Hartimi i planit të bëhet me pjesëmarrje të gjerë të të gjithë mësimitdhënësve -Të përfshihet numër sa i madh i nxënësve në aktivitete ekstra-kurrikulare. -Të ngrihet niveli i higjienës në të gjitha hapësirat e shkollës (brenda dhe jashtë objektivit). -Të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të pajisur shkollën me sallë të edukatës fizike.

Vlerësimi i fushës së cilësisë		
Fusha e cilësisë: MENAXHIMI DHE QEVERISJA		
Shkalla e cilësisë:		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Sqarime
<p>Konstatohet gjendja reale e shkollës në kuadër të fushës përkatëse përmes një përshkrimi përmbledhës të gjetjeve në nivel të kriterëve. Për secilën fushë konstatohen përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës në raport me pritshmëritë e përcaktuara në Kornizën e Vlerësimit të Performancës së Shkollës.</p> <p>.....</p>	<p><i>p.sh.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani Zhvillimor i Shkollës - Plani vjetor i punës së shkollës - Të dhënat nga intervista e realizuar me NN, Kryesues i Këshillit të Prindërve (datë) - Të dhënat nga intervista e realizuar me N.N, Kryetar i Këshillit të Shkollës (datë) - Të dhënat nga intervista e realizuar me Drejtorin e shkollës (datë ...), - Të dhënat nga anketa e aplikuar me (12) nxënës për identifikimin e perceptimeve të tyre mbi prioritetet që duhen adresuar në shkollë - Të dhënat nga anketa e aplikuar me (12) prindër mbi prioritetet që duhen adresuar në shkollë - Raporti nga takimi me fokus grupin e nxënësve - 	<p><i>Trendi, krahasuar me vlerësimin paraprak</i></p> <p><i>Kufizimet/ përparësitë nga faktorët jashtë kontrollit të shkollës</i></p> <p><i>Masat që duhet të ndërmerren nga shkolla</i></p>

Në bazë të kërkesave të prezantuara më lart dhe udhëzimeve në tabelë për vlerësimin e performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë, janë analizuar produktet e shkollave për këtë pjesë të VBSH-së. Gjetjet nga kjo pjesë e analizës, ashtu si për përshkrimin e treguesve dhe vlerësimin në nivel të kriterëve të cilësisë, pasqyrojnë dallime të theksuara në përshkrimin e performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë, numrin dhe llojet e dëshmime/evidencave, si dhe në sqarime që lidhen me kufizimet dhe përparësitë nga faktorët jashtë kontrollit të shkollës dhe masat që duhet të ndërmerren nga shkolla për adresimin e faktorëve ndikues. Këtë e ilustron shembujt e vlerësimeve të bëra nga shkollat për fushën e cilësisë Mësimdhënia dhe nxënia.

Tabela 28

Shembuj në raportet e VBSH-së, të përshkrimit të performancës në fusha të cilësisë së shkollës

Vlerësimi i fushës së cilësisë - Raporti i VBSH-së (nr. 9)		
Fusha e cilësisë: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA		
Shkalla e cilësisë: Performancë e pranueshme		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Sqarime
<p><i>Shkolla ka bërë angazhim të vazhdueshëm që përpos mësimdhënësve të siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në veprimtaritë mësimore. Prindërit janë të gatshëm të kontribuojnë me mjete të ndryshme në procesin mësimor. Mësimdhënësit mundohen që gjatë orëve mësimore të zbatojnë teknika të ndryshme të mësimdhënies bashkëkohore gjithashtu edhe nxënësit janë të përfshirë në avancimin e procesit mësimor.</i></p> <p><i>Vazhdimisht prindërit informohen për suksesin apo mossaksesin e nxënësve si dhe disiplinën e fëmijëve, kurse vlerësimi shfrytëzohet për inkurajimin dhe motivimin e nxënësve për nxënie, ku del se pjesërisht është vlerësimi i të nxënësve transparent dhe korrekt, prandaj nxënësit gjithmonë janë në dijeni për notat e tyre.</i></p> <p><i>Identifikimi i masave të nevojshme për zhvillimin e kompetencave kryesore në kuadër të planeve dhe programeve për shkallë kurrikulare është bërë në një shkallë të mirë. Mësimdhënësit e shfrytëzojnë vlerësimi formativ për përkrahjen e nxënësve në planifikimin e të nxënësve të tyre, prandaj bëhet identifikimin dhe adresimin e nevojave të ndryshme të nxënësve me rastin e planifikimit të procesit mësimor. Planet dhe programet e mësimdhënësve për procesin mësimor janë në një masë të kënaqshme në funksion të qasjes dhe mësimdhënies së integruar. Përmbajtjet dhe proceset mësimore janë në funksion të arritjes së rezultateve të nxënies për fushën përkatëse kurrikulare, përmbajtjet mësimore janë në hap me zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore e shkencore si dhe në përputhshmëri me KB. Sa i përket detyrave të personelit mësimor janë përcaktuar në bazë të aftësive të tyre.</i></p> <p><i>Shkolla është e përkushtuar për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve mësimore duke u bërë monitorime dhe kontrolle të procesit mësimor dhe planeve mësimore, gjithashtu mësimdhënësit angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies. Shërbimet profesionale të shkollës janë efektive në mbikëqyrjen dhe përkrahjen e mësimdhënësve. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve bëhet në bazë të rregullt dhe kohë pas kohe nga drejtori i shkollës.</i></p> <p><i>Kurse anëtarë negative të shkollës sa i përket kësaj fushe janë me sa vijon: Sipas vlerësimeve të jashtme shihet se nxënësit nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë e aktiviteteve mësimore në të cilat marrin pjesë, pra puna e tyre në shtëpi është e mangët. Preokupimet dhe pritshmëritë e nxënësve dhe prindërve në planet e aktiveve profesionale për përmirësim të proceseve mësimore nuk mund të themi se janë pasqyruar pasi se nuk kemi shënime, pra deri më tani aktivitetet profesionale edhe nëse janë takuar nuk kanë mbajtur shënime. Dobësi kryesore e shkollës sonë është se nuk kanë mbajtur procesverbale nëpër libra të tyre, përpos në ditarë të klasës dhe librin e Këshillit të arsimtarëve. Nxënësit shumë pak janë të motivuar për mësim, është vështirë përkrahja individuale e zotërimit të kompetencave kryesore pasi se nuk kemi hapësirë të mjaftueshme. Disa mësimdhënës nuk tregohen efikas në menaxhimin e orës. Sipas rezultateve të PISA shihet se në Kosovë, prandaj edhe tek ne është e njëjtë pak i është kushtuar vëmendje zhvillimit të shkathësive të mendimit kritik gjatë procesit mësimor. Si gjithkund mësimin me zgjedhje nuk e zgjedhin nxënësit por i ndahet mësimdhënësve për plotësim norme.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgimi i proceseve mësimore - Portofoliot e nxënësve - Pyetësorët me nxënës - Intervista me fokus grupe me nxënës - Intervista me fokus grupe me prind - Planet mësimore (për shkallë kurrikulare, vjetore, dy/tre mujore, javore, ditore) - Ditarët e viteve paraprake - Raportet e analizave përmbyllës të rezultateve të nxënësve - Planet dhe programet e kurrikulës me zgjedhje - Procesverbalet e takimeve të organeve profesionale - Fokus grupet me mësimdhënës - Raportet mbi realizimin e planeve dhe programeve mësimore - Evidencat mbi ecurinë e planifikimit të proceseve mësimore në nivel të shkollëve kurrikulare, vjetore dhe javore - Evidencat mbi ecurinë e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje - Raportet e realizimit të planeve dhe programeve të kurrikulës me zgjedhje 	<p><i>Me qëllim të mësimdhënies dhe nxënies sa më të mirë kërkohet nga DKA që të bëjë pagesën për shpërndarjen e internetit në shkollë pasi që ka njësi shumë mirë të sqaruar në internet të cilat nuk mund të shkarkohen (dovlladohen).</i></p> <p><i>Të krijohen aktivitetet profesionale, të mbajnë takime të rregullta dhe këto takime të evidentohen në libra të posaçme, gjithashtu çdo organ tjetër i shkollës të mbajë procesverbal në libra të posaçme. Disa mësimdhënës të çohen në trajnime të ndryshme. Planet dhe programet të sillen me kohë dhe të jenë të përpiluar mirë. Mësimin me zgjedhje ta zgjedhin nxënësit në bazë të konkurrimit të mësimdhënësve me plan dhe projekt të qartë.</i></p>

Vlerësimi i fushës së cilësisë - Raporti i VBSH (nr. 20)		
Fusha e cilësisë3: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA		
Shkalla e cilësisë: Performancë e mirë		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Sqarime
<p>Në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollën tonë janë të përfshirë prindërit dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, të cilët me anë të ligjëratave, programeve artistike dhe aktiviteteve jashtëshkollore ndihmojnë në avancimin e procesit mësimor.</p> <p>Pas intervistës së bërë në shkollën tonë ka motivim të nxënësve, si dhe përkrahje për fuqizimin, identifikimin realizimin e potencialit të nxënësve.</p> <p>Mësimdhënësit bashkëpunojnë për planifikimin dhe zhvillimin e kompetencave duke përdorur metodat adekuate, është bërë identifikimi i masave të nevojshme për zhvillimin e kompetencave në kuadër të plan-programeve në shkallë kurrikulare të cilat monitorohen nga drejtoria.</p> <p>Për vlerësimin sumativ të nxënësve shfrytëzohen rezultatet e vlerësimit formativ dhe informatat kthyes duke shfrytëzuar burimet për identifikimin e nevojave të ndryshme të nxënësve në rastin e planifikimit të procesit mësimor.</p> <p>Menaxhmenti i shkollës përkrah dhe inkurajon mësimdhënësit për përcjelljen e ndryshimeve pedagogjike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave mësimore në arritjen e rezultateve për atë fushë kurrikulare. Qasja e metodologjisë së punës së mësimdhënësve shpeshherë reflektojnë zhvillimin e shumë sferave jetësore. Aktivitetet që realizohen në shkollë nxënësve u ndihmojnë në zbatim të dijës, shkathhtësive, si dhe aktiviteteve të tjera jetësore.</p> <p>Në shkollën tonë është bërë shpërndarja e fondit të orëve në dobi të arritjeve të kompetencave si dhe janë përzgjedhur lëndët më atraktive për nxënës. Këto janë zbatuar sipas kriterëve të KKK-së për zgjedhjen e përmbajtjeve mësimore. Shkolla ende nuk ka bërë vlerësimin për shkallë kurrikulare dhe ende nuk është bërë vlerësimi i kompetencave për shkallë. Udhëheqësit e shkollës kanë përzgjedhur personelin sipas aftësive dhe ofrimit të projekteve, dhe i ka përdorur të gjitha resurset njerëzore që i posedon shkolla.</p> <p>Shkolla ka një sistem relativisht të mirë të punës duke përfshirë në mënyrë aktive të gjithë faktorët që lidhen me procesin mësimor. Mësimdhënësit praktikojnë forma të ndryshme të punës në klasë për të përkrahur nxënësit në punë ekipore, individuale dhe i inkurajojnë që të hulumtojnë për vlerat e shoqërisë demokratike. Qasja e metodologjisë së punës së mësimdhënësve vëzhgohet në mënyrë sistematike nga udhëheqësit e shkollës dhe për çdo mësimdhënëtar arkivohen dosje personale, ku raportohen anët e dobëta dhe të forta të tyre.</p>	<p>Pyetësorë për mësimdhënësit</p> <p>Pyetësorë për nxënës</p> <p>Pyetësorë për prindër</p> <p>Intervistë me drejtorin</p> <p>Raportet e monitorimit</p> <p>Vëzhgimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mësimi në kabinete 2. Sallat, mjetet teknologjike 3. Planet individuale 4. Portfoliot e mësimdhënësve 5. Ueb-faqja e shkollës 6. Fletorja e konsultimeve 7. Raporti i mësimi shtues dhe plotësues 8. Raporti i KDSH 9. Procesverbali i mbledhjeve me prindër. 	

Vlerësimi i fushës së cilësisë - Raporti i VBSH (nr. 11)		
Fusha e cilësisë3: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA		
Shkalla e cilësisë: Performancë e mirë		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Sqarime
<p>Prindërit dhe partneret kanë mundësi të shohin drejtpërdrejt procesin e realizimit të mësimdhënies dhe nxënies, duke filluar nga "Dita e hapur" ku ata mund ta vlerësojnë punën e mësimdhënësve përmes punës me projekte dhe aktiviteteve të ndryshme. Ata gjithëherë janë të informuar me kohë për suksesin si dhe për të arriturat gjithashtu edhe për ngeçjet në mësim. Ajo mundësohet përmes takimeve me prindër si në mbledhje po ashtu në takime të veçanta. Për planifikimin e jetësimit të kurrikulës me bazë në shkollë prindërit deri diku janë të përfshirë në këtë proces. Forma më e mirë e përfshirjes së nxënësve janë projektet e punuara në bashkëpunim me mësimdhënësit. Me anë të ndarjes së punës në role krijon hapësirë që çdo nxënës të shprehë talentin e tij. Nxënësit në shkollë tonë nuk janë shumë të vetëdijshëm për rëndësinë e aktiviteteve, mbetet që shkolla të organizojë sa më shumë aktivitete të zbatueshme të cilat gjejnë zbatim në jetën e përditshme.</p> <p>Në shkollë tonë vlerësimi është transparent, por jo gjithmonë korrekt dhe inkurajues për mësim. Në rast mospajtimit të vlerësimit nxënësit kanë mundësi që të rivlerësohen, mirëpo shqetësim është ngurrimi i nxënësve për të treguar nganjëherë duke pasur frikë hakmarrjen. Kërkohej që shkolla të ketë parasysh a ka bazë për këtë. Për mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave ku mësimdhënësit i motivojnë nxënësit përmes orëve mësimore, të cilat i planifikojnë duke u bazuar në tri nivele dhe përmes aktiviteteve të ndryshme, duke bërë integrimin në fusha tjera kurrikulare. Mësimdhënësi në të shumtën e rasteve aplikon edhe në raste individuale për të arritur nxënësi kompetencat, të cilat i identifikon përmes portofolios, testeve, eseve që i bën pas çdo përfundimi të temës, kapitullit apo periudhës. Prijet individuale nuk kanë ndonjë program të veçantë, përveç motivimit nga ana e mësimdhënësve.</p> <p>Mësimdhënësit bashkëpunojnë ndërmjet vete përmes aktiveve profesionale për hartimin e plan-programeve, instrumenteve të vlerësimit dhe hartimit të testeve. Gjithashtu, bashkëpunojnë edhe me mësimdhënësit e fushave të tjera që të bëhet integrimi i lëndëve mësimore për arritjen e kompetencave kryesore. Mësimdhënësit përgatitja punën e tyre në mënyrë sistematike, bëjnë planifikimin e planit vjetor, dymujor, tematike dhe përgatitjet ditore, por në tërësi nuk janë në funksion të mësimdhënies së integruar. Shumica e mësimdhënësve i kushtojnë vëmendje ndërlidhjes së përbajtjeve mësimore në situatë reale, ku nxënësit përfitojnë më mësim gjatë gjithë jetës. Kjo mundësohet duke shfrytëzuar burimet e ndryshme në mjedisin ku jetojnë. Gjithashtu në masë të madhe i kushtohet vëmendje zhvillimit të shkathtësive të mendimit kritik gjatë procesit mësimor. Mirëpo gjatë zgjidhjes së problemeve në praktikë hasim në vështirësi për shkak të mjeteve adekuate, të cilat mungojnë në masë të madhe. Kurrikula me zgjedhje nuk kalohet në tërësi në procedura të rregullta të parapara në KB, për arsye se shkolla është në pilotim. Mësimdhënësit nuk i kanë dërguar projektet për mësim zgjedhor në shkollë. Shkolla përpiqet vazhdimisht në përmirësimin e proceseve mësimore dhe për këtë arsye përdor mekanizmin që e monitoron dhe e kontrollon procesin mësimor. Mësimdhënësit përdorin të gjitha mjetet e nevojshme që kanë në dispozicion, duke shfrytëzuar burimet e nevojshme në dobi të mësimdhënies dhe nxënies. Shërbimet profesionale mbikëqyren dhe përkrahen mësimdhënësit për të realizuar kërkesat e kurrikulës. Sfidat gjatë procesit mësimor evidentohen nga organet profesionale, e gjithashtu rishikohen dhe përmirësohen edhe planet vjetore çdo vit nga aktivet profesionale.</p>	<p>-Foto të "Ditës së hapur" të shkollës. -Punimet e nxënësve të aktiviteteve të ndryshme mësimore. -Raportet e mbledhjeve me prindër nga fletëpalosjet e KKK të cilat shkolla ju ka shpërndarë prindërve -Përfshirja e prindërve në Kurrikulën me zgjedhje. -Portofoliot e nxënësve. -Pyetëtori për nxënës. -Analiza e rezultateve të vlerësimit sumativ të nxënësve (në fund të çdo teme mësimore) në çdo periudhë mësimore. -Kutia e ankesave. -Psikologja e shkollës Plan-programet mësimore instrumentet e vlerësimit, testet për vlerësim. Pyetëtori për mësimdhënësit. Punimet e nxënësve publikohen brenda në shkollë dhe jashtë saj (foto) Mësimi shtues dhe plotësues figurojnë në ditarët e klasave. Planet e aktiveve profesionale. Raportet-planifikimi për ditë Planifikimi vjetor, mujor, javor. Intervista me mësimdhënësit Fokus grupe me mësimdhënësit Intervista me nxënës. Projektet e mësimdhënësve Dëshmitë e monitorimit nga drejtori shkollës.</p>	<p>Mësimdhënësit kanë nevojë për pajisje me mjete të konkretizimit të cilat e ndihmojnë dhe e lehtësojnë punën e tyre në mësimnxënien. Mjetet e konkretizimit janë- Fotokopjues, printer, skaner, letër A4 etj. Këto kërkesa dalin me që ata vazhdimisht testet dhe materialet tjera për mësimdhënien i fotokopjojnë jashtë shkollës me mjete vetanake dhe ato po kushtojnë.</p>

Përshkrimi i fushave të cilësisë së performancës së shkollës, në dokumentin e Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, është pika orientuese për shkollat se ku duhet të fokusohen për vlerësimin e gjendjes në fushat përkatëse të cilësisë. Udhëzimet dhe shembujt e dhënë në udhëzuesin për VBSH janë në koherencë të plotë me dokumentin e kornizës. Prandaj nuk pritej që të mos shfrytëzohen në masën e duhur këto orientime, por edhe të ketë dallime të theksuara në përshkrimin e gjendjes së shkollës në fusha të cilësisë. Bazuar në kontekstin e shkollës, nuk kemi pritur që përshkrimet për fusha të njëjta të cilësisë, me dëshmi dhe sqarime, të jenë të njëjta. Burimet e të dhënave që mund t'i kenë shkollat, përkatësisht instrumentet e përdorura për të mbledhur informacionin për treguesin përkatës, janë të ndryshme nga shkolla në shkollë.

Në analizën në vijim, nuk kemi bërë krahasime në mes të shkollave për përshkrimin e performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë, në mënyrë specifike jemi përqendruar në mbulueshmerinë e pyetjeve që duhej të përmbante përshkrimi për fusha të cilësisë, si:

- *Përcaktimi i shkollës së cilësisë për fushat përkatëse, a e reflekton vlerësimin e bërë në nivel të kriterëve të fushës përkatëse?*
- *Përshkrimi i performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë, a përmban nga një konstatim përmbledhës për secilin kriter të cilësisë?*
- *Konstatimet përmbledhëse për kriteret e cilësisë, a reflektojnë gjendjen e evidentuar në raport me treguesit (për kriterin përkatës)?*
- *A janë identifikuar përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë?*
- *A janë të mjaftueshme dhe relevante evidencat/burimet e shfrytëzuara?*

Evidencat e analizës së vlerësimeve në nivel të fushave të cilësisë, me konstatimet Po ose Jo, bazuar në pyetjet e shtruara për këtë qëllim, na mundësuan kuantifikimin e të dhënave. Në bazë të të dhënave të kuantifikuara, nxorëm një pasqyrë për të gjitha shkollat, për përmbushjen e kërkesave nga shkollat për vlerësimin në nivel të fushave të cilësisë së shkollës.

Kuantifikimi i raporteve të shkollave për përshkrimin e bërë në vlerësimet në nivel të fushave të cilësisë tregon se asnjëra nga 39 shkollat e përfshira në studim nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e pyetjeve për këtë pjesë të raportit të VBSH-së. Janë 6 ose 15.4% e shkollave që kanë dëshmi se janë përmbushur mesatarisht kërkesat në këtë pjesë të procesit të VBSH-së. Ndërsa 23 shkolla ose 59.% prej tyre kanë plotësuar kërkesat minimale. Por 3 shkolla ose 7.6% prej tyre fare nuk i kanë plotësuar kërkesat, ndërsa 7 shkolla ose 18% nuk e kanë bërë vlerësimin në nivel të fushave të cilësisë apo nuk e kanë përdorur fare instrumentin e vlerësimit. Rrjedhimisht shihet se këto të fundit nuk u janë përmbajtur formatit dhe udhëzimeve për vlerësim në nivel të fushave të cilësisë.

4.4.7. Vlerësimi i performancës së përgjithshme të shkollës

Dokumenti Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës (f. 30), vlerësimi i performancës së përgjithshme të shkollës përmban një përmbledhje të gjendjes së konstatuar në nivel të fushave të cilësisë që kanë qenë objekt i vlerësimit dhe vetëvlerësimit të shkollës. Ky vlerësim bëhet nga perspektiva e ndikimit që kanë pasur praktikat shkollore të nxënësit dhe nxënia e tyre, në kuadër të fushave përkatëse të cilësisë. Me rastin e vlerësimit të përgjithshëm, shkolla identifikon përparësitë dhe dobësitë e performancës së saj dhe masat që duhet të ndërmerren për mirëmbajtjen dhe avancimin e përparësive dhe për përmirësimin e anëve të dobëta, respektivisht tejkalimin e sfidave të evidentuara.

Tabela në vijim është pjesë e formularit të vlerësimit të performancës së shkollës, që i referohet vlerësimit të përgjithshëm të performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë dhe që duhet të plotësohet në bazë të udhëzimeve të dhëna në udhëzuesin për VBSH.

Tabela 29

Forma e përshkrimit në nivel të përgjithshëm të performancës së shkollës dhe udhëzimet përcjellëse në udhëzuesin për VBSH

NIVELI I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS SË SHKOLLËS		
Shkalla e cilësisë: (konstatohet njëra nga katër shkallët vijuese: (i) Performancë e shkëlqyeshme; (ii) Performancë e mirë; (iii) Performancë e pranueshme; iv) Performancë e papranueshme)		
Përshkrimi i performancës së përgjithshme	Përparësitë dhe dobësitë e evidentuara	Rekomandime
<i>Përshkruhet performanca e shkollës përmes një përmbledhje të gjetjeve në nivel të fushave të cilësisë.</i>	<i>Zhvillimet e përgjithshme Trendi, krahasuar me vlerësimin paraprak. Përkushtimi i shkollës për përmirësim; Anët e forta dhe sfidat kryesore të shkollës; Kufizimet/përparësitë nga faktorët jashtë kontrollit të shkollës.</i>	<i>Rekomandimet për punën e mëtejme të shkollës në adresimin e sfidave dhe përforcimin e anëve të forta.</i>

Në bazë të formatit të tabelës dhe udhëzimeve, EVV-të duhet ta vlerësojnë dhe ta përshkruajnë performancën e përgjithshme të shkollës. Gjetjet nga kjo pjesë e analizës, ashtu si për vlerësimin në nivel të fushave të cilësisë, tregojnë dallime në raportet e shkollave për vlerësimin e përgjithshëm të performancës së shkollës. Metodologjia e VBSH-së, e zbatuar për këtë proces, mundëson që të ketë dallime në përshkrim dhe në shkallë të vlerësimit të performancës së shkollës, kur kemi parasysh kontekstin e shkollave, zhvillimet e përgjithshme në shkolla, arritjet në shkolla, etj. Mirëpo, dallime vërehen në përshkrimet e shkollave për vlerësim të përgjithshëm të performancës së shkollës. Këto dallime janë pasojë e mosrespektimit të plotë të metodologjisë së vlerësimit, gjegjësisht ndjekjes së hapave kryesorë të procesit të vlerësimit të brendshëm.

Në vijim po i prezantojmë dy shembuj të vlerësimit të përgjithshëm të performancës së shkollës, të integruar në raportet e VBSH-së, të shkollave të përfshira në studim.

Tabela 30

Shembuj në raportet e VBSH-së, të përshkrimit në nivel të përgjithshëm të performancës së shkollës

Organizohen aktivitetet e ndryshme ekstra kurrikulare, të cilat i ndihmojnë nxënësit të arrijnë në vetëvlerësim.

Nga kjo del se procesi i vlerësimit të brendshëm i ka përparësitë e veta dhe lëshimet e veta. Ajo që duhet potencuar është se ekipi për vlerësim të performancës i ka paraqitur në mënyrë reale të gjeturat.

Nga të gjeturat del që duhet të reflektohet në arritjet e mësimdhënësve për zbatim të planeve e programeve mësimore dhe mungesa e trajnimeve të vazhdueshme për vlerësimin e nxënësve, gjë e cila duhet të merret në konsideratë në të ardhmen.

Shtirirja e KKKs-pa informata të mjaftueshme (administratë mësimdhënës).

-Mungesa e hapësirave të nevojshme të laboratorëve mosplotësimi i kushteve në sallën e edukatës fizike.

-Ndarja e buxhetit të pamjaftueshëm për shpenzimet e shkollës.

-Mungesa e krijimit të autonomisë dhe fleksibilitetit të shkollës.

-Mungesa e nevojshme e materialeve të punës.

-Lëvizshmëria mes kateve.

-Gëlqerosja e objektit të shkollës.

-Lagështia që posedojmë klasat që është e dëmshme si për nxënës po ashtu edhe për mësimdhënësit.

-Mungon plani PIZH për mësimdhënës.

-Mungon plani PIA për nxënës.

-Kurrikula me zgjedhje nuk kalon në tërësi me procedura të rregullta, siç kërkohet nga KB arsyeja është pilotimi.

-Nuk kanë burime të mjaftueshme (familjet nuk janë të pajisura me mjete teknologjike).

-Mungon plani individual i ZHP të mësimdhënësve.

-Trajnime me bazë në shkollë PIA.

-Pilotimi ka qenë sfidues për mësimdhënës.

-Tekstet e nxënësve nuk përputhen me temat e kërkesave në KB.

-Nxënësit nuk përkrahen në pjesëmarrje në gara në nivel shtetëror.

-Trajnimet që janë ofruar deri më tani për mësimdhënës nuk kanë siguruar cilësi të mjaftueshme.

Tabela 31

Shembuj në raportet e VBSH-së, të përshkrimit në nivel të përgjithshëm të performancës së shkollës

Shkolla i kushton vëmendje të theksuar zhvillimit të mendimit kritik gjatë procesit të mësimi, si dhe zbatimit të dijes dhe shkathtësive, të qëndrimeve dhe vlerave në kontekst të zgjidhjes së problemeve të caktuara nga jeta reale. Shpërndarja e fondit të orëve për lëndë / vit shkollor bëhet në mënyrë transparente në aktivitetet e fushave kurrikulare. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve nuk bëhet në mënyrë të rregullt dhe në mënyrë sistematike, përveç në disa raste.

Shkolla posedon me planin e vet për zhvillimin profesional të mësimdhënësve (PZHMP), i cili përfshin periudhën 2013- 2016. Në hartimin e PZHMP kanë punuar disa mësimdhënës në bashkëpunim me menaxherin e shkollës.

Plani i zhvillimit profesional të mësimdhënësve (PZHMP) bazohet në prioritetet e shkollës, performancën e mësimdhënësve dhe performancën e nxënësve, mirëpo mungon plani individual i zhvillimit (PIZH). Nevojat individuale të mësimdhënësve për zhvillim profesional identifikohen në disa raste përmes monitorimit, por edhe në bazë të kërkesave të mësimdhënësve apo mënyrave tjera si raportet e fushave kurrikulare ku evidentohen nevojat për zhvillim profesional të mësimdhënësve të caktuar, nga raportet e punës së shërbimeve profesionale apo edhe në bazë të mungesës së përvojës në procesin edukativo-arsimor. Performanca e nxënësve dhe rezultatet e arritshmërisë së nxënësve merren parasysh në identifikimin e nevojave të mësimdhënësve për ZHPM. Udhëheqja e shkollës dhe shërbimi profesional monitorojnë ndikimin e ZHPM në ngritjen e cilësisë dhe efektivitetit të mësimdhënësve për zhvillimin e kompetencave kryesore. Shkolla mbikëqyrë ndikimin e ZHPM në planifikimin dhe realizimin e proceseve mësimore, duke monitoruar në orët mësimore, duke kontrolluar planet individuale të mësimdhënësve dhe portofolit e mësimdhënësve për ZHP.

Nxënësit ndihen të sigurt dhe të respektuar në shkollë, sepse shkolla në përgjithësi i përmbushë pritshmëritë e tyre 79.31% të të anketuarve, ndërsa mendim të kundërt kanë 20.69% e tyre. Shkolla krijon hapësirë e nevojshme dhe të domosdoshme, duke i mbështetur nxënësit në adresimin e nevojave dhe kërkesave të tyre në lidhje përmirësimin e ambientit shkollor; ngritjen e rezultateve në mësim, zhvillimit të aktiviteteve të lira në shkollë etj. Në bazë të vëzhgimit të performancës së nxënësve, portofoliove të nxënësve, mostrave të punimeve të nxënësve (eseve, testeve, projekteve, detyrave të shtëpisë), rezultatet në nivelin e zotërimit të të gjitha kompetencave plotëson pritshmëritë e vendosura me KB. Gjithashtu në bazë të vëzhgimit të performancës së nxënësve, portofoliove të nxënësve, mostrave të punimeve të nxënësve, rezultoni se niveli i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve përcaktuara për të gjitha fushat kurrikulare, plotëson pritshmëritë e vendosura me KB. Njëpërmjet të përfaqësuesve të tyre, nxënësit janë të përfshirë në përgatitjen e programit për aktivitete ekstra-kurrikulare në shkollë dhe jashtë saj. Këto aktivitete shkolla i planifikon dhe organizon së bashku me nxënësit duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e tyre, dhe në bazë të afiniteteve të tyre dhe sipas nevojave për të mbështetur zhvillimin e tyre personal dhe shoqëror; 65.52% e nxënësve deklarohen se janë të përfshirë në së paku një aktivitet ekstra-kurrikular, ndërsa 34.48 kanë mendim të kundërt.

Mangësitë

- Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve nuk bëhet në mënyrë të rregullt.

-Mungon plani individual i zhvillimit (PIZH).

- Nuk mbahet mësim plotësues për nxënësit që nuk kanë rezultate pozitive.

-Mungesa e vlerësimit për shkallë kurrikulare.

-Mungesa e hartimit planeve me pjesëmarrje të gjerë.

-Niveli jo i kënaqshëm i përfshirjes së nxënësve në aktivitete ekstra-kurrikulare.

-Higjiena në të gjitha hapësirat e shkollës (brenda dhe jashtë objektit) i higjienës së shkollës nuk është i kënaqshëm.

-Mungon salla e edukatës fizike.

-Të bëhet vlerësimi i performancës së mësimdhënësve në mënyrë të rregullt.

-Të hartohet nga secili mësimdhënës plani individual i zhvillimit (PIZH).

- Të hartohet plan veprimi për mbajtjen e mësimi plotësues për nxënësit që kanë ngecje në mësim.

-Të bëhet vlerësimi për shkallë kurrikulare.

-Hartimi i planit të bëhet me pjesëmarrje të gjerë të të gjithë mësimdhënësve

-Të përfshihet numërsa i madh i nxënësve në aktivitete ekstra-kurrikulare.

-Të ngrihet niveli i higjienës në të gjitha hapësirat e shkollës (brenda dhe jashtë objektit).

-Të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të pajisur shkollën me sallë të edukatës fizike.

Dy shembujt e dhënë paraqesin qasjen që EVV kanë ndjekur për vlerësimin e përgjithshëm të performancës së shkollës. Siç pasqyrohet në këta dy shembuj, ka dallime në mes të shkollave edhe në qasjen e tyre për ta sintetizuar vlerësimin e përgjithshëm të performancës së shkollës. Në analizën në vijim, jemi fokusuar në

gjetjen e mbulueshmërisë së kërkesave për vlerësimin e përgjithshëm të performancës së shkollës nga të gjitha shkollat e përfshira në studim. Analizën e mbulueshmërisë së kërkesave për vlerësimin e përgjithshëm të performancës së shkollës e kemi bërë në bazë të pyetjeve:

- *Përcaktimi i shkallës së cilësisë për vlerësimin e përgjithshme të performancës së shkollës, a e reflekton vlerësimin e bërë në nivel të fushave të cilësisë?*
- *Përshkrimi i performancës së shkollës, a përmban nga një konstatim përmbledhës për secilën fushë të cilësisë?*
- *Konstatimet përmbledhëse për fusha të cilësisë, a reflektojnë gjendjen e evidentuar për kriteret e cilësisë (në kuadër të fushës përkatëse)?*
- *Përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës në nivel të përgjithshëm janë identifikuar?*
- *Rekomandimet e vendosura, a i orientojnë masat që duhet të ndërmerren për mirëmbajtjen dhe avancimin e përparësive dhe për përmirësimin e anëve të dobëta?*

Edhe për këtë pjesë të analizës krijimi i evidencave sipas shkollave, me konstatimet Po ose Jo, bazuar në pyetjet e shtruar për këtë qëllim, na mundësuan kuantifikimin e të dhënave. Në bazë të të dhënave të kuantifikuara, nxorëm një pasqyrë për të gjitha shkollat lidhur me përmbushjen e kërkesave nga shkollat për vlerësimin e përgjithshëm të performancës së shkollës.

Kuantifikimi i raporteve për vlerësimin e përgjithshëm të performancës së shkollës tregon se asnjëra nga 39 shkollat e përfshira në studim nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e pyetjeve për këtë pjesë të raportit të VBSH-së. Por, 5 ose 12.8% e shkollave kanë dëshmi se janë përmbushur mesatarisht kërkesat në këtë pjesë të procesit të VBSH-së, ndërsa 20 shkolla ose 51.3% i kanë plotësuar kërkesat minimale dhe 6 shkolla ose 15.4% nuk i kanë plotësuar fare kërkesat. Gjithashtu, 8 shkolla ose 20.4% prej tyre nuk e kanë përdorur fare instrumentin e vlerësimit për këtë pjesë të raportit të VBSH-së. Ndërsa katër prej tyre nuk kanë raportuar për realizimin e vlerësimit të përgjithshëm të performancës së shkollës.

Analiza e raporteve të VBSH-së tregon se vlerësimi në nivel të përgjithshëm të performancës së shkollës është sfiduar te shkollat, të cilat nuk i kanë përmbushur kërkesat për fazat paraprake të procesit të vlerësimit të brendshëm. Sfidë më vete duket të jenë: nxjerrja e konstatimeve përmbledhëse për secilën fushë të cilësisë dhe mbështetja e tyre në evidencat për vlerësim në kriteret e cilësisë, identifikimi i dobësive të shkollës të lidhura drejtpërdrejt me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit, si dhe vendosja e rekomandimeve që orientojnë vetë shkollën të ndërmarrë masa për mirëmbajtjen dhe avancimin e përparësive dhe për përmirësimin e anëve të dobëta të identifikuara.

4.4.8. Raporti përmbledhës

Vetëvlerësimi shërben dhe ndihmon për të drejtuar procesin e intervenimit të planifikuar për përmirësim ose avancim të performancës së shkollës. Prandaj, raporti narrativ – raporti përmbledhës, duhet të hartohet dhe shfrytëzohet si bazë për diskutim dhe reflektim në mes të mësimdhënësve, menaxhmentit dhe komunitetit të shkollës, përkitazi me performancën, misionin dhe rolin e shkollës. Në raportin përmbledhës duhet të integrohet një përmbledhje e shkurtër e procesit të VBSH-së, të dhënat bazë për shkollën dhe gjetjet kryesore nga VBSH-ja, të cilat merren nga formulari i VBSH-së (vlerësimi i përgjithshëm, vlerësimi i fushave të cilësisë dhe vlerësimi i kritereve) për pjesët përkatëse. Raporti shërben për planifikimin e masave për përmirësim/avancim të shkollës dhe për informimin e vlerësimeve të jashtme të performancës së shkollës. Pas aprovimit nga Këshilli Drejtues i Shkollës, raporti do të jetë bazë për rishikim të Planit Zhvillimor të Shkollës dhe për përgatitjen e Planit vjetor të veprimit. Ky raport, përveç nga Këshilli Drejtues i Shkollës, do të përdoret edhe nga vlerësuesit e jashtëm, nga DKA-ja etj (IPK, 2016b).

Analizë e raporteve përmbledhëse e fokusuar në gjetjet e përgjigjeve në tri pyetje kryesore:

- *A është përgatitur raporti përmbledhës i VBSH-së?*
- *A e respekton raporti përmbledhës, i përgatitur nga shkolla për VBSH-në, strukturën/përmbajtjen e propozuar me udhëzuesin për VBSH?*
- *A ofron një bazë të mirë për rishikimin e PZSHH-së dhe për përgatitjen e Planit vjetor të veprimit raporti përmbledhës i përgatitur nga shkolla për VBSH.*

Për analizën e raportit përmbledhës përdorëm formularin përkatës, me konstatimet Po ose Jo, bazuar në dy pyetjet e shtruar për këtë qëllim. Evidencat për raportin përmbledhës na mundësuan kuantifikimin e të dhënave. Pastaj, në bazë të të dhënave të kuantifikuara, u mundësua që të nxjerrim një pasqyrë për të gjitha shkollat lidhur me përmbushjen e këtyre dy kërkesave për përgatitjen e raportit përmbledhës të VBSH-së.

Bazuar në rezultatet e analizës, mbi 51% e shkollave nuk e kanë përgatitur raportin përmbledhës të VBSH-së në fazën e parë, me arsyetimin se vlerësimi i përgjithshëm në nivel shkollë është konsideruar formë e raportit përmbledhës. Shkollat që e kanë përgatitur raportin përmbledhës të VBSH-së, jo të gjitha, i janë përmbajtur strukturës së propozuar në Udhëzuesin e VBSH-së për raportin përmbledhës, por ofrojnë një bazë relativisht të mirë për rishikimin e PZSHH-së dhe për përgatitjen e planit të veprimit. Kuantifikimi i të dhënave të analizës për këtë pjesë tregoi se 5 shkolla, ose 12.8% e prej tyre, kanë dëshmi se janë përmbushur mesatarisht kërkesat për përgatitjen e raportit përmbledhës, 14 shkolla ose 35.9% kanë plotësuar kërkesat minimale, ndërsa 20 shkolla ose 51.34% nuk e kanë përgatitur fare raportin përmbledhës, duke iu referuar arsytimit të mësipërm.

Në mungesë të raportit përmbledhës, EVV-të mund të kenë pasur sfida në diskutimet dhe reflektimet në mesin e mësimdhënësve, menaxhmentit dhe komunitetit të shkollës, përkitazi me gjetjet kryesore nga VBSH-ja. Njëkohësisht nuk është krijuar baza e dokumentit për miratim nga KDSH dhe rrjedhimisht për t'u bërë dokument bazë për rishikim të Planit Zhvillimor të Shkollës dhe për përgatitjen e Planit vjetor të veprimit.

4.4.9. Përmbledhje e analizës së raporteve të vlerësimit të brendshëm

Në këtë kapitull është bërë prezantimi, interpretimi dhe diskutimi analizës së raporteve të vlerësimit të brendshëm të shkollave të përfshira në studim, duke plotësuar kërkesën e objektivit të dytë të studimit: *Të përshkruhet niveli i përmbushjes së kritereve e procedurave të vlerësimit të performancës së shkollës në raportet e vlerësimit të brendshëm të shkollave të përfshira në mostrën e studimit.* Kjo është arritur duke përdorur listën e kontrollit për krijimin e evidencave dhe nxjerrjen e konstatimeve për nivelin e plotësimit të kërkesave për 8 hapat kryesorë të procesit të vlerësimit të brendshëm: 1. Faza përgatitore; 2. Identifikimi i burimeve të të dhënave dhe përzgjedhja e mostrës; 3. Përzgjedhja dhe përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave; 4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave; 5. Përshkrimi i gjendjes për tregues të performancës së shkollës dhe vlerësimi në nivel të kritereve; 6. Vlerësimi në nivel të fushave të cilësisë; 7. Vlerësimi i përgjithshëm; dhe 8. Raporti narrativ – raporti përmbledhës.

Të dhënat e evidencave të krijuara me ndihmën e instrumentit të përgatitur për analizë të raporteve të VBSH-së janë diskutuar në aspektin e interpretimit dhe shpjegimit të të dhënave, krahasimit me kërkesat për plotësimin e secilit hap të procesit të VBSH-së, si dhe janë kuantifikuar në bazë të pesë niveleve të plotësimit të kërkesave, sipas hapave kryesorë të procesit të VBSH-së. Tabela numër 32 pasqyron një përmbledhje të nivelit të përmbushjes së kritereve e procedurave të vlerësimit të performancës së shkollës, të kuantifikuar në numër dhe përqindje.

Tabela 32

Niveli i përmbushjes së kritereve e procedurave të vlerësimit të performancës së shkollës, sipas hapave kryesorë të procesit të vlerësimit (në numër të shkollave dhe %)

Nr.	Hapat kryesorë të procesit të vlerësimit	Plotësim i plotë i kërkesave të VBSH-së	Plotësim mester i kërkesave të VBSH-së	Plotësim minimal i kërkesave të VBSH-së	Nuk është plotësuar asnjë kërkesë e VBSH-së	Nuk ka dëshmi ose nuk është përdorur instrumenti standard i VBSH-së
		Numri dhe % e shkollave				
1	Faza përgatitore	6 Shkolla ose 15.4 %	13 Shkolla ose 33.3 %	6 Shkolla ose 15.4 %	/	14 Shkolla ose 35.9 %
2	Identifikimi i burimeve të të dhënave dhe përzgjedhja e mostrës për VBSH	3 Shkolla ose 7.6 %	8 Shkolla ose 20.4 %	12 Shkolla ose 30.7 %	/	16 Shkolla ose 41.3 %
3	Përzgjedhja dhe përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave	/	8 Shkolla ose 20.4 %	27 Shkolla ose 69.2 %	/	4 Shkolla ose 10.3 %
4	Mbledhja dhe analiza e të dhënave	/	7 Shkolla ose 17.9%	20 Shkolla ose 51.3 %	/	12 Shkolla ose 30.8 %
5	Përshkrimi i gjendjes për tregues të performancës së shkollës dhe vlerësimi në nivel të kritereve	/	6 Shkolla ose 15.4%	27 Shkolla ose 69.2 %	2 Shkolla ose 5.2 %	4 Shkolla ose 10.3 %
6	Vlerësimi në nivel të fushave të cilësisë	/	6 Shkolla ose 15.4 %	23 Shkolla ose 59 %	3 Shkolla ose 7.6 %	4 ₍₃₎ +3 ₍₄₎ Shkolla ose 17.9%

³ Në raportet e 4 shkollave nuk ka dëshmi për vlerësimin në nivel të fushave të cilësisë së shkollës.

⁴ Në raportet e 3 shkollave vlerësimi në nivel të fushave të cilësisë së shkollës nuk është bërë sipas instrumentit të vlerësimit dhe nuk përkon me kërkesat për këtë nivel të vlerësimit.

7	Vlerësimi i përgjithshëm i performancës së shkollës	/	5 Shkolla ose 12.8 %	20 Shkolla ose 51.3 %	6 Shkolla ose 15.4 %	4 ⁽⁵⁾ +4 ⁽⁶⁾ Shkolla ose 20.4%
8	Raporti narrativ – raporti përmbledhës	/	5 Shkolla ose 12.8 %	14 Shkolla ose 35.9 %	/	20 Shkolla ose 51.3 %

Siç shihet nga tabela për nivelin e përbushjes së kriterëve e procedurave të vlerësimit të performancës së shkollës, të kuantifikuar në numër dhe përqindje, në dy hapat e parë të VBSH-së, ka një respektim më të madh të kërkesave për VBSH. Në hapat 3 dhe 4 kemi një dominim të plotësimit minimal të kërkesave për VBSH, edhe në hapat e tjerë, 5-7, kemi një dominim minimal të plotësimit të kërkesave për VBSH dhe në anën tjetër kemi edhe shkolla që fare nuk i kanë plotësuar kërkesat e VBSH, por edhe shkolla që nuk e kanë respektuar instrumentin standard të VBSH-së dhe nuk kanë dhënë dëshmi për realizimin e këtyre hapave të VBSH-së. Ndërsa, për raportin narrativ – raportin përmbledhës, numri më i madh i shkollave nuk kanë ofruar dëshmi të përgatitjes së raporteve përmbledhëse dhe miratimit të tyre, si bazë për rishikim të PZSHH-së dhe përgatitjen e planeve të veprimtimit për përmirësim të vazhdueshëm.

⁵ Në raportet e 4 shkollave nuk ka dëshmi për vlerësimin e përgjithshëm të performancës së shkollës.

⁶ Në raportet e 4 shkollave vlerësimi i përgjithshëm të performancës së shkollës nuk është bërë sipas instrumentit të vlerësimit dhe nuk përkon me kërkesat për vlerësim të përgjithshëm të performancës së shkollës.

KAPITULLI V

DISKUTIM I REZULTATEVE

Diskutimi i rezultateve ndërlidhet me çështjet kryesore të hulumtimit siç janë realizimi i qëllimit, objektivave dhe pyetjeve kërkimore të studimit, lidhur me përvojat e para në vlerësimin e performancës së shkollës në Kosovë, si dhe masat që duhen ndërmarrë për zbatim cilësor të vetë sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë, bazuar në praktikatat e mira të vendeve evropiane. Në lidhje me qëllimin e studimit u përcaktuan tri objektiva kryesore, të cilat i shqyrtoam përmes pyetjeve dhe nënpyetjeve kërkimore.

Objektivi i parë i studimit ishte të analizohen dhe të përshkruhen ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet politikave, procedurave dhe qasjeve ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë me vendet e BE-së. Ndërsa, pyetja kërkimore për këtë objektivi ishte: *A kanë ngjashmëri politikatat, procedurat dhe qasjet ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë me vendet e BE-së?*

Objektivi i dytë i studimit ishte të analizohen dhe të përshkruhen ngjashmëritë dhe dallimet e perceptimeve ndërmjet përfaqësuesve të shkollave dhe bartësve të tjerë që kanë rol në procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, lidhur me informimin, përgatitjet, praktikatat dhe efektet e para të zbatimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe nivelin e përkushtimit institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Pyetjet kërkimore për këtë objektivi ishin: *Si e perceptojnë subjektet e shkollës përvojën e parë të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës? Çfarë është niveli i përkushtimit institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë?* Ndërsa nënpyetjet kërkimore ishin:

- Cilat janë karakteristikat e subjekteve të përfshira në procesin e VBSH-së, në bazë të rolit të tyre në këtë proces?
- Çfarë janë këndvështrimet e përfaqësuesve të shkollave të përfshirë në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës? Me fokus për informimin dhe përgatitjen e shkollës në realizimin e VBSH-së, praktikën e udhëhequr nga shkolla për realizim, materialet dhe mbështetjen profesionale në realizimin e VBSH-së, efektet e para dhe përmirësimin e cilësisë së procesit të VBSH-së.
- A ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve për koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së, me rolin e tyre në këtë proces?
- A ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të stafit të shkollës për

koordinimin dhe udhëheqjen e VBSH-së në raport me përfshirjen e tyre në programet e trajnimit të lidhura me fushën e studimit?

- A ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të personelit udhëheqës dhe koordinues sipas tipave të shkollës (SHFMU, Gjimnaz) për mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së?
- A ka ndërlidhje ndërmjet rolit të personelit të shkollës të përfshirë në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës dhe nivelit të qëndrimeve të tyre për efektet e para të këtij procesi?
- A ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të inspektorëve të arsimit dhe KC në DKA lidhur me interesimin dhe përkushtimin institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë?

Objektivi i tretë i studimit ishte të përshkruhet niveli i përmbushjes së kriterëve e procedurave të vlerësimit të performancës së shkollës në raportet e vlerësimit të brendshëm të shkollave të përfshira në mostrën e studimit. Pyetjet kërkimore për këtë objektivi ishin: *Sa janë përmbushur hapat kryesorë për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës nga shkollat e përfshira në këtë proces? Çka tregojnë raportet e vlerësimit të brendshëm të shkollës për përvojat e para të vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë – respektimi i kërkesave dhe procedurave të vlerësimit, mësimet e nxjerra dhe sfidat gjatë realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës?*

5.1. Mbi sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë - krahasuar me vendet e Evropës

A kanë ngjashmëri politikatat, procedurat dhe qasjet ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë me vendet e BE-së?

Kjo pyetje kërkimore e orientoi punën e hulumtuesve për të shqyrtuar raportet dhe dokumentet lidhur me vlerësimin e performancës së shkollës. Interesi kryesor ishte që të mësohej më shumë për zhvillimet në politikatat, procedurat dhe praktikatat për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar në vende të Bashkimit Evropian, me fokus të veçantë në sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës.

Sipas studimit komparativ të BE-së (European Commission, 2015b), vlerësimi i performancës së shkollës është një përvojë relativisht e re dhe ka filluar me një sistem të organizuar në fillim të këtij shekulli. Pjesa më e madhe e shteteve të BE-së kanë hartuar dokumente rregullative për sigurim të cilësisë, kanë ndërtuar mekanizmat për mbështetje të shkollave në realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe janë në fazë të konsolidimit të këtyre mekanizmave në funksion të përmirësimit të performancës së shkollës. Në Kosovë, dokumentet kryesore për rregullimin e sistemit për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar janë zhvilluar në tri vitet e fundit dhe janë në

harmoni të plotë me tetë parimet e BE-së për cilësinë.

Sikurse në vendet e Evropës, edhe në Kosovë janë përcaktuar fushat e cilësisë së shkollës si objekt vlerësimi, kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës. Gjatë analizës kemi konstatuar se sistemi i vlerësimit të performancës, kundrejt sistemeve shkollore në vendet e BE-së, ka dallime të vogla në emërtimin e fushave të cilësisë, numrin e fushave dhe të kriterëve të cilësisë. Vëmendja e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në fushat e caktuara dallon nga vendi në vend. Kjo përçohet edhe në sistemin e Kosovës, ku fushë prioritare për sigurimin të cilësisë së shkollë është Performanca e nxënësve.

Raportet mbi vlerësimin e performancës së shkollës në vendet e Evropës, të publikuara në Eurydice (European Commission, 2015b), përshkruajnë profilin e sistemeve për sigurim të cilësisë në nivel vendi (për secilin shtet që mbulohet me raport), si dhe krahasojnë qasjet, strukturat dhe rolin e sistemeve për vlerësim të jashtëm dhe të brendshëm të shkollave. Analiza dhe krahasimi i këtyre raporteve, me sistemin e vlerësimit të performancës së Kosovës, tregon pothuajse në të gjitha vendet e Evropës (në 27 sisteme arsimore), edhe në Kosovë, se vlerësimi i brendshëm i shkollës obligohet/rekomandohet nga niveli qendror. Gjithsesi, politikat për zbatimin e tij dallojnë mjaft në shumicën e vendeve ku shkollat kanë autonomi të caktuar sa i përket realizimit të VBSH-së.

Ngjashëm me përvojën e vendeve tjera evropiane, bartës kryesor i vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës edhe te ne është Inspektorati i Arsimit, krahas rolit të caktuar që kanë edhe autoritetet e tjera të nivelit qendror (MASHT), autoritetet e nivelit lokal, si dhe vetë shkollat. Kriteret e përzgjedhjes së vlerësuesve të jashtëm në Kosovë, respektivisht kërkesat sa i përket kualifikimit të tyre, janë në linjë me përvojat e mira të vendeve tjera në Evropë. Rekomandimet e fundit në raportet e publikuara nga Eurydice theksojnë nevojën për koherencë dhe sinergji më të lartë ndërmjet proceseve dhe mekanizmave të ndryshëm për sigurim të cilësisë, me theks të veçantë në ndërveprim sa më efektiv ndërmjet elementeve të sistemeve të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm (European Commission, 2015b).

Prirja aktuale në vendet e BE-së është rritja e autonomisë së shkollës, në mënyrë që ajo t'u përgjigjet më mirë kontekstit lokal dhe nevojave individuale të nxënësve të saj. Në këtë frymë, mekanizmat për sigurim të brendshëm të cilësisë mbështesin vendimmarrjen e bazuar në fakte për llogaridhënie të brendshme dhe zhvillim të shkollës. Sa i përket funksionit të vlerësimit të performancës së shkollës, tendenca është që të arrihet një balancë ndërmjet funksionit llogaridhënës dhe zhvillimor. Shumë vende theksojnë rëndësinë e kalimit nga qasja ndaj sigurimit të cilësisë, si formë “kontrolli”, drejt qasjes së “bazuar në besim” (European Commission, 2015a). Qasjen zhvillimore mëton ta promovojë edhe sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë. Tani nevojitet zotim dhe përkushtim i lartë i të gjitha palëve për vënien e tyre në zbatim dhe shfrytëzimin e proceseve të vlerësimit të performancës së shkollës për përmirësim dhe avancim të vazhdueshëm të cilësisë së shkollave, si dhe për rritje të nivelit të llogaridhënies dhe përgjegjësisë.

5.2. Mbi përvojat e shkollave në realizimin e vlerësimit të performancës së shkollës

Pyetja kërkimore: *Si e perceptojnë subjektet e shkollës përvojën e parë të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës?*, e orientoi punën e hulumtuesve në përgatitjen e nënpyetjeve kërkimore dhe instrumenteve të hulumtimit në shkolla dhe në analizën e thelluar të pikëpamjeve të komunitetit të shkollës të përfshirë në studim për rolin dhe përfshirjen e tyre në procesin e VBSH-së, informimin dhe përgatitjen e shkollës në realizimin e VBSH, praktikën e udhëhequr nga shkolla në realizimin e VBSH, materialet dhe mbështetjen profesionale të ofruar për realizimin e VBSH, efektet e para të VBSH-së, si dhe pikëpamjet për përmirësimin e cilësisë së procesit të VBSH-së.

Rolet e stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve të përfshirë në VBSH. Pjesëmarrja është një nga parimet kryesore të vlerësimit të brendshëm të shkollës, sipas të cilit të gjithë kanë të drejtë dhe detyrë, sipas përgjegjësive personale dhe profesionale, të marrin pjesë në krijimin e një pasqyre të saktë për gjendjen dhe prirjet zhvillimore të shkollës. Njëkohësisht, të gjithë do të jenë pjesë e planifikimit dhe e zbatimit të masave përmirësuese në shkollë, në pajtim me gjetjet e vetëvlerësimit (IPK, 2016b).

Për të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në studim, analizuam rolin e tyre në shkollë dhe ndërlidhjen me përfshirjen e tyre në procesin e VBSH-së, në bazë të grupit të interesit që ata kanë përfaqësuar, përfshirë stafin e shkollës, nxënësit dhe prindërit. Të dhënat nga rezultatet e analizave përshkruese treguan se në VBSH kemi një përfshirje relativisht të mirë të përfaqësimit në bazë të roleve që kanë në shkollë, si të stafit të shkollës, ashtu edhe të prindërve dhe nxënësve. Në bazë të deklaramit të respondentëve për rolin e tyre në procesin e VBSH-së, mund të përfundojmë se parimi i pjesëmarrjes është plotësuar në masë të kënaqshme.

Analiza e përgjigjeve të dhëna në pyetësor nga stafi i shkollës tregoi se respondentët e studimit kishin role të ndryshme në procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës. Përfshirë drejtorë shkollë, zv.drejtorë, përfaqësues të shërbimit profesional në shkollë, koordinatorë të cilësisë në shkollë, udhëheqës të aktiveve profesionale, anëtarë të ekipit për vetëvlerësim të performancës së shkollës, mësimdhënës të përfshirë në mostrën e shkollës për ofrimin e të dhënave për VBSH dhe të angazhuar në përkrahje të ekipit të shkollës për vlerësim të brendshëm, si dhe mësimdhënës të përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së, pa ndonjë rol tjetër të veçantë.

Edhe prindërit dhe nxënësit e përfshirë në procesin e VBSH-së përfaqësojnë mekanizmat e tyre në shkollë, si Këshillin e Prindërve dhe Këshillin e Nxënësve. Sa i përket përfshirjes së nxënësve, të cilët ishin subjekti bazë për përfshirjen edhe të mësimdhënësve dhe prindërve, shumica e shkollave në procesin e VBSH-së i kanë përfshirë nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm (5) dhe shumë mirë (4). Këtë e pasqyrojnë të dhënat demografike të nxënësve që ishin pjesë e studimit tonë, ku rreth 83% e tyre thonë se kanë sukses të shkëlqyeshëm dhe 13% thonë se kanë sukses të shumë mirë. Kjo qasje nuk siguron parimin e gjithëpërfshirjes, kur kemi parasysh grupet e marginalizuara të nxënësve, nevojat dhe kërkesat e tyre.

Përfshirja e komunitetit të shkollës në ofrimin e të dhënave dhe dëshmive për procesin

e **VBSH-së**. Saktësia është një parim tjetër i vlerësimit të brendshëm të shkollës, sipas të cilit të dhënat dhe dëshmitë e mbledhura do të jenë të sakta, të matshme dhe të dokumentuara në mënyrë të qartë për të gjitha palët e interesuara në procesin e vlerësimit (të brendshëm dhe të jashtëm) të performancës së shkollës (IPK,2016b). Bazuar në këtë parim, për të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në studim, kemi analizuar format e përfshirjes së tyre në ofrimin e të dhënave dhe dëshmimeve për procesin e VBSH-së.

Rezultatet e analizave përshkruese tregojnë se respondentët e përfshirë në këtë studim janë përfshirë në forma të ndryshme në ofrimin e të dhënave dhe dëshmimeve për procesin e VBSH-së, si në plotësimin e pyetësorit të anketës, intervista, takime në fokus grupe dhe formave të tjera të përfshirjes. Sikurse stafi i shkollës (mbi 56%), ashtu edhe prindërit (rreth 50%) dhe nxënësit (mbi 73%), në përqindje më të madhe janë përfshirë në ofrimin e të dhënave dhe dëshmimeve me anë të pyetësorit të anketës.

Deklarimet e stafit të shkollës flasin për një përqindje relativisht të vogël të përfshirjes në ofrimin e të dhënave dhe dëshmimeve, përmes pjesëmarrjes në diskutim me fokus grupe, vëzhgimeve në orë mësimore apo në aktivitete të tjera të proceseve mësimore. Pa minimizuar rëndësinë e instrumenteve (si. p.sh. pyetësorit të anketës) dhe relevancën për mbledhjen e të dhënave, ato nuk mund ta zëvendësojnë diskutimet me fokus grupe për tregues të shumtë të performancës, vëzhgimin, gjegjësisht protokolin e vëzhgimit, sidomos për vlerësimin e performancës në fushat e cilësisë: Mësimdhënia dhe të nxënit, Kultura dhe mjedisi shkollor dhe Performanca e nxënësve.

Informimi dhe përgatitja e institucioneve arsimore për realizimin e VBSH-së. Transparenca është një parim tjetër i vlerësimit të brendshëm të shkollës, sipas të cilit të gjithë anëtarët e personelit, nxënësit dhe prindërit do të jenë të informuar hollësisht për procedurën e vlerësimit të brendshëm dhe do të jenë pjesë aktive e implementimit të tij (IPK,2016b). Rezultatet e analizave përshkruese tregojnë se shumica e shkollave kanë organizuar takime informative me të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e vetëvlerësimit. Rezultatet tregojnë se si stafi i shkollës, ashtu edhe prindërit dhe nxënësit në masë të madhe pajtohen se shkolla ka organizuar takime informuese për procesin VBSH-së: Stafi i shkollës 90%, nxënësit 68,1%, prindërit 81,0%. Po ashtu, rezultatet tregojnë se anëtarët e personelit, nxënësit dhe prindërit, janë të informuar në masë të madhe me formimin e EVV-së dhe me detyrat e ekipit (stafi i shkollës 85,5%, prindërit 84,5% dhe nxënësit 71,2%).

Në mesin e stafit të shkollës, që janë shprehur neutralë apo se nuk janë të informuar me formimin e EVV-së, del të jenë mësimdhënësit e përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit të brendshëm të shkollës 46,5% dhe udhëheqësit e aktiveve profesionale 34,9%. Gjithashtu edhe informimin me detyrat e EVV-së, në mesin e stafit të shkollës që janë treguar se janë neutralë apo se nuk janë të informuar, shprehen të jenë mësimdhënësit e përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit të brendshëm të shkollës 50%, udhëheqësit e aktiveve profesionale 25%, anëtarët e EVV-së 16,7%, mësimdhënësit e angazhuar në përkrahje të EVV-së 12,5%, si dhe shërbimi profesional në shkollë 4,2%.

Koordinimi dhe udhëheqja e procesit të VBSH-së. Në bazë të dokumenteve në zbatim, të miratuara nga MASHT-i, koordinimi dhe udhëheqja e procesit të vetëvlerësimit

të shkollës bëhet nga koordinatori i cilësisë së shkollës dhe EVV-së. I gjithë procesi duhet të jetë i organizuar në atë mënyrë që të sigurojë një pasqyrë reale e të paanshme të gjendjes lidhur me performancën e shkollës në tërësi dhe të faktorëve individualë, në veçanti. Të dhënat e hulumtimit tregojnë se shumica e pjesëmarrësve në hulumtim del të jenë të kënaqur me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së. Më të pakënaqurit me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të vetëvlerësimit të shkollës shprehen të jenë nxënësit me 15,12% dhe prindërit me 12,61%. Gjithashtu, të dhënat tregojnë se rreth 25 % e nxënësve dhe mbi 15% e prindërve, shprehen të jenë neutral rreth nivelit të kënaqësisë së tyre me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së.

Ka dallime në nivelin e qëndrimeve të stafit të shkollës, prindërve dhe nxënësve për koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së, por ato nuk janë të theksuara shumë sa i përket rolit të tyre në procesin e VBSH-së. Në mesin e personelit të shkollës, mësimdhënësit e përfshirë në mostër të studimit dhe të angazhuar në përkrahje të EVV-së, si vetë EVV-së, shprehin neutralitet dhe pakënaqësi, sa i përket përkrahjes së EVV-së nga drejtorët e shkollave. Dominon shkalla e të qenit neutral, mbi 90% sa i përket përkrahjes nga drejtorët e shkollave. Pastaj, prindërit e përfshirë vetëm në mostrën e VBSH-së (mbi 17%) dhe prindërit në cilësinë e kryetarëve të prindërve të klasës (mbi 13%) janë më të pakënaqurit në mesin e gjithë prindërve për koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së. Ndërsa, në mesin e nxënësve, sipas roleve të tyre, del se anëtarët e Këshillit të nxënësve në nivel shkolle (rreth 24%) dhe kryetarët e klasave (rreth 19%) janë nxënësit më të pakënaqur me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së.

Dallimet në nivelin e qëndrimeve të stafit të shkollës për koordinimin dhe udhëheqjen e VBSH-së me përfshirjen e tyre në programet e trajnimit të lidhura me fushën e studimit, janë minimale. Përqindja më e madhe e stafit të shkollës që kanë shkallë të ulët të kënaqësisë me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së, janë nga radhët e personelit që kanë vijuar programin e trajnimit për udhëheqje dhe menaxhim të shkollës, rreth 3% e tyre shprehin këtë qëndrim. Koordinimi dhe udhëheqja e procesit të VBSH/vetëvlerësimit të shkollës, reflekton një pjesë të organizimit, menaxhimit dhe udhëheqjeve të proceseve që zhvillohen në shkollë. Fullan, M. (2010), shprehet se performanca e organizatës suaj bëhet e dukshme përmes veprimtarive që i ndërmerr, për ta përmbushur misionin e saj. Procesi i VBSH-së ka një mision në vete që duhet të përmbushet nga udhëheqja e shkollës, proces i cili duhet të ketë përkrahje nga drejtori i shkollës, në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë reale dhe e paanshme e gjendjes në shkollë. Diskutimet me koordinatore të cilësisë dhe anëtarë të EVV-së, tregojnë se një pjesë e drejtorëve të shkollave nuk i kanë përmbushur në nivel të duhur kërkesat e udhëheqjes së këtij procesi.

Zbatimi i hapave kryesorë të procesit të VBSH-së. Një tjetër element i rëndësishëm i hulumtuar në kuadër të këtij studimi ishte zbatimi i hapave kryesorë të procesit të VBSH-së, të cilët përbëjnë një zinxhir të veprimeve që shpijnë në konstatimin e gjendjes në nivel të treguesve të performancës, kritereve dhe fushave të cilësisë së shkollës dhe në orientimet për përmirësim dhe avancim të punës së shkollës. Në përgjithësi, personeli i shkollës, nxënësit dhe prindërit, shprehen të kënaqur me zbatimin e hapave

kryesorë të VBSH-së, ndonëse ka një përqindje relativisht të lartë që janë neutralë dhe të pakënaqur, sidomos në mesin e nxënësve dhe prindërve. Duket se më shumë i referohen anës procedurale të zbatimit të hapave në VBSH sesa cilësisë së tyre, siç reflektohet në pyetjet e hapura, ku në disa prej tyre shpërfaqen edhe mospajtime rreth besueshmërisë së të dhënave dhe vlerësimit të gjendjes së shkollës në kritere dhe fusha të ndryshme të cilësisë. Në zbatimin e hapave të VBSH-së është me rëndësi, siç thotë Elmore, R. (2011), të dish gjënë e duhur që duhet bërë, në mënyrë që ky proces të pasqyrojë gjendjen reale në shkollë dhe të nxitë veprime, të cilat ndikojnë që të përmirësohet cilësia e punës së shkollës.

Materialet, trajnimi dhe mbështetja e ofruar në realizimin e procesit të VBSH-së. Pjesëmarrësit në studim rikujtuan rëndësinë e referimit në dokumentet e VPSH-së, rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve dhe ofrimit të formave tjera të mbështetjes për procesin e VBSH-së. Në përgjithësi, perceptimet e stafit të shkollës, të përfshirë në këtë pjesë të studimit, tregojnë pajtueshmëri të lartë lidhur me dokumentet për VBSH dhe mbështetjen e ofruar në procesin e VBSH-së. Vlen të theksohet se mbi 18% e anëtarëve të EVV-së, në bazë të deklarimeve të tyre, nuk kanë marrë informata të mjaftueshme nga drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë të përfshirë në trajnime dhe punëtoritë për VBSH, lidhur me realizimin e procesit të VBSH-së dhe përmirësimet e nevojshme pas marrjes së informatave kthyesë nga analiza e drafteve të para të raporteve të VBSH-së.

Ka dallime në nivelin e qëndrimeve të personelit udhëheqës dhe koordinues të procesit të VBSH-së për mbështetjen e ofruar në këtë proces, por ato nuk janë të theksuara shumë sa u përket tipave të shkollës (SHFMU, Gjimnaz). Përqindja më e lartë e personelit të shkollës që nuk pajtohen me mbështetjen e ofruar për procesin e VBSH-së janë nga gjimnazet. Këtë e shprehin rreth 9% e personelit nga gjimnazet, kundrejt rreth 4% të SHFMU-së. Ndërsa në përqindje më të lartë të personelit që kanë qëndrim neutral ndaj mbështetjes janë nga radhët e SHFMU-ve, rreth 45% e stafit, kundrejt 38% të stafit nga gjimnazet, që shprehin qëndrim neutral ndaj mbështetjes së ofruar për procesin e VBSH-së. Përqindja tjetër e të dy tipave të shkollave shprehin shkallë të lartë të pajtueshmërisë me mbështetjen e ofruar për procesin e VBSH-së. Pavarësisht kësaj, mbështetja e shkollave në këtë proces duket të jetë një kërkesë që duhet sforcuar në mënyrë që të sigurohet cilësia e procesit të VBSH-së.

Mungesa e mbështetjes nga DKA-të theksohet më shumë, sidomos mbështetja me zyrtarizim të pozitave të koordinatorëve të cilësisë në shkolla dhe mbështetja me mjete financiare që lidhet me ndërmarrjen e masave për përmirësimin e performancës në kriteret/ fushat e cilësisë dhe që kanë kërkesa të buxhetit. Situata e paqartësive me koordinatorë të cilësisë në shkolla ka nxitur debate, të cilat kanë marrë kohë në këtë proces dhe ka ndikuar tek disa mësimdhënës në humbjen e seriozitetit në këtë proces shprehin një pjesë e madhe e drejtorëve të shkollave. Shqetësimi për mungesë të përkrahjes nga DKA, në masë më të madhe është ngritur nga drejtorët e shkollave (rreth 33% e drejtorëve të shkollave) dhe koordinatorët e cilësisë (rreth 34% e KC). Sipas detyrave dhe përgjegjësisve të bartësve të sistemit të VPSH-së, DKA-të kanë rol mbështetës si për vlerësimin e brendshëm ashtu edhe për vlerësimin e jashtëm

të performancës së shkollës. Përmbushja e këtij roli siguron edhe përparësi për vetë DKA-të në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes për ndërmarrjen e masave në përmirësimin e cilësisë së arsimit në nivel komune.

Fokusi në ngritjen e kapaciteteve të EVV-së dhe mbështetja nga udhëheqja e shkollës ishte një aspekt tjetër i theksuar në reflektimet e pjesëmarrësve në pyetjet e hapura për mbështetjen në realizimin e procesit të VBSH-së. Perceptim i stafit të shkollës është se anëtarët e EVV-së do të jenë të efektshëm atëherë kur të jenë të gjithë të trajnuar, kur ndihmohen nga udhëheqja e shkollës dhe përkrahen nga personeli mësimdhënës, të cilët kanë rol të veçantë në këtë proces. Është përgjegjësi e mekanizmave për sigurim të cilësisë, të cilët dëshirojnë që ndryshimi në shkollë të këtë pikënisje rezultatet e vetëvlerësimit dhe procesi të jetë i efektshëm për shkollën dhe sistemin, të mbështesin zhvillimin e kapaciteteve të EVV dhe të ofrojnë alternativa të tjera mbështetëse, në bazë të nevojave dhe kërkesave të shkollave.

Efektet e para të procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës. Në bazë të perceptimeve të personelit të shkollës, mund të nxirret përfundimi se tashmë në shkollat e përfshira në programin për VBSH shihen efektet pozitive të këtij procesi, i cili ka ndikuar në rritjen cilësore të bashkëpunimit në nivel shkolle, nxitjen dhe motivimin individual të stafit të shkollës për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë, si dhe mobilizimin e mekanizmave në nivel të shkollës për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme për ngritjen e cilësisë në shkollë.

Efekt tjetër i reflektuar në perceptimet e stafit të shkollës ishte nxjerrja në pah e sfidave dhe problemeve që i kanë shkollat karshi proceseve të reja dhe ndryshimeve. Detyrë dhe përgjegjësi e shkollës është që ta ruajë frymën pozitive të këtij procesi, duke ndërmarrë veprime që funksionalizojnë të gjithë mekanizmat e shkollës (organet qeverisëse dhe profesionale), që t'i mundësojnë secilit anëtar të stafit të shkollës të jetë i përfshirë dhe të japë kontributin në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së shkollës, si dhe t'i trajtojë me kujdes të shtuar problemet e identifikuara.

Rezultatet përshkruese të këtij studimi tregojnë se ka ndërlidhje midis rolit të personelit të shkollës të përfshirë në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës dhe nivelit të qëndrimeve të tyre për efektet e vetë procesit. Drejtorët e shkollës, koordinatorët e cilësisë në shkollë dhe anëtarët e ekipit të shkollës për vetëvlerësim, shprehen në përqindje më të lartë se VBSH ka pasur ndikim në motivimin e tyre për kontribut të shtuar në proceset e brendshme për ngritjen e cilësisë në shkollë. Këtë e shprehin mbi 94% e drejtorëve, mbi 61% e anëtareve të EVV-së dhe rreth 90% e koordinatorëve të cilësisë në shkollë. Ndërsa zv.drejtorët e shkollave dhe pedagogët e psikologët e përfshirë në studim shprehen në përqindje më të madhe se efektet e VBSH-së janë reflektuar në mobilizimin e mekanizmave në nivel shkolle për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë.

Qasja pozitive e menaxhmentit të shkollës ndaj përkrahjes së individëve dhe mekanizmave të shkollës për të dhënë kontribut në proceset e brendshme në shkollë e përmirëson cilësinë e procesit të VBSH-së dhe nxit veprime për përmirësim të

vazhdueshëm të punës së shkollës.

Sfidat e shkollës karshi procesit të vlerësimit të performancës së shkollës. Pa minimizuar mësimet e mira dhe efektet e para të procesit të VBSH-së, pjesëmarrësit në studim paraqitën edhe sfidat, me të cilat janë ballafaquar gjatë përvojës së parë të vetëvlerësimit. Kishte pak raste që nuk i kanë përshkruar sfidat, me të cilat shkollat janë përballur në procesin e VBSH-së.

Duket se ndër aspektet më sfiduese ishin: vendosja e KC sipas kritereve të përcaktuara nga MASHT-i, rezistenca e një numri të mësimdhënësve për përfshirje në procesin e VBSH-së, mungesa e përkrahjes së nevojshme dhe e motivimit, interesimi jo i mjaftueshëm i prindërve, koha e limituar për realizimin e aktiviteteve në kuadër të procesit të VBSH-së, hartimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, hezitimi i nxënësve për të vlerësuar punën e mësimdhënësve, objektiviteti në vlerësim – pasqyrimi real i gjendjes në shkollë, shkrimi i raportit të VBSH-së etj.

Sfidë më vete për vlerësimin e brendshëm del të jetë sigurimi i informacionit të kujdesshëm dhe kuptimplotë për arritjet e nxënësit, shqyrtimi i tij kritik gjatë vlerësimeve dhe gjyqimeve për efikasitetin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënës të shkollës, bazuar në informacion të plotë dhe domethënës (Pasku, 2014).

Nëse nisemi nga fakti se VBSH-ja duhet të realizohet çdo vit, është përgjegjësi dhe mundësi e mirë e udhëheqjes së shkollës dhe e mekanizmave të tjerë në shkollë që të mësojnë nga kjo përvojë dhe për proceset e ardhshme të adresojë sfidat e shpërfaqura, duke iu qasur atyre me kujdes, informim, planifikim, organizim dhe ndërmarrje të veprimeve për përmirësimin e cilësisë së vetëvlerësimit.

Përmirësimi i cilësisë së procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës. Fokusi i përmirësimit të organizimit të procesit të vetëvlerësimit është një aspekt tjetër i theksuar nga pjesëmarrësit e përfshirë në studim. Procesi i vetëvlerësimit kërkon organizim të veçantë, për të siguruar që ekipi i shkollës përqendrohet në çështjet e duhura, që t'i shfrytëzojë burimet në mënyrë më të efektshme gjatë tërë procesit dhe t'i përdorë instrumentet gjegjëse për mbledhjen dhe analizën e informacionit (Lusthaus, Ch., Adrien, M.-H., Anderson, G. & Carden F, 2005). Ndër çështjet më të frekuentuara të ngritura nga pjesëmarrësit në studim si nevojë për rritjen e cilësisë së VBSH-së përmenden: trajnimet, mbështetja gjatë procesit, sidomos gjatë zhvillimit të instrumenteve dhe analizës së të dhënave, shtimi i bashkëpunimit cilësor në mes të gjithë aktorëve të shkollës, stimulimi i ekipeve për vlerësim, përfshirja e të gjithë mësimdhënësve në trajnimet për vetëvlerësim, si dhe mbështetja nga ana e DKA-së gjatë procesit të vlerësimit.

Gjithashtu, kishte kërkesa për llogaridhënie dhe përgjegjësi profesionale të mësuesve dhe të tjerëve gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm. Për ta përmirësuar cilësinë e praktikës së vetëvlerësimit, duhet ndjekur sugjerimin e dhënë nga OFSTED & DfES (2006), sipas të cilit vetëvlerësimi duhet të bëhet pjesë integrale e kulturës së punës së shkollës dhe jo thjesht një ushtrim në letër e plotësuar për qëllime burokratike (sipas Çobaj, T. 2016).

5.3. Mbi përkushtimin e institucioneve në zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës

Në lidhje me këtë çështje të studimit, është ngritur pyetja kërkimore: *Çfarë është niveli i përkushtimit institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë?*

Bazuar në analizën e përmbajtjes, nxorëm rezultate të rëndësishme për diskutim. Një nga aspektet më të diskutuara me inspektorët e arsimit dhe koordinatorët e cilësisë në DKA ishte përfshirja dhe përmbushja e rolit të tyre edhe e bartësve tjerë të sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës. Inspektorati i Arsimit në këtë proces ka rol në vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës, ndërsa DKA-ja, gjegjësisht koordinatorët e cilësisë në DKA, kanë rol mbështetës për shkollat dhe Inspektoratin e Arsimit. Të gjithë pjesëmarrësit në studim që vijnë nga SIA dhe DKA kanë përvoja të ndryshme në këtë fushë. Përvojat e tyre lidhen me tri aspekte, me përfshirje në diskutime gjatë zhvillimit të dokumenteve, me përfshirje në trajnime në këtë fushë, fasilitim e disa punëtorive për VBSH, si dhe me fillimin e zbatimit në praktikë të sistemit të VPSH-së. Reflektimet e të intervistuarve flasin për përfshirje në diskutim të dokumenteve dhe në trajnimet, si përvoja të mira, që u mundësuan të njohin më mirë dhe të familjarizohen më shumë me procesin e VPSH-së.

Perceptimi i inspektorëve të arsimit dhe KC në DKA për qasjen që duhet të tregojnë institucionet arsimore (niveli qendror dhe lokal) në mbështetje të shkollave për realizimin e procesit të vlerësimit të performancës së shkollës përfshinë attribute që i referohen lidhjes midis zhvillimit të dokumenteve dhe zbatimit të tyre në praktikë, si: zbatimi cilësor i UA për sigurim të cilësisë dhe VPSH, funksionalizimin e KC në nivelin qendror, në DKA dhe në secilën shkollë, zbatim të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për aspektet që lidhen me sigurimin e cilësisë në institucione arsimore. Po ashtu, mbështetje direkte për shkollat në koordinimin e agjendave për realizimin e vlerësimit të performancës së shkollës dhe zbatimin e plotës të ciklit për sigurimin e cilësisë në shkollë, ndarje të buxhetit shtesë për zbatim të prioriteteve që sigurojnë cilësinë në arsim, trajnime dhe punëtori shtesë për procesin e VPSH-së. Vetëm duke bërë lidhjen midis zhvillimit të dokumenteve dhe krijimit e fuqizimit të mekanizmave për mbështetje në zbatimin të tyre në praktikë mund të ndryshohen realitetet shkollore, përfshirë edhe sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës.

Përkushtimi institucional i Inspektoratit të Arsimit dhe DKA-ve në zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës mund të reflektohet edhe në planet sektoriale për përmbushjen e rolit të tyre në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës. Brenda kontekstit të planeve të sektorëve të arsimit nga niveli qendror deri tek planet e njëjësive që kanë rol në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës duket të këtë një lidhje në referim të planeve strategjike për arsim dhe dallime në mënyrën e përmbushjes së rolit të tyre në këtë proces. Planet e DKA-ve, sa i përket përfshirjes së shkollave në vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës, janë mjaft ambicioze, në anën tjetër vetë KC në DKA shprehen se planet dhe procesi i VPSH-së mund të sfidohen nëse nuk zbatohet UA për vendosjen e koordinatorëve të

cilësisë në nivel qendror, në nivel komunal dhe në nivel të secilës shkollës, si dhe mund të sfidohen edhe për mungesë të kapaciteteve në DKA dhe për mungesë të mjeteve të nevojshme financiare.

Marrë në përgjithësi inspektorët e arsimit dhe koordinatorët e cilësisë në DKA nuk janë të kënaqur me praktikën aktuale, interesimin dhe përkushtimin e MASHT-it për zbatimin e politikave arsimore për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë, me interesimin dhe përkushtimin e DKA-ve për rregullimin e pozitës së koordinatorëve të cilësisë në shkolla, si dhe për përkrahjen e shkollave në realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe në zbatimin e ciklit për sigurim të cilësisë në shkollë.

Në nivelin komunal, kjo qasje në disa komuna reflektohet nga mungesa e gatishmërisë për të punuar ngushtë me shkollat, ndërkohë nëse nuk ka mbështetje të drejtpërdrejtë në shkolla për aktivitetet e sigurimit të cilësisë, nuk do të fuqizohet qasja zhvillimore e procesit të vlerësimit të performancës së shkollës dhe, me këtë, vetëvlerësimi rrezikon të mos bëhet pjesë integrale e kulturës së punës së shkollës.

Fillimi i vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës nga inspektorët e arsimit shihet si një masë për ta parë progresin e shkollës. Megjithatë, kapacitetet ekzistuese të Inspektoratit të Arsimit në SIA nuk mund të sigurojnë mbulueshmërinë e shkollave në rajonet përkatëse dhe kjo rrezikon zbehjen e relacionit ndërmjet vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm. Është përgjegjësi e MASHT-it që të caktojë koordinatorin e cilësisë në nivel qendror - MASHT, i cili do të shërbejë si një pikë referimi për komunikim dhe koordinim për të gjitha DKA-të, Inspektoratin e Arsimit dhe shkollat, lidhur me sigurimin e cilësisë në përgjithësi dhe sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës në veçanti.

5.4. Mbi raportet e vetëvlerësimit të performancës së shkollës

Sa janë përmbushur hapat kryesorë për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës nga shkollat e përfshira në këtë proces? Kjo pyetje kërkimore e udhëhoqi punën e hulumtuesve për të analizuar në mënyrë kritike raportet e vetëvlerësimit të shkollave të përfshira në mostër të studimit dhe për të përshkruar nivelin e përmbushjes së kriterëve e procedurave të vlerësimit të performancës së shkollës, mësimet e nxjerra dhe sfidat në realizimin e VBSH-së dhe në dokumentimin e këtij procesi me raportin e vetëvlerësimit.

Për të lehtësuar punën e EVV-së në realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës ato janë pajisur me udhëzuesin për vlerësim të brendshëm, në të cilin janë përshkruar në detaje hapat kryesorë të procesit të vlerësimit të brendshëm, duke filluar nga: 1. Faza përgatitore; 2. Identifikimi i burimeve të të dhënave dhe përzgjedhja e mostrës; 3. Përzgjedhja dhe përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave; 4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave; 5. Përshkrimi i gjendjes për tregues të performancës së shkollës dhe vlerësimi në nivel të kriterëve; 6. Vlerësimi në nivel të fushave të

cilësisë; 7. Vlerësimi i përgjithshëm dhe 8. Raporti narrativ – raporti përmbledhës. Mbi këtë bazë janë analizuar edhe raportet e vetëvlerësimit dhe informacionet e tjera të siguruara nga shkollat për këtë proces.

Raportet e vetëvlerësimit dhe raportet e tjera të analizuar për procesin e VBSH-së, në shkollat e përfshira në këtë studim, tregojnë se në përgjithësi shkollat i kanë përmbushur kërkesat bazë për fazën përgatitore të realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës. Kjo përbën një tregues të rëndësishëm për fazat tjera të këtij procesi. Megjithatë, vendimet e pjesës më të madhe të shkollave për themelimin e EVV-së i karakterizon fakti se në këto vendime nuk janë përcaktuar disa dispozita që i mundësojnë EVV-së punë të papenguar, qasje në të gjitha burimet e mundshme të informacionit dhe që njëkohësisht e obligojnë gjithë personelin shkollor që të bashkëpunojë me EVV-në në këtë proces. Nëse marrim parasysh hezitimin e personelit të shkollës për të qenë pjesë e përkrahjes substanciale në reformat e viteve të fundit, mossaktësimi i këtyre dispozitave për punën e EVV-së mund të shtojë dilema të tjera që mund të dëmtojnë procesin e VBSH-së.

Në bazë të përshkrimeve në pjesën hyrëse të raporteve të vetëvlerësimit, e cila i referohet kontekstit të shkollës dhe procesit për mbledhjen e të dhënave, nuk duket se EVV-të janë mbështetur në tri pyetjet kryesore që e orientojnë punën e tyre në realizimin e procesit të vetëvlerësimit: Si po e bëjmë? Si mund ta dimë? Çfarë do të bëjmë tani? Këto pyetje orientuese ndihmojnë ekipet që në fazën përgatitore të merren në konsideratë konteksti dhe specifikat e shkollës për përgatitje të mëtejme në realizimin e procesit të vetëvlerësimit, treguesit e performancës së shkollës të vendosur në Kornizën për siguri të cilësisë së performancës së shkollës, për referim në vlerësimet për të gjitha nivelet e vlerësimit të performancës së shkollës, si dhe format e raportimit dhe e ndërmarrjes së veprimeve për përmirësim pas procesit të vetëvlerësimit²⁹.

Në raportet e vetëvlerësimit dhe në raportet e tjera të shkollave përshkruhet një hap tjetër i rëndësishëm në kuadër të procesit të VBSH-së, siç është identifikimi i burimeve të të dhënave dhe përzgjedhja e mostrës për VBSH. Analiza e dokumentacionit të dërguar nga shkollat tregon se EVV-të kanë shfrytëzuar dokumentacionin shkollor, por në përshkrimet e bëra për gjendjen në tregues të performancës së shkollës nuk vërehet mjaftueshëm shfrytëzimi i raporteve dhe analizave që lidhen me arritjet e nxënësve në vlerësimet e brendshme, vlerësimet kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

Raportet tregojnë për mungesë të dëshmimeve për përfshirjen e nxënësve me prirje të theksuara, me nevoja të veçanta, si dhe për nxënës me prejardhje të ndryshme familjare. Mungesa e burimeve adekuate të të dhënave dhe mungesa e përfaqësimit të komunitetit arsimor të shkollës bie ndesh me dy parimet bazë të procesit të vlerësimit të brendshëm, objektivitetin dhe saktësinë e të dhënave, gjetjeve.

²⁹ Në origjinal: How are we doing? How do we know? What are we going to do now? Më gjerësisht shih linkun: https://www.educationscotland.gov.uk/Images/HGIOS4August2016_tcm4-870533.pdf

Rrjedhimisht, kjo fazë kërkon kujdes të shtuar, kur kemi parasysh se shërben si orientim për përzgjedhjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, për përpilimin e pyetjeve për mbledhjen e të dhënave, si dhe për analizën e të dhënave të mbledhura.

Përzgjedhja e teknikave dhe instrumenteve adekuate për të mbledhur informacione ose dëshmi për qëllimet e VBSH-së, i ndihmon konsistencës, objektivitetit dhe saktësisë në procesin e mbledhjes së informacioneve. Kjo i kontribuon arritjes së konkluzioneve të besueshme dhe të vlefshme të vlerësimit në lidhje me aspektet relevante të punës së shkollës (IPK, udhëzuesi për VBSH, f. 14).

Raportet e VBSH-së tregojnë se numri i instrumenteve të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave është i pamjaftueshëm; vërehet tendencë për reduktimin e instrumenteve vetëm në pyetësorë. Por, edhe në një numër të madh të pyetësorëve pyetjet nuk janë relevante dhe të duhura për informatat që synohen të mblidhen.

Sfidat dhe problemet e identifikuara në përzgjedhjen dhe përgatitjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për VBSH kërkojnë vëmendje dhe kujdes të veçantë, kur kemi parasysh se kjo fazë ka ndikim të drejtpërdrejt në përshkrimin e gjendjes në treguesit e performancës së shkollës dhe vlerësimet, si në nivel të kriterëve të cilësisë, ashtu edhe në nivel të vlerësimit të fushave të cilësisë së shkollës dhe në nivele të përgjithshme të performancës së shkollës. Udhëzuesi për vlerësim të brendshëm është plotësuar me instruksione dhe formularë për identifikimin e instrumenteve dhe sistemimin e tyre.

Gjatë trajnimeve me shkollat e tjera, këtij aspekti dhe përgatitjes së instrumenteve duhet t'i kushtohet vëmendje edhe më e madhe. Gjithsesi është e domosdoshme edhe një qasje më serioze dhe më e përgjegjshme e vetë shkollave ndaj këtij procesi.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave është hapi tjetër në procesin e VBSH-së. Në pjesën më të madhe të raporteve të VBSH-së të analizuar gjejmë pak të dhëna për organizimin e mbledhjes së të dhënave, llojet e të dhënave të mbledhura dhe mënyrën e analizës së tyre. Ato shkolla që kanë përshkruar në raporte të VBSH-së procesin e mbledhjes së të dhënave tregojnë se dominojnë të dhënat e mbledhura me pyetësorë, kurse për analizë të të dhënave kryesisht është përdorur programi i kompjuterit Exel, përmes të cilit të dhënat janë nxjerrë në numër dhe përqindje. Në përgjithësi, raportet tregojnë se mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre përbën një sfidë më vete për EVV-në. Prandaj, duhet të bëhet kujdes në llojin e të dhënave të mbledhura dhe në metodat për analizën e të dhënave sasiore dhe cilësore.

Në rastin e vlerësimit të performancës së shkollës, të dhënat kërkohet të mblidhen dhe të analizohen për të dhënë përgjigje në pyetjet orientuese dhe për të përshkruar gjenden reale për treguesit përkatës të performancës së shkollës, gjithnjë duke u mbështetur në evidenca dhe duke pasur në mend kriteret e cilësisë, të cilët vlerësohen me një nga katër shkallët e cilësisë.

Përshkrimi i gjendjes për tregues të performancës së shkollës dhe vlerësimi në nivel të kriterëve të cilësisë është aspekti tjetër i analizuar thellësisht në raportet e VBSH-së. Analiza e raporteve të shkollave për këtë pjesë tregon se në pjesën më të madhe

konstatimi i gjendjes në raport me treguesit nuk i adreson të gjitha pyetjet orientuese të dhëna në udhëzuesin për vlerësim të brendshëm. Sikurse gjendja e përshkruar në treguesit e performancës së shkollës, ashtu edhe vlerësimi në nivel të kriterëve dominohet nga një vlerësim i lartë, përkatësisht me performancë të mirë për kritere të cilësisë, kundrejt mungesës së dëshmiëve për shumë tregues të performancës në raport me pritshmëritë e përcaktuara me kornizë të performancës së shkollës. Si i tillë, informacioni është i mangët për të vlerësuar performancën në nivel të kriterëve, duke pamundësuar edhe vlerësimin korrekt e të bazuar në nivelet tjera të vlerësimit.

Vlerësimi në nivel të fushave të cilësisë së shkollës, sipas përshkrimeve në raportet e VBSH-së të përfshira në studim, është sfiduar tek shkollat të cilat nuk i kanë përmbushur kërkesat për fazat paraprake të procesit të vlerësimit të brendshëm, përfshirë identifikimin dhe shfrytëzimin e burimeve relevante, zhvillimin e instrumenteve, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, përshkrimin e gjendjes në treguesit e performancës, me argumentim në dëshmi relevante etj. Sfidë më vete duket të jetë nxjerrja e konstatimeve për kritere të cilësisë, në ndërlidhje me gjendjen e evidentuar në raport me treguesit përkatës, por edhe nxjerrja e dobësive të brendshme të shkollës, në mënyrë të veçantë e atyre që pasqyrojnë cilësinë e proceseve mësimore.

Ka shkolla që nuk e kanë shfrytëzuar fare formularin standard të vlerësimit të brendshëm të shkollës, pjesën e formularit që lidhet me vlerësim të fushave të cilësisë. Vetëvlerësimi, si instrument i përmirësimit të shkollës, nuk lejon devijime të tilla, kërkon sistemim të informative në instrumentet gjegjëse për mbledhjen dhe analizën e informacionit, në mënyrë që ato të shqyrtohen edhe në vlerësimet e radhës dhe nga vlerësuesit e jashtëm të performancës së shkollës. Në menaxhimin e informatave nuk mjafton vetëm mbledhja e tyre me anë të kontrollit dhe matjes, por ato duhen klasifikuar dhe përpunuar në mënyrë sistematike, për të vërtetuar gjendjen reale të një institucioni arsimor (Zeneli, 2013).

Nxjerrja e konstatimeve përmbledhëse për secilën fushë të cilësisë dhe mbështetja e tyre në evidencat për vlerësimin në kriteret e cilësisë, identifikimi i dobësive të shkollës të lidhura drejtpërdrejt me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit, si dhe vendosja e rekomandimeve që orientojnë vetë shkollën të ndërmarrë masa për mirëmbajtjen dhe avancimin e përparësive dhe për përmirësimin e anëve të dobëta të identifikuar, duket të jenë sfida më vete për hartuesit e raporteve të vetëvlerësimit.

Edhe pse në raportet e disa shkollave vërehet një prirje për respektimin e kërkesave dhe instruksioneve, kërkohet përkrahje e mëtejme për përmirësimin e cilësisë së formulimit të përshkrimeve, duke diferencuar nivelet e përgjithësimin (nga vlerësimi i kriterëve deri te vlerësimi i përgjithshëm).

Krijimi i një kulture pune të shkollave ndër vite, në përgatitje të raporteve të punës së shkollës pa një thellim në problemet e cilësisë në shkollë, ka bërë që në raportet e disa shkollave akoma të dominojë përqendrimi në identifikimin e problemeve që nuk janë në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të shkollës, që më shumë janë faktorë ndikues të jashtëm dhe të nxirren rekomandime, të cilat u dedikohen institucioneve të tjera dhe jo vetë shkollës.

Marrë në përgjithësi, raportet përshkruhen pa një trajtim të thelluar të arritjeve të rezultateve të të nxëniet në lëndë dhe kompetenca të veçanta, si në shkathtësitë e leximit dhe shkrimit, shkathtësitë e komunikimit në gjuhë amtare dhe gjuhë të huaj, matematikë, shkenca, etj., por edhe mungesë të analizave për arritjet e nxënësve, krahasuar me vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në studimin PISA 2015 kanë qenë të përfshira 9 shkolla, nga 39 të përfshira në këtë studim për analizë të raporteve të VBSH-së. Edhe pse shkollat nuk i kanë marrë rezultatet e ndara sipas shkollave, ato i kanë rezultatet e nxënësve në nivel Kosovë dhe të krahasuara me vendet e tjera. Në raportet e VBSH-së nuk i gjejmë në referencë këto rezultate gjatë vlerësimit të kriterëve të cilësisë, veçanërisht atyre për fushat e cilësisë: Mësimdhënia dhe të nxëniet dhe Performanca e nxënësve.

Në raportet e shkollave ka pak dëshmi që pasqyrojnë praktikat e shkollave në vlerësimin e nxënësve, mënyrat se si bëhen analizat dhe përmbledhjet e arritjeve të nxënësve, monitorimi i arritjes së nxënësve me kalimin e kohës etj. Përdorimi vetëm i të dhënave statistikore për arritjet e nxënësve dhe shkollës, siç thonë Choi, K., Goldschmidt, P. & Yamashiro, K. (2006), pa një krahasim të rezultateve vit pas viti, jep vlerësime mashtruese të performancës së shkollës. Sfida e vlerësimit të brendshëm është sigurimi i një informacioni të kujdesshëm dhe kuptimplotë për arritjet e nxënësit, shqyrtimi kritik i tij gjatë vlerësimeve dhe gjykimeve për efikasitetin e procesit të mësimdhënies dhe të nxëniet të shkollës, bazuar në informacion të plotë dhe domethënës (Pasku, 2014).

Në raportet përmbledhëse të vetëvlerësimit nuk gjejmë orientime të mjaftueshme për fushat, për përmirësimet që kanë dalë si rezultat i gjetjeve nga procesi i VBSH-së dhe orientime për planet për përmirësim. Kjo qasje nuk e ndihmon avancimin drejt përmirësimit të cilësisë së proceseve të vetëvlerësimit në shkollat përkatëse dhe ndërmarrjen e veprimeve për përmirësim në fushat e identifikuara me probleme dhe nevoja për përmirësim të vazhdueshëm.

Vetëvlerësimi nuk e paraqet vetvetiu përfundimin, por është një proces diagnostifikimi dhe reflektimi, i cili duhet të nxisë mekanizmat për veprime. Për fat të keq, disa organizata ndalen para se të ndërmarrin veprime. Ato ndalen në momentin kur përfundon diagnostifikimi dhe dështojnë për të vepruar duke u mbështetur në rezultatet. Nëse keni nevojë të përdorni rezultatet e vetëvlerësimit tuaj për të bërë përmirësime, atëherë sigurohuni që rezultatet të mos harrohen, apo të injorohen (Lusthaus, Adrien, Anderson, & Carden, 2005).

KAPITULLI VI

KONKLUZIONE

Studimin e realizuam me qëllim të konstatimit të ndërlidhjes së sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë me përvojat e vendeve evropiane dhe me qëllim të evidentimit e vlerësimit të praktikave të vetëvlerësimit - mësimet, efektet dhe sfidat nga përvoja e parë e këtij procesi. Përmirësimi dhe avancimi i praktikave të vetëvlerësimit ishte synim kryesor i këtij studimi.

Nga studimi dolën në pah një numër i konsiderueshëm i gjetjeve, të cilat vlerësojmë se mund të shërbejnë për vendosjen e hapave dhe masave të mëtejshme që duhen ndërmarrë për zbatim të vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë.

Supozimi ynë se politikat, procedurat dhe qasja ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë janë në harmoni me ato në vendet e BE-së u vërtetua. Në Kosovë, dokumentet kryesore për rregullimin e sistemit për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar dhe sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës janë në harmoni të plotë me tetë parimet e BE-së. Tani nevojitet përkushtim më i lartë i të gjitha palëve për zbatimin e tyre dhe shfrytëzimin e proceseve të vlerësimit të brendshëm të shkollës për përmirësim dhe avancim të vazhdueshëm të cilësisë së shkollave, si dhe për rritjen e nivelit të llogaridhënies dhe përgjegjësisë.

Rekomandimet e fundit të grupit punues për shkollat, në kuadër të ET2020 të Bashkimit Evropian, theksojnë nevojën për koherencë dhe sinergji më të lartë ndërmjet proceseve dhe mekanizmave të ndryshëm për sigurim të cilësisë, me theks të veçantë në ndërveprim sa më efektiv ndërmjet elementeve të sistemeve të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm (European Commission, 2017). Këto rekomandime i përgjigjen edhe kontekstit të Kosovës, kur kemi parasysh qasjen që promovon sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës dhe përvojën fillestare në këtë proces.

Supozimi ynë i dytë, se ka dallime në perceptimet e përfaqësuesve të shkollave dhe bartësve tjerë që kanë rol në procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, lidhur me informimin, përgatitjet, praktikat dhe efektet e para të zbatimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe nivelin e përkushtimit institucional për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës në institucionet e arsimin parauniversitar në Kosovë, u vërtetua. Megjithatë, mendimi dominues i personelit të shkollës, ashtu edhe i prindërve, është pozitiv, me dallime në disa aspekte. Pjesa më e madhe e personelit të shkollës (rreth 75%) dhe prindërve (rreth 60%) shprehen të kënaqur me praktikën e shkollës në realizimin e hapave kryesorë të procesit të vetëvlerësimit. Ndërsa, nxënësit janë në përqindje më të ulët të kënaqur (rreth 42%), pjesa tjetër rreth 43% janë neutralë, ndërsa rreth 15% janë të pakënaqur me praktikën e realizimit të procesit të vetëvlerësimit.

Vlen të theksohet se realizimi i procesit të vlerësimit të brendshëm në shkolla ka vënë në lëvizje disa nevoja për ndryshim. Dy janë aspektet e theksuara më të rëndësishme: e para, përmirësimi i cilësisë së informimit të përgjithshëm të aktorëve shkollorë dhe e dyta, përfshirja e gjerë e tyre në proceset që zhvillohen në shkollë. Për këtë, mendim të përafërt shprehin si personeli i shkollës, ashtu edhe nxënësit dhe prindërit e tyre.

Informimi dhe përgatitjet për procesin e VBSH kanë rëndësi të madhe ndikuese në qëndrimet e personelit të shkollës, prindërve dhe nxënësve me praktikën e shkollës në realizimin e hapave kryesorë të procesit të vetëvlerësimit. Mbi 90% e personelit të shkollës, mbi 80% e prindërve dhe mbi 70 % e nxënësve shprehen se janë të kënaqur me informimin dhe përgatitjet për procesin e VBSH-së. Peshë të ndikimit del të kenë edhe koordinimi dhe udhëheqja e procesit të VBSH-së. Mbi 90% e personelit të shkollës, rreth 73% e prindërve dhe mbi 60 % e nxënësve, shprehen se janë të kënaqur me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të VBSH-së. Më të pakënaqurit me koordinimin dhe udhëheqjen e procesit të vetëvlerësimit të shkollës shprehen të jenë nxënësit, ku mbi 15% (neutralë 25%) dhe prindërit rreth 13% (neutralë 15%). Shikuar nga këndvështrimet e personelit të shkollës, prindërve dhe nxënësve të përfshirë në studim, përmirësimi i cilësisë së informimit, përgatitjeve, koordinimit dhe udhëheqjes së procesit të VBSH-së përmirëson cilësinë e zbatimit të hapave kryesorë të procesit të vetëvlerësimit.

Një dallim ndërmjet qëndrimeve në mesin e personelit të shkollës shpërfaqet në mendimet e tyre për mbështetjen e ofruar për realizimin e vetëvlerësimit. Mbi 76% e personelit të shkollës shprehen se janë të kënaqur me mbështetjen e ofruar për realizimin e procesit të VBSH-së. Nga kjo përqindje, rreth 33% e drejtorëve të shkollave dhe rreth 34 % e koordinatorëve të cilësisë në shkolla shprehin shqetësimin e tyre për mungesë të përkrahjes nga DKA-të, kurse mbi 18 % e anëtarëve të EVV-së, në bazë të deklarimeve të tyre, nuk kanë marrë informata të mjaftueshme nga drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë, të përfshirë në trajnime dhe punëtoritë për VBSH, lidhur me realizimin e procesit të VBSH-së dhe përmirësimet e nevojshme pas marrjes së informatave kthyesë nga analiza e drafteve të para të raporteve të VBSH-së.

Gjatë analizës evidentuam edhe faktorët që ndikojnë në qëndrimet e personelit të shkollës lidhur me efektet e procesit të vetëvlerësimit. Një prej këtyre faktorëve është roli i personelit të shkollës në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës. Drejtorët e shkollave, koordinatorët e cilësisë në shkollë dhe EVV, kanë rol koordinues dhe udhëheqës në procesin e VBSH-së. Ata shprehen se VBSH-ja ka pasur ndikim në motivimin e tyre për kontribut të shtuar në proceset e brendshme për ngritjen e cilësisë në shkollë. Këtë e shprehin mbi 94% e drejtorëve, rreth 90% e koordinatorëve të cilësisë në shkolla dhe mbi 61% e anëtarëve të EVV-së. Kjo tregon se delegimi i përgjegjësi në nisma, si procesi i VBSH-së, qartësimi i roleve dhe përfshirja aktive në procese të tilla, ndikon në mënyrë të dukshme në rritjen e besimit për mundësinë e dhënë dhe në motivimin për kontribut të shtuar në ngritjen e cilësisë në shkollë.

Shikuar nga këndvështrimi i personelit të shkollës, nxënësve dhe prindërve, procesi i VBSH-së kishte ndikim pozitiv edhe në identifikimin e sfidave me të cilat janë përballur

në procesin e VBSH, si: përzgjedhja e KC sipas kriterëve të përcaktuara nga MASHT, rezistenca e një numri të mësimdhënësve për përfshirje në procesin e VBSH, mungesa e përkrahjes së nevojshme dhe e motivimit, interesimi jo i mjaftueshëm i prindërve, koha e limituar për realizimin e aktiviteteve në kuadër të procesit të VBSH, hartimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, hezitimi i nxënësve për të vlerësuar punën e mësimdhënësve, objektiviteti në vlerësim – pasqyrimi real i gjendjes në shkollë, shkrimi/hartimi i raportit të VBSH-së etj.

Vetëvlerësimi në shkolla ka ecur një hap para, kundrejt konsolidimit të mekanizmave për mbikëqyrje, monitorim dhe mbështetje të vazhdueshme të institucioneve shkollore në procesin e vetëvlerësimit. Në vitin 2018, komponenti i vlerësimit të performancës së shkollës është përfshirë në planet e MASHT-it – Inspektoratit të Arsimit dhe në pjesën më të madhe të planeve të DKA-ve. Mirëpo, qasja ndaj përgatitjeve të planeve për zbatimin e tyre, si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal, tregon se këto dy nivele akoma janë larg përmbushjes së përgjegjësive që kanë në zbatimin e sistemit të VPSH-së.

MASHT-i deri në kohën e realizimit të studimit nuk e ka përcaktuar koordinatoren e cilësisë në nivel qendror, nuk ka përcaktuar një mekanizëm të qëndrueshëm për mbështetje profesionale të vlerësuesve të brendshëm dhe të vlerësuesve të jashtëm të performancës së shkollës, si dhe nuk ka bërë mjaftueshëm për të shtyrë procesin e informimit dhe promovimit të sistemit të vlerësimit të performancës, si një mekanizëm për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve në shkolla. Në anën tjetër, Inspektorati i Arsimit ka filluar me vlerësimin e jashtëm të performancës në një numër të shkollave që mbulojnë SIA-të në rajone. Mirëpo, nuk është krijuar masa e nevojshme dhe në cilësinë e duhur e kapaciteteve (Çobaj, T., 2016) të inspektorëve për të udhëhequr procesin e vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës dhe harmonizimin e tij me shkollat që janë duke e realizuar procesin e vetëvlerësimit. Ndërsa, pjesa më e madhe e DKA-ve nuk kanë arritur ta bëjnë rregullimin e pozitës së koordinatorëve të cilësisë në shkolla, vendosjen e mekanizmit për mbikëqyrjen dhe përkrahjen e shkollave dhe Inspektoratit të arsimit në realizimin e vlerësimit të performancës së shkollës, si dhe në zbatimin e ciklit për sigurim të cilësisë në shkollë, cikël i cili duhet të ndërlihet edhe me PZHAK-në.

Supozimi ynë i tretë, se përmbushja e kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës pasqyrohet në të gjitha raportet e vetëvlerësimit të shkollave, nuk u vërtetua. Përkundrazi, shumica e raporteve të VBSH-së janë të përshkruara me lëshime teknike, organizative dhe përmbajtjesore, të cilat në detaje janë prezantuar në kapitullin 4 të këtij studimi, në pjesën 4.4. – Analiza krahasuese e raporteve të vetëvlerësimit, si dhe në pjesën e diskutimeve mbi raportet e vetëvlerësimit.

Përkundrazi faktit se ka raporte të vetëvlerësimit që kanë elemente shumë të mira në përmbushjen e kërkesave të procesit të VBSH-së, marrë në përgjithësi, raportet e vetëvlerësimit i karakterizon anashkalimi i kërkesave, të cilat shumë qartë janë të elaboruara në udhëzuesin për vlerësim të brendshëm të shkollës. Kjo qasje pengon avancimin drejt përmirësimit të cilësisë së proceseve të vetëvlerësimit në shkollat

përkatëse dhe ndërmarrjen e veprimeve për përmirësim në fushat e identifikuara me probleme dhe nevoja për përmirësim të vazhdueshëm.

Korniza për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë përbën një risi në përcaktimin e pritshmërive nga shkolla dhe vendosjen e një standardi të ri në sistemin arsimor, siç është vetëvlerësimi i performancës së shkollës dhe planifikimi zhvillimor bazuar në të dhënat e vlerësimit të performancës, që nuk është vlerësuar dhe konsideruar si duhet në procesin e vetëvlerësimit të shkollës dhe në përgatitjen e raportit të vetëvlerësimit.

Instrumenti/formulari standard i vlerësimit të performancës së shkollës dhe udhëzuesit për shfrytëzimin e tij, pavarësisht formatit orientues dhe udhëzimeve përcjellëse për plotësimin e tij, nuk janë shfrytëzuar drejt në realizimin e qëllimit të tyre, në standardizimin e qasjes në vlerësim, duke ndërlidhur vlerësimin nga treguesit e performancës së shkollës – kriteret e cilësisë- fushat e cilësisë dhe performanca e përgjithshme në nivel shkolle. Problematikat në aplikimin e instrumentit/formularit standard të vlerësimit të performancës së shkollës dhe të udhëzimeve për plotësimin e tij nuk i mundësojnë shkollës të bëjë analiza të thelluara të gjendjes në shkollë, të identifikojë përparësitë dhe dobësitë e performancës së saj dhe masat që duhet të ndërmerren për mirëmbajtjen dhe avancimin e përparësive dhe për përmirësimin e anëve të dobëta, respektivisht tejkalimin e sfidave të identifikuara (MASHT & IPK, 2016).

Problematikat e shfaqura në realizimin e vetëvlerësimit sipas hapave kryesorë, përfshirë edhe hartimin e raportit përmbledhës të vetëvlerësimit, dëshmojnë që kapacitetet e EVV-së dhe personave përgjegjës për udhëheqjen e këtij procesi nuk janë në nivelin e kërkuar të sfidës për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës. Kjo shtron nevojën për ngritje dhe fuqizim të mekanizmave përkrahës të shkollave dhe për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve për vlerësim të performancës së shkollës dhe për aplikim të ciklit për sigurim të cilësisë Planifiko – Bëj – Kontrolllo – Rishiko.

Sfidat e shpërfaqura nga përvoja e parë në procesin e vetëvlerësimit janë gjithashtu tregues se një pjesë e madhe e shkollave akoma nuk janë gati për të realizuar këtë proces në bazë të kërkesave dhe pritshmërive të përcaktuara, ose nuk e kanë marrë me seriozitet dhe si prioritet këtë proces. Nisur nga fakti se vetëvlerësimi si proces është përvojë e re për shkollat në Kosovë, aplikimi i këtij standardi të ri në sistemin arsimor kërkon përkrahje, sinergji dhe përkushtim institucional për të kthyer/drejtuar atë në një proces të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, pjesë të kulturës së shkollës, nëpërmjet të cilit shkolla ushtron përgjegjësinë e saj për cilësinë e shërbimeve të ofruara për nxënës dhe nxënien e tyre.

Referuar gjetjeve të këtij studimi, diskutimit të rezultateve dhe konkluzioneve nga ky studim, më poshtë dalin disa rekomandime:

Përmirësimi i cilësisë së procesit të vetëvlerësimit. Për këtë, shkollat duhet të bëjnë një vetëreflektim për përvojën e parë të vetëvlerësimit, në mënyrë që të mësojnë nga praktikat e mira, lëshimet, dobësitë dhe të fillojnë adresimin e sfidave për vlerësimet

e radhës. Drejtorëve të shkollave u rekomandohet që të sforcojnë udhëheqjen e këtij procesi, mbështetjen e KC dhe EVV dhe bërjen e vetëvlerësimit pjesë integrale të kulturës së punës së shkollës. Përmirësimi i cilësisë së procesit të vetëvlerësimit duhet të ketë referencë kornizën për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës, udhëzuesit përkatës, gjetjet e këtij studimi dhe orientimet e dhëna në diskutim të rezultateve për të gjithë hapat kryesorë të procesit të vetëvlerësimit. Fokusi i vetëvlerësimit duhet të orientohet në cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit, në raport me pritshmëritë e përcaktuara me dokumentet kurrikulare dhe nevojat e nxënësve për përkrahje nga shkolla dhe mësimdhënësit për zotërimin e kompetencave kryesore të parapara me kurrikulë.

Informimi mbi sistemin e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore parauniversitare. Ndjeshmëria e procesit të vlerësimit të performancës dhe qëllimi i vendosjes së sistemit të vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore parauniversitare shtrojnë nevojën për të ndërtuar një kornizë për informim mbi sistemin e vlerësimit të performancës, që do të ishte e përdorshme për shkollat, në veçanti dhe për opinionin arsimor publik në përgjithësi (Buleshkaj, 2013). Pjesë e sistemit të informimit rekomandohet të jetë edhe vendosja e një platforme ‘online’ për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar, të cilën e mirëmban dhe e përditëson koordinatori, apo zyra për cilësi në arsimin parauniversitar në nivel qendror.

Vendosja dhe konsolidimi i strukturave për menaxhimin e cilësisë në shkolla. Për të përmirësuar praktikën e vetëvlerësimit të shkollës, rekomandohet që të vendosen dhe konsolidohen të gjitha strukturat për menaxhim të cilësisë në nivel qendror, nivel komunal dhe në çdo shkollë. Gjithashtu, shtrohet nevoja e angazhimit të një instituti apo agjencie në sektorin e arsimit, për ofrimin e mbështetjes profesionale për institucionet e përfshira në sistemin e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore. IPK-ja, me mbështetjen e UNICEF-it, ka dhënë një ndihmesë të madhe në këtë fazë, mirëpo nuk ka mandat dhe përcaktim ligjor që ta udhëheqë këtë proces në fazat e mëtejme. Prandaj, MASHT-it i rekomandohet që të përcaktojë autoritetin që do të ofrojë mbështetje në këtë proces, në mënyrë që institucionet arsimore, veçanërisht shkollat, të kenë adresën e qartë për mbështetje në tejkalimin e sfidave dhe në avancimin e praktikës së vetëvlerësimit.

Plotësimi i kuadrit të udhëzuesve dhe instrumenteve për vlerësim të performancës së shkollës. Nisur nga fakti se metodologjia e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore parauniversitare është një praktikë e re dhe nisur nga fakti se shkollat kanë pasur vështirësi në zhvillimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për procesin e VBSH-së, rekomandohet që Udhëzuesi për vetëvlerësim dhe Udhëzuesi për vlerësim të jashtëm të plotësohen me disa instrumente standarde për mbledhjen e të dhënave dhe me udhëzime përcjellëse për administrimin e tyre dhe analizën e rezultateve të mbledhura.

Zhvillimi i kapaciteteve. Ishte një mendim pozitiv ndaj trajnimeve dhe mbështetjes së ofruar. Mirëpo, nga të gjithë subjektet që kanë rol koordinues dhe udhëheqës në këtë proces u konstatua qartë nevoja për zhvillim të kapaciteteve të të gjithë anëtarëve

të EVV-së dhe vlerësuesve e mbështetësve të këtij procesi, si dhe u dhanë orientime për një qasje holistike që mundëson zhvillimin e kapaciteteve për aplikim cilësor të metodologjisë së vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm të shkollës dhe për praktikën e udhëheqjes së këtij procesi në frymën e ciklit të plotë për sigurim të cilësisë.

Studime të mëtejme. Studimi i përvojave të para të procesit të vetëvlerësimit hodhi dritë mbi mësimet, problemet dhe sfidat, me të cilat shkollat janë ballafaquar në këtë proces. Për të ndërlidhur këtë përvojë me ciklin për sigurim të cilësisë, rekomandohet që të bëhen studime të mëtejme për të parë se sa kanë shërbyer ky proces dhe gjetjet e tij në planifikimin zhvillimor të shkollës, në zbatimin e masave nga vetë shkolla për përmirësimin e cilësisë dhe në qasjen e shkollave ndaj vetëvlerësimeve të radhës. Gjithashtu, rekomandohet që të zhvillohen edhe studime për praktikën e vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës dhe të relacionit në praktikë ndërmjet vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm.

Zhvillimi i një studimi pas një periudhe 2-3 vjeçare, me të njëjtat shkolla që kanë realizuar VBSH-në, për të parë ndikimin e këtij vlerësimi, do të shërbente të nxirren gjykime lidhur me ndikimin pozitiv/negativ të këtij procesi në përmirësimin e cilësisë në këto shkolla.

Në përmbyllje, ky studim ofron informacione për aspekte të ndryshme që parashikohen të ndikojnë në praktikën e vlerësimit të performancës së shkollës dhe në dinamizmin e krijimit të mekanizmave mbështetës për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës, për të cilin nevojitet angazhim maksimal i të gjitha institucioneve arsimore që kanë rol dhe përgjegjësi në këtë proces, në mënyrë të veçantë i personelit udhëheqës në MASHT, Inspektoratin e Arsimit, DKA, shkolla, por edhe ekipeve për vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm, stafit mësimdhënës, prindërve dhe nxënësve. Sahlberg (2011) shprehet se ndryshimi i vërtetë arsimor ndodh kur shkolla lulëzon në nivelin e poshtëm, me presion nga anash dhe drejtohet nga lart (Saqipi, 2013). Vendosija në binarë të drejtë e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës dhe e mekanizmave për sigurim të cilësisë do të ndihmojë të ndodhë ndryshimi i vërtetë arsimor...

Jetojmë në epokën digjitale, kur ndryshimet në shoqëri dhe teknologji janë marramendëse dhe të përditshme. Kjo shton përgjegjësinë dhe domosdonë për ndjekjen e këtyre hapave zhvillimorë. Procesi i VBSH-së është njëri ndër këta faktorë për sigurimin e cilësisë së nxënies dhe të mësimdhënies, pa të cilat nuk mund të mëtojmë ndjekjen e hapave zhvillimorë.

Gjithashtu, procesi i VBSH-së është një udhërrëfyes i sofistikuar për shkollën, drejtorët, mësuesit dhe nxënësit, por edhe për vendimmarrësit e tjerë për diagnostifikimin e gjendjes: Ku jemi; si të lëvizim para dhe ku do të arrijmë. Prandaj këtë mekanizëm duhet ta jetësojmë në mjedisin shkollor te ne, në të gjitha nivelet e arsimit.

Përvojat që prezantuar në këtë raport studimi duhet të shërbejnë si mësim për shkollat e tjera dhe si trampolinë për shkollat që tanimë kanë bërë hapat e parë për avancim të vetë procesit dhe të cilësisë së performancës së shkollës.

Gjatë procesit të hulumtimit dhe të analizës së të dhënave, por edhe kontakteve që i kishim me aktorët e këtij procesi, kemi vërejtur një entuziazëm shpresëdhënës se shkollat janë shumë të interesuara për marrjen e përgjegjësisë mbi vete sa i përket promovimit të cilësisë së performancës, por edhe gatishmërisë për llogaridhënie për të.

Ky fakt na trimëron që të kërkojmë nga të gjithë aktorët, sidomos DKA-ja dhe MASHT-i, për një përkrahje më të madhe shkollave, por edhe qasje më të përkushtuar për një proces të këtillë. Me këtë ne po promovojmë mekanizmin parësor për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës në të gjitha elementet e saj. Këtë e bëjnë të gjitha vendet me traditë arsimore.

BURIMET DHE LITERATURA

1. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. (2011). *Sigurimi i cilësisë në institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional – Udhëzues praktik për implementim*. Prishtinë. http://akk-ks.net/uploads/sigurimi_i_cilesise_në_institucionet_e_AAP-së_udhëzues_praktik_për_Implementim.pdf
2. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2014). Raport mbi rezultatet e hulumtimit rreth shkollave profesionale dhe qëndrimit të tyre ndaj sigurimit të cilësisë dhe kornizës kombëtare të kualifikimeve dhe autoritetit kombëtarë të kualifikimeve, Prishtinë. http://akk-ks.net/uploads/hulumtimi_-_autoriteti_kombetar_i_kualifikimeve_qendrimet_e_shkollave_te_AAP_rreth_sc_kkkandakk.pdf
3. Birzea, C., Çekini, M., Harrison, K., Krek, J., & Spajiç-Verkash, V. (2005). Instrument për sigurimin e cilësisë së Edukimit për Qytetari Demokratike në shkollë. UNESCO, Council of Europe, CEPS 2005. <http://izha.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/02/3.-Instrument-per-sigurimin-e-cilesise-se-edukimit-per-qytetari-demokratike.pdf>
4. Brejc, M., Arčnik, M., Koren, A., Pučko, R., Gradišnik, S. & Širec, A. (2014). Protokol za uvajanje izboljšav in samoevalvacijo V šolah in vrtcih. Šola za ravnatelje, Kranj – Slovenia.
5. Buleshkaj, O. (2013). Ndërtimi i kapaciteteve për leadershipin shkollor në Kosovën e pasluftës. Revista Shqiptare e Studimeve Arsimore, Volumi 1, nr. 1 2013 f. 25-48. CDE, Tiranë. <http://www.cde.edu.al/sites/default/files/biblioteka/Revista%20Shqiptare%20E%20Studimeve%20Arsimore%201.pdf>
6. Buleshkaj, O. & Mehmeti, S. (2012). Raport mbi vlerësimin e nevojave të drejtorëve të shkollave për ngritje të kapaciteteve në udhëheqje arsimore, EU IPA 2009 projekt, Prishtinë.
7. Lusthaus, Ch., Adrien, M.-H., Anderson, G. & Carden F. (2005). *Përmirësimi i performancës së organizatës (Një komplet mjetesh për vetëvlerësim)*. Prishtinë: ADEA.
8. Choi, K., Goldschmidt, P. & Yamashiro, K. (2006). Exploring Models of School Performance: From Theory to Practice. University of Los Angeles, California/CRESST. <https://cresst.org/wp-content/uploads/R673.pdf> (shkarkuar me 21.03.2018)
9. Çobaj, T. (2016). Plani vjetor i shkollës, roli i tij në sigurimin e cilësisë. Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Evropiane. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/10/Teuta-%C3%87obaj-Doktorature.pdf>
10. Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës (2001): Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës, Arsimi parashkollor, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i latë, libri i bardhë për diskutim, Prishtinë.
11. Department of Education and Skills in Irish. (2012). The Quality Assurance of Irish Schools and the Role of Evaluation: Current and Future Trends, Dr. Harold Hislop, Chief Inspector Department of Education and Skills. <https://www.education.ie/en/Publications/Inspection-Reports-Publications/Evaluation-Reports-Guidelines/The-Quality-Assurance-of->

[Irish-Schools-and-the-Role-of-Evaluation-Current-and-Future-Trends.pdf](#)

12. Elmore, R. (2011). Reforma shkollore nga Brenda jashtë: Politika, praktika dhe performanca. Shtëpia Botuese Universitare: U.F.O. Press, Tiranë.
13. European Union (2011). Glossary Quality in education and training. Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2011. file:///C:/Users/USER/Downloads/glossary_quality_in_education_-_cedefop_-_2011.pdf
14. European Commission. (2015a). Assuring Quality in Education: Policies and Approaches to School Evaluation in Europe, Eurydice Report. http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/178en.pdf
15. European Commission. (2015b). Comparative study on quality assurance in EU school education systems: Policies, procedures and practices: final report, Directorate-General for Education and Culture. https://www.schooleducationgateway.eu/files/esl/downloads/69_Comparative_Study_on_QA.pdf
16. European Commission. (2017). Quality assurance for school development: Guiding principles for policy development on quality assurance in school education, Report of the ET2020 Working Group Schools,. https://ec.europa.eu/education/sites/education/files/2017-school-development-quality-assurance_en.pdf
17. Fullan, M. (2010). Forca e ndryshimit – Depërtim në thellësinë e reformës arsimore. Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë.
18. Growing, E. & Saqipi, B. (2010). Raport mbi vlerësimin e nevojave për zhvillim të kapacitetit të Drejtorive Komunale të Arsimit në Kosovë, EU Education SWAP projekt, Prishtinë.
19. Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016a). Instrumenti për vlerësimin e performancës së shkollës. Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/instrumenti-per-vleresimin-e-performances-se-shkolles/>
20. Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016b). *Manual për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë*. IPK, Prishtinë.
21. Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016c). *Udhëzues për vlerësimin e brendshëm të shkollës (Fushat e cilësisë – Kriteret – Treguesit)*. IPK, Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/udhezuesi-per-vleresimin-e-brendshem-te-shkolles/>
22. Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016d). *Udhëzues për vlerësimin të jashtëm të performancës së shkollës*. IPK, Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/udhezuesi-per-vleresimin-e-jashtem-te-shkolles/>
23. Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (2011). Metodologjia e inspektimit dhe vlerësimit të brendshëm të institucioneve arsimore parauniversitare. IKAP, Tiranë.
24. Kabashi, A. (2017). Raporti i progresit Twinning Follow up. (Raporti i përgatitur për ‘KulturKontakt Austria’, për mbështetjen e ofruar shkollave për sigurimin e cilësisë).
25. Kocani, A. (2008): *Ushtrime me metodat e kërkimit sasior në shkencat sociale*. Ufo

Press. Tiranë.

26. Komisioni Evropian (2017). Raporti përfundimtar i projektit të binjakëzimit 31 mars 2017). Omnia, Autoriteti i Përbashkët i Arsimit në Rajonin e Espo-s (Finlandë) & ‘KulturKontakt’ (Austria) (Raport i pa publikuar).
27. Komuna e Mitrovicës (2017). Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Mitrovicës, 2018-2022, Mitrovicë.
28. Komuna e Pejës (2017). Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Pejës 2018-2022, Pejë. http://keen-ks.net/site/assets/files/1378/plani_zhvillimor_i_arsimit_-_peje_-_alb.pdf
29. Komuna e Prishtinës (2017). Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Prishtinës 2018-2022, Prishtinë. http://prishtinaonline.com/uploads/c_3.13.4._plani_zhvillimor_i_arsimit_per_komunen_e_prishtines_2018-2022_alb_final.pdf
30. Koren, A. (2014). *Roli i drejtorëve të shkollave në zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca*. Konferenca ndërkombëtare - Qasja e re kurrikulare sfidë e së ardhmes, Kumesat, prezantimet dhe rekomandimet, (f 129-140). Prishtinë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
31. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.03/L-068 (2008), Prishtinë. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L068_al.pdf
32. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji Nr.04/L-032 (2011), Prishtinë. <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20parauniversitar.pdf>
33. M. Carmen , MA. & M. Selim, MA. (2012). *E drejta për edukim – Edukimi cilësor*. Prishtinë: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit-GIZ.
34. Marsh, J. Colin. (2009). *Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin*. Botimi i katërt në shqip, Tiranë, Qendra për Arsim Demokratik.
35. Mary-Kerstin Hassiotis. (2015, 07. 4.). *How to Implement the Plan-Do-Check-Act Cycle - PDCA*. Shkarkuar më: 22.11. 2016, nga A Global Manufacturing Company: <http://news.ewmfg.com/blog/how-to-implement-the-pdca-cycle-plan-do-check-act-in-any-department>
36. Mehmeti, S., Zylfiu, H., Potera, I., Buleshkaj, O. dhe Lehner-Stift, U. (2016). Manual për sigurimin e cilësisë në shkollë. Bashkimi Evropian – në kuadër të Projektit të Binjakëzimit.
37. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). *Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë*. IPK, Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles/>
38. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). Raport vjetor i vlerësimit Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2017-2021, MASHT & GIZ.
39. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (04/2017). *Udhëzimi Administrativ*

- nr. 04/2017: *Vlerësimi i performancës në Institucionet e Arsimore*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-arsimin-parauniversitar-rotated.pdf>
40. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016a). *Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021*. Prishtinë. http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf
 41. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016b). *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës* (e rishikuar). Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>
 42. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016c). *Udhëzimi Administrativ nr. 24/2016: Sigurimi i cilësisë në Arsimin Parauniversitar*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf180.pdf>
 43. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016d). *Udhëzimi Administrativ nr. 23/2016 për Planin zhvillimor të shkollës dhe Planin zhvillimor komunal të arsimit*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf90.pdf>
 44. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016e). *Udhëzimi Administrativ nr. 22/2016 për Aktivitet Profesional (Departamentet) të shkollave*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/22-ua-nr-22-2016-per-aktivitetet-profesionale-te-shkollave.pdf>
 45. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016f). *Raport për arritjet e nxënësve të Kosovës në PISA 2015. Divizioni për vlerësim, standarde dhe monitorim. MASHT*.
 46. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2015). *Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/qa-strategy-final-shqip.pdf>
 47. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2012). *Udhëzimi Administrativ nr.04/2012: Standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollës*. Shkarkuar më: 21.10. 2017, nga http://www.masht-gov.net/advCms/documents/udhezim_administrativ_04_2012_shqip.pdf
 48. MASH dhe Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (2011). *Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës (Udhëzues për inspektimin e plotë të shkollës)*. IKAP, Tiranë.
 49. O'Day, J. (2002) *Complexity, Accountability, and School Improvement*. Harvard Educational Review: September 2002
 50. Pasku, V. (2014). *Vlerësimi dhe inspektimi në funksion të zbatimit të kurrikulës*. Konferenca ndërkombëtare - Qasja e re kurrikulare sfidë e së ardhmes, Kumtesat, prezantimet dhe rekomandimet, (f. 115-128). Prishtinë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
 51. Qeveria e Republikës së Kosovës (2017). *Plani Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2018*. Prishtinë. http://www.kryeministri-ks.net/.../Plani_Vjetor_i_Punës_së_Qeverisë_për

[viti_2018_Shqip](#)

52. Quality Insurance. (2010). *Philip Crosby's concept of Quality Improvement*. Shkarkuar më: 13. 02.2018, nga <http://www.qasigma.com/2008/12/philip-crosbys-concept-of-quality-improvement.html>
53. Raportet e vlerësimit të brendshëm të 39 shkollave të përfshira në studim. (pa publikuara).
54. Rrjeti evropian i korrespondentëve nacional të CAF dhe Qendra Evropiane e Resurseve CAF në EIPA . (2013). *Korniza e përbashkët e vlerësimit (KPV) Përmirësimi i organizatave publike përmes vetëvlerësimit*. Shkarkuar më 15.02.2018 https://archive.eipa.eu/files/File/CAF/Albanian_CAF%202013.pdf
55. Saqipi, B. Të ndryshosh shkollat për kohërat në ndryshim: Perspektiva e mësimdhënies në Kosovë. Revista Shqiptare e Studimeve Arsimore, Volumi 1, nr. 2, 2013 ,f. 4-21. CDE, Tiranë. <http://www.cde.edu.al/sites/default/files/biblioteka/Revista%20Shqiptare%20E%20Studimeve%20Arsimore%202.pdf>
56. The use of school self-evaluation results in the Netherlands and Flanders, British Educational Research Journal, Vol. 38, No. 1, 2012.
57. UNESCO (2011). UNESCO and Education “Everyone has the right to education” <http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002127/212715e.pdf>
58. Zgaga, P.(2000) Educational policy and quality in education. International Conference «Ways towards Quality in Education» Open Society Institute Slovenia, College of management Koper, School of Principals. Brdo pri Kranju (Slovenia), 8-10 April 2000. <https://core.ac.uk/download/pdf/11872376.pdf>
59. Zeneli, I. (2013). Bazat e Menaxhimit: Menaxhimi i institucioneve të arsimit. Libri Shkollor. Prishtinë.
60. Zylfiu, H. (2017). Sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë. *Kërkime pedagogjike - përmbledhje punimesh, 2017, nr.2, f. 4-33*. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Shtojcat

Shtojca A: Lista e shkollave të përfshira në studim.

Shtojca B: Instrumentet e hulumtimit

1. Pyetësi për stafin e shkollës
2. Pyetësi për nxënës
3. Pyetësi për prindër
4. Protokoll i intervistës
5. Listë kontrolli për analizë të raporteve të VBSH-së

Shtojca C: Tabelat e analizës statistikore për përgatitjen e institucioneve arsimore për realizimin e VBSH-së

Shtojca D: Tabelat e analizës statistikore për praktikën e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës

Shtojca E: Tabelat e analizës statistikore për materialet, trajnimin dhe format e tjera të mbështetjes në realizimin e procesit të VBSH-së

Shtojca A: Lista e shkollave të përfshira në studim

Nr.	Shkolla	Vendi
1	“A. Z. Çajupi”	Vushtrri
2	“Ahmet Gashi”	Prishtinë
3	“Aleksandër Xhuvani”	Podujevë
4	“Asdreni”	Llabjan - Novobërdë
5	“Asdreni”	Pejë
6	“Avdullah Shabani”	Mitrovicë
7	“Azem Bejta”	Grabanicë
8	“Bedri Gjinaj”	Mitrovicë
9	“Bedri Pejani”	Pejë
10	“Dardania”	Hani i Elezit
11	“Daut Bogujevci”	Fushë Kosovë
12	“Dëshmorët e Tivarit”	Peqan - Suharekë
13	“Emin Duraku”	Prizren
14	“Eqrem Çabej”	Vushtrri
15	“Faik Konica”	Prishtinë
16	“Fan.S. Noli”	Kamenicë
17	“Gjon Buzuku”	Prizren
18	“Hajdar Dushi”	Gjakovë
19	“Hasan Prishtina”	Godanc - Shtime
20	“Hivzi Sulejmani”	F. Kosovë
21	“Ibrahim Rugova”	Obiliq
22	“Ismail Qemali”	Kamenicë
23	“Ismet Rraci”	Klinë
24	“Kongresi i Manastirit”	Gllamnik - Podujevë
25	“Kuvendi i Arbërit”	Ferizaj
26	“Luigj Gurakuqi”	Klinë
27	“Naim Frashëri”	Shtime
28	“Pavarësia”	Siboc - Podujevë
29	“Qamil Ilazi”	Kaçanik i Vjetër - Kaçanik
30	“Rexhep Elmazi”	Gjilan
31	“Shaban Shala”	Podujevë
32	“Skënderbeu”	Kaçanik
33	“Tefik Çanga”	Ferizaj
34	“Xhemail Mustafa”	Prishtinë
35	“Xhevdet Doda”	Prishtinë
36	“Ymer Berisha”	Siqevë - Klinë
37	“Zekeria Rexha”	Gjakovë
38	“Zenel Hajdini”	Gjilan
39	“17 Shkurti”	Shirokë - Suharekë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEKNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY



PYETËSOR

për

EKIPIN E VETËVLERSIMIT DHE STAFIN E SHKOLLËS

VETËVLERËSIMI - VLERËSIMI I BRENDSHËM I SHKOLLËS

I/e nderuar

Ju jeni përzgjedhur për të marrë pjesë në këtë studim. Të gjitha të dhënat, që do të mblidhen me këtë pyetësor, do të përdoren vetëm për qëllime studimi, qëllimi i të cilit është marrja e qëndrimeve të aktorëve kryesorë në nivel shkollë lidhur me praktikën e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës në Kosovë. Përmirësimi dhe avancimi i këtyre praktikave është synim kryesor i këtij studimi.

Çdo informacion i dhënë në këtë pyetësor do të mbetet konfidencial. Lutemi që pyetësorin e plotësuar ta ktheni në ditën që u shpërndahet për plotësim, te personi i cili e ka shpërndarë këtë pyetësor ose te drejtori i shkollës.

Ju faleminderit për bashkëpunim!

I. TË DHËNAT E SHKOLLËS DHE TË DHËNAT PERSONALE

1.	Komuna	
2.	Emri i shkollës	
3.	Vendi	
<i>(Ju lutem rrethoni opsionin përkatës)</i>		
4.	Gjinia	1 Femër
		2 Mashkull
5.	Mosha	1 21-30 vjeç
		2 31 – 40 vjeç
		3 41 -50 vjeç
		4 Mbi 50 vjeç
6.	Përvoja e punës	1 0-1 vjeç
		2 2 – 6 vjeç
		3 7 – 11 vjeç
		4 12 – 16 vjeç
		5 Mbi 16 vjeç
7.	Niveli i shkollimit në të cilën ju punoni	1 Fillor (klasa 1-5)
		2 Mesëm i ulët (klasa 6-9)
		3 Gjimnaz (klasa 10-12)
8.	Numri i nxënësve në shkollën tuaj	1 Deri 150 nxënës
		2 151-250 nxënës
		3 251-500 nxënës
		4 501-750 nxënës
		5 751-1000 nxënës
		6 1001 – 2000 nxënës
		7 Mbi 2000 nxënës
9.	Viti i fillimit të zbatimit të kurrikulës së re në shkollën tuaj	1 Viti shkollor 2016/2017
		2 Viti shkollor 2017/2018
<i>(Ju lutem rrethoni opsionin përkatës. Sipas nevojës rretho më shumë se një përgjigje)</i>		

10.	Roli i juaj në shkollë – në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	1	Drejtor i shkollës
		2	Zv.drejtor i shkollës
		3	Shërbimi profesional në shkollë (pedagog/psikolog)
		4	Koordinator i cilësisë në shkollë
		5	Udhëheqës i aktivitet profesional
		6	Anëtar i ekipit të shkollës për vetëvlerësim
		7	Mësimdhënës i angazhuar në përkrahje të ekipit të shkollës për vlerësim të brendshëm
		8	Mësimdhënës i përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit të brendshëm të shkollës
11.	Në ofrimin e të dhënave për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës sime, unë kam qenë pjesë e:	1	Plotësimin të pyetësorit/eve të përgatitur nga shkolla
		2	Intervistës së realizuar me mua nga ekipi i shkollës
		3	Fokus-grupit të realizuar nga ekipi i shkollës
		4	Tjetër (shëno):
12.	Në cilat prej trajnimeve të mëposhtme keni marrë pjesë?	1	Trajnimin për udhëheqje dhe menaxhim të shkollës
		2	Trajnimin për sigurim të cilësisë në shkollë
		3	Trajnimin për vlerësim të brendshëm të shkollës
		4	Trajnimin për zbatimin e kurrikulës së re

II. Praktikët e shkollës në realizim të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës (VBSH)

Fjalitë e mëposhtme kanë ndërlidhje me fazën përgatitore të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës. Ju lutem zgjidhni opsionin që e përshkruan më së miri përfshirjen tuaj dhe praktikën e shkollës në këtë fazë.

1= Fare nuk pajtohem, 2= Nuk pajtohem, 3 = Nuk e di, 4= Pajtohem, 5= Pajtohem plotësisht						
Sa jeni të pajtimit ose të mospajtimit lidhur me aspektet në vijim? (Ju lutem, vendosni X në opsionin përkatës)						
		1	2	3	4	5
13.	Unë jam informuar me të gjitha dokumentet e hartuara nga MASHT-i për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës.					
14.	Unë jam në dijeni se shkolla ka organizuar takime të veçanta informative për VBSH, me mësimdhënës, prindër, nxënës dhe udhëheqës të organeve profesionale e qeverisëse të shkollës.					
15.	Unë kam marrë informata dhe udhëzime të qarta për procedurat e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe rolin e aktorëve kryesorë të shkollës në këtë proces.					

PËRVOJAT E PARA NË VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS NË KOSOVË

16.	Unë kam qenë pjesëmarrës vetëm në takimet informative dhe aktivitetet përgatitore të shkollës për realizimin e VBSH-së.					
17.	Unë kam pasur rol në organizimin e takimeve informative dhe në aktivitetet përgatitore të shkollës për realizimin e VBSH-së.					
18.	Unë jam në dijeni se shkolla ka formuar ekipin e shkollës për vlerësim të brendshëm, sipas Udhëzimit administrativ për vlerësimin e performancës së shkollës.					
19.	Unë jam informuar me detyrat dhe përgjegjësitë e ekipit të shkollës për VBSH.					
20.	Unë jam informuar me kohë me planin e ekipit për VBSH dhe rolin tim në procesin e vlerësimit të brendshëm.					
21.	Unë jam në dijeni se në procesin e vlerësimit të brendshëm janë përfshirë të gjithë përfaqësuesit e aktorëve kryesorë të shkollës.					

Fjalitë në vijim pasqyrojnë praktikat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Ju lutem zgjidhni opsionin që e përshkruan më së miri shkallën e kënaqësisë suaj në secilin prej aspekteve në vijim.

1=Plotësisht i pakënaqur, 2=Nuk jam i/e kënaqur, 3=Neutral, 4=I kënaqur, 5= Plotësisht i kënaqur						
Sa jeni të kënaqur ose të pakënaqur me? (Ju lutem, vendosni X në opsionin përkatës)		1	2	3	4	5
22.	Përkrahjen nga drejtori i shkollës.					
23.	Koordinimin e procesit nga udhëheqësi i ekipit për VBSH.					
24.	Punën e ekipit të VBSH.					
25.	Pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë të shkollës në procesin e VBSH-së.					
26.	Procesin e identifikimit të të dhënave të nevojshme.					
27.	Njoftimin e pjesëmarrësve me kohën dhe formën e përfshirjes në procesin e vetëvlerësimit.					
28.	Përgatitjen e instrumenteve të nevojshme për mbledhjen e të dhënave.					
29.	Procesin e mbledhjes së të dhënave, saktësinë për të dhënat dhe dëshmitë e mbledhura.					
30.	Objektivitetin dhe paanshmërinë në analizën e të dhënave.					
31.	Praktikën e diskutimit të gjetjeve preliminare me pjesëmarrësit e përfshirë në vlerësim të brendshëm.					
32.	Finalizimin e gjetjeve preliminare në instrumentin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, duke pasqyruar gjendjen për secilin tregues në mënyrë specifike, të matshme, të pranueshme dhe reale për shkollën tonë.					

33.	Përcaktimin objektiv të shkallës së cilësisë në nivel të kritereve, në nivel të fushave të cilësisë dhe në nivel të përgjithshëm.					
34.	Identifikimin e përparësive dhe mangësive të performancës së shkollës.					
35.	Praktikën e formulimit të rekomandimeve për masat e nevojshme për përmirësim të mangësive dhe avancim të përparësive.					
36.	Praktikën e informimit të gjithë aktorëve në nivel shkolle për rezultatet e vlerësimit të brendshëm, përfundimet dhe rekomandimet.					
37.	Formimin e ekipit për rishikim/hartim të Planit Zhvillimor të Shkollës.					
38.	Rishikimin/hartimin e planit zhvillimor të shkollës duke u mbështetur në gjetjet e raportit të VBSH-së.					
39.	Hartimin e planit vjetor të punës/ planit të përmirësimit të shkollës, në ndërlidhje me PZSHH-në e rishikuar.					
40.	Fillimin e zbatimit të aktiviteteve prioritare për përmirësimin e cilësisë në shkollë.					

III. Materialet, trajnimi dhe mbështetja për realizimin e procesit të vetëvlerësimit

(Këtë pjesë e plotësojnë vetëm: drejtorët e shkollave /zv.drejtorët, koordinatori i cilësisë në shkollë dhe anëtarët e ekipit për vlerësim të brendshëm të shkollës. Të tjerët vazhdojnë plotësimin e pyetësorit në pjesën IV).

Fjalitë në vijim u referohen dokumenteve, udhëzuesve për performancë të shkollës, trajnimit për sigurim të cilësisë dhe vlerësim të performancës së shkollës, si dhe formave tjera mbështetëse për këtë proces. Ju lutëm zgjidhni opSIONIN që e përshkruan më së miri shkallën e pajtimit/mospajtimit tuaj me këto aspekte.

1= Fare nuk pajtohem, 2= Nuk pajtohem, 3 = Nuk e di, 4= Pajtohem, 5= Pajtohem plotësisht						
Sa jeni të pajtimit ose të mospajtimit lidhur me aspektet në vijim? (Ju lutem, vendosni X në opSIONIN përkatës)		1	2	3	4	5
41.	Kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës të përcaktuara me kornizë kanë pritshmëri të qarta për shkollën se ku duhet të fokusohet në VBSH.					
42.	Udhëzuesi për vlerësim të brendshëm është specifik dhe ofron informacion të mjaftueshëm për realizimin e procesit të VBSH-së.					

43.	Shtojcat e instrumenteve të bashkangjitura në udhëzuesin për VBSH kanë lehtësuar punën e ekipit të shkollës.					
44.	Trajnimi për vlerësim të brendshëm të shkollës ka ofruar informacion të mjaftueshëm për hapat, procedurat dhe praktikat që duhet ndjekur në realizimin e procesit të VBSH-së.					
45.	Përfaqësuesit e shkollës të trajnuar për vlerësim të brendshëm të shkollës kanë ofruar informacion të mjaftueshëm për ekipin e shkollës për vetëvlerësim lidhur me hapat, procedurat dhe praktikat që duhet ndjekur në realizimin e procesit të VBSH-së.					
46.	Informacionet kthyesë nga trajnerët lidhur me përgatitjet e shkollës, instrumentet dhe raportin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, kanë qartësuar punën e ekipit të shkollës, kanë orientuar nevojat për plotësim/ndryshim në vetëvlerësimin e radhës që do të organizohet nga shkolla.					
47.	Punëtoritë përcjellëse të mbajtura lidhur me raportin e vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe përdorimin e gjetjeve nga vlerësimi i brendshëm në procesin e përmirësimit të shkollës kanë qartësuar mënyrën e shfrytëzimit të gjetjeve dhe rekomandimeve nga raporti i vlerësimit në planifikim shkollor dhe në marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm.					
48.	Mbështetja e ofruar nga DKA-ja – koordinatori i cilësisë, ka ndihmuar shkollën në realizimin e procesit të VBSH-së.					
49.	Mbështetja financiare e ofruar nga DKA-ja ka ndihmuar shkollën në prioritetizimin dhe ndërmarrjen e masave për përmirësim të performancës në kriteret/ fushat e cilësisë që vlerësimet kanë dalë jo mirë.					

IV. Mendimi juaj për efekte të procesit të vlerësimit të brendshëm në shkollën tuaj

Ju lutem analizoni fjalitë në vijim dhe zgjidhni opsionin që i përshkruan më së miri efektet e vlerësimit të brendshëm të shkollës, të reflektuara tek Ju dhe në nivel shkollë.

<i>1= Fare nuk pajtohem, 2= Nuk pajtohem, 3 = Nuk e di, 4= Pajtohem, 5= Pajtohem plotësisht</i>						
Sa jeni të pajtimit ose të mospajtimit lidhur me aspektet në vijim? <i>(Ju lutem, vendosni X në opsionin përkatës)</i>		1	2	3	4	5
Procesi i vlerësimit të brendshëm të shkollës:						
50.	Mua më ka nxitur për të bërë punë shtesë për shkollën time, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së shkollës.					
51.	Mua më ka përgatitur për të punuar me ekipin e vetëvlerësimit për të realizuar të gjitha fazat e këtij procesi.					

52.	Mua më ka krijuar një ndjenjë më të fortë për të qenë pjesë e ekipit të shkollës për përmirësim të vazhdueshëm të performancës së shkollës.					
53.	Mua më ka bërë të besoj se shkolla ime çdo vit do ta realizojë me sukses VBSH-në.					
54.	Mua më ka motivuar për të qenë më i përkushtuar ndaj procesit të mësimdhënies dhe nxënies.					
55.	Mobilizojë të gjithë aktorët e shkollës në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për përmirësimin e cilësisë.					
56.	Nxiti diskutime në shkollë rreth cilësisë së performancës në shkollë.					
57.	Rezultoi me motivim shtesë të gjithë mësimdhënësve për t'u angazhuar në aktivitete që sigurojnë cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies për të gjithë nxënësit.					
58.	Rezultoi me veprime konkrete nga udhëheqja e shkollës për përmirësim të vazhdueshëm të shkollës.					
59.	Nxiti organet qeverisëse në shkollë (KDSH, KP dhe KN) të organizojnë konsultime më të shpeshta për sigurimin e cilësisë në shkollë.					
60.	Nxiti bashkëpunim më të madh në mes të vetë mësimdhënësve.					
61.	Nxiti organet profesionale në shkollë të organizojnë konsultime më të shpeshta për procesin mësimor.					
62.	Rezultoi me monitorim më të shpeshtë të punës së mësimdhënësve nga udhëheqja e shkollës.					
63.	Nxiti përkushtimin më të madh të shkollës ndaj zhvillimit profesional të mësimdhënësve.					
64.	Nxori në sipërfaqe pakënaqësitë e stafit të shkollës me mënyrën e organizimit të punës në shkollë.					
65.	Nxori në pah problemet e shkollës në udhëheqje të proceseve të ndjeshme siç është zbatimi i kurrikulës së re, planifikimi zhvillimor etj.					
66.	Nxori në sipërfaqe rezistencën e stafit të shkollës ndaj ndryshimeve.					

V. Mendimi juaj për perspektiven e zbatimit të vlerësimit të brendshëm në të gjitha shkollat e Kosovës

67. Cilat janë aspektet më të mira në praktikën e shkollës suaj gjatë realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës, që mund të ndahen edhe me shkollat e tjera në Kosovë?

68. Cilat janë aspektet më sfiduese në praktikën e shkollës suaj gjatë realizimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës, ndaj së cilave duhet të kemi kujdes me shkollat tjera në Kosovë?

69. Sipas mendimit tuaj, si do të mund të përmirësohet efikasiteti i punës së udhëheqësve dhe ekipeve shkollore për vlerësim të brendshëm të shkollës?

70. Nëse do të mund të ndryshonit një gjë në procedurat e vlerësimit të brendshëm, që procesi të jetë më efektiv, cila do të ishte ajo?

71. Ndonjë koment apo sugjerim tjetër që do të mund të jetë i dobishëm për qëllimin e këtij studimi:



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY



PYETËSOR

për

PRINDËR

VLERËSIMI I BRENDSHËM I SHKOLLËS

I/e nderuar,

Ju jeni përzgjedhur në mesin e prindërve të shkollës për të marrë pjesë në hulumtimin për praktikën e vlerësimit të brendshëm të shkollës në Kosovë. Të gjitha të dhënat, që do të mblidhen me këtë pyetësor, do të përdoren vetëm për qëllime studimi, qëllimi i të cilit është marrja e qëndrimeve të aktorëve kryesorë të shkollës për praktikën e realizimit të vlerësimit të brendshëm. Përmirësimi dhe avancimi i këtyre praktikave, avancimi i suksesit të shkollës suaj, është synim kryesor i këtij studimi.

Çdo informacion i dhënë në këtë pyetësor do të përdoret vetëm për qëllime hulumtimi dhe për asgjë tjetër. Do të mbetet i besueshëm. Lutemi që pyetësorin e plotësuar ta ktheni në ditën që u shpërndahet për plotësim, te personi i cili e ka shpërndarë këtë pyetësor ose te drejtori i shkollës.

Ju faleminderit për bashkëpunim!

I. TË DHËNAT E SHKOLLËS DHE TË DHËNAT PERSONALE

1.	Komuna:	
2.	Emri i shkollës	
3.	Vendi	
<i>(Ju lutem rrethoni opsionin përkatës)</i>		
4.	Gjinia	1 Femër
		2 Mashkull
5.	Moshë	1 31 – 40 vjeç
		2 41 -50 vjeç
		3 Mbi 50 vjeç
6.	Kualifikimi/shkollimi	1 Shkolla e mesme
		2 Fakulteti
		3 Master/Magjistraturë
		4 Doktoratë
<i>(Ju lutem rrethoni opsionin përkatës. Sipas nevojës rretho më shumë se një përgjigje)</i>		
7.	Roli juaj në shkollë – në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës	1 Kryetar i Këshillit Drejtues të Shkollës
		2 Anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës – përfaqësues i prindërve
		3 Kryetar i prindërve të klasës
		4 Anëtar i Kryesisë së prindërve në nivel klase
		5 Prind i përfshirë vetëm në vlerësimit të brendshëm të shkollës, pa një rol tjetër përfaqësues për prindër të shkollës
8.	Në procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës kam qenë pjesë e:	1 Plotësimi të pyetësorit të përgatitur nga shkolla
		2 Intervistës së realizuar me mua nga ekipi i shkollës
		3 Fokus-grupit të realizuar nga ekipi i shkollës
		4 Tjetër (shëno):
Pyetje për fëmijën tuaj		
9.	Në këtë viti shkollor (2017/2018), në cilën klasë i vijon mësimet fëmija juaj?	1 Klasa 6
		2 Klasa 7
		3 Klasa 8
		4 Klasa 9
		5 Klasa 10
		6 Klasa 11
		7 Klasa 12
10.	Çfarë ishte suksesi i fëmijës tuaj në vitin shkollor 2016/2017?	1 Shkëlqyeshëm
		2 Shumë mirë
		3 Mirë
		4 Mjaftueshëm

II. Praktikrat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës

Fjalitë/deklaratat e mëposhtme kanë ndërlidhje me përfshirjen e prindërve të shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Ju lutem zgjidhni opsionin që e përshkruan më së miri praktikën e shkollës në këtë proces.

Sa jeni të pajtimit ose të mospajtimit lidhur me fjalitë/deklaratat në vijim? (Ju lutem, rrethoni në opsionin përkatës)						
11	Shkolla ka organizuar takime të veçanta me prindër për informim lidhur me vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe rolin e prindërve në këtë proces.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
12	Shkolla ka formuar ekipin e shkollës për vlerësim të brendshëm.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
13	Shkolla ka përfshirë së paku 10 prindër të shkollës në mostrën për mbledhjen e të dhënave për gjendjen e performancës së shkollës.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
14	Shkolla ka përdorur instrumente të ndryshme (si p.sh. pyetësor të anketës, pyetësor të intervistës, pyetësor për diskutim në fokus grupe) për mbledhjen e të dhënave nga prindërit për gjendjen e punës së shkollës.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
15	Shkolla ka informuar prindërit me rezultatet/ gjetjet preliminare nga vlerësimi i brendshëm.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht

PËRVOJAT E PARA NË VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS NË KOSOVË

16	Shkolla ka informuar prindërit me rezultatet përfundimtare të vlerësimit të brendshëm dhe masat që do të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë në shkollë.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
17	Shkolla ka informuar prindërit për Planin Zhvillimor të Shkollës, të rishikuar pas vlerësimit të brendshëm të shkollës.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht

Fjalitë/deklaratat në vijim pasqyrojnë praktikën e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Ju lutem zgjidhni opsionin që e përshkruan më së miri shkollën e kënaqësisë suaj në secilin prej aspekteve në vijim.

Unë jam i/e kënaqur ose i/e pakënaqur me: (Ju lutem, rrethoni në opsionin përkatës)						
18	Praktikat e shkollës për informimin e prindërve lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
19	Informatat dhe udhëzimet e dhëna për hapat e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe rolin e prindërve në këtë proces.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
20	Organizimin e takimeve informative dhe përgatitore të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur

21	Përfshirjen e Këshillit të prindërve të shkollës në organizimin e takimeve informative me prindër për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
22	Përfshirjen e time në aktivitetet përgatitore dhe organizative të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
23	Përfshirjen e time në procesin e ofrimit të të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
24	Instrumentet e përdorura me mua për mbledhjen e të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
25	Objektivitetin dhe paanshmërinë time në ofrimin e të dhënave për gjendjen në nivel shkolle.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
26	Praktikën e shkollës për diskutim me prindër të gjetjeve të vlerësimit të brendshëm.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
27	Përfundimet për shkallën e cilësisë së performancës në fusha të caktuara dhe për gjendjen e përgjithshme në shkollë.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur

PËRVOJAT E PARA NË VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS NË KOSOVË

28	Përcaktimin e masave që do të ndërmerren nga shkolla për përmirësimin e cilësisë në shkollë, me fokus përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
29	Fillimin e ndërmarrjes së masave për përmirësimin e cilësisë në shkollë	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur

30. Komente apo sugjerime që lidhen me rolin e prindërve, përfshirjen dhe përgjithësisht me procesin e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës në shkollën tuaj:



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEKNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY



PYETËSOR

për

NXËNËS

VLERËSIMI I BRENDSHËM I SHKOLLËS

I/e nderuar nxënës/e,

Ju jeni përzgjedhur për të marrë pjesë në hulumtimin për praktikat e vlerësimit të brendshëm të shkollës në Kosovë. Të gjitha të dhënat, që do të mblidhen me këtë pyetësor, do të përdoren vetëm për qëllime studimi, qëllimi i të cilit është marrja e qëndrimeve të nxënësve për praktikat e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës. Përmirësimi dhe avancimi i punës, suksesit dhe jetës suaj në shkollë është synim kryesor i këtij studimi.

Çdo informacion i dhënë në këtë pyetësor do të mbetet vetëm tek ne. Lutemi që pyetësorin e plotësuar ta ktheni në ditën që u shpërndahet për plotësim, te personi i cili e ka shpërndarë këtë pyetësor ose te drejtori i shkollës.

Ju faleminderit për bashkëpunim!

I. TË DHËNAT E SHKOLLËS DHE TË DHËNAT PERSONALE

1.	Komuna	
2.	Emri i shkollës	
3.	Vendi	
(Ju lutem rrethoni opsionin përkatës)		
4.	Gjinia	1 Femër
		2 Mashkull
5.	Klasa në të cilën vijoni mësimet (qarkoni vetëm klasën tuaj)	1 Klasa 6
		2 Klasa 7
		3 Klasa 8
		4 Klasa 9
		5 Klasa 10
		6 Klasa 11
		7 Klasa 12
6.	Suksesi juaj në fund të vitit shkollor 2016/2017	1 Shkëlqyeshëm
		2 Shumë mirë
		3 Mirë
		4 Mjaftueshëm
(Ju lutem rrethoni opsionin përkatës. Sipas nevojës rrethoni më shumë se një përgjigje)		
7.	Roli juaj në shkollë – në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës	1 Kryetar i Këshillit të nxënësve në nivel shkollë
		2 Anëtar i Këshillit të nxënësve në nivel shkolle
		3 Kryetar i klasës
		4 Anëtar i Kryesisë së klasës
		5 Nxënës i përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit të brendshëm të shkollës
8.	Në procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, kam qenë pjesë e:	1 Plotësimi të pyetësorit/eve të përgatitur nga shkolla
		2 Intervistës së realizuar me mua nga ekipi i shkollës
		3 Fokus-grupit të realizuar nga ekipi i shkollës
		4 Tjetër (shëno):

II. Praktikët e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës

Fjalitë/deklaratat e mëposhtme kanë ndërlidhje me përfshirjen e nxënësve të shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Ju lutem zgjidhni opsionin që e përshkruan më së miri praktikën e shkollës në këtë proces.

Sa jeni të pajtimit ose të mospajtimit lidhur me fjalitë/deklaratat në vijim? (Ju lutem, rrethoni në opsionin përkatës)						
9	Shkolla ka organizuar takime të veçanta me nxënës për informim lidhur me vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe rolin e prindërve në këtë proces.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
10	Shkolla ka formuar ekipin e shkollës për vlerësim të brendshëm.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
11	Shkolla ka përfshirë së paku 10 nxënës të shkollës në mostrën për mbledhjen e të dhënave për gjendjen e performancës së shkollës.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
12	Shkolla ka përdorur instrumente të ndryshme (si p.sh. pyetësor të anketës, pyetësor të intervistës, pyetësor për diskutim në fokus grupe) për mbledhjen e të dhënave nga prindërit për gjendjen e punës së shkollës.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
13	Shkolla ka informuar Këshillin e nxënësve të shkollës me rezultatet/ gjetjet preliminare nga vlerësimi i brendshëm.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
14	Shkolla ka informuar Këshillin e nxënësve të shkollës me rezultatet përfundimtare të vlerësimit të brendshëm dhe masat që do të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë në shkollë.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht

PËRVOJAT E PARA NË VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS NË KOSOVË

15	Shkolla ka informuar Këshillin e nxënësve të shkollës me planin zhvillimor të shkollës, të rishikuar pas vlerësimit të brendshëm të shkollës.	1 Fare nuk pajtohem	2 Nuk pajtohem	3 Nuk e di	4 Pajtohem	5 Pajtohem plotësisht
----	---	-------------------------------	--------------------------	----------------------	----------------------	---------------------------------

Fjalitë/deklaratat në vijim pasqyrojnë praktikat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës. Ju lutem zgjidhni opsionin që e përshkruan më së miri shkollën e kënaqësisë suaj në secilin prej aspekteve në vijim.

Unë jam i/e kënaqur ose i/e pakënaqur me: <i>(Ju lutem, rrethoni në opsionin përkatës)</i>						
16	Praktikat e shkollës për informimin e nxënësve lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
17	Informatat dhe udhëzimet e dhëna për hapat e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe rolin e nxënësve në këtë proces.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
18	Organizimin e takimeve informative dhe përgatitore të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
19	Përfshirjen e Këshillit të nxënësve të shkollës në organizimin e takimeve informative me prindër për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
20	Përfshirjen e time në aktivitetet përgatitore dhe organizative të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
21	Përfshirjen e time në procesin e ofrimit të të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur

22	Instrumentet e përdorura me mua për mbledhjen e të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
23	Objektivitetin dhe paanshmërinë time në ofrimin e të dhënave për gjendjen në nivel shkollë – me fokus në procesin mësimor.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
24	Praktikën e shkollës për diskutim me nxënës, të gjetjeve të vlerësimit të brendshëm.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
25	Përfundimet e nxjerra për shkallën e cilësisë së performancës në fusha të caktuara dhe për gjendjen e përgjithshme në shkollë.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
26	Përcaktimin e masave që do të ndërmerren nga shkolla për përmirësimin e cilësisë së shkollës, me fokus në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur
27	Fillimin e ndërmarrjes së masave për përmirësimin e cilësisë në shkollë	1 Plotësisht i/e pakënaqur	2 Nuk jam i/e kënaqur	3 Neutral	4 I kënaqur	5 Plotësisht i/e kënaqur

28. Komente apo sugjerime që lidhen me rolin e nxënësve dhe prindërve, përfshirjen dhe përgjithësisht procesin e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës në shkollën tuaj:

PROTOKOLLI I INTERVISTËS ME: Inspektorë të arsimit (SIA), koordinatorë të cilësisë dhe zyrtarë të arsimit në DKA	
I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME	
I.1. Hapja e intervistës	
Prezantimi i intervistuesit	
Prezantimi i studimit: VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SHKOLLËS	
<p>Qëllimi i studimit: Instituti Pedagogjik i Kosovës është duke bërë një studim gjithëpërfshirës për vlerësimin e performancës së shkollës, qëllimi i të cilit është të bëjë një analizë krahasuese të politikave, procedurave dhe qasjeve ndaj vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë me vendet e BE-së, të vlerësojë praktikën e zbatimit të vlerësimit të brendshëm në shkollat e para të Kosovës të përfshira në programin për vlerësimin e performancës së shkollës, efektet e përvojave të para në zhvillimin e shkollës, si dhe të vlerësojë gatishmërinë institucionale për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës.</p> <p>Përfshirja juaj në këtë studim do të japë ndihmesë në vlerësimin e përvojave të para në vlerësimin e performancës së shkollës, në vlerësimin e efekteve të përvojave të para në zhvillimin e shkollës, si dhe do të ndihmojë në vlerësimin e gatishmërisë institucionale për zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës.</p> <p style="text-align: right;">Ju faleminderit për bashkëpunim!</p>	
I.2. Evidentimi i të dhënave hyrëse për intervistën	
<i>Data e intervistës dhe koha e fillimit të intervistës</i>	
<i>Vendi ku është zhvilluar intervista</i>	
<i>Persona të tjerë të pranishëm gjatë intervistës (PO/JO)</i>	
Forma e realizimit të intervistës (drejtpërdrejt ose përmes e-mailit)	
I.3. Evidentimi i të dhënave të të intervistuarit	
<i>Emri dhe mbiemri</i>	<i>Gjinia M/F</i>
<i>Pozita aktuale (zyrtar arsimor, inspektor i arsimit, udhëheqës në sektorin e arsimit ose SIA)</i>	
<i>Përvoja e punës në këtë pozitë</i>	
<i>Numri i telefonit kontaktues, e-mail adresa</i>	
II. TEMAT DHE PYETJET KRYESORE TË STUDIMIT	
1. Politikat, procedurat dhe praktikat për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë dhe vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore	
1.1. A jeni i/e informuar me gjithë pakon e dokumenteve që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e performancës në institucione arsimore të arsimit parauniversitar në Kosovë? A keni ndonjë koment të veçantë lidhur me këto dokumente?	
1.2. Çfarë informatash keni lidhur me zbatimin në praktikë të pakos së këtyre dokumenteve?	

1.3. Si e vlerësoni në mënyrë specifike përgatitjen e institucioneve arsimore për realizimin e vlerësimit të performancës së shkollës?
2. Përvoja juaj në procesin e vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore
2.1. Çfarë është përvoja e përvoja juaj në vlerësimin e performancës së shkollës? Si jeni përfshirë në këtë proces? Çfarë zhvillimi profesional keni marrë në fushën e vlerësimit të performancës së shkollës?
2.2. Cilat janë mësimet pozitive nga përvoja juaj në vlerësimin e performancës së shkollës, dobësitë e vërejtura dhe cilat janë sfidat me të cilat jeni ballafaquar gjatë kësaj përvoje?
2.3. Cilat janë efektet e para nga procesi i vlerësimit të brendshëm në zhvillimin e shkollës?
2.4. Sipas mendimit tuaj, si do të mund të përmirësohet efikasiteti i punës së udhëheqësve dhe ekipeve të shkollave për vlerësim të brendshëm të shkollës?
3. Planet e institucionit tuaj për procesin e vlerësimit të performancës së shkollës
3.1. Përshkruani shkurtimisht aktivitetet e dy muajve të fundit të realizuara nga institucioni juaj për procesin e vlerësimit të performancës së shkollës:
3.2. Cilat janë planet e institucionit tuaj për vitin 2018, për vlerësimin e performancës së shkollës? <i>(a mund t'i bashkëngjitet kësaj interviste plani i punës së institucionit tuaj për vitin 2018 - vetëm pjesën për vlerësim të performancës së shkollës?).</i>
3.3. Çfarë mbështetje institucionale pritni për realizimin e këtij plani?
3.4 A mund të sfidohet zbatimi këtij plani? Nëse Po, pse? Nëse Jo, cilat janë argumentet kryesore?
4. Perspektiva e zbatimit në praktikë i politikave arsimore për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë
4.1. Si e vlerësoni praktikën aktuale, interesimin, përkushtimin e MASHT-it për zbatimin e politikave arsimore për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë <i>(Strategjisë për Sigurim të cilësisë, UA për koordinatore të cilësisë, UA për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore)?</i>
4.2. Si e vlerësoni praktikën aktuale, interesimin, përkushtimin e DKA-ve për emërimin e koordinatorëve të cilësisë në shkolla?
4.3. Si e vlerësoni praktikën aktuale, interesimin, përkushtimin e DKA-ve për përkrahjen e shkollave në realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe në zbatimin e ciklit për sigurim të cilësisë në shkollë?
4.4. Çfarë rekomandoni apo këshilloni, si duhet t'i qasen institucionet arsimore (niveli qendror dhe lokal) mbështetjes së shkollave për realizimin e procesit të vlerësimit të performancës së shkollës dhe zbatimit të ciklit për sigurim të cilësisë në shkollë?
4.5. A ka ndonjë çështje tjetër që do të donit të ndani me ne, apo ndonjë koment tjetër që do të donit të bëni për procesin e vlerësimit të performancës së shkollës?

Listë kontrolluese për analizën e raporteve të vetëvlerësimit

Komuna:	
Shkolla dhe ID:	

Hapat kryesorë të procesit të VBSH-së	Krijimi i evidencave		Niveli i plotësimit të kërkesave – sipas hapave kryesorë të procesit të VBSH-së ⁷
	Po	Jo	
I. Faza përgatitore			
I.1. Vendimi për themelimin e EVV është marrë			
I.2. Detyra dhe përgjegjësitë e EVV janë përcaktuar në vendim			
I.3. Dispozitat që krijojnë kushte për të përbushur funksionin janë definuar			
I.4. Plani i punës është përgatitur nga EVV			
I.5. Plani i punës përmban aktivitetet kryesore të procesit të vetëvlerësimit, afatet kohore për realizimin e aktiviteteve janë përcaktuar dhe personat përgjegjës për secilin aktivitet janë definuar			
II. Identifikimi i burimeve të të dhënave dhe përzgjedhja e mostrës për VBSH			
II.1. Udhëzimet për identifikimin e burimeve të të dhënave janë respektuar			
II.2. Identifikimi i burimeve të të dhënave – dokumentacionit shkollor, lidhet me treguesit përkatës së performancës së shkollës			
II.3. Kriteret për përzgjedhjen e mostrës së nxënësve janë respektuar			
II.4. Kriteret për përzgjedhjen e mostrës së prindërve janë respektuar			
II.5. Kriteret për përzgjedhjen e mostrës së mësimit janë respektuar			
III. Përzgjedhja dhe përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave			
III.1. Instrumentet e përgatitura janë mbështetur në pyetjet orientuese të dhëna për vlerësim të treguesve të performancës së shkollës			
III.2. Instrumentet e shfrytëzuara janë të mjaftueshme			
III.3. Instrumentet e shfrytëzuara janë përgatitur në mënyrë adekuate			

⁷ Vendoset njëri nga kriteret në vijim: plotësim i plotë i kërkesave, plotësim mesatar, plotësim minimal, nuk janë plotësuar kërkesat, nuk ka dëshmi. Dhe, një koment i përgjithshëm që argumenton vlerësimin për nivelin e përbushjes së kërkesave.

IV. Mbledhja dhe analiza e të dhënave			
IV.1. Të dhënat për VBSH janë mbledhur nga dokumentacioni shkollor, i lidhur me fushat përkatëse të cilësisë			
IV.2. Të dhënat për VBSH janë mbledhur me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të subjekteve të shkollës (nxënës, mësimitdhënës, prindër, menaxhmenti i shkollës)			
IV.3. Të dhënat për VBSH janë mbledhur në mënyrë adekuate			
IV.4. Analiza e të dhënave të mbledhura është bërë në mënyrë adekuate			
IV.5. Analiza e të dhënave të mbledhura është dokumentuar me forma të ndryshme (raporte të veçanta, me paraqitje tabelare, grafike dhe përshkruese)			
V. Përshkrimi i gjendjes për tregues të performancës së shkollës dhe vlerësimi në nivel të kriterëve			
V.1. Përshkrimi i gjendjes në raport me treguesit përmban informacion të mjaftueshëm (së paku përgjigje në të gjitha pyetjet orientuese të dhëna në UVB)			
V.2. Përshkrimi i gjendjes në raport me treguesit është konciz (nuk ka informacion të tepërt dhe të panevojshëm)			
V.3. Përshkrimi i gjendjes në raport me treguesit është i bazuar në fakte			
V.4. Shkalla e cilësisë në nivel të kriterëve reflekton gjendjen e përshkruar në raport me treguesit			
VI. Vlerësimi në nivel të fushave të cilësisë			
VI.1. Shkalla e cilësisë reflekton vlerësimin e bërë në nivel të kriterëve			
VI.2. Përshkrimi i performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë përmban nga një konstatim përmbledhës për secilin kriter			
VI.3. Konstatimet përmbledhëse për kriterë reflektojnë gjendjen e evidentuar në raport me treguesit (për kriterin përkatës)			
VI.4. Përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë janë identifikuar			
VI.5. Evidencat/burimet e shfrytëzuara janë të mjaftueshme dhe relevante			
VI.6. Evidentimi i ndikimit negativ apo pozitiv të faktorëve që janë jashtë kontrollit të institucionit arsimor dhe masat që do të ndërmerren nga shkolla për adresimin e këtyre ndikimeve, janë identifikuar dhe janë relevante			

VII. Vlerësimi i përgjithshëm i performancës së shkollës			
VII.1. Shkalla e cilësisë reflekton vlerësimin e bërë në nivel të fushave të cilësisë			
VII.2. Përshkrimi i performancës së shkollës përmban nga një konstatim përmbledhës për secilën fushë të cilësisë			
VII.3. Konstatimet përmbledhëse për fusha të cilësisë reflektojnë gjendjen e evidentuar për kriteret e cilësisë (në kuadër të fushës përkatëse).			
VII.4. Përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës në nivel të përgjithshëm janë identifikuar			
VII.5. Rekomandimet e ofruara përmbajnë zgjidhjet e mundshme dhe masat e nevojshme për tejkalimin e dobësive dhe/apo përforcimin e anëve të forta			
VIII. Raporti përmbledhës i vetëvlerësimit			
VIII.1. Raporti përmbledhës është përgatitur nga EVV			
VIII.2. Raporti respekton strukturën/përmbajtjen e propozuar me UVB			
VIII.3. Raporti ofron një bazë të mirë për rishikimin e PZSHS dhe për përgatitjen e planit vjetor të veprimit.			

Shtojca C: Tabelat e analizës statistikore për përgatitjen e institucioneve arsimore për realizimin e VBSH-së

Tabela 1. Niveli i pajtueshmërisë lidhur me organizimin e takimeve dhe informimin e stafit të shkollës për dokumentet dhe procedurat e realizimit të VBSH-së

	Informimi për dokumentet e hartuara nga MASHT-i		Organizimi i takimeve të veçanta informative për VBSH		Informimi dhe udhëzimet për procedurat e realizimit të VBSH-së	
	Nr	%	nr	%	Nr	%
Fare nuk pajtohem	6	1,6	4	1,0	6	1,6
Nuk pajtohem	14	3,7	8	2,1	17	4,5
Neutral	42	11,2	26	6,8	39	10,1
Pajtohem	172	45,9	112	29,2	131	33,9
Pajtohem plotësisht	141	37,6	233	60,8	189	49,5
Total	375	100,0	383	100,0	382	100,0

Tabela 2. Të dhëna përshkruese lidhur me informimin e stafit të shkollës për dokumentet dhe procedurat e VBSH-së

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Informimi për dokumentet e VPSH-së të hartuara nga MASHT	375	1	5	4,14	,874
Organizimi i takimeve të veçanta informative për VBSH	383	1	5	4,47	,798
Informimi dhe udhëzimet për procedurat e realizimit të VBSH	382	1	5	4,26	,923
Valid N (listwise)	387				

Tabela 3. Organizimi i takimeve të veçanta informative për VBSH, me mësimdhënës, prindër, nxënës dhe udhëheqës të organeve profesionale e qeverisë së shkollës.

	Nxënësit		Prindërit		Stafi i shkollës	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Fare nuk pajtohem	11	3,7	1	0,8	4	1.0
Nuk pajtohem	20	6,7	4	3,3	8	2.1
Neutral	64	21,4	17	14,2	26	6.8
Pajtohem	130	43,5	39	32,5	112	29.2
Pajtohem plotësisht	73	24,4	55	45,8	233	60.8
Gjithsej	299	100,0	121	100	383	100

Tabela 4. Informimi i stafit të shkollës me detyrat, përgjegjësitë dhe planin e EVV-së

	Informimi për detyrat dhe përgjegjësitë e EVV-së		Informimi për planin e EVV-së	
	Nr	%	Nr	%
5. Pajtohem plotësisht	219	58,1	182	49,1
4. Pajtohem	112	29,7	129	34,8
3. Neutral	34	9,0	36	9,7
2. Nuk pajtohem	5	1,3	18	4,9
1. Fare nuk pajtohem	7	1,9	6	1,6
Përgjigjur gjithsej	377	100	371	100

PËRVOJAT E PARA NË VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS NË KOSOVË

	Jam informuar me detyrat dhe përgjegjësitë e EVV		Jam informuar me kohë me planin e EVV dhe rolin e tyre në procesin e vlerësimit të brendshëm		Unë jam në dijeni se në procesin e vlerësimit të brendshëm janë përfshirë të gjithë përfaqësuesit e aktorëve kryesorë të shkollës.	
	Fare nuk pajtohen/ Nuk pajtohen	Neutral	Fare nuk pajtohen/ Nuk pajtohen	Neutral	Fare nuk pajtohen/ Nuk pajtohen	Neutral
Drejtor i shkollës	1 2,3%	0 ,0%	0 ,0%	2 5,9%	0 ,0%	0 ,0%
Zv.drejtor i shkollës	0 ,0%	0 ,0%	0 ,0%	1 2,9%	0 ,0%	0 ,0%
Shërbimi profesional në shkollë (pedagog/psikolog)	0 ,0%	0 ,0%	1 4,2%	0 ,0%	0 ,0%	2 5,1%
Koordinator i cilësisë në shkollë	0 ,0%	0 ,0%	0 ,0%	1 2,9%	0 ,0%	1 2,6%
Udhëheqës i aktivitetit profesional	15 34,9%	0 ,0%	6 25,0%	10 29,4%	5 29,4%	11 28,2%
Anëtar i EVV	0 ,0%	0 ,0%	4 16,7%	4 11,8%	1 5,9%	12 30,8%
Mësimdhënës i angazhuar në përkrahje të ekipit të shkollës për vlerësim të brendshëm	7 16,3%	0 ,0%	3 12,5%	7 20,6%	2 11,8%	6 15,4%
Mësimdhënës i përfshirë vetëm në mostrën e vlerësimit të brendshëm të shkollës	20 46,5%	0 ,0%	12 50,0%	11 32,4%	10 58,8%	11 28,2%
Total	43	0	24	34	18	43

Percentages and totals are based on respondents.

a. Dichotomy group tabulated at value 1.

Tabela 5. \$Roli*Informimi Crosstabulation

Të dhëna nga stafi i shkollës
1. Faza përgatitore e shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës

Pyetjet	Pajtohem plotësisht		Pajtohem		Neutral		Nuk pajtohem		Fare nuk pajtohem	
13. Jam informuar me të gjitha dokumentet e hartuara nga MASHT për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës	141	37,6	172	45,9	42	11,2	14	3,7	6	1,6
14. Shkolla ka organizuar takime të veçanta informative për VBSH, me mesimdhënës, prindër, nxënës dhe udhëheqës të organeve profesionale e qeverisë të shkollës.	233	60,8	112	29,2	26	6,8	8	2,1	4	1,0
15. Kam marrë informata dhe udhëzime të qarta për procedurat e realizimit të VBSH dhe rolin e aktorëve kryesorë të shkollës në këtë proces	189	49,5	131	33,9	39	10,1	17	4,5	6	1,6
16. Kam qenë pjesëmarrës në takimet informative dhe aktivitetet përgatitore të shkollës për realizimin e VBSH	93	26,6	155	44,3	37	10,6	37	10,6	28	8,0
17. Kam pasur rol në organizimin e takimeve informative dhe aktivitete përgatitore të shkollës për realizimin e VBSH	118	33,1	109	30,6	46	12,9	46	12,9	37	10,4
18. Unë jam në dijeni se shkolla ka formuar ekipin e shkollës për vlerësim të brendshëm, sipas udhëzimit administrativ për vlerësimin e performancës së shkollës.	284	74,7	74	19,5	13	3,4	9	2,4	-	-
19. Jam informuar për detyrat dhe përgjegjësitë e ekipit të shkollës për VBSH	219	58,1	112	29,7	34	9,0	5	1,3	7	1,9
20. Jam informuar me kohë me planin e ekipit për VBSH dhe rolin e tyre në procesin e vlerësimit të brendshëm	182	49,1	129	34,8	36	9,7	18	4,9	6	1,6
21. Jam në dijeni se në procesin e vlerësimit të brendshëm janë përfshirë të gjithë përfaqësuesit e aktorëve kryesorë të shkollës.	208	54,3	116	30,3	41	10,7	12	3,1	6	1,6

Shtojca D: Tabelat e analizës statistikore për praktikat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës

1. Praktikrat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës

Pyetjet	Plotësisht të kënaqur		Të kënaqur		Neutral		Të pa kënaqur		Plotësisht të pa kënaqur	
22. Përkrahjen nga drejtori i shkollës	278	74,3	72	19,3	14	3,7	6	1,6	4	1,1
23. Koordinimin e procesit nga udhëheqësi i ekipit për VBSH	205	53,8	135	35,4	32	8,4	8	2,1	1	0,3
24. Punën e ekipit të VBSH	184	48,7	139	36,8	46	12,2	8	2,1	1	0,3
25. Pjesëmarrjen e aktorëve kryesor të shkollës në procesin e VBSH	146	38,9	157	41,9	61	16,3	9	2,4	2	0,5
26. Procesin e identifikimit të të dhënave të nevojshme	129	35,1	164	44,7	63	17,2	11	0,3	-	-
27. Njoftimin e pjesëmarrësve me kohën dhe formën e përfshirjes në procesin e vetëvlerësimit	194	50,9	135	35,4	47	12,3	4	1,0	1	0,3
28. Përgatitjen e instrumenteve të nevojshme për mbledhjen e të dhënave	184	48,4	127	33,4	57	15,0	11	2,9	-	-
29. Procesin e mbledhjes së të dhënave, saktësinë për të dhënat dhe dëshmitë e mbledhura	137	36,1	165	43,5	65	17,2	10	2,6	2	0,5
30. Objektivitetin dhe paanshmërinë në analizën e të dhënave	179	47,4	131	34,7	61	16,1	5	1,3	2	0,5
31. Praktikën e diskutimit të gjetjeve preliminare me pjesëmarrësit e përfshirë në vlerësim të brendshëm	108	28,7	167	44,4	87	23,1	11	2,9	3	0,8
32. Finalizimin e gjetjeve preliminare në instrumentin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, duke pasqyruar gjendjen për secilin tregues në mënyrë specifike, të matshme, të pranueshme dhe reale për shkollën tonë.	111	29,4	183	48,4	71	18,8	10	2,6	2	0,5
33. Përcaktimin objektiv të shkallës së cilësisë në nivel të kriterëve, në nivel të fushave të cilësisë dhe në nivel të përgjithshëm	142	37,5	172	45,4	53	14,0	12	3,2	-	-
34. Identifikimin e përparësive dhe mangësive të performancës së shkollës	144	38,6	172	46,1	49	13,1	8	2,1	-	-
35. Praktikën e formulimit të rekomandimeve për masat e nevojshme për përmirësim të mangësive dhe avancim të përparësive	113	29,9	180	47,6	69	18,3	13	3,4	3	0,8

Pyetjet	Plotësisht të kënaqur		Të kënaqur		Neutral		Të pa kënaqur		Plotësisht të pa kënaqur	
22. Përkrahjen nga drejtori i shkollës	278	74,3	72	19,3	14	3,7	6	1,6	4	1,1
23. Koordinimin e procesit nga udhëheqësi i ekipit për VBSH	205	53,8	135	35,4	32	8,4	8	2,1	1	0,3
24. Punën e ekipit të VBSH	184	48,7	139	36,8	46	12,2	8	2,1	1	0,3
25. Pjesëmarrjen e aktorëve kryesor të shkollës në procesin e VBSH	146	38,9	157	41,9	61	16,3	9	2,4	2	0,5
26. Procesin e identifikimit të të dhënave të nevojshme	129	35,1	164	44,7	63	17,2	11	0,3	-	-
27. Njoftimin e pjesëmarrësve me kohën dhe formën e përfshirjes në procesin e vetëvlerësimit	194	50,9	135	35,4	47	12,3	4	1,0	1	0,3
28. Përgatitjen e instrumenteve të nevojshme për mbledhjen e të dhënave	184	48,4	127	33,4	57	15,0	11	2,9	-	-
36. Praktikën e informimit të gjithë aktorëve në nivel shkolle për rezultatet e vlerësimit të brendshëm, përfundimet dhe rekomandimet	124	33,2	175	46,8	59	15,8	12	3,2	3	0,8
37. Formimin e ekipit për rishikim/hartim të Planit zhvillimor të shkollës	172	46,5	126	34,1	56	15,1	10	2,7	6	1,6
38. Rishikimin/hartimin e planit zhvillimor të shkollës duke u mbështetur në gjetjet e raportit të VBSH	147	38,8	147	38,8	69	18,2	13	3,4	3	0,8
39. Hartimin e planit vjetor të punës/planit të përmirësimit të shkollës, në ndërlidhje me PZSHSH-në e rishikuar	168	44,2	139	36,6	56	14,7	15	3,9	2	0,5
40. Fillimin e zbatimit të aktiviteteve prioritare për përmirësimin e cilësisë në shkollë	145	38,2	175	46,1	44	11,6	14	3,7	2	0,5

Të dhëna nga prindërit

2. Përfshirja e prindërve të shkollës realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës

Pyetjet	Pajtohem plotësisht		Pajtohem		Neutral		Nuk pajtohem		Fare nuk pajtohem	
11. Shkolla ka organizuar takime të veçanta me prindër për informim lidhur me vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe rolin e prindërve në këtë proces.	55	47,4	39	33,6	17	14,7	4	3,4	1	,9
12. Shkolla ka formuar ekipin e shkollës për vlerësim të brendshëm.	60	52,2	36	31,3	19	16,5	-	-	-	-
13. Shkolla ka përfshirë së paku 10 prindër të shkollës në mostrën për mbledhjen e të dhënave për gjendjen e performancës së shkollës.	44	38,9	38	33,6	29	25,7	2	1,7	-	-
14. Shkolla ka përdorur instrumente të ndryshme (si p.sh. pyetësor të anketës, pyetësor të intervistës, pyetësor për diskutim në fokus grupe) për mbledhjen e të dhënave nga prindërit për gjendjen e punës së shkollës.	50	43,1	39	33,6	22	19,0	4	3,4	1	,9
15. Shkolla ka informuar prindërit me rezultatet/ gjetjet preliminare nga vlerësimi i brendshëm	37	30,6	44	38,9	18	15,9	6	5,3	8	7,1
16. Shkolla ka informuar prindërit me rezultatet përfundimtare të vlerësimit të brendshëm dhe masat që do të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë në shkollë	45	40,2	38	33,9	16	14,3	5	4,1	8	7,1
17. Shkolla ka informuar prindërit me planin zhvillimor të shkollës, të rishikuar pas vlerësimit të brendshëm të shkollës	47	42,0	38	33,9	16	14,3	7	6,2	4	3,6

3. Praktikrat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës

Pyetjet	Plotësisht të kënaqur		Të kënaqur		Neutral		Të pa kënaqur		Plotësisht të pa kënaqur	
18. Praktikrat e shkollës për informimin e prindërve lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	40	35,1	46	40,4	21	18,4	6	5,3	1	,9
19. Informatat dhe udhëzimet e dhëna për hapat e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe rolin e prindërve në këtë proces.	41	36,3	44	38,9	19	16,8	8	7,1	1	,9
20. Organizimin e takimeve informative dhe përgatitore të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	38	33,6	44	38,9	23	20,4	7	6,2	1	,9
21. Përfshirjen e Këshillit të prindërve të shkollës në organizimin e takimeve informative me prindër për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	44	38,3	42	36,5	20	17,4	8	7,0	1	,9
22. Përfshirjen e time në aktivitetet përgatitore dhe organizative të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	38	33,0	46	40,0	16	13,9	10	8,7	5	4,3
23. Përfshirjen e time në procesin e ofrimit të të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	30	25,4	50	42,4	23	19,5	12	10,2	3	2,5
24. Instrumentet e përdorura me mua për mbledhjen e të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	30	26,1	45	39,1	30	26,1	7	6,1	3	2,6
25. Objektivitetin dhe paanshmërinë e time në ofrimin e të dhënave për gjendjen në nivel shkollë.	41	35,3	50	43,1	18	15,5	4	3,4	3	2,6
26. Praktikën e shkollës për diskutim me prindër të gjetjeve të vlerësimit të brendshëm.	44	37,9	36	31,0	22	19,0	12	10,3	2	1,7
27. Përfundimet për shkallën e cilësisë së performancës në fusha të caktuara dhe për gjendjen e përgjithshme në shkollë.	22	19,1	65	56,5	17	14,8	10	8,7	1	,9
28. Përcaktimin e masave që do të ndërmerren nga shkolla për përmirësimin e cilësisë në shkollë, me fokus përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.	41	34,7	59	50,0	8	6,8	10	8,5	-	-

PËRVOJAT E PARA NË VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS NË KOSOVË

Pyetjet	Plotësisht të kënaqur		Të kënaqur		Neutral		Të pa kënaqur		Plotësisht të pa kënaqur	
18. Praktikrat e shkollës për informimin e prindërve lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	40	35,1	46	40,4	21	18,4	6	5,3	1	,9
19. Informatat dhe udhëzimet e dhëna për hapat e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe rolin e prindërve në këtë proces.	41	36,3	44	38,9	19	16,8	8	7,1	1	,9
20. Organizimin e takimeve informative dhe përgatitore të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	38	33,6	44	38,9	23	20,4	7	6,2	1	,9
21. Përfshirjen e Këshillit të prindërve të shkollës në organizimin e takimeve informative me prindër për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	44	38,3	42	36,5	20	17,4	8	7,0	1	,9
22. Përfshirjen e time në aktivitetet përgatitore dhe organizative të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	38	33,0	46	40,0	16	13,9	10	8,7	5	4,3
23. Përfshirjen e time në procesin e ofrimit të të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	30	25,4	50	42,4	23	19,5	12	10,2	3	2,5
29. Fillimin e ndërmarrjes së masave për përmirësimin e cilësisë në shkollë.	42	36,2	50	43,1	17	14,7	5	4,3	2	1,7

Të dhëna nga nxënësit
4. Përfshirja e nxënësve të shkollës realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës

Pyetjet	Pajtohem plotësisht		Pajtohem		Neutral		Nuk pajtohem		Fare nuk pajtohem	
9. Shkolla ka organizuar takime të veçanta me nxënës për informim lidhur me vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe rolin e prindërve në këtë proces.	73	24,5	130	43,6	64	21,5	20	6,7	11	3,7
10. Shkolla ka formuar ekipin e shkollës për vlerësim të brendshëm.	98	33,2	112	38,0	57	19,3	18	6,1	10	3,4
11. Shkolla ka përfshirë së paku 10 nxënës të shkollës në mostrën për mbledhjen e të dhënave për gjendjen e performancës së shkollës.	83	27,9	119	40,1	69	23,2	17	5,7	9	3,0
12. Shkolla ka përdorur instrumente të ndryshme (si p.sh. pyetësor të anketës, pyetësor të intervistës, pyetësor për diskutim në fokus grupe) për mbledhjen e të dhënave nga prindërit për gjendjen e punës së shkollës.	107	35,9	104	34,9	49	16,4	32	10,7	6	2,0
13. Shkolla ka informuar Këshillin e nxënësve të shkollës me rezultatet/ gjetjet preliminare nga vlerësimi i brendshëm.	60	20,3	112	37,8	86	29,1	29	9,8	9	3,0
14. Shkolla ka informuar Këshillin e nxënësve të shkollës me rezultatet përfundimtare të vlerësimit të brendshëm dhe masat që do të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë në shkollë	93	31,2	107	35,9	68	22,8	19	6,4	11	3,7
15. Shkolla ka informuar Këshillin e nxënësve të shkollës me planin zhvillimor të shkollës, të rishikuar pas vlerësimit të brendshëm të shkollës.	61	20,4	106	35,5	101	33,8	20	6,7	10	3,3

5. Praktikrat e shkollës në realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës

Pyetjet	Plotësisht të kënaqur		Të kënaqur		Neutral		Të pa kënaqur		Plotësisht të pa kënaqur	
16. Praktikrat e shkollës për informimin e nxënësve lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës..	56	18,7	128	42,8	77	25,8	29	9,7	7	2,3
17. Informatat dhe udhëzimet e dhëna për hapat e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe rolin e nxënësve në këtë proces..	79	26,4	115	38,5	73	24,4	22	7,4	9	3,0
18. Organizimin e takimeve informative dhe përgatitore të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	75	25,1	105	35,1	83	27,8	30	10,0	6	2,0
19. Përfshirjen e Këshillit të nxënësve të shkollës në organizimin e takimeve informative me prindër për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	95	31,8	94	31,4	60	20,1	40	13,4	10	3,3
20. Përfshirjen e time në aktivitetet përgatitore dhe organizative të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	79	26,5	130	43,6	51	17,1	27	9,1	10	3,4
21. Përfshirjen e time në procesin e ofrimit të të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	70	23,6	118	39,9	67	22,6	29	9,8	11	3,7
22. Instrumentet e përdorura me mua për mbledhjen e të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	64	21,6	108	36,5	86	29,1	33	11,1	4	1,4
23. Objektivitetin dhe paanshmërinë e time në ofrimin e të dhënave për gjendjen në nivel shkollë – me fokus në procesin mësimor.	68	23,3	118	40,4	86	29,5	17	5,8	2	,7
24. Praktikën e shkollës për diskutim me nxënës të gjetjeve të vlerësimit të brendshëm.	85	28,8	113	38,3	58	19,7	33	11,2	6	2,0
25. Përfundimet për shkallën e cilësisë së performancës në fusha të caktuara dhe për gjendjen e përgjithshme në shkollë.	68	23,1	109	37,1	71	24,1	37	12,6	9	3,1
26. Përcaktimin e masave që do të ndërmerren nga shkolla për përmirësimin e cilësisë në shkollë, me fokus përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.	106	35,8	106	35,8	45	15,2	35	11,8	4	1,4

Pyetjet	Plotësisht të kënaqur		Të kënaqur		Neutral		Të pa kënaqur		Plotësisht të pa kënaqur	
16. Praktikrat e shkollës për informimin e nxënësve lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës..	56	18,7	128	42,8	77	25,8	29	9,7	7	2,3
17. Informatat dhe udhëzimet e dhëna për hapat e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës dhe rolin e nxënësve në këtë proces..	79	26,4	115	38,5	73	24,4	22	7,4	9	3,0
18. Organizimin e takimeve informative dhe përgatitore të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	75	25,1	105	35,1	83	27,8	30	10,0	6	2,0
19. Përfshirjen e Këshillit të nxënësve të shkollës në organizimin e takimeve informative me prindër për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.	95	31,8	94	31,4	60	20,1	40	13,4	10	3,3
20. Përfshirjen e time në aktivitetet përgatitore dhe organizative të shkollës për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës.	79	26,5	130	43,6	51	17,1	27	9,1	10	3,4
21. Përfshirjen e time në procesin e ofrimit të të dhënave lidhur me gjendjen e performancës së shkollës në fusha të caktuara.	70	23,6	118	39,9	67	22,6	29	9,8	11	3,7
27. Fillimin e ndërmarrjes së masave për përmirësimin e cilësisë në shkollë.	139	46,8	97	32,7	34	11,4	19	6,4	8	2,7

Shtojca E: Tabelat e analizës statistikore për materialet, trajnimin dhe format tjera të mbështetjes në realizimin e procesit të VBSH-së

Tabela 1. Materialet, trajnimi dhe mbështetja nga DKA-të në realizimin e procesit të VBSH-së

<i>Kërkesat e pyetësorit</i>	<i>%</i>					<i>Nr.</i>	<i>%</i>
	<i>5</i>	<i>4</i>	<i>3</i>	<i>2</i>	<i>1</i>		
41. Kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës të përcaktuara me kornizë, kanë pritshmëri të qarta për shkollën se ku duhet të fokusohet në VBSH.	38,7	53,4	7,9	0	0	191	92,3
42. Udhëzuesi për vlerësim të brendshëm është specifik dhe ofron informacion të mjaftueshëm për realizimin e procesit të VBSH.	44,3	50,0	4,7	1,0	0,0	192	92,8
43. Shtojcat e instrumenteve të bashkangjitura në udhëzuesin për VBSH, kanë lehtësuar punën e ekipit të shkollës.	52,6	41,6	5,8	0,0	0,0	190	91,8
44. Trajnimi për vlerësim të brendshëm të shkollës ka ofruar informacion të mjaftueshëm për hapat, procedurat dhe praktikat që duhet ndjekur në realizimin e procesit të VBSH.	36,5	46,4	15,5	1,7	2,2	181	87,4
45. Përfaqësuesit e shkollës të trajnuar për vlerësim të brendshëm të shkollës kanë ofruar informacion të mjaftueshëm për ekipin e shkollës për vetëvlerësim lidhur me hapat, procedurat dhe praktikat që duhet ndjekur në realizimin e procesit të VBSH.	49,5	43,8	4,7	1,6	0,5	192	92,8
46. Informacionet kthyes nga trajnerët lidhur me përgatitjet e shkollës, instrumentet dhe raportin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, kanë qartësuar punën e ekipit të shkollës, ka orientuar nevojat për plotësim/ndryshim në vetëvlerësimin e radhës që do të organizohet nga shkolla.	38,4	48,9	9,5	2,6	0,5	190	91,8
47. Punëtoritë përcjellëse të mbajtura lidhur me raportin e vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe përdorimin e gjetjeve nga vlerësimi i brendshëm në procesin e përmirësimit të shkollës, kanë qartësuar mënyrën e shfrytëzimit të gjetjeve dhe rekomandimeve nga raporti i vlerësimit në planifikim shkollor dhe në marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm.	33,5	52,7	10,1	2,7	1,1	188	90,8
48. Mbështetja e ofruar nga DKA – koordinatori i cilësisë, ka ndihmuar shkollën në realizimin e procesit të VBSH.	30,7	36	10,6	11,1	11,6	189	91,3
49. Mbështetja financiare e ofruar nga DKA, ka ndihmuar shkollën në priorizimin dhe ndërmarrjen e masave për përmirësim të performancës në kriteret/ ushat e cilësisë që vlerësimet kanë dalë jo mirë.	0	12,2	39,6	26,6	21,6	139	67,1

a. Dichotomy group tabulated at value 1. N=207

Tabela 2. Trajnimi për programet që ndërlidhen me VBSH

Pozita në procesin e VBSH	Përfshirja vetëm në njërin prej trajnimeve			Përfshirja në dy e më shumë trajnime			
	Udhëheqje dhe menaxhim të shkollës (UA)	Sigurim të cilësisë në shkollë (SC)	Vlerësim i brendshëm i performancës së shkollës (VBSH)	UA dhe SC	UA, SC dhe VBSH	SC dhe VBSH	UA dhe VBSH
Drejtor i shkollës	88,9	77,8	72,2	5,6	2,8	63,9	0,0
Zv.drejtor i shkollës	87,5	25,0	62,5	0,0	0,0	12,5	0,0
Koordinator i cilësisë në shkollë	26,3	65,8	86,8	7,9	0,0	28,9	2,6
Anëtar i ekipit të shkollës për vetëvlerësim	23,2	19,2	26,4	55,2	0,0	8,0	0,0
Gjithsej	78	79	97				
%	30,7	31,1	38,2				

Tabela 3. Ndikimi i procesit të VBSH-së në motivimin e stafit për bashkëpunim dhe kontribut të shtuar në proceset e brendshme në shkollë.

<i>Kërkesat e pyetësorit</i>	%					Nr.	%
	5	4	3	2	1		
50. Mua më ka nxitur për të bërë punë shtesë për shkollën time me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së shkollës.	49,9	40,4	6,3	2,6	0,8	381	98,4
51. Mua më ka përgatitur për të punuar me ekipin e vetëvlerësimit për të realizuar të gjitha fazat e këtij procesi.	43,2	39,2	12,4	3,2	1,9	370	95,6
52. Mua më ka krijuar një ndjenjë më të fortë për të qenë pjesë e ekipit të shkollës për përmirësim të vazhdueshëm të performancës së shkollës	48,1	36,8	10,3	4,0	0,8	378	97,7
53. Mua më ka bërë të besoj se shkolla ime çdo vit do ta realizojë me sukses VBSH	50,0	25,9	18,9	4,3	0,9	381	98,4
54. Mua më ka motivuar për të qenë më i përkushtuar ndaj procesit të mësimdhënies dhe nxënies	59,4	34,0	5,3	1,1	0,3	379	97,9
55. Mobilizoi të gjithë aktorët e shkollës në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për përmirësimin e cilësisë.	43,0	44,3	10,6	2,1	0,0	377	97,4
56. Nxiti diskutime në shkollë rreth cilësisë së performancës në shkollë.	53,5	37,6	7,5	0,8	0,5	372	96,1
57. Rezultoi me motivim shtesë të gjithë mësimdhënësve për tu angazhuar në aktivitete që sigurojnë cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies për të gjithë nxënësit.	39,2	48,4	10,3	2,1	0,0	378	97,7
58. Rezultoi me veprime konkrete nga udhëheqja e shkollës për përmirësim të vazhdueshëm të shkollës.	46,1	45,0	7,5	0,5	0,8	373	96,4
59. Nxiti organet qeverisëse në shkollë (KDSH, KP dhe KN) të organizojnë konsultime më të shpeshta për SC.	37,5	44,5	14,0	3,5	0,5	371	95,9
60. Nxiti bashkëpunim më të madh në mes të vet mësimdhënësve.	51,1	41,6	5,7	1,4	0,3	368	95,1
61. Nxiti organet profesionale në shkollë të organizojnë konsultime më të shpeshta për procesin mësimor	44,7	44,7	8,3	2,1	0,3	374	96,6
62. Rezultoi me monitorim më të shpeshtë të punës së mësimdhënësve nga udhëheqja e shkollës	38,9	47,7	9,9	2,9	0,5	375	96,9
63. Nxiti përkushtimin më të madh të shkollës ndaj zhvillimit profesional të mësimdhënësve	44,5	44,0	9,1	2,4	0,0	373	96,4
64. Nxori në sipërfaqe pakënaqësitë e stafit të shkollës me mënyrën e organizimit të punës në shkollë	26,9	44,8	17,9	7,3	3,0	368	95,1
65. Nxori në pah problemet e shkollës në udhëheqje të proceseve të ndjeshme siç është zbatimi i kurrikulës së re, planifikimi zhvillimor, etj.	36,5	43,2	11,8	6,4	2,1	373	96,4
66. Nxori në sipërfaqe rezistencën e stafit të shkollës ndaj ndryshimeve.	30,4	37,5	18,5	8,2	5,4	368	95,1

a. Dichotomy group tabulated at value 1. N=387

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.014.3(496.51)

Përvojat e para në vlerësimin e performancës së shkollës në Kosovë / Selim Mehmeti... [et al.]. – Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2018. – 210 f. ; 21 cm.

1.Mehmeti, Selim 2. Boshtrakaj, Lindita 3. Bytyqi, Lirije
4.Zylfiu, Haxhere 5. Potera, Ismet

ISBN 978-9951-591-43-0

ISBN 978-9951-591-43-0



9 789951 591430

Përkrahur nga UNICEF, Zyra në Kosovë